KRISTO FLOQI
Doktor në Drejtësi

ALBUM ME POEZI

"Shkëndija" (Antologji shkollore)
"Tingëllimet e zembrës"
Poezi të Kristo Floqit
të mbledhura andej-këndej.

Mblodhi e përgatiti për botim
Henrik Kaçulini

Botimet Jozef, 2026

ALBUM ME POEZI

"Shkëndija" (Antologji shkollore)
"Tingëllimet e zembrës"
Poezi të mbledhura andej-këndej.

Nga KRISTO FLOQI

Mblodhi e përgatiti për botim
Henrik Kaçulini

Botimet Jozef, 2026

ISBN – 978-9928-942-17-3

© - Henrik Kaçulini

NË VEND TË HYRJES

Requiem aeternam
dona eis, Domine[1]

I nderuar lexues!

Po e filloj këtë album vjershash të poetit kombëtar shqiptar, Kristo Floqi, me tre vjersha të shkruara prej tij në kujtim të 4 fëmijëve të tij të vdekur në moshë të njomë, Teftës, Shpresës, Dritës, dhe djalit të tij (që nuk ia di emrin), si dhe të nënës së tij, Angjelina Mitko, që ai e quan "Shpatore". Dy vjershat për fëmijët e tij të vdekur i kam përmbledhur nën titullin "Zemër Babe". Unë besoj se shpirti i Kristo Floqit prehet në Parajsë, përpara dritës së fytyrës së Zotit, së bashku me gruan e tij, Uranija, dhe fëmijët e tij.

Ky album ka tre pjesë. Pjesa e parë ka vjersha të Kristo Floqit që ndodhen në librin e botuar prej tij, "SHKËNDIJA", libri i dytë ka vjersha që ndodhen në librin "TINGËLLIMET E ZEMBRËS", pjesa e tretë ka vjersha të shkruara nga Kristo Floqi e të mbledhura andej-këndej prej meje.

[1] Jepu o Zot pushimin e pasosun.

Kristo Floqi shkruan se libri shkollor "SHKËNDIJA" është në dy volume dhe ka gjithsej 600 tituj vjershash, por unë nuk e kam gjetur volumin e dytë të këtij libri.

HENRIK KAÇULINI

S'IME BIJE, TEFTËS[2]

(Vdiq në Salt-Lake City t'Amerikës më 20 Oktobrit 1910)

Moj dallëndyshe,
Teftë moj bijë,
Prit pak të të nis,
Moj sý larushe
Moj dudîë,[3]
Qëndro të të stolis,
Të t'kreh leshkat e t'ua,
Të shndritshme, po si âr,
O Ëngjell, o pallûa,
Pastaj të shkosh në varr.

Moj faqe-kuqe,
Që s'pushonje,
Si zogë, si bilbil,
Ah, moj burbuqe,
Qysh fjalonje,
O Teft' o trandafil!
A munden të harrohen
Moj lul' ajy kuvënt
Dhe fjalët mos kujtohen,
I ëmbli zëthi tënt?

[2] Kjo poezi ndodhet në AQSH F.429-3-242 me shkrim dore.
[3] dudië = Vajzë a grua shumë e bukur dhe tërheqëse.

I shkret'i mjerë
Të çaj dete
Të vinj n'Ameriqië
Në vent të gjerrë
Në ca stepe
Der në Kallifornië
Edhè pa çlodhur mirë,
Befas e më një ças,
Prej fruthit të pështirë
O Teftë të t'humbas!

Mbi hidhërimet
Të pa-anë,
Ti që një ngushëllim
Dhe në trishtimet
Kur që pranë,
Ti ishe përdëllim!
Me nënëqeshjen t'ënde,
Harronja ç'do mjerim,
Dhe me ato kuvënde
M'a zbutnje shpirtin t'im!

Sôt po të ndahem,
Tefta ime,
Ah, më s'të shohim mê,
Lottët s'na mbahen
Zemrat thime[4]
Jot'ëmë qân me zê!
O Sumbull[5], o zëmbake,
Hap krahët flutro,
O Teft', o fluturake,
Iq në Parajsë shko!!!

[4] thime = të thyera
[5] Sumbull = Syth i bimës, që çel gjethe; bulë.

S'IME BIJE SHPRESËS[6]

(Vdiq në Vlorë, 18 Oktober 1914)

Edhè ti, o bij', o Shpresë
Si një lulezë me vesë,
Bij' e vogël e e mitur,
Në pekûle tepër ritur
Merr dhuratë një kurorë

Në Parajs'atje ku shkon,
Edhè hap krahët e lehtë
E flutrò në Qjej përpjetë
Shko, avritu atjè pranë,
Ku kè motrën e vëllanë
Dhe të trè si Engjellorë

Prehi, losni për gjithmonë.
Nè, sado vetëm na latë,
Si t'ët ëmë, si t'ët atë,
Sa do q' iktë e u ndatë
Paçi bekim e uratë,
Kurrë, kurrë s'u harrojmë.

[6] Poezia ndodhet në AQSH F. 429-3-244 me shkrim dore.

Mendja, shpirti me ju tok,
Sa fatbardh' o bijë jini
Atjè tok të trè ku rrijni,
Dhe sa keq nè po n'a lini
Po s'e shihni, ah, s'e dini!

Eh! Durim! .... Kështu do rrojmë
Shpres'o lule, bozilok!

SHPIRTIT S'IM' ËJE

(botuar te Kalendari "Korça", 1913, f. 185-187)

Në mes të kopshtit mbushur me lule,
Me manushaqe e me burbuqe,
Ish një shpatore[7] e bardh' e kuqe,
Rritur me lajka e me pekule.

Një djal' i mitur vinte për hera,
Në kopshn' e bukur dhe e vaditte,
Era e shpatës i përsëritte,
Shpirtin e tija sikur çel vera.

Kur zbardhëllohej e lindte drita,
Dhe lulet ishin mbushur me vesë,
Djali lëshohej edhe plot shpresë,
Vij ne shpatorja t'i thom "mir dita".

Shpator' e bardhë, e but' e qetë,
Ndjente gas shumë kur i vij pranë,
Gëzim i tyre nuk kishte anë,
Se qenë dashur me të vertetë.

[7]shpatore = Familje bimësh barishtore shumëvjeçare si shpatorja, shpatëza etj. që i kanë gjethet si shpatë dhe lulet të mëdha, të bukura e zakonisht të mbledhura në vastakë, në kallinj a në vile. Në këtë poezi "djali" është vetë autori Kristo Floqi dhe "shpatore" është e ëma e tij, Angjelina.

Ishin të lumur shkonin mirë,
Njëri për jatrin jetënë linin,
Tok kuvendonin, tok, hanin, pinin,
Tok rrinin, flinin, plot me dëshirë.

Se qysh ra puna që djal' i gjorë,
U ndah prej shpatës e u largua,
Në dhé të huaj keq u mërgua,
E la të vetëm edhe pa dorë

Shpator' e varfër s'duronte mallë,
Që kish në zembër për bir' e dashur,
Ish e vrerosur edhe shpirt plasur,
Dhe e mejtuar! Do t'a shij[8] vallë?

Djali për hera i ipte shpresën,
I thosh që pritmë, o shpata ime,
Se do vinj prapë, s'të le jetime,
Të dhashë fjalën me "besa-besën".

Po shpat' e gjorë zuri po thahej,
Fletët i binin si koqe thrime,
Ju zhurit zembra në psherëtime,
E zu venitej s'qëndronte, s'mbahej.

Po kur një ditë të Vjeshtës dytë,
Një re e zez del n' Hapësirë,
Një tufan fryri keq i vështirë,
Shpatores gjorë i mbylli sytë.

[8] shij = shihte

Ju përzhit palca, fletët i ranë,
I iku era që kundërmonte,
Ju thanë rrënjët, râ, më s'qendronte,
I dolli shpirti! .... Pa djalën pranë?!

O! Det i pa anë, Det'i rëpirë,
Fuqi! Naturë. Gjithësi, Jetë!
Që ngjall Remetnë[9] pa gjë të metë,
Si për një lule s'pate mëshirë?

O lul' e bukur o shpata ime,
Q' keq të desha, keq të pëlqenja,
Që pranë teje bridhnja, dëfrenja,
Pse sot m' bëre zemrenë thrime?

Ti vërtet ike nga kopsht'i vlerë,
Dhe flytyrove me lehtësirë,
Po s't'arthi keq, s't'arthi mëshirë,
Për bir' e dashur q'e le të mjerë!

Me helm në zembër qanj dit' e natë
E s'ngushëllohet, s'gjen prejtje kurrë
Rri i përzishmë e i sëmurë
S'i pushon shpirti për ty, o shpatë!!!

Salt Lake City, 28 Novembr, 1909.

[9] remet = grumbull njerëzish

KRISTO FLOQI

Se shekulli që jemi sot është për dritë bërë,
Pa msim e pa qytetëri janë të kota tërë.

Naim Frashëri

SHKËNDIJA

Ose

ANTOLOGJÍ SHKOLLARE
(Këngë, vjersha e dijalogë shkollorë)

Për rendet III, IV, V e VI të shkollave fillore
Me autorizimin e Ministrisë së Arësimit
Nr. 1399/1 me datë 21-IX-1923

V L O R Ë
Shtypshkronja "Vlora"
G. DIRETTORE
1923

MINISTRÍ E ARSIMIT

Nr. 1399

OBJEKT

Pranimi i një dorëshkrimi

Z. KRISTO FLOQI
T I R A N Ë

Libri juaj i paraqitur në këtë Ministrì, me titullin SHKËNDIJA ose ANTHOLOGJÍ SHKOLLARE, u këndue dhe u studijue prej komisjonit teknik dhe u da i arësye-shëm pranimi i tij ndër shkollat e Shtetit për këndim e recitacjon.

Me vendimin t'onë, Nr. 34 e me datë 21-VIII-923, ju lajmërojmë se kemi lânë të lirë t'a shtypni këtë libër për llogarinë e juej e me shpenzimet e jueja, por me kushtin që çmimi i eksemplarëve mbas të cilit këta do të shiten, do të caktohet prej kësaj Ministrije.

MINISTRI
(d.v.) **R. Mitrovica**

Tiranë 21-IX-1923

MINISTRÍ E ARSIMIT

N.1399â1

Qarkore

Inspektorive t'arsimit e
drejtorive të shkollave plotore.

Tue vrejtë mungesën e madhe që kanë shkollat e jona për vjersha e dhialoge shkollare që vyejnë zhvillimin e mendjes së nxansavet mbi ç'do pikpamje mësimi, si b.f. mbi detyrat kundrejt Zotit, prindve, mësuesve e njerzis, mbi kuptimin e Atdheut e të patriotizmit, mbi moral, mbi diturit natyrore etj. e mbassi vepra me titullin "Shkëndija" ose Antologji shkollare" (përmbledhje kangësh, vjershash e dhialogësh) e shkrimtarit të njohtun e vjershtorit kombtar Z. *Kristo Floqit*, e paraqitun kësaj Ministrije, i përgjigjet plotësisht kësaj mungese e me vendim Nr.34 me 21 Gusht 1923 të Këshillit qendruer të kësaj Ministrije, u pëlqye dhe u pranua si një *libër këndimi e recitacjoni shkolluér* për shkollat e Shtetit e sidomos për rendet III, IV, V e VI të shkollave fillore.

Prandej, porositeni t'a veni në zbatim *detyrimisht* në rendet e naltë përmenduna, tue u caktuem mësuesavet

pjesët që kanë m'u msuem nxanësavet si mbas moshës, fuqis e mentalitetit të tyne.

Çmimi i librit do të caktohet në marrveshje me aukto-rin e do të ju lajmohet.

MINISTRI
R. MITROVICA

Këndonjësve

Tyke parë mungesën e madhe që kanë shkollat t'ona fillore për vjersha e dialogë shkollorë edhé nga ana tjetër i ngutur edhé prej shumë miqve e mê fort profesorëve e msuësve të tjerë, trajtova këtë libër, i cili sot po sheh dritën.

Disa prej vjershave e dialogëve janë marrë prej vjershëtorit frênk, të pavdekurit Lafontaine *– i cili prapë është hojtur prej filosofit grek Aisop – të tjerat janë origjinale.*

Është zakon që vjershat e shkollave të rreshtohen si pasoja pas disa msimeve, të trajtuara në prozë, po këjo vepër u trajtua për së shpejti për plotësim të një mungese të dukur, prandaj s'u gjent koha që të mbahej zakoni.

Shpresonj se do t'i shërbenjë mjaft masës së ré s'onës si në pikpamje pedagogjike, ashtu edhé në pikpamje psykologjije e morali.[10]

KRISTO FLOQI

[10] Shif faqen e fundit "Shqyptarët ose një bisedim midis një Shqipëtari e një Maxhari".

Flamuri që u ngrit më Vlorë më 28 Nëndor 1912 hartuar nga Marigo Pozio. Stampa u gdhend nga Dom Mark Vassa.

Flamûri jonë

(Botuar edhe në gazetën "Perlindja e Shqipëniës"
Vjesht e III Nr. 26 f. 9)

Flamûr! Ti që me shkabën po valon,
E ndehesh palë-palë i lavdruar,
O trashëgim i prindve pa harruar,
Vallë ç'po ëndëron?

Sot po flakron i mburur në Shqypní,
Dhe ëndra e pa pritur po n' a çfaqet,
Gëzohen gjithë fiset e bajraqet
Që ndrit me një madhnì!

Të shoh flamûr i kuq i Skënderbeut,
Të meriton dafinë e kurorë,
Burra sa sa për ty ranë dëshmorë
Për nderin e Atdheut!

Tmer i armikut, të njoh cili jé,
Kreshnik, krenar, si kundër të tregojnë,
Që hon' e gërxhe edhé sot dëshmojnë
Kush ishe ti për né!

Flamûr i shêjtë për né ti mos msho,
Se sa të mundim ty do t' të nderojmë,
Qollë s'të lemë, jo, s'të turpërojmë
As pakë mos dysho.

Shko njatë Leshit[11], ndehu e qendro
Xgjoje nga gjum' i rënd' e i paprerë,
Âtën e kombit Skënderben' e ndjerë,
Me shpres'e qetso.

Atjé, te varr' i shêjtë ku do vesh,
I thuaj se Shqiptarët nuk harrojnë,
Gjyshët e prindët nuku i mohojnë,
O! Lark kjo qoftë nesh.

Qofsh i bekuar edhé lâ e mê lâ
Flamûr, për né ti mos kurseh bekimet
Për të mbaruar ca më shpejt qellimet
E ëndrat e mbëdha!

[11] njatë Leshit = përgjatë qytetit të Lezhës

Indipendenca jonë

Qiell i bukur i Lirisë
Qielli kalltërt i Arbrisë
Dhe ti Diell' i Shqipërisë
Çel e shkrepëtij,

Çel, o ditë e shënuar,
Dit' e bardh' e shëntëruar
Dhe nga Zoti e bekuar
Ndrit e vetëtij,
Ndrit, o ndrit, agoj Lirija
Ndrit, se sot u ngjall Shqiprija!

O flamûr i lavdëruar,
Shënj' e vlefshme e uruar,
O kujtim i ëndëruar,
Hapu sot, valo,

Kodra, maja, fusha, male,
Bjeshka, prozhme[12] e moçale
Det, liqena, bregje, zalle
Tej e tej mbulo,
Mburru sot q'agoj **Lirija**
Mburru, se shpëtoj **Shqiprija**!

[12]prozhme = Pyllishte, bjeshkë.

Ngreu prej varrit ti, o burrë,
Trim që nuk harrohesh kurrë
Kanisk[13] kombi të ka prurë
E me zê të thret,

Ngreu, se ardhi dit' e naltë,
Që shtatûnë[14] t'ënde, t'artë
Me dëshir' e mall të zjartë
Të të ngrehim mbret!
Skënderbej, u çpall Lirija
An' e kant sot qesh Shqiprija!

Ejani, o Shqiptarë,
Si vëllezër të pandarë,
Këtë ditë kaq të mbarë
Né t'a lusim sot

Lé t'i flakim krejt mërzitë,
Lé t'i lemë armiqësitë,
Lé t'harrojmë mizoritë
Mjaft punuam kot,
Sot e sot q' agoj Lirija,
Për né rroftë Shqipërija!

[13]kanisk = peshqesh, dhuratë që i jep dhëndri nuses ditën e dasmës..
[14] shtatûa = shtatore, statujë

Ushtari i rì

Nënë, më veshnë ushëtar,
Me shokët po shkonj tok,
Si i vërtet Shqipëtar,
Sot arm' e shpatë rrok,

Më dhanë pushkën e bajonetën,
Edhé pallaskat[15] edhé shigjetën,
Edhè zantrinë[16] që thret *tà-tà*
O burra për mbi 'tâ!

Nema uratën, se po shkonj
Koha kalon e s'pret
Ikinj me shokët të luftonj
Trumbeta po më thret,

Flamûri jonë po prîjn përpara
Dhë armët t'ona ndritin të lara
Vrengllijnë shpatat vrink, vrink, *tâ-tâ*
O burra për mbi 'tâ!

[15] Pallaska-Mbajtëse fyshekësh, apo shigjetash luftarake që mbahen në brez.
[16] Zantrina = Tromba, trombeta.

Nënë e dashur hesht, mos qaj,
Në kthehem, a në vdes,
Lotë mos derth, as zî mos mbaj
Zoti n'a ka kujdes.

Me kto armë do të luftojmë
Nder' e flamurit né do t'a mbrojmë
Dhe do t'a çojmë lâ e më lâ
O burra për mbi 'tâ!

Bekomë armët, o im' mê,
Mbaj zembrën e durro,
Për nderin t'em mos pesho gjê,
Këtë mos e harro

Se është marrè[17] një bir si mua,
Të rijë brenda po si një grua,
Dëgjo trumbetën si thret *tâ-tâ*
O burra për mbi 'ta!

Detyra jonë ësht atjé
Atjé n'ato kufî,
Kush vdes për komp e për Atdhé,
Kush vdes për Shqipëri,

[17] mârre = turp, koritje.

Kush vdes me armët si trim e burrë,
Ajy s'harrohet, as që vdes kurrë,
Dëgjo trumbetën si thret *tâ-tâ*!
O burra për mbi 'tâ!

O, lamtumirë, po kalonj,
Po ikinj me gëzim
Po shkonj si shokë të luftonj,
Si Shqipëtar, si trim,

Mbi këto armë qëndron Lirija
Mbi këtë shpatë mshtetet Shqiprija,
Prandaj trumbeta po thret *tâ-tâ*
O burra për mbi 'ta!

Pranvera

Delni, djema, të gjithë delni,
Se me gas po vjen pranvera,
Brigje, kodra, pllaja merrni
E dëfreni gjithë tok

Oh, sa bukur ndrit natyra
Fryn veriu, fullimi[18], era,
Dhe blerimi ngjyra-ngjyra,
Qeshni,brithni shok me shok.

Vini, djem, ata verorë,
Kaq të këndeshm' e të mirë,
Si në gushë, si në dorë
Shënjë vere q' ardhi sot,

E këputni lul' e thanë
Që po ëndin plot me hîrë
Manushgaqe, jargavânë,
Mos e bjerrni kohën kot.

Bora, akulli po shkrijnë,
Edhé dheu u zbukurua,
Edhé mbletët po shëndijnë
Edhé bima gjelbëron,

[18] Fullim = erë e lehtë, er' e këndshme. Verì, Fllad, Majistral, puhizë, fllad.

Shpesht' e zoqtë flytyrojnë
Edhé moti u ndryshua,
Qyqet ëmbël po këndojnë
E bilbili ligjëron.

Urth[19] i njohm' i çarruvitur
Po si pjergull i përdredhur,
Ent' e zgjatet tyke rritur
Zërdëllin në gjethe plot

Majë vithit të gjelbruar
Skarth' i murmë tyke bredhur,
Bisk më bisk si i harbuar,
Mbi filizat breth e lot.

Shihni pêmët si po endin
Fushat plot me lulukuqe,
Dallëndyshet si po rendin
Si belbrojnë pa pushim,

Bosilogu,trentelini,
Trëndafilat me burbuqe
Dhe vijollcat, jasemini
Kundrëmojnë me gëzim.

Delni, djem, të gjithë delni,
S'ka m' e bukur se pranvera,
mos përtoni e mos ngelni,
Po gëzohi sot e sot,

[19] Urth = një parazit që përzjehet me grurën, urthi, egjra.

E stolisur e pajuar
Qé, n' a mrîni si nga hera
Qeshni, losni, të gëzuar,
Na e çon i madhi Zot.

Edhé ju të rinj sa jini,
Losni, qeshni e dëfreni,
Sa të rremen Botë s'njihni,
Cmir, nakar e dhelpërí,

Moti kthehet po si rrota,
Dhe të ritë nuk e gjeni,
Kështu u krijûa Bota
Ku jeton i ziu njerí!

Liqeni i Ohrisë

Shko moj lundër mbi liqén,
Tash që dielli s'po ka dalë,
Këtë fllad ti nuk e gjen,
As tallazin palë-palë.

Shko moj lundër mbi liqén
Fryn veriu edhé fullimi,
Orizoni n' a dëfren
Dhe i qeshur vjen agimi

Shko moj lundër mbi liqén,
Hape velën të vrapojmë,
Se më pakëz moti kthen,
Është koha të lundrojmë.

Shko moj lundër mbi liqén,
Edhé sillu nga *Ohrija*
Te qyteti që shkëlqén
Që dikur e kish Shqiprija!

Shko moj lundër mbi liqén
Edhé ktheu nga *Shënt-Naûmi*
Ku dëfrim e prejtje gjén,
Ku i ëmbël të merr gjumi.

Shko moj lundër mbi liqén
Çaje ujin me krahrorë,
Që dhe fundin t'a rrëfen,
Valët ngreh të bardha dborë.

Shko moj lundër mbi liqén
Se atë s'nginjem së pari,
Sa më k' ënda, më pëlqén,
Uj' i tij që ndrit si âri!

Xgjohu djalë

Xgjohu, djalë, të shohsh nj'herë
Këtë dit' e këtë verë,
Ngrehu të shohsh si shkrepi Dielli,
Sa i bukur q' është Qielli,
Mos përto, gjumin e lerë,
Xgjohu djalë të shohsh nj' herë

Ngrehu, mjaft fjete, ngrehu, dëfrehu,
Shih natyrën edhé prehu,
Sa e bukur, sa e qetë,
Si parajsë e vërtetë
Lahu, veshu edhé krehu
Ngrehu, mjaft fjete, ngrehu, dëfrehu.

Lere shtratin, agoj dita,
Kaloj nata, ardhi dita,
Ngrehu t'a ndjesh jetën, të rritesh,
Ngrehu të ngjallesh të përsrritesh,
Çohu bir, se mjaft të prita,
Lere shtratin, zbardhi drita.

Shih natyrën si po çfaqet,
Shpirti zembra të kënaqet,
Shpesh'[20] e flutura mënguan[21]
Edhé punës shpejt ju shtruan
Shëko thneglën, shëko bletën
Xgjohu, bir, t'a gëzosh jetën.

Puna ka duk' e uratë
Ësht' e mirë e begatë,
Mjer ajy që rì pa punë,
S'ka m' e madh' e keq' e dhûnë,
Ngrehu, mos rì me duar thatë,
Puna ka duk' e uratë.

[20]shpesh = shpend
[21] mëngoj = Ngrihem herët, çohem shpejt, ngrihem që në mëngjes.

I verbri

Lëmoshën t'uaj po kërkonj,
Mëshirën mos kurseni
Dhe unë Zotin e besonj,
Të verbrin përdëlleni[22].

Jam vllathi juaj un i ziu,
Ndonse pa sŷ më shihni,
Fati i keq jetën më nxiu
Vëllezër, sot më ndihni!

Lija e shkretë më verboj,
Të mjerin që voglije,
Më la pa sŷ e më shëmtoj,
E s'kam as duk' as hije!

Më la pa dritë, më mjeroj,
Më la të zî për jetë,
Më la të varfër, më piklloj,
Më la të urrët[23], shkretë!

Gjithë gëzohen këtë dit,
Xbaviten e dëfrejnë,
Ditën e shohin që po ndrit,
Gjithë të mirat gjejnë.

[22]përdëllim = ngushëllim, dhembshuri, mëshirë
[23] urrët = uritur

Veç un' i ziu nuk shoh gjëkunt,
Përveç se erësirë,
Ah, si t'ju thom që nuku munt
Të ndjenj një sent të mirë!

Lypinj pa shpresë prej jush sot,
Vëllezër mëshironi,
Ja u shpërbleftë ajy Zot
Të gjitha sa kërkoni.

Jini me plëng e me shtëpi,
Gjë s'u mungon, e kini,
Po unë s'kam ç'të ha, ç'të pi,
Të urët mos më lini!

Prindër kam pasur po si jy,
Jam rritur në pekule[24]
Po sot më shihni, jam pa sŷ,
I xhveshur pa kësule!

S'kam as njeri, se fati im,
Për mua kshtu ka qenë,
Ah, mos më lini në dëshprim,
Gzofshi bab' e nënë.

[24]pekule = përkëdheli, dashuri, llastim

Lé t'isha çal' e pa kërsi,
Pa gojë lé të isha
I mjer' i urrët e fatzi,
Po sŷtë lé t'i kisha!

Lé të isha rop për jetë,
Ah, kshtu mos qoftë as njerì,
Si mua kush mos mbettë!

Lëmoshën t'uaj po kërkonj,
Të mjerë mos më lini,
Zotin e math ju përgjëronj,
Juve që sŷt i kini!

O, ju që kini sŷt' e vet,
Që dritën e shëkoni,
Ndihni të verbrit që ju thret,
Të verbrin e kujtoni.

Ndero prindët

Kush më lindi, më dha dritë,
Sisë kush më dha të pi?
Kush më mkoj, më hapi sŷtë,
Kush më mbajti në pëqì?
Nëna ime ish ajo,
Që më lindi e më do!

Kur i mitur isha djalë
Kush më rriti, më madhoj?
Kush m' ushqen e dal-nga-dalë
Më përkëmbi[25] e më msoj?
Babaj im ish, babaj im,
Që më rriti, më dha msim.

Për këta do kujdesohem,
Do t'i dua që të dy,
Për të dy do përgjërohem
Që t'i shoh po si dy sŷ.

Kur të mplaken, prapë unë
Do t'i mbanj, do t'i ushqenj,
Jo me fjalë, po me punë
Borxhin t'im do t'a shpëblenj.

[25] përkëmbi = ngreh në këmbë,mbanj më këmbë,storas.

Duaj Atdhenë

Me sa fuqi që ké,
Sa gjall jeton mbi dhé
Atë, q'i thret *Atdhé*
E duaj e ndero.

Nga prindër e nga ç'ké
Të shtrënjtë për mbi dhé,
Prapë atë *Atdh é*
Mê fort e adhuro.

Shqiprinë nën' e ké
N' atë ti dritën pé,
Për të jeton dhé jé
Ké embër e ké nder,

Dhe gjuha që po flet,
Dhe fati që të pret
Shqipërisë i përket
Prej saj i ké, i merr.

Shqiprin' e ké Atdhé,
E duaj e përdlleh,
Për 'të gjê mos kurseh,
Dhe jetën ja dhuro,

E mbaj, në qiêj e ngreh,
Sé dhe ajo të sheh,
Ç'do që i bën t'a njeh,
këtë mos e harro.

Lavdi e Zotit

O Zot i math i jetës
Atdhenë n'a shpëto,
O drit e së vërtetës
E mbro nga cilido.

Prej teje Shqipërija,
Pret drit' e lulëzim,
Prej teje vjen lumrija,
Jé shpresë, jé gëzim.

Flamûrin Ti bekona,
Të Shêjtin Arbëror,
Fatbardhësi dhurona,
T'a shohim madhështor.

Një shpirt të rì Shqiprisë
O Perëndi i fal,
Prej xgjedhës e robrisë
E përsërit, e ngjall.

Ti jé e kombit shpresa,
Shqiptari me ty rron,
Ti jé për të mburresa,
Me ty gjithkush e dron.

O Zot, të qofshim falë,
Ngjat dorën Ti mbi né,
Për ty s'mjaftojnë fjalë,
Mburrona Komp, Atdhé!

Marsh triomfan

(La marseillaise)

Burra, o djemt' e Shqipërisë,
Vraponi gjithë, koha s'pret,
Flamûr i Shêjt'i Arbërisë
Valon i mburur e n'a thret.

Vruli gjithë me arm' si rrufé,
Kundr' armikut që msyni mbi né
Mrîni dita të shpëtojmë
Atdhenë, vendin tonë,
Dhe famë të fitojmë,
Q'e patëm gjithmonë.

O nën' o Shqipëri,
S'të lemë në robri
Për ty rrëké do derdhim gjak,
O burra zjarm e flak!

Mbi ç'do pullâs e ç'do fortesë
Flamûri jonë po valon,
Lëshohi gjithë pa përtesë,
Kohën mos bjerrni, që kalon.
Si sokola të rrebtë dhe né
Lé t'a shtijem armikun për dhé

Është turp Atdheu të vuaj,
Të bjerë në rrezik
T'a shkelë këmb' e huaj,
T'a shkelë ç'do armik!

O mëm' o Shqipëri,
S'të lemë në robrì
Për ty rrëké do derdhim gjak
Me arm' e zjarm e flak.

Kujtoni, djema, trimëritë
Të katragjyshëve të vet,
Veprat e gjithë mrekullitë
Si trashëgim që n' a përket,

Që gjithkunt faq' e dheut nuku pa,
Burra, trima, fatosa si 'ta,
Botën gjithë e shpëtuan
Prej xgjedhës së pështirë
Dhe nder të math fituan
Pa njollë, pa mynxyrë!

O mëm' o Shqipërì,
S'të lemë në robrì,
Rrëké, rrëké do derdhim gjak,
O burra zjarm' e flak!

Dallëndyshja

Mir' se n' a vjen, mir' se n'a vjen,
O dallëndyshe gjithë gas,
Sikur na lé, ashtu n'a gjen,
Të pret ç'do strehë, ç'do pullâs.

Shtëpija jote si e lé
Ësht' edhé sot gatì, gatì,
Hyrë e çlodhu në folé
Hyrë atjé të gjesh shtektì[26].

Sa fjalë t'ëmbla që po flet,
Sa llafazane që po jé,
Po belbëron[27], po thret, po thret,
Me fjalët breshër, si rrëké.

Na bije verën si gjithnjê,
O bisht-gërshërë shpesh[28] veror
Sa tingëllon, oh ajy zê,
Që ngjall ç'do zembër e krahror.

Si s'e harrove shtekun t'ënt,
Sa kapërxeve tok' e det?
Sa mir' e bukur e mban mënt,
Çudi më vjen me të vërtet!
Kush t'a merr vesh atë belbrim,
Gjith' ato fjalë që rrjeshton,

[26] Shtekti = strehë, bujtje.
[27] belbëron = cicëron
[28] shpesh = shpend

Atë të këndëshmin tingllim,
Që sokëllin edhé vallzon?

Si punëtore shoqe s'ké,
N' a mso dhé né e n'a stërvit,
Baltën e kashtën qysh e vé,
Çudi! Sa bukur i godit!

Shpent i bekuar flyturo,
Me ato krah' atë shpejtim,
Ti ç'do zembër vjen e ngroh
Ti që derth gas e ngushëllim.

Mir' se n a vjen, mir' se n'a vjen,
O dallëndyshe plot–gëzim,
Me ty shërohet e dëfren
Krahrori, zemra, shpirti im.

Natë e qetë

Sa qetësi që mbretëron mbi dhé,
S'tundet as fletë as âlë[29],
Era s'po fryn dhe Hëna plot me ré,
Nga mali zû të dalë.
Zoqtë të lodhur flenë,
Tulitur në folé,
Pushimi mbulon dhenë,
Natyra qetë flé.

Vetëm një zok në erë po flytron,
Rrugën e tij ka humbur,
S'di ku të vejë, i mjeri sa nxiton,
Po sillet i lëkundur,
Nënën e tij të dashur
I mjeri po kërkon,
I shkretë, buzë-plasur,
Çerdhen s'e gjen, rënkon!

Edhé mbi det një lundër po lundron,
Me velën çjerr' e mjera
Nuk di ku shkon, e shkretë po qëndron,
E ka habitur mnera!
Detar' i zî pa shpresë,
Sŷtë në Qiell i ngreh,
Lotët i derth si vesë,
Se tokën nuk e sheh!

[29] âlë = halë,gjethja e pishës

Një udhëtar i vetëm po vazhdon
Dhe hipur majë kalit,
Tepër i trëmbur anës zallit shkon,
Ai ecën rëzë malit;
Nata e errët sterrë,
Kalorësin tmeron,
Dhe vetëm nga ndo nj' herë,
Hëna e ngushëllon.

Atjé përtej një varr me lule plot,
I njohmë e i qetë,
Veç një të vogël qiparis ka zot
Ah, ajy varr i shkretë!
Të vjen se i ndjen zënë
Të ngratit qiparis,
Që vajzën po si Hënë
E qan, e logoris!

Tomori[30]

Të kam përpara, Tomor, mal i vjetër,
Mal i patundur, qysh se filloj dheu,
Krye–përpjetë që shok nuk ké tjetër,
Që Zot'i jetës për né ty të kreu
O mali plak i lart' e i bekuar,
Kështjellë ti, që flet me Qiêj e ré,
Që jé i qetë aq sa i tmeruar,
Sa madhështi që ké!

Të falem, Tomor, që kurrë s'u tute[31]
Që kur se dita e parë agoj,
Që kur prej diellit si lëmsh u çkëpute,
Kur bubullima e parë gjëmoj,
Që kur rrufêja e zjartë prej Qiellit,
Ra si shigjetë e flaktë mbi dhé,
Kur shkrepi reza jetike e Diellit,
Tomor ti ish' e jé[32]!

[30] Në "Autobiografia ime" K. Floqi thotë se këtë vjershë e ka shkruar në vitin 1914 kur po shkonte nga Berati për në Korçë ku ishte emëruar nga Qeverija e Durrësit si prokuror. Ai është emocionuar shumë nga pamja madhështore e këtij mali dhe është frymëzuar për të shkruar këtë vjershë (H.K.)

[31] S' u tute = nuk u friksove, nuk u trëmbe

[32] Tek artikulli "Tempull i Dodonës" (revista "AGIMI" 1919), K. Floqi argumenton se në majë të malit tëTomorrit Zeusi Pellasgjik kishte banesën e tij dhe 300 e sa vjet më vonë Helenët e përvehtë-suan këtë Perëndi dhe ia transferuan banesën në malin e Olimpit.

Sa më habit kjo pamje gjigantike,
Kjo krenarija jote që po shoh,
Këjo qendresa jote poetike,
Ah, rëndësin' e vleftën sa t'i njoh!
Tomor, ku briheshin[33] mbi ty Titanët
Dhe gjaku derdhej lumë si rrëké,
Dhe britma po jehonte më gjith' anët
Sa rëndësi që ké!

Dborë e ré e mjegull edhe brymë,
Bjeshkët e tua janë mbushur plot,
Që kur se dheu ka qenë balt' e brumë
E jeta për mbi 'të nuk dukej dot,
Dëshmor i gjallë i kohëve të para
Prej mijë shekujsh ti ké qën' e jé,
Me syt' e tu ké parë aq të ngjara
Për Shqipërin' e né!

Tomor, që ishe dikûr shtegu i Zotit,
Selì e Hyjit që tunt Qiell e dhé
Ku shtekëtari fetak[34] i qëmotit
Kushtimin ty me frikë vjen t'a lé,
Tek shkrep e ndrit si gjarpri vetëtima,
Dhe maja jote flakëron rrufé,
E tingëllon e rëndë bubullima,
Tomor, i tmershim jé!

[33] briheshin = mundeshin, ndesheshin, kërlesheshin, luftonin.
[34] fetak = njeri i fesë, besimtar.

Kurorë ké mbi krye madhështore,
Bjeshkat e tua veshur lisa plot,
Dhe anëve tërmale[35] gjelbërore,
Lule t'egra që endin mot për mot,
Edhé kurrizin mbushur me dëllinja,
Me dushk e ah e bung[36] e vîth[37] e ç'ké,
E pyje plot e rrypa, hone, brinja,
Oh, sa i bukur jé.

Të metë mbi ty nuk shoh gjëkundi,
Sytë, shpirtin e zembrën m' i dëfren,
Se Zot i math për ty punoj sa mundi,
Se mendja ime mê të bukur s'gjen,
Mburime çurk me ujë të kulluar,
Të ftohtë shumë derdhen si rrëké,
Dhe udhëtari që shkon i etuar,
Çlodhet aty e flé.

Shkabën e murrme, të fort' e kreshnike,
Dhe shqerbe[38] e bisha po ushqen në gjî
Në zembrën t'ënde, kërthizën fisnike,
Thesar pa masë, ergjënt e florì,
Shpellat e tua të pasura shumë,
Rafshuar plot me çerdhe e folé,
Ushtojnë, fishkllejnë, buçasin si lumë
Ti shoh e t'i vé ré!

[35] Tërmal ose tërmall = anë mali ose të tatëpjetat e malit.
[36] Bung = një farë lisi, përnar, çinar i vogël
[37] vidh = Një farë druri i egër.
[38] shqerbe = egërsinë, bishë

Zê e gjëmim ndjehet te maja e jote,
Vall' atje lart kush flet e predikon?
Të jetë zê njeriu, apo zotrote
Me Perëndit' e vjetër bisedon?
A ngjet myster që s'mundet të shpjegohet,
Apo *orakli* fallin jep atjé[39]?
Mos mrekulli? Mos Hŷji adhurohet,
A falesh ti për né?

Tomor, Tomor, që kur gjëmon i tmershëm
Tunden nga rënjët gjithë rotull ç'ké,
Dhe udhëtarit frikë të skëtershëm,
Në zembër i ké kallur e i vé,
Ti që me hijen t' ënde mblon Atdhenë,
Edhe në gjî mban flagë e rrufé,
Tregoju Shqipëtarëve si qenë,
Detyrën ju rëfé.

Symbol i math i burrëris së parë,
Që me qerpikn' armikun e rëzon,
Ti që e njohe mirë Shqipëtarë,
Që me ty tok ky lindi e jeton,
Sot që po heq e vuan Shqipërija,
Edhé Shqiptari vdes për bes'e fé,
Tregoju ti që vetëm *vllazërija*
Në fatkeqsi s'i lé!

[39] Në artikullin "Tempull' i Dodonës" K. Floqi përshkruan orakllin, i cili jepte fallin e tij për ata që e kërkonin, sidomos për parashikimin e ngjarjeve të vështira, siç ishte lufta.Ky tempull ishte ndërtuar nga Pellasgët.

Bashkoji ku do janë të përçarë,
Bashkoji ti e lidhi shok me shok,
Bashkoji sot si ishin dhe mê parë
Bashkoji në lidhni të gjithë tok
Bashkoji tok të jenë të pandarë,
Bashkoji me bes'e fé që ké,
Bashkoji si vëllezër Shqipëtarë,
Për *Komp* e për *Atdhè!*

Pŷlli i gjelbëruar

Në pŷll' e gjelbëruar
M'a k'ënda të rí,
Atjé i gëzuar
Harronj ç'do mërzí.
O djema vraponi,
Se koha kalon,
Dëfreni, këndoni
Njeri s'ju ndalon

Harrivi pranvera
Me lul' e blerim,
Me ngjyrra, me erra
Me këng'e gëzim
Dëgjoni sa bukur
Bilbili ligjron
Dhe qyqja e çdukur
Po qesh e këndon.

Ngjeroni[40] mirsitë
Natyrën e ré
Dhe Qiellin me dritë
Dhe bimën mbi dhé,
Këputni burbuqe
E lule ç'fardo,
Dhe ca lulukuqe,
Stolisi me to.

[40] ngjeroj = shijonj, marr shije

Vraponi e prêhi,
Mos kini përtim,
Zbaviti, dëfrehi
Dhe lark ç'do mendim,
Pranverën gëzoni
Si nuse të ré
Dhe jetën shijoni
Që ikën ju lé!

Qelì[41] e varfër

N'atë bregoren, lart atjé
Shkëlqen qeli' e bardhë vé
Kamban' e saj nuk tingëllon,
As prifti atje nuk predikon!

Veç një kandile si shkëndi,
I ndrit të naltit Perëndi,
E terrët është atje lâ,
Sepsé kandili vaj nuk ka!

Një kryq të gurt'ajo qelì,
Ka si të vetëmen stolì,
Po sŷri i Zotit e vé ré,
Këtë shkëndi si hŷll atjé.

Shtektar' i gjor' aty kur shkon,
Më shumë drojë e shëkon,
Dhe me një dhembj' e adhurim
Kryqin e puth e ndjen shërim.

[41] qeli = dhomë kallogjeri në monastir.

Teqêja

Majë një kodre, për mes një pŷlli
Shndrit e shkëlqyer si dritë hŷlli
Një fort e bukur, ndërtes'e vjetër,
Që mê të mirë thua s'ka tjetër.
Eshtë teqêja, shtegu i Zotit,
Teqé e shekullit, teqé e motit,
Faltor' e vyer e Bektashisë,
Tempull i Hŷjit, i Perëndisë!

Një varf[42]' i qetë, një varf' i gjorë
Që i punojnë këmbë e dorë,
Shërben i vetëm n'atë kopshtinë,
Zotit i falet për njerëzinë.
Edhé gjahtori edhé shtektari
Edhé gjendari edhé ushtari,
Kur në teqenë vijn' e bujtojnë
Natën të këndshme aty e shkojnë.

Se varfa është njeri i shkuar,
Me vese shumë ësht' i pajuar,
Ka gojë t' ëmbël, fjalë të mira,
Të pret shumë mirë, tregon çudira,
Të gjith' e njohin dervishin t'onë,
Shum' e lëvdojnë e shumë thonë,
Për shërbëtorin e Perëndisë
Po dhe për shëmbllën e vllazërisë.

[42] varf = dervish

Edhé teqêja thua se s'trembet,
As nuku prishet, as nuku shembet,
I zbardhin murret, i zbardh qemeri,
Si rez' e djellit, a si mermeri.
Dhe qesh e lumur, qesh kurdoherë,
Është fatbardhë, është e vlerë,
Si të mos qeshë qelì' e qetë
Me varfën plakun që s'ka të metë?

Lark nga i keqi

Një i vogël, djal' i mitur,
Me pekule tepër rritur,
Që prej shkolle tyke dalë
Në një kopsht hŷn me nga dalë.
Do të lozë, të zbavitet,
Do të bredh' e t'hallavitet,
E këput mollë të kuqe,
Trëndafile e burbuqe
    Gjer sa një i shkretë gjëmp
    E çpoj djalin e u trëmp

I gjakuar, i cfilitur,
Tyke thirur tuke britur,
Në shtëpi vjen tyke qarë
Edhé gjëmbin tyk' e sharë,
Edhé tyke derdhur lotë,
Babës tij vjen e i thotë,
"Ç'punë ka me lulet gjëmbi,
"Që e çpoj e fort i dhëmbi?
    "Psê e kreu i madhi Zot
    "Këtë gjëmp kështu më kot?

Po i ati tyke qeshur,
Si m'i vojtur, si m'i pjekur
"Djal' i tha, ti s'ke të drejtë

"Të mallkosh gjëmbin e shkretë,
"Për ty është msim kjo vojtje
"Se prej gjëmbit nuk u rojte?
"Kështu, pra, gjithmonë drohu,
"Me të keqin mos afrohu,
"Se të keqin kush s'e dron,
"Cok si ty kështu pëson"

Nekrologji

(Mbi varrin e Naim Frashërit)

Fli! Se nuk ardha të të zgjonj,
Qetsinë nuk t'a ngreh,
Dhe gjumin që po flé
Nuk t'a trondit, po rì i qetë,

Rì edhé çlodhu, se kujtonj
Këtu, ku ndodhesh sot,
Vetëm i madhi Zot
Të ka në gjî me engjejt vetë!

E di që flé e s'më dëgjon,
Se ti u ndave nesh,
Të lutem të më ndjesh
Në ardha të të them dy fjalë,

Shpirti im kurrë s'të harron,
Të dua, t'adhuronj
Edhé kur të kujtonj
Zembra më dridhet palë-palë!

Lule të njohma, o Naïm,
Ardha mbi varr' të lé
Këtu që ti po flé
Dhe t'i ujìt me disa lotë,

Një penk të vogël për kujtim,
O vjershëtor prej nesh
Të prura që t'a kesh
Të ngushëllohet hîja jote!

Pushove, o bilbil veror,
S'jehon, s'dëgjohet mê
Ajy i ëmbël zê
Që ishte mjalt' e ëmbëlsirë,

Që ngjallte zembër e krahror,
Që frynte si fullim,
Që britte si gjëmim,
Fjalët e t'ua gjuh' e dlirë!

Kû vallë shkoj ajo fuqì,
Ajo filosofì,
E ralla fantasì
Dhe predikimi yt i zjartë?

Kû ajy shpirt, ajo nxehtsì
Ajo atdhetarì
Për mëmën Shqipërì
Kû ideali yt i lartë?

Endër e rême, utopì
Kujtonje ti gjer djé,
Se ish kjo dit e ré,
Dita e bardhë e Lirisë;

Të dukej si kur ish kllapì
Nuk e besonje dot
Qanje për 'të me lot,
O djal' i vyer i Dangllisë.

Po, dit' e bardhë qé agoj,
Oh, lindi e shkëlqeu
Lindi Naim, po ngreu,
T'a shohësh ti me sŷt e t'ua,

Ngrehu, se Shqiprija sot shpëtoj,
Flamûri po valon,
Dhe populli kremton,
Kremton, po, ditën q'u lirua!

Arbnija jote, sot u ngjall,
Gjith' Bota e dëshmon
Dhe kënga po gjëmon,
Këng' e Rilindjes, e Lirisë,

Jehojnë male, brek e zall
Jehon liqen e det
Gëzohet ky remet[43],
Remeti yt i Shqipërisë!

Vdiqe i mjerë lark Atdheut
Dhe gjith' ajy veprim
Që derdhe me qellim
Thé se u shojt e u farrua

[43]rëmet = popull, llaus

Po, jo!.... Në gjî të Skender-beut,
Një iskër[44], një shkëndi
Që pate ndezur ti
E ndjelli Kombin e u xgjua!

Populli yt nuk t'i harron
Shërbimet e mbëdhâ
Që i ngjeroj, i pâ
Shëmbëll për jetë do t' të ketë;

Ty si një shent të adhuron,
Embrin e shtrentë t'ënt
E ka në shpirt, ndër mënt
Dhe mirë-njohës do t' të jetë!

Fli edhe çlodhu Naïm-bé
O burrë Shqipëtar,
I lartër atdhetar
Fli se Shqipërija t'u lirua,

Flì se po shkonj, lulet t'i lé,
I madhi vjershetor,
Që ré si një dëshmor,
Çlodhu, qellimi t'u mbarua.

[44] iskër = shkëndi zjarri.

Vëllazëria

Jemi vëllezër, ndryshime s'kemi
Fetë s'n'a ndajnë, as sot as mot,
Prej një shtëpije, një vatre jemi,
Kush n'a sjell çarje lodhet kot.
Rroftë flamûri, rroftë Kombsija
Rroft'atdheu jonë, rroftë Shqiprija!

Atdhen' e dashur nga prindët t'anë,
E trashëguam me gjak, me lot,
Ata, si burra,
pa dhûnë ranë
Kohën e tyre s'e humpnë kot!
Rroftë flamûri, rroftë Kombsija
Rroftë për jetë gjithë Shqipëria.

Lindja e Diellit

Lindi Dielli,
Ndriti Qielli
Dhe natyra po ndryshohet,
Agoj dita,
Çeli drita,
Gjithësija po gëzohet.

Lulëzojnë
Kundrëmojnë
Lule, gjethe e burbuqe,
Gjelbërojnë
Kuqëzojnë
Bimë bar' e lulukuqe.

Shih rrëketë
Që përpjetë
Si gjarpinj derdhen, vikasin,
Dhe lumenjtë
E përrenjtë
Shih si rrjedhin e buçasin!

Po levrijnë
Po shendrijnë,
Thnegla, flytura e bleta

Dhe bretkosa
Ndër kullosa,
    Në luadhe, në këneta.

Shih dhe dhëntë
Tok me qëntë
    Dhe atë barín' e gjorë
Kullot dhitë,
Bagëtitë
    E ogiçin me këmborë.

Sa ka hije
Sa ka shije
    Kjo natyr' e lulëzuar,
Kur lind Dielli
Kur ndrit Qielli
    Sa njeriu ësht' i gëzuar!

S'mungon âlë,
S'gjenden fjalë
    Të tregohen bukuritë,
Pun' e motit,
Pun' e Zotit,
    Veprat gjithë mrekullitë!

Luleshitseja

Merrni lule, o bujarë,
Prej së verbrës që po tutet,
Vjen së largu e ju lutet,
Hîrën t'uaj ju kërkon.

Dritën kurrë s'e ka parë,
Leu e verbër e e mjerë,
Të dy sŷtë i ka bjerrë,
E me lulet po jeton.

Ju që dritën e shëkoni
Dhe gëzoni lumtërinë,
Ah, kujtoni Perëndinë
Ah, mentoni fatin t'im,

Dhe të verbrën mëshironi,
Jepni dorën, o bujarë,
Zoti ja u pruftë mbarë,
Paçi jetë e gëzim.

Stinët e Motit

Verë e *Pranverë*, *Dimbër* edhe *Vjeshtë*
Janë bijt'e *Motit*, t'vet, e jo të thjeshtë,
Sjellin mij' të mira, rrush e pêm' e lule,
Shî, të ftohtë, dborë, lodra e pekule.

I

Pranvera

Marsi, Prilli edhé *Maji*,
Që çel gjethi edhé ahi,
Q'endin lulet trëntafili,
E këndon me zê bilbili,
Këto janë, djem, Pranvera,
Që vjen për mot e nga hera,
E përhap gjallni e jetë
Se e çon Zot'i vërtetë.

Zoqtë shkunden e shpupulohen,
Zëmbrat ngjallen e gëzohen,
Dallëndyshja punëtore
Fjalë shum' e belbërore,
Vjen me gas e gjen folenë,
Edhe shpeshët këngën zenë.
Pêmët gjithë zërdëllijnë,
Miza, flytura shëndijnë

Fryn veriu mbi fusha, male,
E fullimi reh nga-dale
Edhé lulet lulëzojnë,
Endin, bukur kundrëmojnë.
Esht' e bukur, po, Pranvera,
Që vjen për mote nga hera,
Që kullosin dhî e bérra,
Që vërrasin[45] qëngj' e shqerra
Që gumzhit bletʼ e uruar,
E bën mjaltin pa përtuar.

II

Vera

U rrit dita, u ngroh moti,
Ardhi vera plot dëfrim,
Digjet kashta si baroti,
Bujku shîn me një gëzim

Qershori, Korriku, Gushti,
Na kënaqin me ushqim
Si shpirt-gjëri, zembër-ngushti
Gjejnë prëhje e ngushllim

Pêm' e drithë sa të thuash,
Edhé bukë e bulmet,
Edhé ç'tjetër gjê të duash,
Për të urrëtin[46] rëmét.

[45] vërrasin = zëri që nxjerrin disa bagëti si dhija,qëngji.
[46] urrëtin = të uriturin

Vera për këta të ngratë
Eshtë mjaft një ngushëllim,
Vjen si mëmë e begatë
Me mëshir' e përdëllim.

Një gëzim kudo dëgjohet,
Kënga, vallja po tingllon,
Embr' i Zotit lavdërohet
Që n'a ngjall, n'a ngushëllon!

III

Vjeshta

Vilen rrushtë dhè vozet gatiten,
Që të mbushen me ver' e me musht,
Tirra, bûte, varele[47] goditen,
Shtypet rrushi me këmb' a me grusht.

Pak mê vonë një lënk por si mjaltë,
Del prej rrushit e ky rri bërsì,
Eshtë vera – që Zoti e faltë –,
N'a forcon këmb' e gjunj' e kërsì.

I forcon për njëment këto vera,
Po kur pijet me mas'e me ment,
Se për ndryshe sjell dëm e potera,
Varfri, fatkeqsi e ç'do sent.

[47] Tirra = but i madh për depozitim vere. Varele = fuçi vere.

Vjesht' e parë[48]*, Tetori, Nëntori*
Janë muaj vjeshtakë të tré
Bujkut n' arë i çohet lakrori,
Se lëvron e mbjell tokën e ré.

Gjithsecili në Vjeshtë mundohet,
Mbleth me kohë ç'do gjê q'i mungon,
Drith' e ver' e bulmét e forcohet
Sepse ndryshe, vjen dimbri rënkon.

Edhé mbletat e mizat përdhesa
Ven' e vinë e bëhen gati,
Pregatiten si nuse shtëpresa[49],
Të mos vuajn kur zé bor' e shî.

Fort e bukur e êmbël kjo stinë,
Ka një shije, një ënd' e pëlqim,
Zot'i Jetës këtë për njerinë,
Ruzullimit ja lâ trashëgim.

[48] Vjesht' e parë = shtatori.
[49] shtëpresa = Zonjë shtëpie, nikoqire, amvisë.

IV

Dimbri

Gjethet zun' e bijen, shtrohen për mbi dhé,
Drurët xhvishen gjithë, ftoht' e madhe zé,
Fryn e bije dborë, akull e tufan,
Mvishen fusha, male, era të përthan!

Rrugët zihen gjithë, fryn stuhi, murlân,
Lumënj e liqena ngrijnë si gollgân,
Ndryshon krejt natyra, mbushet dborë plot!
Një mjerim, një vdekje, gjê s'lëvis, as lot!

Zoqtë mê s'këndojnë, futen në folé,
Dhe arrush' e egër rrudhet e po flé,
Dallëndyshet shkuan, qyqja mê s'bën zê,
Lulet u përthanë, nuku sheh as njê!

Nata fort e gjatë, gjithë kunt pushim,
E gorren'[50] i shkretë bën zhurm' e ushtim,
Bota râ në gjumë, thua s'është gjall,
Veç se bisha ndjehet, ujk, ose çakall.

Po njeriu i mençëm brenda prehet, rrí,
Ka gjithë të mirat, shtrohet, ha e pî.
U kujdes me kohë, sot s'i mungon gjê,
Bujku, punëtori i ka një nga një.

[50] goren = murlân, tufan, er' e marrë, shukullinë.

Jashtë fryn e bije, brënda ngroht' e zjar,
Bukë ka e verë drithë në hambar,
Dhe shtektar' e jashtmë që mir' se e gjet,
Më zembër të çelur, me gëzim e pret.

Ka dhe Dimbr' i gjorë tjetër nj' ëmbëlsì,
Me shoqri, me prêhje e me miqësì.
Të mos jetë Dimri, vera s'vlen një sent,
Pa shî e pa dborë ç'mbillet as një vent

Ashtu si kur stinat vijnë bres-më-bres
Ashtu si kur dita ka mbrëm' e mëngjes,
Dhe njeriu i ngratë me shumë kujdes,
Lindet, rritet, plaket dhé më në funt vdes!

Hymnë Kombëtar[51]

Përpara, përpara, flamûri n'a prîn,
Vraponi, se dita e bardhë po mrîn,
Me shpresën e plottë, me armët e lara,
O burra Shqiptarë, të gjithë përpara,
Shtrëngoni flamûrin të kuq e të zî,
Dhe bini therorë për komp' e Shqypnì.

Qé, qé, shkrepi Dielli
I flakt'i Liris,
Dhe Hŷlli te Qielli
Agoj i Shqiprisë.

[51] Kjo hymnë u pëlqye e u lëvdua në konkursin për "Hymnë Kombëtar" prej anës së komisjonit të posaçëm (shënim i Kristo Floqit). Nga kërkimet e mia gjeta këtë shënim të cilën po e shtoj për të vërtetuar atë çka pohon K.Floqi më sipër (H.Kaçulini).

FLETORJA ZYRTARE E DJELË 10 DHETUER 1922

PROCES-VERBAL

"Sot n' oren 10 para dreke u mbloth komisija e emnueme prej Ministris s' Arsimit për me dhanë gjykimin mbi konkursin e shpallun prej saj më 25-VI-1922 per hartimin e njij hymni kombtar. Hartimet e paraqituna deri më 30 nanduer 1922 janë dymbëdhetë**.** Si u kenduen me verejtje të gjitha hartimet, u skartuen dhjetë prej tyne mbassi nuk i përgjigjeshin qellimit të konkursit. Dy vjershat e tjera, ndonse kanë nji vlerë poetike, prapë nuk u gjetën se bajnë për hymnë kombtar, Me gjith këte, komisija porositë Ministrin e Arsimit qi këto dy vjersha, e para e Z. Ernest Koliqit (le jeune eclaron) dhe e dyta e Kristo Floqit (Gjikë Palla) të botohen ndë nji rivistë shqipe për inkurajim të auktorëve të tyne". Tekstin shihe te Revista pedagogjike, 1922, Nr. 1 shtator, f. 27-31

Tiranë, me 5 Dhetuer 1922

Midhat Frasheri d.v. F.S. Noli d.v. Luigj Gurakuqi d.v.
P. G. Fishta d. v. Mehdi Frasheri d.v.

Si valë prej deti që vjen me tallas,
Buçet an' e mb' anë një zê e një gas,
Gjëmojnë po, malet e fushat e gjâna,
Prej zânit Lirisë q' ushton posi Zâna,
E thret me vigame ç'do burrë Shqyptar,
"Në fushën e nderit kush ësht atdhetar"!

Qé, qé shkrepi Dielli
I flakt'i Lirisë, etj., etj.

Valon krye-naltë flamûr' i Arbnìs,
Flamûri i shêjtë, flamûr' i Burrnìs,
Dhe kodrat e zallet madhnìn i dëshmojnë
Fatosat e parë as sot s'i harrojnë,
O burra, nderoni flamûr' e Atdheut,
Si bij t'atij trimi të math *Skënderbeut*!

Qé, qé shkrepi Dielli
I flakt'i Lirisë, etj., etj.

Mjafton xgjedh' e dobët e poshtra robnì,
Mjaftojnë mjerimet, mjafton tyranì,
Në dhen' e gjigandve fryn era gazmore,
Se sot ësht' e lirë kjo toka Arbnore,
Do vdesim si burrat e jo me dhunì
Për vatrat e shêjta, për nënën Shqypnì!

Qé, qé shkrepi Dielli
I flakt'i Lirisë, etj. etj.

O burra përpara, Atdheu po n'a thret,
Atjé te kufini flamûri n' a pret!
Betohi mbi armët, si burra Shqyptarë,
Vëllazën e shokë e miq të pandarë,
Dhe lithni një besë për dek' a lirì,
Për dhen' e të parëve, për Komp e Shqypnì!

Qé, qé shkrepi Dielli
I flakt'i Lirisë
Dhe Hŷlli te Qielli
Agoj i Shqiprisë.

Kënga e Ushtarit[52]

Ushëtari, fatos i vërtet
Rron me faqe të bardhë mbi dhé,
Dhe me armë e me bajonetë,
Vdes për *Komp*, për *flamûr*, për *Atdhé*!

Për në luft' e në zjar ësht' i lindur
Nuk ka frikë e s'trëmbet as pak
E të madhit gjithmon' ësht' i bindur,
Për Atdhenë s'peshon jet' e gjak.

Shqipërija ka burra, ka trima
Që armikun e kapin në fyt,
Si rrufé, si stuhi, si vettima,
Gjithsecili i derdhet e mbyt.

Si besnik i së shêjtes detyrë
Vdes ushtari e bije theror,
Ballë-lart, krenar, pa mynxyrë,
Për Atdhenë tregohet dëshmor.

Si luâni kur del i hutuar
E vërsulet me hov e furrì,
E si shkaba me thonjt' e tmeruar
Shqipëtari lufton me burrnì;

[52] Ky marsh u kompozua për Regjimentin e II të Tiranës (Shënim i Kristo Floqit)

Në kanâr'[53] e në lufta gjaksore
Ky armikun e shtyp e dërmon,
Ushëtari me armët mizore[54]
Prej rrezikut Atdhen' e shpëton.

Jemi burra, po, burra Shqiptarë,
Nat' e ditë më këmbë, gatì,
Në kushtrimin e luftës të parë,
Marsh! Të gjithë, Baôn[55], Kompanì!

Do t'i dalim armikut përpara,
Me flamurin e shêjtë krenar,
Dhe me armët fisnike të lara,
Për Atdhen *theror* ç'do ushtar!

[53] Kanare = kasaphane.
[54] Armë mizore = armë që të shtijen frikën.
[55] baôn = parafthora (e barabarta e shkurtuar) e fjalës bataljon

Bretkosi e Kau

Një bretkos atjé ku loste
Në kënetë, në një llom,
Sheh një kâ që po kulloste
E përtypeshe rëndom.
Ishte fort i trashë, ishte fort i ngjallmë,
Ishte një buall edhé mjaft i majmë;

Po bretkosi – si vé pûle –
E vé ré dhe e vëzhgëllon,
Mëndje – math, kokë – daûlle
Shtatin kaut po ja lakmon.
Edhé zé mundohet e fillon të zhgryhet
Njerë[56] po përmblidhet, njerë zé të fryhet,
E i thotë kaut të ngratë,
"Dale, prit pa do më njohsh,
Sa do jem nga ty m'i gjatë
Do çuditesh kur t'a shohsh!"

Kau që po e shihte se qysh desh të ngjallet,
Zû me të të qeshë, zû me të të tallet:
"Mos ashtu moj shtâz" i thotë,
"Mos u mat me mua ti"
"Mos u loth, u mundo kotë"
"Zhytu n'ujë e urtë rì"

[56] njerë = një herë

Po bretkosi s'bindet, nuk merr vesh me fjalë
Edhé kaut përpara ky kërkon t'i dalë

Dhe me nj' herë ky kuasi[57]
– Se kujtoj se u bë kâ, –
Po kur *puf*! i shkreti plasi,
E kështu më dysh u ndâ!

Ndodhen shumë herë njerës të vobektë,
Njerës mëndje – shkurtër, njerës fort të cektë,
Që me pasanikë e njerës bujarë,
Duan të reshtohen në rendin e parë,
Por se tyke prishur e tyke harxhuar
Dalin më së fundi krejt të turpëruar,
Edhe nga ndo nj' herë bëjnë aqe dukë,
Sa mbeten të varfër, a mbeten pa bukë!

[57] kuasi = zë i çjerrë si i bretkosës.Në këtë rast bretkosa.

Njeriu i gënjyer

Një njeri i rrejtur, pas mendjes së tija,
Kujtonte se ishte vetë bukurija,
Edhé dit për ditë shihej në pasqyrë,
Sa i bukur ishte, ç'farë kish fytyrë.

Mjerisht, në pasqyrat q' ishin pandryshuar,
Veten e shëkonte tepër të shëmtuar!
Tjetër punë s'kishte, veç me pasqyra,
Po nuk i kënaqej me ato fytyra.

E ankohej shumë, shante e mallkonte,
Se ishte i sigurt që nuku gabonte.
Thosh se kto pasqyrat nuku bënin pare
Që s'tregojnë mirë shtat edhé tipare.

E ish i paqetë e ish në mejtime,
S'gjente as një prehje s'gjente ngushëllime.
Më në funt mejtohet të shihet në ujë;
Pranë një kanalli shkon ngadalë, pa bujë,
Edhé me verejtje shihet mir' e bukur,
Po mjerisht s'kënaqet, s'ësht'as pak i dukur.

Cok atjé ku shihej një barì kalonte,
E si pa të ngratin zû t'a këshillonte:
Mik, i thotë, hiqu, s'të ka faj kanalli,
Ësht'aq i kulluar sa edhé kristalli;

Ti jé i shëmtuar, këjo s'do as fjalë,
Mos u shih dhe nj' herë, mblidhe mendjen djalë,
Në daç të vërtetën eja e t'i shëkojmë
Që të dy fytyrat e pastaj gjykojmë.

Mbi kanallin sŷtë të dy tyke kthyer
Bukuroshi ynë pa se ish gënjyer,
Edhé rrugën vrapthi për në shtëpi mori,
Edhé mê pasqyrat kurrë s'i përdori!

Shpesh i gënjen mendja ca njerës të marrë,
Që s'kanë të meta, që s'kanë të sharë,
Po kur e shëkojnë me sŷ të vërtetën,
Unjen, turpërohen, e njohin të metën.

Plepi e Kallmi

Plepi krye-naltë po mburrej një ditë
Që s'ka shok në botë, as që ka të dytë
E i flet me bujë e me krenarì,
Një kallamit vogël, q'aty unjtas rì.

Ké, i tha të drejtë mjaft që të ankohesh,
E prej fatit t'mjerë fort të dëshpërohesh,
Se m'e vogla âlë që të ngel mbi sy,
Të kërrûs me nj'herë e të përûl ty;

Ty veriu i kandshëm dhe m'e lehta erë,
Arrin pak të fryjnë, të lenë të mjerë!
Po, pa më shih mua sa i lartër jam,
Shih ku e kam kryen, ballin ku e kam!

S'tutem nga stuhîja, s'tutem nga tufani,
Nuk pêshonj rëmorën[58], s'më tremp as murlâni,
Dhe pa ndo një frikë ç'do gjê e vé ré,
Nuk më tremp rrebeshi, nuk më tremp rrufé.

Po ti, mor i mjerë? Ah, jé për të qarë,
Se vërtet më qafë ty të kanë marrë!
T'ishe afër meje, s'kishe një rrezik,
Nënë hîjen t'ime s'ké as një armik.

[58] rëmora = (it.) pengesë në kryerjen e një veprimi.

– Ah, vëlla i dashur, ah, o krye-gjatë.
Po ja pret kallmishti, plepit të bëgatë;
Për mëshirën t'ënde, falem nderit fort,
Ndonse un' i mjeri, nuk kam kurrë mort;

E sa do që thua se jam në rreziqe,
Mos u tremp për mua, atë mendje hiqe.
Ti lufton për hera me er' e duhí,
Po unë fut kryet brenda n' uj' e rí.

Unë jam i dobët e për njëmend ûlem,
Po kurrë nuk thyhem, kurrë nuk përkulem,
Dhe në daç mê mirë, prit se ké me pâ,
Kush ka të drejtën edhé hakk kush ka.

Pa mbaruar fjalën nis një er' e marrë,
Që merr ç'gjen përpara edhé i heq xvarë,
Aqë sa dhe plepin e rëzon për dhé,
Kur se kallamishtin era nuk e zé,

Se ka futur kryet, është krydhur n'ujë,
Pa një kokëçarje edhé pa një bujë.
Era rëzoj lisa, shelgje, plepa ç'gjet,
Po kallamisht'i gjorë si kur ishte mbet.

Kur u pré tufani, e filloj një vapë,
Kallamisht'i vogël del mbi ujë prapë,
Por se plep' i gjatë s'duket as gjëkunt,
Kryj' e tij e naltë ra për dhé, u shkunt!

Kështu e pësojnë ata që lëvdohen,
Bijen krye – poshtë e pastaj pendohen,
Por ajy që unjet e s'ka madhërí,
Eshtë m'i fituar e m'i lartër rí!

Shpresa e detarit

Ret'e zeza si stihí[59]
Qiellin e mbulojnë,
Fryn tufan e fryn stuhí
Valët shkumbëzojnë!
Kush detarin e kujton,
Kush e sheh, kush e mejton,
Veç ti, o Zot
Shpëto detarin sot!

Det'i egër po gjëmon,
Vala e harbuar
Çon tallaze e dërmon,
Shkon tyke çkatruar,
Po detarit kush i prîn,
Kush i vjen e kush i mrîn,
Veç ti, o Zot
Shpëto detarin sot!

Për mbi det s'dëgjohet zê
Eshtë terrët, natë,
Rreth e qark nuk duket gjê,
Veç se val' e gjatë,
Po detar' i zi po thret,
Ndihmën, ah, prej kujt e pret?
Veç ti, o Zot,
Shpëto detarin sot!

[59] stihí = fantazmë, lugat, xhint, djall, llamje, lubi, kulçedër.

Një mëngjes Pranvere

Shkëlqen mbi malet Diell'i bukur,
Gjithë kunt shëndrit me hijeshí,
Hyjet e Qiellit janë çdukur,
Natyra ka një madhështí.

O djalthi im prej gjumit zgjohu,
Të shohsh një shend, një bukurí,
Laj sytë shpejt, u ngjish e ndrohu,
Në shtrat i plogët, oh, mos rí.

Del edhé shih ç'është natyra,
Ka një të madhe ëmbëlsí
Dhe Qielli ndrit po si pasqyra,
Shëko rëmet, shëko gjallsí.

Shih si ka çelur trëndafili,
Vijollca erën si lëshon,
Shih trentalini, shih trifili,
Maja, bregore po mbulon.

Zgjohu të shohsh si punon bleta,
Prej lulesh mjaltën si e mbleth
Dhe kopshtet mbushur me lëmpjeta,
Bariu shelegun si e qeth.

Me zëmbrën tënde të gëzuar,
Me buzën t'ëmbël, m'evarí[60]
Zotit të math q'i ka krijuar
Falju për këto bukurí.

Ajy dhe ty do të të mësonjë,
Babën e nënën t'i nderosh
Prap ajy ty do t'të tregonjë,
Se si detyrën t'a mbarosh.

[60] evari = mirënjohje

Maji

Vraponi, djem, se maji arth
Me lule me blerim
Të gjith' atjé n'atë livath
Lëshohi me nxitim

Ësht' i stolisur e po vjen
Me lul' e vjollca plot,
Edhé që tutje po shkëlqen
Edhé me lulet lot.

Jashtë qytetit vrûli[61], djelm,
Dhe nguti sa mê shpejt
Sa s'njihni hidhërim e helm
Atjé vërsûli drejt.

Ajy që lark po n'a këndjell[62],
Me lodra të mbëdha,
Këng' e gëzime po n'a sjell,
Dëfrime, gjithë ç'ka.

Vemi t'a presim edhé né,
Mos bjerrim kohën kot,
Atjé, o djelm, të gjith' atjé
Mê bukur s'ka se sot!

[61] vrûli = shkoni me vrull, me furì,me shpejtësi, me hov.
[62] Këndell ose këndjell = ngreh, çoj lart (p.sh. moralin),përtërij, sjell gëzime shpirtërore.

Gjahu

Pranvera ardhi me gëzim,
E fushat lulëzojnë,
Po del i bukri agim,
E kodrat gjelbëronjnë,
O burra derdhi sa mê shpejt
Gjahu né po n'a thret.

Në duart armët dhe gatí,
Pa shkrepur édhe Dielli
Burîja pzân tí, tí, tí, tí,
Mos silli, mos u qelli ;
Prapë burîja thret tí, tí
O burra, djelm gatí!

Kqyrni si sbresin shpesh e zoq,
Turtuj, shkurta, mëllenja,
Tufë e tufë, sogje-soq
Në ara, në dëllinja,
Burîja thret ti, ti, ti,tí,
Gjahtorë ju gatí.

Secilido strajcën e vet
Dhe bukë pak në dorë,
Shihni zânoren si bërtet
Dhe lepurin e gjorë,
Burija thret ti, ti, ti, ti,
Gjahtori ju gatí!

Ngjitni tërmalin[63] pa përtim,
Dhe zini vënt të gjithë,
Gjuhani ca në fluturim,
Dhe ca fshehur nër drithë,
Ja dhe zantrija thret ti, tí,
O burra, djelm gatí!

[63] Tërmal ose tërmall = anë mali.

I marri e i piri

Një i marr' e një i pirë,
Me një rrugë hasen tok,
Dhe të dy si miq të mirë
U bashkuan shok me shok,
Si shëtitnë një cop' herë,
U sheshuan më një vent,
Edhé kohën pa e bjerrë,
Zun' e hapnë një kuvend.
Dhe fillon e flet i marri
Me një hov e një furrí
Unë jam, i tha, i pari,
Që sundonj këtë mbretrí,
Po, ja pret me nj'her' i piri,
Po dhe unë jam një mbret,
Që s'm'a del ajy m'i miri,
Aq' sa mendja ty s'ta pret.
Dal nga dal i trashnë fjalët,
Dhe u kqyrshin sŷ ndër sŷ,
U zembruan të dy palët
U ashpruan që të dy.
Jé i marr' thot'i marri,
Ti nuk di as pak se ç'flet,
Hesht, se të lith pas një trari,
Që të dish kush është mbret!

Mos u ngut, i thot'i piri,
Se tani të bënj t'a njohsh,
Kush prej nesh është m'i miri,
Sa, do s'do, do t'a mbesosh.
Kshtu po thotë dhe me nj' herë
I jep shokut një shuplak,
Sa të fikët zû t'i bjerë,
Sa dhe sŷt'i rrodhë gjak!
Dhe i marri heshti s'foli,
Mori sŷ e këmb' e shkoj,
Dhe përpara mê s'i dolli,
Pijanikut q'e dhunoj!....

Pralla, sa do q'ësht' e motshme
Të vërtetën n'a tregon,
Se dhe sot në ditt e sotshme,
Na vé mënt edhé n'a mson
Prej të pirit, djelm, largohi,
Nuku ka m'i math rrezik,
Allkoolit i mërgohi,
S'ka m'i math se ky armik!

Shkaba dhe korbi

Shkaba fort e urrët[64] sillej lart mbi retë,
E si gjojti mirë edhé vezhgëlloj,
Derdhet me një herë mbi një qënq të shkretë,
E përfshin me thonjtë, e rëmbeu e shkoj.

Korbi q'atjé tutje sheh edhé tërbohet,
Trimëri' e shkabës tepër i pëlqeu,
Do dhe ky të sulet e nuk i durohet,
Shokët i mbleth rotull, ankthin ju rëfeu.

"Moré shoq të dashur si ju dukem unë,
"Pa më këshilloni si të vepëronj,
"A nuk jam i zoti të bënj atë punë,
"Si e bëri shkaba, qëngjin t'a gllabronj?

Dhe korbët e tjerat, gala edhé sorra,
Folnë e bërtitnë gjithë me një zê,
"Bravo më të qoftë, bëje tani forra,
"Jé vërtet i zoti, s'të mungon as gjë"!

Korbi yn' ahere e vé reé kopenë,
E një qënq të majmë sŷri ja shënoj,
Flytyron e ngrihet gjer sa gjeti rénë[65],
Dhe si mbret i shpeshve me sqep e me thoj.

[64] urrët = e uritur
[65] rénë = prénë

Qëngjit i lëshohet e përfshîn me nj'herë,
Dhe kërkon t'a ngrehë gjahun që gadhnoj[66]
Po nër lesht' e qëngjit thonjt' e korbit mjerë,
S'di se si ngatrohen e korbi ngurroj,

E me këtë bashkë qëngjin me aq' ëndë,
Kjo fuqi e korbit nuk e çonte dot,
Kërkon t'a lëshonjë, i duket i rëndë,
Po nuk ësht' e mundur, po mundohet kot!

Ngeli korb' i ngratë, s'ka si çkatërohet,
Nuku di ç'të bënjë, mëndjen e humbet,
Hidhërohet tepër edhé fort pendohet,
Po mjerisht s'ka shpresë, ç'e kërkoj e gjet!

Një barí at-here, q'u ndoth aty pranë,
Korbit t'onë i turret e një drû i heq,
Dhe sorrat e tjera këtë kur e panë,
Muar dhen' e shkuan, se s'paska më keq!

Bariu si e rreqi, si e ndreqi mirë,
Pêndët ja shkurtovi, korbin e shytoj
Dhe t'a lith për këmbe edhé thret të birë
E j'a jep të lozë, korbi e pësoj!

Pa u matur mirë e pa u mejtuar,
Mos ja fillo punës e mos bëj marrí,
E pëson si korbi, mbetesh i çnderuar,
Tallen me ty gjithë, s'të përfill njerí!

[66]gadhnoj = pushtoj

Dija e padija

Ishin dy fshatarë
Bashkëkatundarë
Njëri fort i pasur tjetri fukarâ,
Edhè bisedonin,
Fjalë shumë ndronin
Njëri ish i ditur, tjetri kish parâ!

Katundari kamës
Ish makût e hamës,
Nat' e ditë thriste njerës në gostí,
Edhé shumë herë
Dijetar' e mjerë
E thriste për darkë edhé për bujtí.

Pasaniku mburrej
E shokut i turrej
I thoshte se bota e kanë zilí,
Tepër e nderojnë,
Fort e lavdërojnë
Se ësht' i begatë e ka pasurí.

Po ti, moré lumë,
Ké të meta shumë,
Sé nuk jé i zoti, as vehten të mbash,
Të ushqenj për hatër
Se s'ke hî në vatër,
Po s'të dhashë unë s'ke as bukë t'hash.

Ti mvishesh i mjerë,
Si dimbër si verë,
Roba ké një palë, gjith' i çveshur rí,
Ti nuk jé si mua,
Mor' lum e përrua,
Që kam gjith' të mirat, që s'i ka njerí!

Ti s'ké tjetër punë,
Veç librat bastunë,
Edhé si të vegjlit ndryhesh e këndon,
Ç'farë kupëtoni
Që kaq fort këndoni,
Pâre nuk fitoni, koha kot ju shkon.

Ty njeri s't'afrohet
Gjithëkush dëshpërohet,
Veç se hîjes t'ënde, prapa kush' s'të ndjek,
S'ké as frut'as verë,
As kush të t'i bjerë,
Edhé shumë herë as kandil nuk djek.

Né si ju nuk jemi,
Pâre shumë kemi,
Ku të duam vemi, njeri s'na ndalon,
Po ju, mor të gjorë,
S'kini, gjê në dorë
Kush ju zê në gojë, kush për ju fjalon?

Dijetar' i shkretë,
Si burr' i vërtetë,
Të padijshmit fjalë ka t'i thotë plot,
Por si një i matur
Puna tha s'do zgjatur,
Mê mirë të heshtë se të flasë kot.

Po mjerisht mê vonë
Katundarët t'onë
Një betaj'[67] e rrebtë i lâ pa shtëpí,
Prej të dysh mê shumë
Kamsi mbet për lumë,
Se i muarr ç'kishte, plënk e pasurí

Edhé u mërguan
Lark katundit shkuan
Si njëri si tjetri mbetnë shumë keq,
Në vent tjetër venë,
Një punë të zenë,
Se gjithcili vuan, nga urrija heq.

Dijetar'n e mirë,
Me gëzim, me hîrë,
Gjithë e nderojnë, e pret gjithkush,
Se njeriu i vlerë
Punë gjen me nj'herë,
Andaj dhe dëshirën ç'do njeri ja mbush.

Kamsi i padijshmë,
Mbet fort i përzishmë,
Punë nuku gjente, hiqte mjaft mërzí,
Se të gjith'e dbonin,
Në prak s'e afronin,
Dhe një copë bukë e fiton mezí!

[67] bëtajë = betejë, çkatërrim.

Ahere kujtohet
E thellë mejtohet,
Se kot dijetarit ju turr, kish gabim,
Me vrer e pikllime,
Me lott' e vajtime
Të mentshmin për hera e shkon në kujtim!

Kamja, pasurija,
Shkon, shduket si hija,
Për një të paditur s'kanë meritim,
Por se diturija
Është lumërija
Ka një tjetër vleftë, ká një tjetër çmim!

Për mbi detin e qetë

Sa bukur shtrihet deti,
Sa ka një ëmbëlsí,
Po flé gjithë remeti
Pushim e qetësí.

Të blerta duken malet
Nata nga dal po vjen,
Nër brigjet e nër zallet
Njeriu një prejtje gjen.

Po ngryset, zoqtë flenë,
As një nuk flytyron,
Dhe gjoni[68] lé folenë
E me mallngjim këndon.

Me sulen[69] fort të lehtë
Dikush përtej lundron,
Qetsin' e detit t'qetë
Me rembat ja trazon.

Shetit tyke kënduar
E ikën gjatas kot,
Dhe lundra e harbuar
Me valët kapet lot[70].

[68] gjon = Një farë shpendi i përvajtur, që ia përngjan kukuvajkës e që këndon vajtushëm netët e verës.
[69] sule = Barkë, lundër.

Hëna po del e qeshur,
Heth rezat për mbi det,
Edhé natyr' e veshur,
Me gas të math i pret.

Hyjet vettijn' e ndritin
Dhe deti xhixhillon,
Njerin' e përsëritin
S'ka zenbër që s'galldon[71].

Kështu kalon kjo jetë,
Gëzohi, djelmt' e rí,
Veç Zoti i vërtetë
Të nesërmën e dí!

[70] lot = mundim, vuajtje, etj
[71] galdon = gëzohet, ngazëllohet (ital.)

Mburimi i Çardhakut[72]

Ah, o mburimi i Çardhakut
Sa i ftohtë që jé ti,
Sa dhe djalit edhe plakut
I fal jetë e fuqí!
N'atë shesh n'atë lëndinë
Sa kënaqem që të rí,
Ëndën tënde bukurinë
Kush t'i fali nuk e dí[73]!

Uji jyt fort i kulluar
Por si lot rrijeth, si âr,
Edhé vend' i lulëzuar
Gjelbëron si qehlibar.
Pa më thuaj daç Perëndinë
Kush t'i fali kto dhurtí[74],
Këtë shesh, këtë lëndinë
Pa m'a thuaj që t'a di?

[72]*Çardhaku* është një fushore e vogël për mbi një pllajë një orë lark Korçës, me një mburim me ujë tepër të ftohtë, dëgjuar nër gjithë redhet e qarkut të Korçës (shënim i Kristo Floqit).
[73]Ky është teksti i një kënge shumë të bukur dhe mjaft popullore në Korçë, që këndohet nga grupi artistik "Lira". (H.K.)
[74] dhurti = dhuratë, darovë, falje, regallo (ital.)

Në gjî t'ënt dua të shtrihem,
N'atë prehër, n'atë vrí[75],
N'atë lule të lëvrihem[76],
N'atë sllok[77] atjé të rí.
Dhe kështu si jam etuar,
Etjen t'ime t'a qetsonj,
Në atë livath të shtruar,
Të zbavitem, të pushonj.

Nër ato stolit' e tua
Dua jetën t'a kalonj,
N'atë ambull[78], ah, sa dua
Ç'do mjerim që kam t'harronj!
Oh, sa kam ënd' e dëshirë
Ujën t'ëmbël t'a thëthinj
N'atë hîje të jem shtrirë
Të çlodh këmbët e kërsinj!

Q'atjé lart nga maja jote,
Nga e bukra selí
Që rrëket'i derth si lote
Në për bjeshka, nër lajthí.
Shoh të këndeshëm natyrë
Devoll, Korçë e Ohrí,
Dhe liqenet si pasqyrë
Që shkëlqejnë si florí!

[75] vrî = kullotë dimbri. Pyll i dëndur e i mprojtur prej malesh me kullotë brenda.
[76] Të lëvrihem = të qarkullonj, të vozit, të sillem andej – këndej, të reshperonj, të shkonj posht' e përpjetë.
[77] Sllok = vënd' i naltë pyllor
[78] Ambull = vendi ku mburron uji.

Të kam pirë disa herë,
E s'jam ngopur dot me ty,
Si në ver' e në pranverë
Më vjen se të kam ndër sy,
Nga sa ujë kam shprovuar
Ujë tjetër si ky s'ka,
Dhe ku do që kam jetuar,
Ky kujtim prej mentsh s'm'u nda!

Kush të piu e s'u freskua,
Të shijoj e s'u habit,
Kush të pa e s'u etua,
Të ngjeroj e s'u mahnit?
Kush shkoj njat'[79] e s'tu afrua,
Cilin s'hoqe si magnit,
Cili ambull, cili krua
E ngjall robin e përsrit?

Dhe tani që s'të kam pranë,
Ah ta dish sa dëshironj
Atë hije, atë rânë
Nat' e dit'i ëndërronj!
Do të kem, ah lumërinë,
Ndo një qënq atjé të pjek,
Në limerin[80] me lajthinë,
T'a heth jashtë e t'a djek?

[79] Njat' = aty afër, aty pranë.
[80] limer = vent i fshehtë në mal, ose në pyll ku fshihen e qëndrojnë cubat (hajdutët, kusarët).

Ditët t'ime, ah, si shkojnë,
Si kalon të ritë t'em,
Zembrën, ah, si m'a coptojnë,
Eshtra, gjak m'i bëjnë ujem[81]!
Ah, si kur të ngjitesha pakë,
E t'a njohmnja fytin t'em
Tyke shuar këtë flakë
Që rehat s'më lé të jem!

[81] ujem = të përzjerit, të ngatërusarit, të nakatosurit.

Aht-Marrja

Në të shavi ty njerí,
Të përbuzi, a të ngau,
Mos i mbaj atij mërí,
Mos u msho dhe në të rau[82].

Shko e fli në dhomën t'ënde,
Prit të gdhihet e do shohsh,
Se shpërblimin që përmënde,
As do duash t'a kujtosh.

Gjith' ajo mëri që pate,
Hov' i math, ajy zembrim,
Shkoj me natën, shkoj e vate,
Edhé më s'kërkon shpagim.

Se furrija e marrija
Ngjan si deti me tallas,
Që shkatron lundra, anija,
E mbi shkëmbin i përplas,

Por mbassi kalon stuhija
Deti zbutet bëhet vaj,
Andaj djelm, zembrimi, mrija
Lark jush qofshin paskëtaj!

[82] Rau = rrahu, të rrahu

Sami bé Frashërit

(ELEGJI)

Rrufêja s'bije mbi kallinë
As ferr' e shkarpë s'përvëlon,
Po plepin, lisin e selvinë
E djek e depërton;
Breshri i rrebët në Pranverë
Bar e lëndinë nuk farron,
Po vreshtin, arën kurdo herë
I shtron e i rrënon

O pshat[83] i math i Dangëllisë,
Frashër i bukur, që Atdheu
Të ka si djepin e kombësisë,
Ah, të iku Sami beu!
Nga eshtrat t'ona cop' e vyer,
U nda prej nesh, s'e shohim mê,
Burri i math e i çkëlqyer,
Na la për gjithënjê!

Atjé ku lulja me gas shumë
Ent edhé gjethi gjelbëron,
Ku dallëndyshja për mbî lumë
Ndehet e belbëron,
Ku kenga e vallja bumbullonte
Ku kish pranvera nj'embëlsí
Kû qyq' e belbër të shurdhonte
Sot ndjen një vaj, një zî!

[83] pshat = fshat

O Sami bej, që nuk harrohesh
Punove tepër për Turqi,
Po në Turqi nuku kujtohesh,
Sa sot në Shqipëri!
Për Turqit ishe një i huaj
Po për Shqiprinë babë jé
Ato të pakta vepra t'uaj
Ah, vlejnë fort për né.

Ish *Abdyl beu*, fryma, fuqija
Dhe shpres'e shêjtë për Atdhé,
Ti dhe Naimi diturija
Drit' edhe shpirt për né,
Ish njëri krahu e pushteti,
Grushti i hekurt, një titan,
Po shpirtin ju këtij remeti
Ja dhat' e po e mban.

O atdhetarë, o dëshmorë
Që s'pattë shok njerí,
Ju meriton nga një kurorë
Për veprat për Shqiprí.
Qofshi për jetë të bekuar
Dhe shëmblla ju për brez' e rí,
Qofshi për jetë të nderuar
Abdyl, Naim e Samí!

Tallazi e Detari

Nata e zez' e keqe fort
Vala e egër ndihet,
Si mal, përpjet ngrihet
Buçet e shkumbëzon!
Ndihmo, o Zot, o Perëndi
Shpëtomë lundrën t'ime,
Që të mos bëhet thrime,
Mbi valët kur lufton.

Moti gjëmon e bubullin,
Rrufetë po rëzohen,
Si gjarpërinj lëshohen,
Anijes rreth e qark,
Stuhí e madhe pu shungllon[84],
Lundra kërcen si flutur,
E trembur e e tutur
Prej valësh q'i ka vark!

Ah, do të mbytem, ndihm' o Zot
Ngjat dorën e shpëtomë
Të mjerin ngushëllomë,
Rrezikun m'a largo,
Se rruzullimi ty të ka,
O Zot të qofsha falë,
Qetsohe këtë valë,
Dhe tokën n'a trego.

[84] shungllon = buçet, tingëllon,gumzhit, jehon.

Dervishi

Prej qytetit me trajstën ngarkuar
Një dervish rëzë malit po shkon,
Fort i but' e i qet vazhdon
Me tespijet ndër duar

Të përpjetën me krrabën në dorë
E merr drejt tyke u ngjitur në mal
Krye – unjur, si plak, me nga dal
Ecën varfa[85] i gjorë.

Atjé lart – sa do është mukët[86] –
Një teqé si mermer zbardhëllen,
Që shtektari që lark e shëmbëllén,
Ësht' e ngrehur mbi sukët[87].

Me mjeshtri e kujdesje ndërtuar
Kjo faltore e bardhë si vé,
N'atë shesh majë malit atjé
Shekuj mjaft ka qëndruar.

Udhëtari që shkon në për male,
Shtekëtari, gjahtori q'e njeh,
Kur zé nata vjen çlodhet atjé
Në teqé hyn nga dale.

[85] varfa = dervish

[86] mukët ose mugët, të mugëtit = Kohë mbrëmje, terët, errësirë, koha kur ndizen dritat. Kohë midis akshamit e natës.

[87] suka = kodër, çukë. Mal i ulët i mveshur me drû.

E gjen zjar e të ngrën' e të pirë,
Shtrat e shtresë e fjal' e njerzí,
E bujton si një mik pa mërzí,
E kënaqet mjaft mirë.

Ky plakoshi i mir' e i thinjur
Varfa jonë, dervishi po shkon,
I ngarkuar duron, nuku mshon[88],
Duket q'është i ngjinjur.

Porsa pranë teqesë afrohet
Del Baloshi parpara, ulërin,
Sa njeh varfën me vrap e lëpin
Si një bir i gëzohet.

Dhe dervishi e merr në për duar,
E lëmon e i jep buk' e mish,
Edhé kurrë, dëshirën s'ja prish,
Qenit, shokut besuar.

Pra të dy në teqé të gëzuar
Hyjnë brenda si miq edhé tok
Qen' e ka shërbëtor po dhe shok
Ky dervish i uruar.

Se atjé në teqé ësht' i vetë,
Varfa jonë një shok nuku ka
Pra me Baloshin qesh, lot, bën shakâ,
Shkon të lumur një jetë.

[88] Nuk mshon = nuk ankohet

Po, i është dhé ndihmës Baloshi
Se mbi dborë e akull kuxon
Udhëtarin që ngel ky e çon
Në teqé te plakoshi

Se takon dimbr' i math shumë herë
Që gjahtorin ky befas e zé
Edhe rrugë as një nuk i lé
Gati vdekjen t'i bjerrë.[89]

Pra po qen' i dervishit të gjorë
Ushtëruar si trim vet'e gjen
E me të në teqé bashkë vjen
E shpëton nga kjo borë.

Shumë herë godit[90] ky gjahtori
Thar' e mpirë pa shpirt e pa gjak
Po Baloshi ahere e flak
Për mbi supet i gjori.

Dhe ndër dhëmbë dervishit ja bije,
Ropn' e Zotit q'e gjen e shëlbon[91],
Në teqé vjen e sjell, e lëshon
Varfës mikun ja shpije.

Ësht' i mirë dervishi pa fjalë,
Gjithë bota e njeh e nderon,
Se të varfrit i sheh, i shëron,
Nuk përton, është djalë.

[89] Gati vdekjen t'i bjerrë = t'a shpëtojë nga vdekja
[90] Godit = ndodh që, bën vakì
[91] shëlbon = shpëton, libron.

Bektashí, zembër – bardhë pa masë,
Bën detyrën e tij pa mërzí,
Si besnik agjëron dhe për zî
Të asaj *Qerbelâsë.*

Kal *Niazë* e lus *Fatimenë*,
Një *Hassan,* një *Hyssen*, një *Alí*,
Dhe *Imamit*, *Bektashin Velí*,
Dhe atë *Hatixhenë.*

Si fetak, fanatik s'është kurrë,
Perëndi, pejgamberë beson,
Po edhé kombin e vet s'e mohon,
Atdhetar ësht' e burrë.

Bektashiu nuk bën keq, do të drejtën,
Fen' e tija, po dhé ç'do fé nderon,
Dhé për komp e atdhê gjê s'pêshon
Sa ju fal edhé jetën!

Dhe pa bërë as zhurm' as rëmujë,
Kombësisë i ndih nat' e dit,
Dhé lumninë asaj i gatit
Bujarisht e pa bujë.

Në teqé varfa jon' ësht' i mirë
Dhé sa do rron i ndarë, ashketí[92]
Po punon me të but'e urtí
Për Atdhenë të lirë.

Është varfë vërtet me doktrinë,
Po me zembër i math atdhetar,
Dëshiron me një afsh' e një zjar
Një lumni për Shqipërinë!

[92] ashket = eremit, kallogjer.

Oshenari[93]

Ti ç'rí këtu, oshenar i mjerë
I mbyllur në qelí,
I vetëm, filli ç'po mbjell përherë
Pa shok e pa njerí?
Si zogu i verës[94] që këndon bukur
E s'e sheh dot njerí,
Dhe ti i gjore jé i pa dukur,
Punon, njeri s'ta dí!

Qelin' e vogël në mest të kopshtit
Të pastër për zilí,
E majë malit i falesh Zotit
I vetëm ashkëtí
Kandil i ndezur ty, o uratë
T'a shoh e t'a vé ré,
Si hyll i vogël shkëlqen për natë
Sa zbetë ndrit atjé.

Për kê punon, o mungar i gjorë,
E lodhesh aqë fort,
E s'të rresht kurr as këmb' as dorë
Përse mundohesh kot?
Ti jé i vetëm, plak i drobitur,
I shkret' e filli jé,
Ti djelm e vasha s'ké për të rritur,
Fëmij' e fis nuk ké.

[93]Oshënar = eremit, ashketi, mungar, kallogjèr monastiri, ose kuvendi.
[94] zogu i verës = Pater Gjergj Fishta me këtë emër quan bilbilin (shih "Gjuha Shqype" e Gj. Fishta H.K.)

Sa do t'i thuash s'përgjigjet fjalë
Orvat edhé lëvron,
Si plak që është dal' e nga dalë
Ky punën e mbaron.
Punon pa lodhur e s'përton kurrë
I gjori oshenar,
Me djersë ballit, elp, misër, grurë
Shet, mer argjent e âr.

Në qytet poshtë shkonte me barrë
E bënte tregëtí
Po t'hollat s'deshte pas që t'i marrë
S'i çonte në qelí.
Me ca të varfër, lypës të gjorë
E shihnje shumë shpesh,
Di ç'ka ju vinte mshehtas në dorë,
Di ç'ka ju thosh në vesh.

I ndante gjithë sa pare kishte
Për vehte s'mbante gjê,
Dhe për ç'do vepër i fshehtë ishte
Zakon e kish gjithnjê,
Dhe kur dëgjonte ndo një të mjerë,
Të lik[95], ose ulok
Mungar' i sulej këtij në derë
I lehtë si një zok.

[95] i lik = i sëmurë

Fshatarët gjithë e mbanin n'gojë
I bënin shumë nder
Nga do të vejë, nga do të shkojë
Ky qesen shpesh e nxjer.
Vajza të varfra, i ka pajuar
Së fshehtazi, pa zê,
Mijë të mira, ju ka dhuruar
Pa buj' e pa kurrgjê!

Një natë dimbri disa kusarë
I vijnë në qelí,
Dhe si të egër e si të marrë
I lypin âr, florí.
Po mbassi s'gjetnë e hoqnë xvarë
E e munduan kot,
E xhveshn' e rahnë po si barbarë
Po pare s'gjetnë dot!

Një tjetër herë këta hajdutë,
Si s'gjetnë prap, as gjê
Shpinën ja bënë si bark të butë
Po ky nuk nxori zê;
Dhe një ditë tjetër këta ladutë[96],
Kur udhës i takoj,
Ju ndau ç'kish prurë, e zu t'i zbutë
Dhé në qelí i ftoj.

[96] ladut = njeri i pabesë; shpirtkeq

Si i gostiti bukur e mirë
Të nesërmen i zgjoj,
Ju foli pastër, ju foli dlirë
Dhe mjaft i këshilloj.
Ishin të shenjta, ishin të larta
Këshillat që ju dhâ,
Fjalë të urta, fjalë të ârta,
Ju foli e i lâ.

Pas pak kohë pêsë kalorës
Të ndruar bukur fort
E tyke çarë togjet e dborës
Q' ish rrafshtë mali, plot,
Javo[97] aviten e zën' oborë
Dhé plakut oshënar
Më gjunj' i bijen i puthin n'dorë
Të shënjtit shpëtimtar.

Mungar i gjorë i njeh shtektarët
Që ishin gjith' ata,
I priti mirë – ishin kusarët –
Gëzohet fort q'i pa.
Këta të mjerë, fort të penduar
Me syt' unjur për dhé,
Florinj dy strajsta plakut i nxuar,
I thanë "ah, n'a ndjé"

[97] javo = që, ja ku, n' atë kohë, ahere, befas, papritur.

Po oshënari i ngreh më këmbë
Dhe syt'i derdhin lot,
I dridhet shtati, eshtra e dhëmbë
Ngashrimin s'e mban dot!
Po dhe kusarët zunë e qanin
Me zê si miturí,
E oshënarin me lot e lanin
E ky mallëngjyer rí!

Mungar i ngratë të pes'i mblodhi,
Si ât' i ngushëlloj,
Te Qeverija tok me ta brodhi
Kusarët i liroj
Se Qeverija desh, që t'i zinte
Këta të pês' armiq,
Edhè as nj'herë qetë s'i linte
Ishin njerës të liq;

Ky oshënari, zembër–bujari
Për 'ta ndërmjetësoj
Edhé nga burgu e nga litari
Hajdutët i shpëtoj!
Mungarit t'onë i shkonte fjala
E donte ç'do njerí
Se ky në shumë brenga e vala
U ndoth për Qeverí;

Pra po një fjalë e oshenarit
Kusarët i liroj,
Veprën fisnike të një bujarit
Kjo qeverí e çmoj.
Vjete kaluan... këta kusarë
Që ishin aq të liq
Zunë tregtinë, udhën e mbarë
Me gjith' u bënë miq,

Fituan ndere, fituan pare,
E rronin me njerzí
Dhe karakterin e ndruan fare,
Bënin mjaft mirësí.
N'atë qelinë të vogël shumë
Kandili si shkëndí,
U shojt një natë e ra në gjumë!
.... Qelija mbante zî!

Mungar' i mjerë, shtrirë, i vdekur,
Po dukej si kur flé,
Nuk ish i zbetë, nuk ish i tretur,
Fytyrë – qeshur qé!
Rrotull tij ishin miqtë të pêsë
– Kusarët për njëmënt –
Babën bâmirës qanin pa shpresë
Pa ngushëllim pamënt!

Në për ca shkresa u gjent dhiata
E shkruar prej atij,
Ku kupëtohej se ky urata
Kish mjaft thesar në gjî.
"Kamjet e mija" – thosh në dhiatë –
"Vobekve ju dhuronj.
"Kopshtin bonjakve[98] ju lé dhuratë
"Dhe ndjesën ju kërkonj
"Të holla të tjera që kam nën vatër
"I lé si porosí
"Që të martohen vajza, jo tjatër,
Që s'kanë pasurí".

Afër qelisë një kryq i gurtë,
I bardhë po shëndrit,
Në një kutizë mbi varr'n e murtë
Kandili prapë ndrit.
Mungar' i Zotit aty qetsohet,
Bota e qan me lot,
Pun' e pavdekur e tij s'harrohet,
O, nuk harrohet dot!

[98] bonjak = jetim

Ora

Punonj nat'e ditë
Pa zjar e pa dritë,
Edhé nga të ftohtit nuk dua t'ja dí,
Dimbër, ose verë
Ju xgjonj kurdoherë,
Punonj e pa lodhur,punonj me urtí.

Rrogë s'më paguajn,
As një sent s'më huajn,
Veç kohë më kohë dua një fuqí,
Edhe kur m'a japin
Sa mirë e mat çapin,
Qoftë se më mbajnë në xhep, a në gjî.

Punonj me një rregull
Si në shî, në mjegull,
Brymë, ose vesë ndo një dêm s'më sjell,
Ditën edhe natën
Edhe dikûr datën
I shënonj me masë, si me një pergjell[99].

[99] pergjél = një aparat matje, kompasi, sheshtja

Ju tregonj prap' unë
Dhe detyr' e punë,
Edhe si t'a çmoni dit për dit ju msonj.
Ju msonj të mëngoni[100]
Ju mësonj të nxitoni,
Kohën t'a kurseni si mik ju kshillonj.

Makinën shëkoni
Mjeshtrinë veshglloni,
Si, me një të rafme tik, tik, e tik, tak,
Ju jap të kuptoni
Si do të punoni
Burrë, ose grua, djalë, ose plak.

Djelm këshilla merrni,
Kohën mos e bjerrni
Punoni, vraponi, përpiqi gjithmon,
Përtim të mos kini,
Të plogët mos jini,
Se pastaj pendohi, po do jet von!

[100] Të mëngoni = të çohi shpejt, të ngriheni herët në mëngjes.

Zëri i Atdheut

Si valë deti një zê po gjëmon,
Hapet Qielli lëshon rrufè,
I rrebti tufan
Shungllon si vollkan
Tërmeti dhenë e tunt e çkatron,
Zëri i Atdheut
Hîj' e Skënderbeut
Né, djemt' e tyre n'a thret e na xgjon.

Çohi, Shqiptarë, ardhi dita sot,
Gati gjithë burrat e dheut
Edhè gjithë tok
Lidhi shok me shok
Armët e bardha bekon ajy Zot.
Që Nart' e Tivar,
Prevezë e Shar,
Është vendi jonë, s'mohohet dot.

Prej Mitrovice në Adriatik,
Jakovë, Prishtin' e Ipek[101],
Dibër e Prisdren,
E Kallkandelèn,
Ysqyp[102] e Lumë, Tuz' e Kaçanik,
Pllavë e Ulqyn,
Hott, Grudë e Shëngjin,
Është Shqipëri gjer Ferizovik.

[101] Ipek = Peja e Kosovës
[102] Ysqyp = Shkupi, kryeqyteti i Maqedonisë

Edhè Monastir Përlep e Ohrî
Fllorinë, Kostur, Qypërlí,
Devoll e Dangllí,
Gramôs e Labrí,
Shi prej Gjilâni e në Çamërí,
Si Vlor' e Përmet
Dhe Parg' e Brekdet,
Pogon e Janinë, janë Shqiprí.

Dhe Llak' e Sulit edhè Ajdonât
Konic' e bukur, Vojdhomat,
Krushov' e Dhjavat,
Sajadh' e Filjât
Sazan e Himarë, Fiêr e Berat
Opar, Arbërí,
Shkrapar, Lunxhërí,
Krajë, Vraninë, Shpuz, Danilogrât.

Lè të luftojmë më gjithë fuqí,
Dhen' e shêjtë t'a mbrojmë sot,
Me shpirt e krahror,
Me flî e theror,
Lè të punojmë, o djelm, për Shqiprí,
Flamûrin e shênt,
Ku do, më ç'do vent,
Lè t'a nderojmë me ndere lavdí!

Qyqeja

N'atë pyll e n'atë vrî,
N'ato mrîza e lajthí,
N'ato gjeth' e kullumbrí[103]
Që s'të zè sŷri njeri.
Një zê shpeshi ligjëron,
Po dëgjohet, po tingllon,
Shpirt e zembër të dëfren,
E kërkon e më s'e gjen

Është fshehur shumë thell e s'e sheh dot.

E ka zëthin për zilí
Me një barrë bukurí,
Mrekullí edhe çudí
Më një ëndj' e ëmbëlsí
Kûku, kûku, po këndon,
Nuku rresht, as nuk pushon,
Të mahnit e të habit,
Të zbavit, të përsërit,

Mos kërko me sŷ t'a shohësh, lodhesh kot.

[103] Kullumbrì = një farë shelgjishte që bën një lloj peme si xinxifja

Pushim rrotull mbretëron,
Lulja ent, e gjelbëron,
Bimët çelin me blerim
Me një gas e një pëlqim.
Reze Dielli nuku sheh,
Pŷll' i dëndur nuk të lè,
An' e kant një qetësí,
Ku do shkel e ku do rí.

Po një zû i bukur thellë po vazhdon.

Të galldohet spirti t'ënt
Në këtë të lumin vënt,
Që ka rregull edhè rënt
Më ç'do cep e më ç'do kënt,
Kûku, kûku, po këndon
Nuku hesht as që pushon,
Dhe sa do që e vè rè,
Shpesh me sŷ gjëkûndi s'sheh,

Është qyqja që kaq bukur po këndon.

Një myster duket se ngjan,
Si kur qesh, a si kur qan,
Dhè sa do që veshin mban
Nuk merr vesh se ngaj pëzân,
Kûku, kûku, zê po del
Të kënaq, të ngjall, të çel,
Kush të jetë ajy zok,
Që s'i gjëndet tjetër shok.

Dhe prej vendit nuk të iket, do t'a shohsh?

Oh, sa bukur po këndon,
Dhe sa gjërra të kujton,
Sa mjerimet i harron,
Edhe plagët t'i shëron.
Si t'a quash atë zê,
Që mê t'ëmbël nuk ka mê?
Është qyqeja ajo,
Që s'e sheh, po fort e do,

Nuk nginjesh dit për dit sa t'a dëgjosh!

Gjahtorët

Me mëngjez' e bukur shumë
Dhe gjahtorët kanë dalë,
Bota flè, është në gjumë,
Dhe fullimi fryn nga dalë,
Ata ngritur me të shpejtë
Lenë shtrate, lenë prejtje,
Dhe vërsuen me gjak nxehtë
Shkojnë jashtë me një etje.

E me këmbë fort të lehta
Marrin qenë e langorë,
Që rrëshqasin si shigjeta,
Në për akulla, në dborë,
Ngjeshin rrypa e pallaska,
Mârrin kurthe edhè legje,
Edhè strasta edhè taska,
Brî, turbí edhè fishegje.

Veshin bruca[104], veshin guna,
Edhè majtas një zanuer,
Dhe gati si e do puna,
Eshk' unorë edhè kùer.
Jashtë cingërim i ftohtë
Dhe thëllimi në për bjeshka,
Zogu mshtillet ku gjen ngrohtë,
Dhe në guall rrudhet breshka.

[104] Brucë = Një farë gune e leshtë me flokë, në ngjyrë të zezë.

Po gjahtorin s'e tremp kurrë
As e ftohta, as tufani,
Në për curra, në për gurrë,
Ec pa frikë si luani.
Ky as bishave s'u trembet
As nga cuba e hajdutë,
Me krahrorin çiltas gjendet
Pa u drasht' e pa u tutë.

Ka kërsinj të fortë shumë
Edhè thundra udhëtore,
Kalon mal' e pronj e lumë
Pllaja, brinja e bregore.
Rrug' e gjatë e e madhe
Atij s'i mërzitet kurrë
Breth pa lodhur si zorkadhe,
Si në shesh edhè nër gurrë.

Harron grua, bir' e bijë
Harron babë, harron nënë,
Nuk menton as për fëmijë
Se pas gjahut është shtënë,
Nuk përfill po, as rrëzikët
Që gjahtorin e stërdinë,
Nuku i pêshon armikët
Thînë, ujkun e arinë.

Posa zè të zbardhëllehet,
Fshihet Hëna, agon drita
Kasht' e kumtrit s'shëmbëllehet,
Edhè s'duket Afërdita,
Një zântrí dëgjohet thellë,
Dhe gjahtorët tyke shpirë,
Zenë ushet[105] tyke ndjellë,
Langorecët e rëpirë.

Mbajnë frymën e s'pëptijnë,
Sŷtë katër, veshët ngrehur,
Fishëllejnë, sokëllijnë,
Fort të vrazhët e të nxehur;
Dhe zagarët e stërvitur,
Bredhin leht' e kapin pruan[106],
Dhe nuhatin tyke britur
Gjahut ja gjejnë torruan.

Edhè gjyrmën posa çquajn,
Kaf e *kaf* ulritin, lehin,
Këmba-këmbën gjahn' e gjuhajn,
Gjer t'a çkulin e t'a ngrehin.
Pra gjahtori i harbuar
Shmanget n'ush' e gatit shtizat,
Dhe lëshohet pa duruar
E pret gjahun në për drizat.

[105] Ushe, a = kolibe e vogël gjahu. Kasolle e bërë prej thuprash që mshifen gjahtorët kur gjuajnë shpendët.
[106] Pruan = prè, ja. Kafsha apo shpendi i vrarë.

Po dëgjohet tatëpjetë
Një ushtim edhè një bujë
Ferra, dushnja, gjeth' e fletë
Shkelen grumbull me rëmujë,
Shungullon përoj i qetë,
Tunden lisa, bredhe, pisha,
Shkon për mes posi shigjetë

Derr' i egër, shqerbja[107], bisha.
Pas e ndjek me vrap langori,
Ulërin, nxiton e s'mbahet,
Ikën shkarthi[108], a tërthori.
Këmba-këmbës mê s'i ndahet
Dhe gjahtori tyke parë
Derr'n e egër q'u afrua
Bâm… Dhe derri râ i vrarë,
Râ galamsh[109] e u rrëzua!

Sa gëzim ahere ndjejnë
Si gjahtorë, si zagarë,
Shtrohen sheshazi dëfrejnë,
Posi shokë të pa ndarë;
Dhe si hanë e si pijnë,
Të pangjinjur, të pakorrë[110],
Sdrypin tok me gjahun, thinë,
Si gjahtorë, si langorë.

[107] Shqerbe = egërsinë, bishë.
[108] shkarthi = tërthoras, tërthorazi,kithi.
[109] galamsh = ulok, ajy që s'luan dot nga vëndi.
[110] i pakorë = i lakmuar, i pangopur

Shpeshi ka një tjetër shije
Si thëllëza, si mëllinja,
Shkurta, turtulli kur bije
Në për ara, në dëllinja,
Po dhe gjahu në kënetë,
Në liqen, ose në lumë
Për gjahtorin s'ka të metë,
E do tepër, e do shumë.

Gjahu është i pëlqyer
Për atë gjahtor' e mirë,
Për atë s'ka të rrëfyer
Sa ka ënd' e ëmbëlsirë.
Po gjahtori të mentonjë
Për shtëpi e për fëmijë
Jo të shtihet sa t'harronjë
Grua, nën' e bir' e bijë.

Arth Pranvera

Arth Pranvera, ardhi djelm,
Mbrîni e gëzuar,
Kodra, male, fush e vrî
Me sa shîj' e bukurí
Endin, marrin shpirt të rí,
Çelin të gjelbruar.

Shifni shelgj' e ram' e gjêm,
Lule po lëshojnë,
Dhe natura lulëzon
An' e mb' an po shkelzon,
Bim' e bar e gjeth bleron,
Vjollcat kundrëmojnë.

Shpesh e zoq janë në shênd
Bukur po këndojnë,
Djelli shih sa bukur del,
Edhè gjethi si po çel
Bariu qengjin përkëdhel,
Gjithë po punjnë.

Edhè ju, o djelm të rinj,
Qeshni, mos zemrohi,
Koha juaj, po kalon,
Dhe pranvera vjen e shkon,
Moti kthen e rrotullon,
Losni e gëzohi.

I dënuari

Lamtumir' Atdhè i dashur
Qofsh gjithmon' i lumtur ti
I dënuar e shpirt-plasur,
Sot po shkonj në arratì!
Jam prej fatit i shtërnguar
Dhe në zëmër kam dëshprim
Po të lè i pikëlluar,
Lamtumirë o fshati im!

Qofsh fat-bardhë ti për jetë,
Dheu i shêjtë arbëror,
Prejtje kurrë do mos ketë
Zembra ime, ky krahror!
O Atdhè, s'të harronj kurrë
Se u linda në gjî t'ënt
Ti më rrit' e sot jam burrë
Ty të kam në shpirt, ndër mënt!

Do mos shoh malet e t'ua
Ato fusha e stolì,
Ambull, vijë, kron e prua,
Që rrijedhin për zilì,
Do mos shoh ato bregore,
Ato bjeshka, ato vrî,
Ato brinjat gjelbërore,
Ato lule bukurì!

Do mos kem përpara meje
Ata zoq, ato bagtì,
Do të ndodhem, ah, lark teje
Kur të frynj' ajy verì,
Kur të endin trëntafilet
Sa lark teje do të jem,
Qyqet t'ënde e bilbilet,
S'do t'i shoh nuk do t'i kem!

Do mos shoh lulet me vesë
M' atë herë[111] e blerim
Do mos kem uzdaj'[112] e shpresë
Do mos kem një ngushëllim!
Edhè Prilli e Pranvera
Me aq'ënd' e begatì,
Kur të çelin si nga hera,
Unë jam në arratì!

As ogiçin me këmborë
Cjept' e zilet s'i dëgjonj,
Fyellin, xhuran' e gjorë
Ah, sa do t'i dëshëronj!
N'ato sheshe do mos shtrihem,
Në luadhet plot me bar,
N'ato mriza nuk do mshihem
N'atë djerr, n'atë ugar!

[111] herë = kundërmim, profum
[112] uzdajë = shpresë

Tymin t'ënt që del përjetë
Nga ç'do shtreh' e ç'do pullas,
Edhè mjergullin e lehtë
Ku t'i gjenj, ah, ku t'i has?
Dallëndyshen belbërore,
Ah, sa shpesh do t'a kërkonj,
Dhe thëllëzen malësore
Edhè nj'herë s'e dëgjonj!

Qiell' e bukur, ato hŷje
Ato zalle e lumënj
Ato lisa, ato pŷje
E liqena e përrënj,
Detn' e gjërrë e të gjatë
Me tallas ose kur flè,
Dhe shkëndijat nat-për natë,
Ah, i ziu, ku do t'i lè!

Si fajtor jam i përzënë,
Ikënj që të gjenj shpëtim,
Te armiku të kam lënë,
O Atdhè, o fshati tim!
Nat' e ditë kam punuar,
Të të jap një përparim,
Të të shoh të lulëzuar,
Ky ka qënë faji im!

Sa do shkonj tyk' u larguar,
Tok' e bukur, Shqipërì,
Po në zembër në krahruar,
Ndjenj për ty një shpirt të rì;
Ndjenj një etje të pashuar,
Të përpiqem nat' e dit,
Ndjenj një zë të shentëruar,
Që më ndes e më mahnit!

Valon gjaku në për rëmba
Nat' e dit për ty mentonj
Shpendra, hithra, ferra, gjëmba,
Nuk më trembin, s'i pêshonj!
Ah do vinj' e lumja ditë
Që do ngjallesh e do rrosh,
Që do marrësh jet' e dritë
Dhe ç'do brengë do t'a harrosh!

Lamtumirë pra, o vënde
Lamtumirë o Atdhè
Lamtumirë prehra, kënde
Lamtumirë tok' e dhè,
Lamtumirë fusha e male,
Lamtumirë det, liqen,
E mburime edhè zalle,
Shpirti im si ju nuk gjen!

Valo Flamûr!

(Botuar edhe në gazetën "Perlindja e Shqipëniës"
Vjesht e III Nr. 26 f. 9)

Valo, valo, si të ka hije
Shkrep po si Dielli, vetëtì
Flamûr, o shënjë trimerije
Valona sot në Shqipërì!

Pas kaqe kohë tyranije,
Pêsë qint vjet në robërì
Flamûr, o shënjë trimërijë
Valona sot në Shqipërì!

Shpresa, dëshira atdhesije
Ndjenja të larta, dashurì
Flamûr, o shënjë trimërije
Të presin sot në Shqipërì.

Çohi, o djelmt' e Shqipërisë,
Çlodhi dëshmorët e Atdheut
Valon flamûri i Lirisë,
Flamûr, i kuq i Skënderbeut!

Valo mbi malet e bekuar,
Fushat e brigjet i mbulo,
Valo i mburur i lëvduar,
Valo flamûr, valo, valo!

Ti që e hoqe Skënderbenë
Në lufta e në mundësì[113]
Flamûr, që mpronje, ti, Atdhenë,
Valo dhe sot në Shqipërì.

Po unjim gjûn' e t'adhurojmë,
Po përgjërohemi për ty,
Dhe besa-besën po betojmë,
Armiq s'do lemë me të msŷ.

Rrofsh, o flamûr' i Arbërisë,
Me lavd' e fam'e krenarì,
Flamûr i shêjtë i Lirisë
Valo, valo në Shqipërì!

[113] Mundësì = fitore.

Hymni i Djelmnis

Agoj dita çohi burra, o Luanat e Arbnis,
Trima t'hekurt por si zâna, shkelni vargjet e Robnis,
Dhe në duart tua flakrue t'shêjtin flamur kuq' e zî,
Jepni dorën shoqi-shoqit, lithni bes'e miqësì,

Për Shqypnì, Djelm, për Shqypnì,
Mos duroni t'hujen kambë,
Si një fis e një vllaznì
Mproni vendin pllamb' e pllambë.

Pêsë shekuj, o mjaftojnë, nënë xgjedh' e tyranì,
Mjaft mjerime e potera, tym e mjegull gjer tanì,
E gjallnis ja mrrîni dita, delm vraponi, koha s'pret,
Shkrepi Dielli i Lirisë, zan' i kombit po ju thret.

Për Shqypnì, djelm, për Shqypnì, etj.

Mbi ç'do maj' e ç'do fortesë, ç'do naltsin' e ç'do pullas,
Valon flamur' i madhnushëm me një hîr e me një gas,
Është lavd' i prindve t'onë, n'a e lanë për kujtim,
Do t'a ruajm, do t'a mprojmë si mê t'shëjtin trashëgim.

Për Shqypnì, djelm, për Shqypnì, etj.

Shqype ti, kreshnik' e motit, që në çerdhë pîjtas rî,
Hapi fletët e krenohu, ngjalli zembrat përsërì,
Dhe nga len e perndon dielli zoqt' e tu ku do q'i kè,
Mblidhi tok si kokra meli, por si nan' e tyne q'jè.

Për Shqypnì, djelm, për Shqypnì, etj.

Fusha, male po ushtojnë, zê lirije po tingllon,
Prozhme, bjeshka po jehojnë edhe Leshi po shungllon[114]
Skënderbeu me shpatën xhveshun,
burra, djelm bërtet pa pra,
Do duroni mê të huej, me ju shtyp e me ju da?

Për Shqypnì, djelm, për Shqypnì, etj.

Është turp Atdhenë t'uej ju t'a lini në rrezik,
Thundr' e huej t'ju shkelë, o t'msyjë një armik,
Si e lan' ata të parët krejt të lirë këtë dhè,
Delni zott dhe ju si burra mos ju namin mas' erè.

Për Shqypnì, djelm, për Shqypnì, etj.

Të Shtërgjyshve t'vorfnat eshtna sot po prehen në qetsi
Ktu, atjè hîjet e shëjta ven' e vijnë me ngutsì,
Dhè prej vorrve e ngufon zani, tue bërditë "Lirì", "Lirì",
Agoj dita, çohi burra, sot e sot për Shqipërì.

Për Shqypnì, djelm, për Shqypnì, etj.

Lè të lidhim, pra, një besë për shpëtim e Atdheut,
Të bashkuem, të pa damun si të bijt' e Skënderbeut,
Për madhnin e kombit t'onë jet' e vdekj' e therorì,
Kryenaltë lè t'a shohim plot me lavd' e krenarì!

Për Shqypnì, djelm, për Shqypnì, etj.

[114]Leshi po shungllon = qyteti i Lezhës (Lezha) po ushton.

Dielli perëndoj

U ngrys dita prapë,
Nat' e qet' afroj,
Shkoj e madhja vapë,
Dielli perëndoj.

Hën' e zbetë dolli,
Dritën e lëshoj,
Shih sa gëzim solli,
Djelli perëndoj.

Kthehen bagëtija,
Bujk, barí kaloj
Çlodhen shpeshërija
Djelli perëndoj.

Hŷjtë shkrepëtijnë,
Qjelli krejt ndryshoj,
Ndritin, vetëtijnë,
Djelli perëndoj.

Edhé shkerba, bisha
U shduk edhé shkoj
U fut në për pisha,
Djelli perëndoj.

Sa i qetë deti
Tallazi pushoj,
Flé gjithë remeti
Djelli perëndoj.

Nesër prapë gdhihet
Djelli shkrep, agon
Dhe ndaj natë fshihet
Prapë perëndon.

Dhe njeriu i ngratë
Lind, vdes e mbarron
Bëhet dhé i thatë,
Prapë ngjallet, rron.

Kënga e Ushtarit

Ushëtari i vërtetë
Gjithëmonë ri gatì,
Armët pas duhet t'i ketë
Pushkë, shpatë e zântrì,

Kalit hipur po këndon,
E me vrap me 'të po shkon,
Hop, hop, hop, hop, hop, hop,
Kalë brith, me gallop,
Brith, o kalë, brith o kalë, me gallop,
Hop, hop, hop, hop, hop, hop,
Me gallop.

Shpatën nxjerë, tue vringllue
Msyn armikun me rëmbim,
Edhè kali tue shungllue,
Turret sipër me tërbim,

Kalit hipur po këndon
E me vrap me të po shkon etj.

Plumbat shkojnë si shigjeta,
Bijen kurma vrik mbi dhè,
Përhap tmerrin bajoneta,
Edhe gjaku shkon rrëkè.

Kalit hipur po kalon
E me të me vrap po shkon, etj., etj.

Prîn flamûri tue fllakrûe
Zjarm e flagë sheh gjithkunt
E ushtrija tue shkatrûe
Gjithëmon' anmikn' e munt.

Kalit hipur po këndon
E me të me vrap po shkon. etj., etj.

Ka nevojë piksëpari
Për një zembër, një kuxim,
Se për ndryshe ushëtari,
S'ka një vleftë, s'ka një çmim,

Kalit hipur po këndon,
E me të me vrap po shkon, etj., etj.

Mëshira e Zotit

I.

Dimbri

Dimbr' i math me dborë
Thëllim e tufân,
Dheu i mjer' i gjorë
Ngrirë vè, gollgan,
Jashtë fryn e bije,
Dbora flok-e-flok,
Era shelgjet shtije,
Rrudhet i ziu zok.

Bota ësht' e shkretë
Dheu i bardhë vè,
Lisat s'kanë fletë,
Mot i zî me rè,
Sokëllin Gorreni
Palcën depërton,
Mblidhet shukthi qeni,
Zê gjëkunt s'dëgjon

Fishellèn i marrë
I egri murlân,
Korr, këput heq xvarrë
Fshin rëmben, përlan;
Akull an' e mb'anë,
Moti po rënkon
Ah, të varfrit s'kanë,
Njeri s'i kujton!

I përsllon e ftohta
S'kanë as zjar, as drû,
As shtresa të ngrohta,
S'kan' as një kërcû;
Dridhet shpesh' i gjorë
Shmangur në folè,
Capi me këmborë
Po mërzjen e flè,

Veç'e egra bishë
Posht, e lart po breth
Jehon kresht' e pishë
Shungllon rrap e breth.
Një pushim i gjatë
Një zî, një tmerim
Sa e frikshme natë
Sa keq, sa mjerim!...

Kamësi gëzohet,
Dimbrin s'e pret dot,
Ka zjar e po ngrohet,
Ha e qesh e lot,
Po të varfrin vallë
Kush e shkon nër mënt
Në rron, n'ësht' i gjallë,
Kamsi e përmënt?

O, ju pasanikë
Nuk ju vjen keq
S'kini dhembj' e frikë
Për një rop kur heq?
Kini pak mëshirë,
Kini përdëllim,
Kini shpirt të mirë,

Jepni ngushëllim!
Jini robt' e Zotit
Si ajy si ti,
Po ndryshim' i motit
S'i la buk' as hî,
Duhet pra, të shkretë
Në mjerim t'a lesh
Ajy të mos ketë
E ti të dëfresh?

Mos! Këtij mëkati
Kamës ju largo,
Të dy duart zgjati
T'urëtin kujto,
Edhè mëshiroje
Tregohu njeri,
Të varfrin shpëtoje
Kujto Perëndi!

II.

I sëmuri

Në një fshat atjè rëzë malit
Q'e reh gjëm' e rëmor e tufan
Një rënkim po jehon i një djalit
Edhè vaji i s'ëmës q'e qan.
S'kan' as dritë të mjerët, as pishë,
As qirì, as vaj-gurri, as vaj,
As një shtresë, një plaf, një këmishë,
As një ndihm' a një shpres'a uzdaj!

Tjetër zê nuk dëgjon, gjithë flenë,
Duket fshati se shpirt nuku ka,
As një gjel nuk këndon, po as qenë
S'ulërijnë; një vdekje ka râ!
Gërxhe, rripa, shkëmbinj edhè pllaja
Shungullojn' e gumxhit shpell' e hon,
Fryn stuhija nër pŷje nër maja,
Zër' i bishës buçet e gjëmon.

Për mbi kënt bir' e vetëm sëmurë
Që prej kohësh po vuan e heq,
Mëm' e ngratë, e vèh' e pa burrë
Po e qan se e ka tepër keq!
S'ka me sé t'a mbulonjë e zeza,
Një velenxë, një shkorsh' a plaf[115],
S'ka kësolla as fron' as tryeza,
As mbulesë, jastëk, a çarçaf!

Vatr' e saj ësht' e varfër, e mjerë.
Pa një shkarth, një hardhì, një kërcû,
S'ka kandil, s'ka as vaj që t'i shtjerë,
S'ka kërçele, as shkarpa, as drû.
Dridhet, dridhet, mbërdhin djal' i gjorë,
Se s'ka zjar, as një iskër, shkëndi,
Jashtë fryn me rrebesh, me rëmorë,
Ku të futet i ziu nuku di!

[115] shkorsë = kuvertë leshi, mbulesë, velenxë, tapet i leshtë për t'u shtruar në dysheme. plaf = i njëjti kuptim.

Nuku ka bukë kjo nën' e drobitur,
Ka dy dit me të bir agjeron,
Janë tretur të dy e ronitur,
Pamj' e tyre të vret, të tmeron;
Të këput kjo kërcure mushkritë,
T'a dëgjosh kur zè qan me pikllim,
Dhe mê tepër ndaj natë pa dritë.
Kur vajton e kur s'gjen ngushëllim!

Ah, sa keq të jesh shtrirë e rënë,
I sëmurë, i ftohtë, lipsân,
Pa mbi 'to dhe i urrët pa ngrënë,
Pa fill zjar, pa kandil, pa carrân[116]!
Të mos kesh një të afërm, të dashur,
A një fqinjë, një mik, a një shok,
Të jesh liksht, të jesh keq, buzë-plasur,
Dhe të keqen mos shkosh me të tok!

Kush kuxon atjè poshtë të vejë,
Shkrep e thepa e dborë kush çan,
Djalit t'gjorë një mjekës t'i gjejë,
Kush kalon me të tillë tufan?
Gjith' këto po menton mëm' e mjerë
Dhe tmerohet, e reh vilanì,
Thret, vikat, nuk pushon as një herë,
S'ka m'e madhe për të avanì[117]!

[116] carran = votër
[117] avanì = tiranì

Shtije sŷt'atjé lart mbi korë[118],
Të një shenjti q'i terrët po rì,
Mbi një cep – ku e mban kjo e gjorë, –
Që s'i ndezi kandil, as qirì.
E vé ré m'ato sŷ tuke qarë
E i lutet për djalthin e saj,
T'ja shpëtonjë, t'i marrë për mbarrë,
Se te ky ka një shpres'e uzdaj!

Po mjerisht, djal' i saj nuk ka shpresë,
Ësht' i dobët, shpëtim nuku ka,
Rëmb e gjak, ah ju tretnë si vesë,
As shëkon,as që flet, as që hâ!
Po e ëma dit-prera s'i ndahet,
I rrì sipër, e ngroh, e fërkon,
E me lote e lan, gjê s'i hahet,
Veç të birin t'a ngjallë kërkon.

Në këtë agonì të tmeruar,
Që s'ka shëmbëll, kalon ç'do kufì,
Ku veç vdekja e shkret' ësht'afruar,
Ku s'po ndjehet, s'piptin as njerì,
Kërcet der' e kasolles e shembur
Q' është thurur me thupra, ardhì,
Dhe përnjëriesh një burrë i trembur,
Si një engjell hŷn brenda e rrì!

[118] Korë = konizmë, figurë, ose kadhro e shenjtë

III.

Shpëtimtari

Dimbr' i rrepët kur avritet
Dhe të ftohtit shtrëngon shumë,
Kur thëllimi shtohet, rritet
Edhé ngrin liqen' e lumë,
Gjith' ahere dhe gjahtorë
E kap nj'ënd' e një dëshirë
E çan akulla e dborë
Se ka maleve gjah plot,
Der' i egër n'atë kohë

Gjuhet bukur, gjuhet mirë,
Në për hone, në për llohë[119]
Me një zell' e embëlsirë.
Për gjahtorin e çprovuar
Që e njeh mjeshtrin' e tij,
Ky lloj gjahut s'ka të çmuar,
Vleft' e tij s'sajohet[120] dot.
Në një kohë ksij thëllimi

Ca gjahtorë tyke gjuar,
I zu nata, cingërimi,
E gorreni i tërbuar,
Edhè shkuan u përndanë
Tyke ikur, u larguar,
Po mjerisht një shok e lanë,
Se s'u duk e mê s'u pâ,
Në fshat t'errët e pa-dritë

[119] llohë = Borë e përzier me shi ose me breshër të imët, që bie zakonisht në mot me erë; borë e lagësht
[120] S' sajohet = nuk llogaritet

Atjè ku qan nën' e mjerë,
Posa dëgjon logoritë[121]
Edhè klithmet edhè tmerë,
Vjen avritet ky gjahtori
Zembër math edhè shpirt-mirë,
Ajo vigme[122] nër sŷ mori
Edhè në kasollen râ.

Ndes një drit' i paduruar
Edhè djalin e së vehsë
E merr qetazi ndër duar
E fërkon e i jep shpresë.
Bën një zjar, se ish nevojë
E e ngroh, me vaj e lyen,
Ca rakí i jep në gojë
Edhè t'ëmën e ngushllon,

E pastaj gunën e tija
Ja shtron djalit që të flerë,
Nënës tij q'e shoj uria
I jep buk' e mish e verë.
Ra e ëma me të birë
E u mshtualln nënë gunë,
Për jastëk strajstën e dlirë
Ky i miri ju lëshon!

[121] Logori =Vajtim, të qarit me vaj.
[122] Vigmë = Klithma që nxjerr njeriu në rast fatkeqësie, nga dhembja që ndien etj.; britmë e madhe, sokëllimë. Vigma e vajtores. Ushtoi vigma

Kështu fjetnë atë natë
Dhe të nesërmen pa gdhirë,
Ky gjahtori – pastë uratë –
I merr pas me gas me hirë,
Në qytet i bije pranë,
Në shtëpi të vet' i priti,
I mvesh mir' u jep të hanë,
E i mban që të dy tok;

Prej urisë e prej vdekjes,
Gruan, djalin i shpëtovi,
Prej rrezikut e së keqjes
Që të dy i sigurovi.
S'ish barbar, as ish gjakpirës
Vetëm filli, burr' i shkuar,
Si bujar e si bâmirës
Me të dy ky u bë shok.

IV.

Historija

Në kërthizën e Toskrisë,
Ku mbin lulja e gëzuar
Ku i fal Zoti selvisë
Shtatn' e lartër, të krenuar,
Ku kërcen bredhi përpjetë
Edhè bungu[123] edhè bliri,
E ku endin gjeth' e fletë
Bari, bima për çudi.

[123] bung = një farë lisi, përnar, çinar i vogël.

Ku këndon me zê bilbili
Edhè qyqja tyke qeshur,
Ku çel vjollca, trëntafili,
Dhe natyra ësht' e veshur,
Në një fushë gjelbërore
Një qytet shkëlqen si hŷlli,
Ara ka, pêmë pjellore
E stoli e begati.

Rreth e qark male të naltë
Edhè pŷje edhè lisa
Bleta xgjoje plot me mjaltë,
Dhe të nalta qiparisa
Ku kullosin dhî e berra[124],
Qê e buaj, viç e lopë
Dhe dëshinj[125] e cjep e derra
Dhe të tjera bagëti,

N'ato curra, n'ato shkrepa
N'ato prozhme, n'ato honë,
N'ato gërxhe n'ato thepa
Gjahu gjindet gjithë monë,
Dhe më fort kur er' e marë
Fryn me hov e rrepët shumë
Pyjet mbushen me gjuhtarë,
T'armatisur e gati.

[124] Berr = bagëti e imët
[125] Dëshinj = shumësi i emrit dash

Cok n'atë qytet të bukur,
Q'është djep' i kombësisë,
Q'ësht' i famshëm e i dukur,
Si një hyll i Shqipërisë,
Rronin nj'herë burr' e grua
Dy të rinj, njerës të mirë,
Një bujar që u martua
Me një vajzë bukurí,

S'kishin kamje po jetonin
Me një dashuri të nxehtë,
Që të dy të lumur shkonin,
Pa një breng' e pa të metë,
Por se puna s'i shkoj mbarë
Edhè burri u mërgua,
Gruan n'a e la me barrë
Vetë shkoj në…. Siberi[126]!

Shkuan vjete qysh u ndanë,
Qysh se burri u largua
E me sy të dy s'u panë
Edhè burri u harrua.
Shoqes s'tij Zoti i fali
Një të hijeshm tepër djalë
Q'e pajosi Fuqi-ploti
Me stoli, dhurata plot

[126] Siberi = Kontinent i Rusisë në Azi (Shënim i Kristo Floqit)

Po mjerisht e ngrata grua
Si vobeke, e pa pârë
Si një ambull, si një krua
Kur shterr e s'ka ujë fare
Nuku qeshi s'u gëzua,
Se s'e la poter' e shkretë,
U drobit e u shkretua,
Nat' e dit qante me lot!

Kur e ndjek njerinë fati
E e merr për tatëpjetë,
Kur potera e zapati[127]
Nuk i lenë as një mjetë,
Oh, ahere e mohojnë
Far' e fis e miq e t'afërm,
E përbuzin e përçmojnë
As njeri s'e do, s'e nqas!

Edhè gruaja e shkretë
Me të birin të pa rritur,
Krejt e lënë pa një mshtetë
Dhe prej botës e mërzitur,
Ngrihet ikën prej qytetit
Më një fshat kondis[128] e mjera,
E dëshpruar prej rrëmetit[129],
Veç të bir' e saj merr pas!

[127] Zapat = e keqja, e liga,mjerimi,varfëria, etj.
[128] Kondis = qëndroj në një vent si mik, si mysafir.
[129] Rrëmet = përmbytje, inondim, rrëmujë, pështjellim

Vjete mjaft shkoj në mjerime
Fort e varfër e drobitur,
Plot me lote, me pikllime
Fillja e vet' e djal'i mitur,
Dhe si kur të mos mjaftonte
Kjo e keqe që e gjeti,
Merr një lajm, që s'e mejtonte
Si kur burri vdiq, e lâ!

Oh, ahere e zeza grua
U prish mentsh, s'di ku të futet,
U mahnit e u marrua
E zû dridhet e zû tutet!
Flytyroj dhe kjo uzdajë,
Zija, helmi krejt u fiknë,
Një poterë, një bëtajë[130]
Gruas s'shkret' i shkrep, i râ!

Ah, s'tregohet hidhërimi,
Bolba, helmi edhe vreri,
Varfërija e dëshpërimi,
Vaj' i math, rreziku mneri!
Po i ziu njeri në jetë,
Kur e keqja e merr xvarë
Duhet mjaft durim të ketë
Të gëlltitë ç'do q'e gjet!

[130] Bëtajë = betejë, frikë e madhe, lemeri; poterë.

Pra dhe gruaja e shkretë
Sa do mbet' e vè, pa burrë,
Pa një ndihm' e pa një mjetë,
Shpresën nuk e humbi kurrë,
Të këqijat i duronte
Edhè shpres'e Perëndisë
Shpirt e zembër i ngushllonte
Se veç kjo uzdajë i mbet!

Kaloj moti, s'bëhej fjalë
As për burrin, as për gruan,
Që të dy dal' e nga dalë
Far' e fisi i harruan!…
Burr' i ngratë kur u kthye,
I panjohur, i ndryshuar
Një poterë ndjen mbi krye,
Kur njeri në shtëpi s'gjet!

E lajmuan se u shduknë
Shoq' e tij me gjith' të birë,
Far' e fis' i tij s'u kuqnë,
As turp patnë, as mëshirë!
E kështu ky burr' i mjerë
Për fëmijën q'e desh shumë
Morri vesh se e ka bjerrë,
E se vetë qyqâr mbet!

V.

Të kthyerit

Ishte një pasdreke herë
E së bukurës Pranverë,
Bima, bari e trifili,
Jargavani, trëntafili,
Manushaqja, bosilogu,
Trentelini edhè shtogu,
Kundrëmonin si nga hera,
Fort të kandëshme të vlera,
Dallëndyshja po këndonte
Dhe bilbili ligjëronte,
Fort i kalltërt ishte Qielli,
Shkrepëtinte tepër Djelli
Një blerim me mijra ngjyra
Kaq e bukur ish natyra!

Në një sllok[131] jashtë qytetit
Jashtë bujës e remetit,
Ku fillon një rrug' e gjatë,
Që rreshperon[132] dit' e natë,
Që të çon në një vent tjetër,
Historik e fort të vjetër,
Vent i famshëm që ka nxjerë
Burra, si Lekën[133] e ndjerë.

[131] sllok = vend' i naltë pyllor
[132] Reshperon = ku shkohet rëndom.
[133] Leka = Aleksandri i madh që e kishte nënën nga Berati i sotëm. (sipas Kristo Floqit)

N'atë sllok të gjelbëruar,
Ku të largmit të mërguar,
Me gazment e ëndë priten
Prej kurbetit kur avriten,
Burra grâ të grumbulluar
Di kê presin pa duruar[134].

Vjete shumë i larguar
Një njerí krejt i harruar,
Kthehej nga kurbet' i gjatë
Tepër kamës, i begatë.
Që pra psè me aq gëzime,
Mirakandje e dëfrime
Pritej sot ky i uruar
Prej llauzit[135] t'kurreshtuar,
Dhe sa do që ish i shkuar,
Burr' i thyer i moshtuar,
Bota pa durim e priste,
E për 'të gjithmonë fliste,
E gjithkujt i dukej ëndër,
Do gjith kush t'a bënjë dhëndër!

Sa fuqí që ka ky âri
Sa nderohet dhe druvari,
Faji kurrë s'i rëfet
Fjal' e tij gjith' i pëlqehet
Dhe gabimet trashanike
Janë virtuta fisnike

[134] Në qytetin e Korçës ndodhet një vend i tillë që quhet "Lëndina e lotëve" (H.K.)
[135] Llauz = Gjindje, popull

Dhe sa do q'ësht' i gënjyer
E i rrepët, i rëmbyer
Gjith' ata që e lëmojnë
Që diç presin, diç kërkojnë
Ja pranojnë budallitë
Dokrat, gjepurat, marritë
Ah, njeriu kur ka nevojë,
Myllka sy, e vesh' e gojë!

Miku ardhi prej kurbeti
Dhe shëndosh' e mir' i gjeti,
Dhe pa çlodhur èdhe mirë,
Daç me hîr, daç me pahîrë
Mblesëritë ven' e vinë,
Sa i prishnë qetësinë;
Po shtektari s'ju vè veshin,
Për sa luteshin e theshin,
Mbassi gruan nuk e gjeti
Ju mërzit tepër remeti,
Nat' e ditë i kujtonte,
Gruan, djalin s'i harronte,
Njeri s'qasi, s'u martua
U ftoh krejt, u dëshpërua!

Prej marazit e hidhrimit,
Prej së keqes e dëshprimit,
Râ pas gjahut si i marrë,
U bê shok me ca gjujtarë,
Edhè gjuhante pa masë,
Shkerbën, bishën si t'a vrasë.

Në për male ngrysej, gdhihej,
Në për pyje flinte, shtrihej,
Jet' e tij kështu po shkonte
Far' e fisin mê s'e donte,
Se ja njohu botës s'shkretë,
Dobësin' e ç'do të metë,
Cok si nj' ashkëti jetonte,
Vetëm fill, i shkreti rronte!

VI.

Të njohurit

Gru' e vè me bir' e vet,
Q' i përmblodhi ky gjahtori
Rronin mirë në qytet
Qysh at' ditë që i morri.
Por si syt' i kish kujdes,
Ky bujari i bekuar,
Nat' e dit, mbrëm' e mëngjes
Me 'ta shkonte i gëzuar,
E i donte që të dy
Si t'i kish njerës të vetë,
I shëkonte si dy sy
Rronte një të lumtur jetë.

Lajmi u përhap gjithkunt
Për të vehnë dhe për djalën,
Për gjahtorin flet kush munt
Mbar' e prap' e kthejnë fjalën,
Po gjahtori si bujar,
S'vinte rè, s'dëgjonte fjalë,
Ishte burr' e jo barbar,
I duronte me nga dalë.

Kish ndërgjigje ish njerí,
Fort i urtë e i qetë,
Kish një dhëmbj' e dashurí,
Kish mëshirë të vërtetë.

Djali dal nga dal u rrit
Me arsime e me sjellje,
U shtrua, dhe u stërvit
Si në pritje, në përsjellje,
Dhe gjahtori me gëzim
E vërente si një âtë,
Edhè ndjente një ngushllim
Si këjy, si nën' e ngratë,
Edhè kurrë nuk e shau,
Po si bab' e këshillonte,
Dhe prej gjirit nuk e ndau
Për të mirë gjith' e msonte.

Gruaja e gjorë ish
Një amvisë e shtëpisë,
Edhè kurrë përtim s'kish
I shërbente zotërisë.
Ish e bindur në ç'do ças
Punëtore e shtëpresë
Dhe sa do që s'ndjente gas
Prapë dukej se kish shpresë.
Kush e shihte në veprim
Shërbëtore e kujtonte
Po gjahtori me nderim
Si një zonjë e shëkonte.

Moti një pas një kaloj,
Që kështu të trè jetonin,
Dhe gjahtorin e ngushlloj
Këjo jet' e rè që rronin.
Dhe sa do që kohë shkoj,
Që me ta ish nat' e ditë
Kurrë në për mënt s'i shkoj
Që ky ndodhej me të tijtë,
Edhè kurrë nuk ju dha
Që t'i pyes gjer' e gjatë,
As një fjalë nuk ju tha
Ç'ishin kta të dy të ngratë!

Gruaja e vè një dit
Tepër rëndë n'a sëmurret
Sa u tret e u venit
Thua se vdekja i turret,
Dhe lëngata s'kish shërim
As njeri shpëtim s'i vinte,
Vdirej[136] me një ngashërim
As që hante, as që pinte.
Afër shtratit s'kish njerí
Veç gjahtorin e të birë
Q'i qendronin si qirí,
E që ndjenin një mëshirë.

Dita vjen për fat të keq
Shkrepi kriza e tmeruar,
Kjo e ngrata u tukeq[137]
Ish e zbet' e dobëtuar,

[136] Vdjerr = vdar,prish, shkatrronj, bjerr, fishk, hupënj.
[137] Tukeqem = bëhem keq e më keq

Dhe me syt' e rrita[138] njeh
Mortin që po i afrohet
Dhe të dy burrat i sheh
Edhè pakëz ngushëllohet.
Po gjahtori s'ka ngushllim,
Të dy tok me djalin qajnë,
Rrotull saj me një mallngjim
Po i rin' e po e mbajnë

Me një ankth e një trishtim
I vështron të dy e mjera
Dhe prej zembrës një pshertim
I shpëton po si potera!
Mirënjojtje, evarí[139]
I tregon gjahtorit t'onë,
Dhe të bir' e saj të ri
Ja beson për gjithëmonë!
Gjithashtu dhe bir' e vet
E këshillon që t'a dëgjonjë
E shtrëngon, i lè shendet
E i thotë t'a nderonjë.

Mbi këto prej gjirit t'saj
Një unazë fort të vyer
Me mallnjim edhè me vaj
Djalit t'ri dyke rëfyer
Si kujtim ja dorëzoj
– Se e kish që kur u vlua,–
Dhe me droje ja lëshoj
Edhè fort u pikëllua.

[138] Ritë = Pak i lagët; pak i njomur nga lotët, me lot në sy.
[139] Evari = mirënjohtje.

Zër' i saj gati u prèh
S'kishte mê fuqi të flas
Dhe fytyra fort ju zbèh,
Fyti zû t'i gurgullasë[140]!

Po gjahtori kur e pâ
At' unazë aq' të vyer,
Ju ngjeth mishtë sa ment râ,
U duk tepër i mallnjyer,
Edhè shpejt dorën e ngjat
Merr unazën e sheh mirë
Q'ish praruar me savat[141]
Me një gur krongjill[142] të dlirë.
E përfshin i math hutim
Zallahitet[143] e mahnitet
Një shkëndí shkrep në kujtim
Dhe hutohet e topitet!

Befas gojet i shpëtoj
Një pshertim që tingëllovi,
Dhe të parat i kujtoj
Dhe të gjitha i kuptovi!
"Burri yt, - tha, - unë jam,
Unë jam i ngrati burrë,
Grua djalë ju u kam,
Që nuk po ju gjenja kurrë!"
I përfshin me mall të dy
I shtrëngon me dhembje shumë,

[140] Gurgulloj = Nxjerr një zë të mbytur e të vazhdueshëm.
[141] Savat = zbukurim mbi një send, i bërë me dorë artisti simbas zakoneve të vendit.
[142] krongjill = varg akulli që mvaret mbas çatije.
[143] zallahitet = pështjellohet.

Ju puth ballë edhè sy
Edhè lott i shkojnë lumë!

Oh, s'kallzohet ajy çast
Ky gëzim që nuk pat shëmbëll,
Ky galldim edhè ky rast
Kjo lumní kaqe e ëmbël!
Gruaja u çel, u ngrit
Dhe me nj'an' e lè lëngatën,
U përkëmp, u përsërit[144],
Kjo gjet burrin, djali âtën!
Dhe pushtohen që të trè,
Qajn' e qajn' e më s'pushojnë,
Dhe gjahtori i vè rè,
Njëri tjetrin po shëkojnë.

Kshtu të lumur pasandaj,
Shkuan bukur shkuan mirë,
Gruaja me shoqn' e saj
Dhe i ati me të birë.
Ish çudi këjo njëment,
Ish bekim i shêjt' i Zotit,
Mrekullí që mbahet ment
Dhe mëshir' e fuqi-plotit!
Lum' ajy që ka durim
Edhè shpresë në Perndinë
Lum' ajy që ka besim
Zot'i Math i fal lumninë!

[144] U përsërit = u ringjall.

Kaposhi dhe Brillandi

I.

Kaposhi një dit n'a gjen
Një brillant që fort shkëlqen
Edhe shkon e ja rëfen,
Një ârtarit[145] q'e pëlqen.

Un' i thotë, po e shoh,
Edhè bukur fort e njoh,
Është sent që nuk më ngroh,
Lutem, mere, më shkarko.

Ti më di se jam një gjel,
Që ngorth për ca kokrra mel,
Merre rëskun[146] që të sjell,
Nëm pak krunde, a pak mjell.

Dhe ârtari kur dëgjoj,
Gjelit rëskun ja gllabroj,
Me ca misër ja shpagoj,
Që i hëngri edhè shkoj.

[145] ârtar = zanatçi që punon vetëm arin.
[146] Risk = Fat, lumturi.

II.

Një dit një anallfabet,
Një dorëshkrim n'a e gjet,
Që i zot'i tij kaq vjet
Ish munduar ditt e nett,

Edhè as minutën s'rrí
Po shkon në një librarí
Edhè këtë pasurí
Do t'ja shesë një florí.

Librashitësit i flet:
Un' e di sa vlen vërtet,
Po mbassi ty të përket,
Merre se e kè kësmet.

Edhè ky posa e pa,
E kuptoj q'ish budallâ,
Pêsë grosh qiti i dha,
Ky i mori e gjê s'tha!

I padijshmi nuku çmon
Rëndësin' e punës mirë,
Edhè vleftën s'ja dallon
Mallit t'shtrejt' a rëskut t'lirë,

Andaj është një fatzí,
Gjithë jetën rron i mjerë,
Po i mentshmi s'ndjen mërzi,
Për atë ç'do sent ka vlerë.

Ujku dhe lejleku

Ujku fort i urrët e përfshin një dele
Edhè si e çqevi shtrohet me lakmí
E bën fasha-fasha, e bën zhele-zhele,
E llufat pa korrë[147], me makutërí.
Po tyk' e llufatur n'a i ngel një brinjë,
Nuk e kapërxente, i qendroj në fyt,
Edhè po mundohet e po bën fëllqinjë[148],
Po e shkreta âshtë gati ment e mbyt!
Zgurdullonte sytë s'merte dot as frymë,
E humbet të dhjetën, ka një angushtim,[149]
Krejt i dëshpëruar ardhi më një rrymë
Dhe kërkon të mbytet mbassi s'ka shpëtim.

Po për fat të tija, sheh më tej lejlekun,
Që kulloste qetas për mbi një luath
I tregon me shênja e me të përpjekun,
Bolbën e poterën, hall' e tij të math.
Edhè shtërgu[150] çohet e i qaset pranë,
Tepër u mallnjyer, se i ardhi keq,
Ujkun e shtrin poshtë e e kthen më nj'anë
Dhe me sqepn' e gjate brinjën ja tërheq.
Me një herë ujku, posa u çlirua,

147 Pa korrë = si i uritur, si i pangopur.
148 Fëllqinjë = mundim, përpjekje.
149 Angushtim = siklet, mizori, shtërngim zemre.
150 shtërg = lejlek

Matet që të ikinj pa i bërë zê,
Për bâmirësinë as pak s'u kujtua
E si shpërblim shtërgut nuk i fal as gjê.

Hej! I thotë shtërgu, ku shkon i hutuar
Nuk e njeh të mirën, a po nuk e çmon,
Ky operacjoni, ujk, duhet paguar,
Mos bëj veshn' e shurdhër!…. A po nuk dëgjon?
Edhè ujku gjegjet : Ah, more kumbare,
Ti qënke i çmëndur edhè mos u tall,
Nuk të mjaftovi që s'ta theva fare
Atë sqep me dhëmbë, po të lash të gjall?
Ti s'e di të mirën, dashke dhe shpërblime,
Qënke, t'u ngjat' jeta, fare miturí,
A kè qef t'i njohësh këto dhëmbët t'ime,
Sa forcatë kanë e sa trimërí?
Shtërgu u friksua, ujkun e la qetë
Shkundi krahët nj'herë edhè flytyroj,
M' a punoj, tha, mirë, fajin e kam vetë,
Lavdi pastë Zoti që nuk më trokoj.

Kurdoher' i keqi kur t'a ka nevojën,
Ulet e përkulet, të lëmon të do,
Po kur mbaron punë prapë e hap gojën,
Nuk t'a njeh të mirën, kot mos u mundo!

I pandehuri shent

Një njeri i lehtë, njeri i paditur
Me disa konisma[151] ngarkuar një dit,
Në një fshat po shkonte, i kish për të shitur,
Dhe me katundarët bashkë u stërdit[152].

Gjith' ato konizma këta kur i panë,
Zunë e po falen me një adhurim,
Edhè shumë syresh më gjunjëzaj ranë
Lypin disa ndjesë e disa shërim.

Po truthati jonë këta tyke parë
Tha me ment' e tija, se mos ish ajy
Që e lusnin kaqë gjith' ata të marrë
Edhè u krenua, si bibân[153] u frŷ!

Po atjè ku mburrej ky njeri i rrejtur
Befas një kalorës njatë po i shkon,
Edhè tyk' e parë e tyk' e verejtur
E njeh q'është pykë dhe e këshillon:

[151] Konizma = ikona
[152] Stërdit = has, takonj, gjenj përpara.
[3] bibân = gjel deti

Ti, or zot, i thotë, qënke fare trokë,
Mos e merr për ashpër ti këtë qortim,
Nuk mentohesh pakë, a kè ment në kokë
Për sè këto lutje e ky adhurim?

Hiq ato konizma që t'a shohësh mirë
Se sa të nderojnë ty, more marroc,
Sa të bën lëkura, viç i pa lëpirë,
Dhe sa jè i çmëndur, sa jè torolloc!

Shpesh herë shëkojmë njerí të paditur
Veshur bukur mirë me stoli e sqim
Që kujton i mjeri q'ësht' i mirëpritur
E s'e merr vesh se robja ka atë nderim!

Gjahtori dhe Dragoj

Një dit një gjahtor,
Humbi një langor,
Një klysh fort të bukur, nga raca fisnik,
Dhe po e kërkon
Po nuk e shëkon
S'mundi dot t'a gjenjë, brodhi sa u fik.

Dolli më një shesh
Dhe aty merr vesh
Se langor' e bukur ja përfshin dragoj
E kap një maras,
Tha do shkoj t'a vras,
Luânin e dobët që më përvëloj.

Stërdit një barí,
Një djalë të rí,
E i qahet shumë, dhëmbët i kërcnon,
Pyet me furrí
Dragoj se ku rrí,
Se shpërblim e shpagë dy fijsh i kërkon.

Bariu zè e qesh
Me këtë sý-lesh
I thotë: nga dale mos u bëj kaq trim,
Se ti kur t'a shohsh
Nuk do t'i qendrosh
Pushka s'të bën pare, as që kè kuxim.

Unë e kam mik
S'kam as një rrezik
Se muaj për muaj nga një dash i fal,
Frikë nuku kam,
Krejt i qetë jam,
Shetit nat' e ditë në pŷll e në mal.

Po ky me mërí
Thotë: mor barí,
Ato janë pralla, mua mos m'i shit,
Folë ku e kè,
Pa, pastaj më sheh
Se sa jam i zoti, shpagën si ja qit!

Mbi këtë fjalim
Vjen një ahullim
Malet sokëllijnë, si kur fryn tufan
Befas del dragoj
Bariu ja tregoj
Ja tek ësht' i thotë, sulu në t'a mban.

Po gjahtori mbet,
Ngriu edhè mê s'thret,
S'di ku të futet dhe dyfegun heth,
Hipën mbi një lis
Dhe as pak s'lëvis
Mshihet në për fletët, mbulohet me gjeth.

Frikacar' i lik
Shan kur s'ka rrezik,
Po kur i afrohet trembet e e dron,
Flet e frikëson,
Grushtin i tregon,
Po kur e sheh pranë gjuh' e fjalë ndron.

Gomari dhe Kali

Kali me gomarë shkonin të ngarkuar,
Tyke hequr udhë tyke biseduar,
Por se udha ish e gjatë
Dhe gomari q'ish përpara
I flet kalit të bëgatë,
Se e rëndë ishte barra,
E i lutet t'a ndihmonjë,
Barrën pakë t'ja lehtësonjë,
Se për ndryshe do mbaronjë,
Nuku mundet të duronjë!

Kal' i përgëdhelur tallet me gomarë,
Dhe as gjysmë barre nuk dëgjon t'i marrë,
E kè mir, i thotë mikut
Duro se për pak harrijmë,
Mos ju tut as pak rrezikut
Se do çlodhemi, do rrijmë,
Se nuk është lark qyteti,
As nuk bëhet kijameti,
Duron shumë shpina jote,
Edhè kot ankon zotrote!

Muar të përpjetën kështu tyke shkuar,
Po gomar' i gjorë ish i dëshpëruar,
E rënkon i shkreti shumë
Vuan, rreket, nuku ecën,
I përzishmë e për lumë,
Po kërruset e po ngecën.
Dal-nga-dal' i ardhi fundi
Ra galamsh, palli sa mundi,
Dhe pa marrë të përpjetën,
Veshë-gjati ndrovi jetën!

Për pak mrrîn i zoti, sheh gomar' e shkretë
Që për shkak të barrës kishte ndrruar jetë.
Me të shpejtë e shkarkovi,
Edhè kalit të harbuar,
Gjithë barrën ja ngarkovi,
Dhe sa do q'ish i rënduar
I vû sipër dhe samarë,
Me të bashkë dhe gomarë,
Se lëkurën e gomarit
Do t' ja shiste tregëtarit.

Fqinjën duhet t'a ndihmojmë
Në të keqen që e gjet,
T'a lehtsojmë, t'a ngushllojmë
Me ç'n'a mundet, ç'n'a përket,
Se n'i shkreptë një humnerë
Ç'do pasoj' e heqim nè,
Në një brengë, një poterë
Barr' e tij neve, n'a zè.

Bonjaku[154]

Pa nënë!
Në këtë botë unë jam,
Njeri të dashur nuku kam
I urët jam pa-ngrënë,
Ah, se s'kam pasur nënë!

Pa nënë!
Kush më do mua, kush më mban?
Gjith kush më shtyn, më rreh, më shan,
Kështu më qënka thënë,
Se nuku paskam nënë!

Pa nënë!
S'më nqas në derë as njerí
S'kam ku të flè e ku të rrí,
I shkretë jam, i lënë,
Psè! Se s'kam pasur nënë!

Pa nënë!
Lyp e njerí s'më mëshiron
Njeri s'më do, s'mê dëshiron
Dhe gjithë më përzënë
Se psè nuk paskam nënë!

[154] Bonjak = Jetim

Pa nënë!
Të gjithë lozin shok me shok,
Të gjithë bredhin, qeshin tok.
Të mveshur për të qënë,
Se ata kanë nënë!

Pa nënë!
Ah, vetëm unë s'kam kuxim
Të los me t'a, të ndjenj gëzim
S'më qasin e s'më lënë,
Se s'kam dhe unë nënë!

Pa nënë!
Ku do festím e bukurí,
Ku do dëfrim e brohorí,
Këngë dhe valle zënë,
Po unë që s'kam nënë?

Pa nënë!
S'të njoha dot, as të mbanj mënt,
Pekule, fjalë e kuvënt,
Ah, ku të kam, moj nënë,
E varfra ime nënë!

Pa nënë!
Veç unë qofsha varfanjak,
Vobek i shkretë e bonjak,
I verbër t'isha qënë
Po lè të kisha nënë!

Dhelpra dhe Shtërgu

Dhelpra sy-shkëndija me shtergun sqep-gjatë,
Hasen një dit mb' udhë, zenë miqësí,
Edhè si miqeshë n'a e fton një natë,
Kumtërin[155], lejlekun e thret më gostí.
Edhè kumtri jonë, çapèt si gamile
Merr rrugën e gjatë, i shkon në shtëpí
Mysafir i vete ndrikullores skile
Por si kukumblaqi kur shkon në bujtí.
Dhelpra ish e mësuar të hante fort lehtë,
Ruante stomahun mos pësojë gjë,
Gjellë s'gatoj shumë veç një omletë
E ja vè përpara, unjet ha në 'të.
Po kumbare-shtërgu m'atë sqepn' e gjatë
Nuku ngjeu as nj'herë, prej kripe s'e pa,
Se dhelpra me gjuhën po si një lopatë
I vè dorë gjellës urrët[156] mikn' e la.
Shtërgu s'bëri fjalë, s'i tha gjê, s'u zunë
Përshëndeti ndrikulln e bark-thatë shkoj,
Po turpin që hëngri, gjithë atë dhûnë
Ndrikullës bisht-gjatë kurrë s'ja harroj!
Si kalon një kohë skiles i çon fjalë
N'a e fton për darkë me një dashurí,
Edhè dhelpr'e zgjuar nuk dyshon as âlë,
Shkon te kumtri shtërgu, e si mike rrí.

[155] Kumtër = Kumbarë
[156] Urrët = të uritur

Ani, edhè shtërgu gjellën më një shtëmbë
Miqeshës ja shtrovi edhè vetë ha,
Dhelpra kot mundohet me thonj e me dhëmbë,
Po shtërgu me sqepin as një thrime s'la!
Dhelpra fort e urrët, merr bishtin nër shalë,
Ikën kokë-unjur bëhet koqe-mel,
M'a punoj, tha kumtri, s'ka dyshim as fjalë,
Shkon e mbyllet brenda, nga turpi mê s'del.
Dhelpra aq' e squar shpesh herë gabohet,
Zihet nga të katrat edhè turpërohet,
Kshtu ata që tallen e ata që rrejnë,
Dikur e pësojnë dhe ç'kërkojn' e gjejnë.

Rrëkêja dhe Lumi

Me të math ushtim, me të math rëmbim
Një rrëkè po derdhej prej një shkëmbi
Edhè ç'do që gjen e fshin me terbim,
I vuri përpara e i shëmbi.

Thret edhè buçet, mburret nga do shkon,
Tundet vendi gjithë nga ushtimi,
Njerí s'e kalon, gjithë kush s'kuxon,
Ikën si shigjeta, si vrengllimi[157].

U ndoth një shtektar, q'ish i math pronar,
E që po e ndiqnin ca kusarë,
Po për fat të tij si një shpëtimtar,
Hyn në mest rrëkèja, i ka ndarë.

U harbua fort, hovin kush s'ja ndal,
Ku do shkon hap udhë, rent me valë,
Edhè shgryhen leth, gurë, zhûrr e zdral[158],
S'pat njeri kuximin që t'ja ndalë.

Kështu me vërtik më në funt harrin
Aty afër lumit q'ish i thellë,
Që dukej se flè, dukej se s'pëptin,
Ishte i kulluar si një vrellë.[159]

[157] Vrëngëllim = tingëllim, buçim, jehim.
[158] Zdral = gur të thyer, gurë lumi.

Në furín' e saj nuk mentoj as pak,
Ju duk pun' e vogël, pun' e lehtë,
Tha do t'a shteronj, mos i mbetet vlak[160],
Do t'i los një lodër që di vetë.

Edhè mê s'mënoj[161], mori një vendim,
Edhè si një tigër, si dragua,
Atë që mentoj e vè në zbatim
Edhè lumit barkthi ju lëshua.

Po, që! Posa vjen, buzët ja stërdit,
Lumi hapi gojën e mê s'priti,
Dhe rrëkèn e fshin krejt e gollofit,
E thëthiu të tërë e gëlltiti.

Ruhi, kini mëndjen prej lumit që flè,
Ju rrëmben të gjallë, ju mbyt e s'ju lè;
Njeriu që s'bën bujë, njeriu që nuk flet,
Është i rrezikshmë, ruhu se të vret

[159] Vrell = pus,ambull, mburrim.
[160] vlak = vlagë, lagështi. Mos i mbetet vlak = mos t'i mbetet pikë uji.
[161] mënoj = vonoj.

Të dy miqtë dhe ariu

Ishin nj'herë dy gjahtorë
Shoq të dashur, të vërtetë,
Kishin zënë bes'e dorë
Se do ishin miq për jetë.

Fqinjës tyre lëkurtarit,
Q'ish i pasur, i dëgjuar
Për një shumë paresh ârit
Një arrûshe të tmeruar

Do t'ja binin krejt të gjallë
– Se i duheshe lëkura –
Do t'i bënin ariut ballë
Si fatosa e si burra.

Të dy miqtë t'armatosur,
Marrin fusha marrin ara,
Dhe ariut, tyke kanosur,
I dalin të dy përpara.

Nuk shkoj shumë ariu dolli,
Prej një shpelle i etuar
Edhè sŷtë mbi 'ta solli
Fort i egër, i zëmbruar

Merr një sulm' e ju lëshohet
Do t'i çqyej do t'i çanjë
Prej marrazit ment tërbohet.
Do t'i hajë, t'i përlanjë

Të dy shokët kur e panë
Këtë bishë të tmeruar,
Interesat krejt i lanë
Edhè tepër të hutuar

Njëri pati kohë e kapet
Pas ca degësh të një lisi,
Tjetri s'ka fuqi, s'përçapet,
Mbet, u shtri e më s'lëvisi;

Se e kish dikû dëgjuar
Që ariu njerin' e vdekur,
Sa do qoftë i etuar
E sa do t'a ketë ndjekur,

Nuk e ha, s'e vè në gojë,
I shtërmanget, i largohet.
Pra dhe ky e pa nevojë
Kur ariu zû t'i afrohet,

Të mos marr' as pak firomë,
Mos nuhatet e mos tundet,
Të qëndronjë si kufomë,
Të mos loz' as mos lëkundet.

Ariu, posa ju afrua,
I vjen rotull, i merr erë
Edhè fort u dëshpërua
Kur e pa këtë të mjerë,

Q'ish pa shpirt edhè pa jetë;
E nuhati nj'her' e mirë
Edhè shkoj e la të qetë,
Ndonse ky kish gjakn' e ngrirë!

Si e pa arinë q'iku
Me të shpejtë zbret prej lisi,
Dhe çuditet tepër miku,
Ajy mik q'e la e krisi.

He! I thotë, qënke burrë,
Që s'e pêshon arinë
Ti s'u trempke nga ky kurrë,
Tash t'a njoha trimërinë!

Po, më thuaj t'u ngjatt' jeta,
Ç'thesh ariu që s'e dëgjonja
Ç'ishin gjith' ato të fshehta
Që nuk muntnja t'i kuptonja?

Të të thom, i thotë miku,
Ky ariu më këshillonte
E më thosh se, "ajy q'iku
S'ishte mik, po të mashtronte!

Shoku njihet në rreziqe
Edhe miku në të keqe,
Andaj atë mendje hiqe,
Edhè marrëdhënjen ndreqe!"

I marri e i urti

Një i marrë me gurë po ndiqte
Një të urtë, pa pasur një shkak,
E plagos, e varron, e përgjak,
Edhè dorë më s'hiqte.

Po i urti për pa u zembruar,
Si njeri fort i matur, me mënt,
S'bëri fjalë, as bëri kuvënt,
Si i ditur, i xgjuar.

E me qënë se prapë i marri
Po vazhdonte me turm' e furrí,
Kthen pak kryet e qit një florí,
E ja fal ky bujari.

Morè mik mos u loth kaqe tepër
Po i thotë i urti këtij,
T'a pagova kujtonj me florí,
Këtë mund, këtë vepër.

Po shëko, këtë zêjë të vlerë
Në të tjerë në muntsh t'a zbatoç,
E ahere do nxesh, do kuptoç
Sa fitim do t'të bjerë.

Tek po thoshte kështu dijetari,
Një zotní aty parthi po shkon,
Me dy rojtës të tjerë kalon
Dhe ju turret i marri.

I tërbuar se mori florinë
Që për çmim të mjeshtris'e kujtoj,
Edhè zejën e tij e dymzoj
Ju lëshohet mbi shpinë.

Po përnjerjesh rojtarët t'a zënë,
Më t'a rrahin, t'a kalbin në drû
Më t'i thyejn kërsinj edhè gjû
Dhe të vdekur t'a lenë!

Rob' i keq, rob' i çmëndur, i marrë
Të ngarkohet pa shkak, të çnderon,
Të përbuz, të fëlliq, të poshtron,
Të mërzit tyke sharë.

Po, kur has më të zotin nga nj' herë
I çpaguan të gjitha avrom[162],
Dhe shpesh herë – po thuaj rëndom –
Mbetet kruspull, i mjerë!

[162] Avrom = Pa i numëruar, pa i peshuar e pa i zgjedhur, qesim.

Këshilla për djelmët

Djelm të mitur,
Të parritur,
Djelm të njohmë, djelm të rinj,
Msimet msoni
Dhe dëgjoni,
E mos bëhi të këqinj.

Prindër, msonjës,
Këshillonjës
Që ju japin drit' e msim,
I uroni,
I nderoni
Se për ju heqin mundim.

Shokët t'uaj
Si të huaj
Mos i shihni, jini miq,
Bashkë duhi,
Vllazën quhi;
Jini shokë jo anmiq.

Bëhi t'urtë
E të butë
Dhe të bindur gjithënjë,
Silli qetë,
Pa të metë,
Mos ankohi as për gjë.

Dhe në shkollë
Pa një qollë,
Ballë-lartë, me nderim,
Të punoni
Të vazhdoni
Plot me shpres' e me durim.

Dhe kur hani,
Mos u qani,
Mos hidhnohi pa një shkak,
Mos ankohi,
Mos zemrohi,
Se ju japin shum' a pak.

Kur qortohi
Mos akrohi[163],
Ndonse liksht ju duket sot,
Kur të rriti,
Do çuditi
Se s'ju shan' ata më kot.

Pleq, sakatë,
Po i patë,
Mos i shihni si armiq,
Ngushëlloni,
Përdëlloni,
Mos tregohi zëmbër-liq.

[163] Mos akrohi = mos kanosni, mos provokoni, mos krijoni sherr.

Të vobekët
E fatkeqët
Që po vdesin në mjerim,
Mos i qeshni,
Po i veshni,
Mos i lijni në dëshprim.

Mos lëvdohi,
Mos krenohi,
Si për fis e begati,
Se shpesh herë,
Del m'i vlerë
Një pa plënk e pa shtëpi.

I bukuri Maj

Maji ardhi
Dita zbardhi,
Ngrihi, djelm, të dalim shpejt,
Të nxitojmë,
Të vrapojmë
Ardhi maji, po n'a pret.

Lê, t'a thresim,
Lê t'a presim
Lê t'a shohim me gëzim,
Tuke bredhur
Tuke hedhur,
Tuke lojtur me dëfrim.

Lê të shkojmë,
Të ngjerojmë
Bukuritë që sjell pas,
Të këndojmë,
T'a kremtojmë,
Që po vjen me aqe gas.

Vjen i qeshur
Ësht' i veshur
Plot me lule e stolí,
Me burbuqe,
Lulukuqe
Kush nuk ndjen për 'të zilí?

Furtuna

Ret' e zeza, sterrë
Ndehen për mbi det,
Moti si skëterë,
Vala po buçet,
Fryn stuhí e marrë,
Dhe tallaze ngreh,
Tmer edhè tromarë[164],
Tjatër gjê nuk sheh!

Qiejtë shkrepëtijnë
Ngarkuar me rè,
Zallet sokëllijnë,
Derdhen plot rrufè,
Një anij' e qetë
Po lundron mbi det,
Fort e mjer' e e shkretë
Ah, ç'fat e gjet!

Alburat[165] e thyer,
Nuku ka timon,
Velat e saj çqyer,
Rem' e gjë s'punon!

[164] Tromarë = tromaksje, friksim, trembje
[165] Albura = direk anije

Sillet për mbi valë,
Sillet për mbi det,
Herë shkon ngadalë,
Herë-her' humbet!

Ah, tallaz' i shkretë
E lëkunt e tunt
Nj' her' e heth përpjetë,
Nj' her' e çon në funt,
Vala e tërbuar
E rreh e dërmon,
E ka çkatërruar,
Ah, ç'heq e ç'duron!

Në këtë poterë,
Në këtë trishtim,
Veç një zê i mjerë
Ndjehet si vajtim!
Ësht' i një detarit
Që ankon e thret
Ndodhet buzë varrit
Kot i ziu bërtet!

Thret po zër' i tija
Jehon e humbet,
E rrëmben stuhija,
Që shungllon,[166] buçet!
Me një helm pa shpresë,
Duart kryqëzon,
Para se të vdesë
Qiellin lart shëkon.

[166] Shungullimë =Gjëmim i fortë, oshtimë e thellë, uturimë

"Eja n'a ndihmoni
Mbytemi për ças,
Eja n'a shpëtoni,
Në këtë tallas!"
Thret detar' i gjorë
Dhe pa shpresë rrí
Po mjerisht këtˊ orë
S'e dëgjon njerí!

"Ti, o Zot i jetës,
Ti, o Perëndí,
Dritˊ e së vërtetës,
Ti më sheh, veç Ti!
Varr e shoh për mua,
Para sysh e kam,
Jeta m'u shkurtua,
Pranë teje jam!"

Mê nuk u dëgjua
Zërˊ i tij pushoj,
Vala u harbua,
E përfshiu!…. Mbaroj!

Palloj e bilbili

Palloj i bukur shumë me sqimet[167] e stolitë,
Junonit[168], perëndeshës, i qaheshe një ditë,
I thosh, o perëndeshë
E lumja mbretëreshë
Për sê, nuku më thua,
Nuk është turp për mua,
Të kem kaq' hij' e ngjyra
Të dlirta si pasqyra
Më shndritin pênd' e pupla të ârta një e një
Dhe zêri im i ngrati mos vlenjë as për gjë?

Nuk është gjê e mefshtë, mëkat i pa dëgjuar,
Bilbili aq i vogël, shtrydhaku i llastuar
Të mburret dit e natë
Për zëthin e bëgatë
T'ja thotë aqe mirë
Me ënd' e ëmbëlsirë,
Sa pyjet të shungllojnë
Dhe kodrat të jehojnë,
E unë, kur hap gojën, mërzitet ç'do njerí?
Për Hyjin, kot m'i fale si shtat, si bukurí!

[167] Sqimë = stoli e tepruar në veshje e në paraqitjen e jashtme.
[168] Juno = Perëndeshë si personifikim femëror.

Junoni kur dëgjovi, u pikëllua tepër
Për një ankim të tillë, për një të tillë vepër;
Me nj'herë u zembrua,
U mvrejt, u turbullua,
Edhè me një bisht syri
E vëzhgëlloj e kqyri,
E mê s'e la të mburret,
Sulmën ja pret, i turret,
Me fjalë të ashpra shumë, kështu filloj e tha,
Sa e hutoj palluan edhê në turp e la!

"Pallua, mëndje-lehtë, psè more kaqë flakë,
Kuximin ku e gjete? Pse s'u mentove pakë?
Në vënt që të pushonje
Dhe punën të shëkonje
Rrugën e shtrembër zure
Dhe me bilbil' e vure
Edhê nakarin çfryve
Pa marrë para syve
Se ti jê i pajisur me shumë bukurí,
Me sqime mijë ngjyrash, me shtat e madhërí?

Kush e ka qafën t'ënde, të gjith' ato dhurata
Që shkon si gjenerali kur ecën në parata?
Kê parë një shpesh tjetër
Të tundet aqe tepër
Të ketë bisht të gjatë,
T'ormisur[169], të bëgatë,
Që herë të xvarohet,
Dhe herë të krenohet,
Një shpesh me aq' virtyta, me spilla[170], me stolí
Që duket po si mbreti kur rrî për mbi selí?

[169] Ormisur = zbukuruar, e stolisur
[170] Spilla = Vishem mirë e stolisem, pispillosem.

Ty kush të shef së afri, kujton se ka përpara
Një *bezestên* brillandësh, djamant' e qehlibara;
Kush ka morê i gjorë,
Kaq rrathë e kurorë
Kush e ka këtë ëndë
Kush sillet aqe rëndë,
Kush ecën, nuk më thua,
Si ecën një pallua?
Në botën shpeshë ç'janë, tjetër si ty nuk ka,
Natyra dhurëtitë pa masë ty t'i dha!

Nè shpendevet ju falmë si kujt nga një dërgatë
Dikush ka sqep të fortë, dikush ka thonjt' e gjatë,
Qyqja ka zën' e mirë,
Bilbili ëmbëlsirë,
Një është gjel, një patë,
Tjetri këndon ndaj natë,
Dikush ka trimërinë
Dhe ti kè bukurinë.
Edhè në mos mbyllç gojën, edhê në mos pushofsh,
Do t'të lè shyt[171], pa pêndë, që edhè ti do shohsh!"

U unj palloj i shkretë, u unj se u qortua,
U ruth se s'kish të drejtë dhe fort u turpërua!
Edhè mê s'bëri fjalë,
As që kuxoj t'i dalë,
E njohu që gabovi,
Që fjala i shpëtovi,
Dhe tepër u pendua,
Q'u ngut e u nxitua!

[171] Shyt = i qethur, i coptuar, pa pendë (për shpezët), pa brirë (për kafshët).

Dhe njerëzit e ngratë, po thuaj kështu janë,
Nuku kënaqen kurrë, me sa të mira kanë;
Lakmija shumë herë n'a lè në një mjerim,
Të mirat s'kthehen prapë, dhe faji s'ka pendim!

28 Nëntor 1912

Shndrit ti, o hyll i bukur i Lirisë,
O Diell' i flaktë rezat i lësho,
Për mbi kështjellat mbarë të Shqipërisë,
An' e kant shkelzo
Dhe ti flamûr' i shênt' i Arbënisë
Mal' e kodra e pullas mbulo,
Ngjalli, o ngjalli shpresat e djelmënisë,
Kuq e zî valo!

Është bajram i math, a pashk' e Zotit
Dita e lume që n'a shkrepi sot,
Kû, bijt' e Lekës[172], Burrit[173] e Kastrjotit
Rrëkè derdhin lott?
Jo! s'â bajram, as pashk' as panaïre,
Kjo dit' e bardhë që leu për Shqypní,
Që u këputnë hallka[174] e sinxhire,
Q'u shtyp kjo robní!

Zembr' e Shqiptarit sot tyke flakruar,
Një zjarm po ndjen, një afshë, një gazment
E mizorit'ajo sa ka duruar,
Tash i sjell ndër ment.
Zoqt' e mjerë të shkabës arbërore
T'arratisur nga lèn e perëndon
Çerdhen e gjejnë të shembur mizore
Dhe shkaba i mblon.

[172] Leka = Aleksandri i Math
[173] Burri = Pirro i Epirit
[174] Hallka = pranga.

Prajni muzika, valle e llahuta,
Prajni britme, vigme e brohorí,
Ulni poshtë armë, pushka e huta,
Shtîjza e zantrí!
Oh, që nga vjen ky zê, kjo gjëm' e tmershme,
Një kjo stuhí e rrebët si rëmor,
Që po më sjell ndër ment kohët e hershme,
Në shpirt në krahror?

Mos â tallas, apo shpërthyen retë,
A Qielli mos u çil e bumbullon,
Dhe si shigjeta po lëshon rrufetë,
Dhen' e shungullon?
O Zânë ti, goj-artë e qjellore,
Zân e Shqiprisë që po të vjen keq,
Ligjrona trimin m'atë zê hynore,
Se Shqypnija heq!

O! qënka vetë Skënderbeu i rallë,
Ky që buçet kështu e tingëllon,
Edhè sa do që sot nuk ësht' i gjallë,
Zër' i tij gurgllon!
Prejtje nuk ka në varr ësht' i çqetsuar,
Eshtrat e varfra èdhe s'janë shkrî,
Gjer sa kjo tokë t'jetë krejt libruar,
Kjo toka Shqiprí!

Çoji shtërnipat e Teftës, t'Agronit,
Të Gjencit[175] e Bardhylit, burrit t'dheut,
E djemt' e Ballçës, gjithë pas zakonit,
Bijt' e Skënderbeut,
E lidhni gjithë besën e Shqiptarit
Por si vëllezër q'jeni shok me shok,
Dhe dhen' e trashëguar prej të parit
T'a gëzoni tok.

Turp është për burrninë q'ju dha Zoti,
Të ngelni si të vdekur në plogsí,
Ju, që ju njojti shekulli e moti
Fusha e Malsí,
Sot që për popujt ka aguar dita
E kur gjithcili kërkon shtekn' e vet,
Çilni sytë, avrituni nga drita,
Koha nuku pret!

Pshtymë e flagë, mjegull, tym, shkëndija,
Tomori i Tosknisë po flakron,
Buçimin po e çon te Perëndija,
Hîrën i kërkon.[176]
Përpara, burra, bekim paçi Zotin,
Zëri i ashpër i Atdheut po thret,
O, mos çnderoni Topejt[177], Kastriotin,
Zëri ju bërtet.

[175] Tefta, Agroni, Gjenci, Bardhyli = mbretër Ilirë.
[176] Kristo Floqi në artikullin e tij "Tempull' i Dodonës", të cilin ai e kishte vizituar dy herë dhe shkruar më 1919, thotë se Zeusi (Zoti) i Pellasgëve, nga rrjedhin Shqiptarët, e kishte banesën e tij në majën e malit të Tomorrit në Berat
[177] Topejt = familja princërore e Karl Topisë.

Lê t'i nderojmë ata prindët t'onë,
Për këtë vent, q'e kemi trashëgim,
Që faqe-bardhë ranë gjithëmonë,
Për nder e shpëtim!
Ata me shpata edhè nè me pênda,
Atdhenë ne t'a mprojmë cep e kënt,
Të gjithë, si Shqyptarë, jasht' e brenda,
Me vepra, me mënt.

Djali dhe Zogu
(Dialog)

Djali

Zok i bukur, sa të dua,
Ah, të lutem nuk më thua
Psè po rrí kaqe i mpîtë
Edhè syt' e tu të rittë
Duket se lëshojnë lot,
Ti diç' kè po s'e flet dot!

Psè e shtyn derën nga dalë,
Mos kè shkak, a mos kè fjalë.
Do të shkosh të n'a lesh vetë
Që po sillesh i paqetë?
Nuk kè preje e qetsí
Nuku kè kënaqësí?

Nuk kè haje, nuk kè pije
Nënë streh' e nënë hije,
Nuk po sheh si të qarkojmë,
Si të duam, të gëzojmë
Si të presim të këndosh,
Të n'a ngjallësh, të n'a ngrosh?

Shtroje mendjen edhè zbutu,
Mos u ashpëro, mos ngutu,
Nè shtëpinë dit për ditë
Me trifil e bar të rimtë[178]
Po t'a shtrojmë si e sheh,
Ndo një brengë nuk e kè.

Kokra meli, kërp e fara,
Të gjitha i kè përpara
Ç'të mungon thuaj, tregoje
Veç rri qetë, mendjen shtroje,
Do t'i kesh me një teprí
Si kur jê në bjeshk' a vrí.

Zogu

Ah, o djal' i mirë djalë,
Falem nderit për kto fjalë,
Se i kam ç'do që më duhet
Shkonj kaq mirë sa më s'thuhet,
I kënaqur me ju jam
Për këtë ankim nuk kam.

Po mentohu pak të lutem
Psè s'jam qet' e psè po tutem,[179]
Kam dhe unë bab' e nënë,
Që sot shkretë i kam lënë,
Për ata kam shumë mall,
Nuk e di a i kam gjall!

[178] Rimtë = i gjelbër, jeshil, i blertë.
[179] tutem = friksohem

Djalthi im, ti si do thoshe
Prindt e vet kur t'i kujtoshe,
Si do bënje t'ishe ndarë
Do duronje dot pa qarë?
Edhè unë atë kam,
Andaj kaq i mjerë jam!

Djali

Ah, për Zotin sa pikllohem,
Ah, sa shumë hidhërohem,
Se dhe vetë nuku dua
Të jem kështu si po thua,
Të rronj lark prindve të mij
Krejt i vetëm n'arratí.

Zogu

Edhè un' o djal i mbarë
Për atë jam tyke qarë,
Se që ditën që më zure
Edhè në kafas më vure,
Për ata ndjenj një mallngjim
Edhê s'gjenj një ngushëllim!

Kam për 'ta shumë dëshirë,
Si dhè ti, o djal' i mirë
E jam tepër zembër vrarë
Q'atë ditë që jam i ndarë
Edhè s'di si ndodhem sot,
Ndaj më vjen të qanj me lot.

Dhe tani ata të mjerë
Që ç'do shpres' e kanë bjerrë,
Nuk e di për mua ç'thonë,
Q'i shkretova për gjithmonë,
Bir i vetëm për 'ta jam,
Andaj prejtje nuku kam!

Kush i sheh ata të shkretë
Si e shkojnë këtë jetë
Si bërtasin e si qajnë
E si djalin zî e mbajnë,
Kush një ngushullim ju flet?
Ah, të mjerët se ç'i gjet!

Djali

Praj[180], o zok, se më mallnjeve,
Shpirt e zembër ti m'i theve,
Nuk duronj të flaç më shumë
Të të shoh kështu për lumë,
Fjala jote më pikllon,
Zembra vrer po më kullon!

Zogu

Si kur t'ishe i burgosur,
Mbyllur brenda e brengosur,
Ç'do të theshe, ç'do mejtonje,
Më një vent a do qendronje?
Kamj' e pasje a peshon
Kur kuvlija[181] s'të lëshon?

[180] Praj = hesht, mos fol.

Djali

Kê të drejtë! Se lirinë
E kreu Zoti për njerinë
Ësht' e keqe robërija,
Nuk e do as Perëndija,
Për këtë nuk kundrështonj
As një fjalë nuku shtonj.

Zogu

E sheh, pra mor djal' i mbarë
Se sa jemi për të qarë,
Se prej prindësh jam i ndarë
Dhe lirinë s'e kam parë,
Shih si vuanj e si heq
Më mbeso s'paska më keq!

Në pallase si kur t'isha
Dhe të mira mjaft të kisha,
Do jetonja prap' i mjerë
Prindt, liri kur të kem bjerrë
Më mjafton një gêm në vrí
Se pallas e pasurí!

Pra në daç të mirën t'ime
M' i dëgjo këto rënkime,
Do të jemi miq për jetë,
Miq të dashur, të vërtetë,
Po më dhè nj' atë lirí,
Për mirnjojtje do t'a dí!

[181] Kuvli = Kafaz.

Ah, peshomi këto fjalë
Orè djalë i njohmë djalë,
Dhe t'a dish se nuk pendohesh
Ca mê tepër do gëzohesh
Se dhe mua më çliron
Edhè prindët m'i gëzon.

E shoh që jè zembër-mirë
Lermë pak të jem i lirë,
Të betonj më Perëndinë
Falma, falma ti lirinë
Kij mëshir' e më shëko,
Çilma derën thuajm "shko".

Djali

Mirë fort, po nuk më thua
Si do bënje ti pa mua?
Unë, po të ndahem teje,
Po s'të pata afër meje,
Nuk duronj dot as një dit,
Kënga jote më zbavit.

Pasandaj kam edhè frikë
Të të them "çohu dhe ikë",
Se e di se nuk do kthehesh,
Dhe me mua mê s'dëfrehesh,
E kështu nuk di ç'të bënj
Kur kujtonj që mê s'të gjënj!

Zogu

Të jap fjalën, të premtohem,
Se për ty do përgjërohem,
Do të vinj në kopshtin t'uaj,
Si një mik, jo si i huaj
Dhe ne gas do të këndonj
Se të mirën s't'a harronj.

Shumë herë dhe pa gdhirë
Do të vinj me ënd' e hirë,
Do t'të xgjonj me këngën t'ime,
Nuk të ndahem as një thrime,
Zërin t'em ti do t'a ndjesh
Edhê shtratin do t'a lesh.

Do të vinj nga ndo një herë
Pa pandehur e pa ndjerë,
Dhe në prehër t'ënt do shtrihem
Do shpuplohem e do brihem,
Po nem fjalën që t'a dí,
Se s'më mbyll mê në kuvlí!

Djali

Vërtet thua? T'a zè besë
Do t'a mbash këtë promesë[182]?

Zogu

Do t'a mbanj, po të betohem,
Me ty nuku turpërohem!

[182] Promesë = premtim.

Djali

Do të vish kështu për dit?

Zogu

Atë mos e përsërit!

Djali

Do mbash fjalën?

Zogu

Rrí i qetë.

Djali

Qê, pra, derën t'a hap vetë,
Edhè mos harro fjalimin,
Besën t'ënde e premtimin
Udh' e mbar' e më kujto,
Edhê mikun e mejto. (*I çil derën*)

Zogu

Lamtumir' o mik i vyer,
Miqësin' e kè rëfyer,
Këtë gjê s't'a harronj kurrë,
Se vërtet u solle burrë,
Prite shpejt këtë shpërblim,
Lamtumir' o miku im! (*Shkon*)

Djali (*Vetëm*)

Ah, i shkreti kish të drejtë
Që e desh lirin' e shêjtë,
Se nuk paska si lirija,
Ësht' e keqe robërija,
Zot' i math kështu urdhroj
Nè të lirë n'a krijoj!

Kënga e bonjakëve[183]

Lozën, qeshin e dëfrejnë
Djelmt' e rritun në lumní,
Se ç'ka lypin gjith' i gjejnë,
Kanë plank e pasuní.
Printt e tyne i llastojnë
I kënaqin për ç'do sent,
Lodra shumë ju dhurojnë,
Ah, të lumit për njëmënt!

Në pallase janë rritun,
Kanë nder edhè kimet,[184]
Janë msuem e stërvitun
Bujarisht si ju përket;
Qefin kush s'guxon t'u çartin,
Shërbëtorë kanë plot,
Ku të duan e s'i bartin,
Fjal' e tyne s'ju shkon kot.

O, sa bukur po jetojnë,
Gjê s'ju lypset, s'ju mungon,
Se ju falin ç't'ju kërkojnë,
Si i pasuri kush rron?

183 Kjo këngë u kompozua për bonjakët e "Strehës Vobeksore" të Tiranës, mbas lutjes që n' a bëri Drejtorí e Kryqit t' Kuq. (Ky shë-nim është i Kristo Floqit)

[184] Kimet = vleftë, vlerë.

Mjer' ajy që mbet pa nanë,
Mbet pa babë, mbet jetim,
Ah të varfrit nuku kanë
Lodra, qeshje e ngushllim!
Porse Zoti i Ruzullimit
Liksht të vorfnit nuk i la,
E vobekut e jetimit
Një shërim ajy ju dha.
Kryqit-Kuq i qofshim falë,
Ky u ndoth për nè shpëtim,
S'gjenden dot të mjafta fjalë
Për mirnjohtje e shpërblim.

Nënë strehën vobeksore
Gjejmë prejtje e qetsí,
Gjejmë kshilla miqsore
Edhè msim e drejtësí,
Msojmë zêje e zanate
Mjeshtëri për me fitû,
Pa rreziq' e taksirate
Do të mundim me jetû
Kryq' i Kuq n'a u gjent nanë,
U gjent babë e vëlla,
Edhè prindët në na lanë,
Ajy n'a përmbloth s'n'a la.
Kryq' i kuq bâmirsi jonë,
Pastë jetë e bekim,
Kur të rritemi më vonë
Nè s'ja lemë pa shpërblim.

Pullumbi e Thneglla[185]

Pullumbi tyke pasur etje shumë
Vjen që të pijë ujë në një lumë,
Po atjè ku pinte ujë,
Pa një zê e pa një bujë,
Sheh një thnegëll që po zhytej
Që po kridhej e po mbytej;

Lëshohet, prej mëshiret, i afrohet
E thnegllën t'a shpëtonjë mundohet,
Një fill bari i heth të mjerës,
E shpëtovi prej poterës,
Thneglla shpejt fuqin e mblodhi
Edhê lumin tej e hodhi.

E mbassi kjo rrezikun e kalovi,
Posa që dolli mb' anë vezhgovi
Një gjahtor me hark në duar
Që po vinte tyke gjuar,
Dhe pullumbin desh të vriste,
Në një ferr' aty e priste.

Ahere edhê thneglla u mentua
Edhê gjahtorit pranë ju afrua,
E atjè ku e qëllonte
Edhè thnegllën s'e mentonte
Kjo i derdhet dhe me dhëmbë
E kafshovi liksht në këmbë.

[185] Thnegëll = Milingonë, mizë përdhese, mizë dheu.

Gjahtorit si i dhembi shumë këmba
Ju drodhë të dy duart e pëllëmba,
Dhe pullumbi për së largu
E shëkon q'i bije argu[186]
E kuptoj se prapë miku
E shëlbovi nga rreziku,

Pullumbi kthevi kryet tyke ikur
Edhè kur pa gjahtorin, q'ish i fikur
Me kënaqj' e përgëzovi
Thngellën trime q'ë shpëtovi,
E i thret me gas e hîrë
"Lamtumirë, lamtumirë!"

[186] Argu = harku

Ujku barí

Në një vathë, në një stan
Që kish dhî e berra shumë,
Barinj, qena e stopan[187]
Që nuk flen' as kanë gjumë,

Ujku plak e sheh që s'munt
Të ngjeronjë as një dele
Që s'e nqasin as gjëkunt,
As q'i shkojnë përkëdhele,

E mejtohet për një mënt
Po si një barí mvishet
E s'lè rasje, as lè vënt
Si të vishet e të ngjishet.

Një lëkurë dhelpre gjen
E heth sipër, u ndryshua,
Dhe një shapkë ja mbërdhen
Kryes s'tij e u spillua.

Merr pastaj edhê një shkop
Edhè një xhurâ të vjetër
Dhe u bë po si një shop,[188]
Që s'i lipsej as gjê tjetër.

[187] Stopan = bariu që tunt qumshtin e bën gjalpën, ose ç'do kush që e bën këtë shërbim.
[188] Shop = Njeri i trashë nga mendja.

Për të ngritur ç'do dyshim
Shkroj mbi shapkën këto fjalë:
"Jam bariu i stanit t'im"
"Ujku nuk kuxon të dalë"

Si u ngrit e u storas,[189]
E qëndroj mbi të dy këmbët
Ndjeu në shpirt të tij një gas
Që s'i duken thonjt' e dhëmbët,

Edhê thosh me mentt' e tij:
Ah, sa bukur q'e kam gjetur,
S'më njeh qen, s'më njeh barí,
Që të gjith' i paskam rrejtur!

Sa i marrë e sa pût[190]
Paskam qën' e nuk e dinja
Që në stan si një hajdut
Natën edhè tinas vinja!

Pse të shkonj si një kusar
Me një frik' e tyke dredhur,
Kur kështu rrëmbenj e marr,
Qengjin ftuj[191]' e dashn' e tredhur?

Kështu ujku thot' e flet
Edhè shtrihet në lëndinë
Edhè mendjen mê s'e vret
As për qen' as për barinë.

[189] Storas = qëndronj më këmbë.
[190] Pût = memec, i pagojë.
[191] Ftuj = kec një viti, kec motshak.

Edhe berrat, dhenj e dhî,
Kur e panë ujkun shtrirë,
E pandyen për barí,
Për besnik e për të mirë,

Dhe pa një mejtim të lik
Gjê e gjallë râ e fjeti,
Edhè ujkun si një mik
U gëzua që e gjeti,

Edhè qen edhè barí
Dhe shtërpari[192] e stopani,
Si e panë mikn' e rí,
Ranë e fjetnë tok te stani.

Mbassi fjetnë, ujku plak
Çohet shpejt e pa vonesë
Si veshtor[193] e si pojak[194]
I arth rreth e qark kopesë.

Nga gëzimi vjen i rí
Afër strungës[195] si i pirë
Edhè sgjeth një dash të rí,
Fort të majm e fort të mirë.

Po përpara se e xhvat
Do dhe vetë t'a shprovonjë
Që vërtet ky pati fat
Edhè duhet t'a besonjë.

[192] Shtërpar = bari që ruan delet shterpa.
[193] Veshtar = ajy që ka veshë të mprehtë.
[194] Pojak = Rojtari i arave e i vreshtave, dragat.
[195] Strunga = vathë bagëtish.

Pra e vè në vepërim,
Si barí fillon të thresë,
Po mjerisht nxjer një ulrim
Që shkaktoj një ngatresë!

Oh, ahere, pik në vrap,
Xgjohen qenj barinj, stopanë,
Balua vitheve e kap
Një merr drunë, një kopanë[196],

E t'a shtrojnë ujkun plak
Gjithë kush me ç'munt t'harrinjë,
Kush me drû, kush me dajak,
Sa i thyejnë kosk' e brinjë,

Dhe baliku[197] më në funt
E përfshin në fyt me nj'herë
E kafshon ujkun sa munt
Sa e la pashpirt të mjerë!

Një kusar a një harbut
Bën dikûr se ndron natyrë,
Bota e beson q'u zbut,
Dhe e nqas si një gjymtyrë,

Po zakon' i keq, i lik
Nuk ndryshon, as munt të ndrohet,
Edhè prapë del armik
I del kripa e çnderohet!

[196] kopân = një rrahës prej druri si lopatë me të cilën dikur gratë rrihnin teshat që lanin në lumë apo përrua apo diku tjetër,pirajkë.
[197] Baliku = qeni, balua

Dhelpra e Sqapi

Dhelpra me cjapin bashk' u takuan
Edhè u njojtnë e u bashkuan,
Njëri me brinjët tepër të gjata,
Po edhè trutë tepër të thata,

Dhelpra e xgjuar edhè dredhake,
Dhe mendje-hollë edhè dinake,
Si shkuan gjatë tyke fjaluar,
U lodhë shumë tyke nxituar,

Dhe gjithsecili ndjejnë një etje,
Që pa e shojtur nuk gjejnë prejtje.
Dhelpra finoke passi nuhati,
Edhè turrinjtë passi i zgjati,

Shpejt i vjen era se aty pranë,
Afër një prôni atjê mb' at'anë,
Do gjenin ujë, mburrim a vrellë.
Avriten, shohin një pûs të thellë

Që kish pak ujë, ndo një pëllëmbë
E mbassi s'patnë as kov' as shtëmbë,
Miqt' e etur vrik u lëshuan
Dhe pin' u ngjijnë, etjen e shuan.

Po mbassi pinë s'muntnin të delnin,
E panë bukur se do të ngelnin.
Dhelpra me nj' herë i sillet sqapit,
Mjekër larushit edhè truthatit,

Edhè i thotë "morè kumbare"
E sheh që mbetmë e s'dalim farë?
Ngrehi të lutem, këmbët përpjetë,
Mpshteti pas murit si e di vetë,

Zgjati dhe brinjët, mos loj, mos tundu,
Qendro, rri mirë e mos lëkundu,
Të hippinj unë herën e parë,
Pastaj prej brinjësh ty të heq xvarë,

E kështu dalim, të dy shpëtojmë,
Edhê kuvendin prap' e pasojmë".
I thotë sqapi: "Mir' u kujtove,
Fort mir' e gjete, mir' e mejtove,

Se besa Zotit, thashë se mbetmë,
Dhe ndofta vdekjen këtu e gjetmë".
Kështu gënjëhet sqapi, truthati,
Dhe këmb' e brirë përpjet'i zgjati,

U mshtet pas murit, s'lëvizi, s'lojti,
Sa dhelpra shtrigë hipi, kalojti.
Sqapi i shkretë kur sheh që dolli,
Dhelprës shtrigane sytë ja solli,

Edhè i thotë: "Tash që shpëtove
Hiqmë prej brirësh si m'u zotove,
Dhe pastaj shkojmë ku të duash,
Bëjmë kuvende, bëjmë ç'të thuash".

Dhelpra dinake nuku durovi,
Qeshi sa mundi kur e dëgjovi,
I tha : Kombare, ti po t'i kishe
Menttë në krye kështu s'do t'ishe;

Tani mos folë rrí se jè mirë,
Të rruat mjekra dhe ata brirë.
Unë po ikinj se kam ca punë,
Se mos më ngjasë një tjetër dhunë.

S'kam ngè të sillem, po ti mundohu,
Daç del përjashta, daç rrí qetsohu.
Të lè shëndenë e lamtumirë,
O mjekër-gjatë e mendje-nxirë".

Iku dredhakja, sqapn' e la vetë,
Këmbët mbi murin brinjët përpjetë!
Kështu e pësojnë sa që s'mejtohen,
Kur ju vjen mendja oh sa pendohen!

Dragoj i plakur

Luani i tmeruar
I thinjur, bërë plak,
Mërzitur e rënduar
Dhe pa fuqi pa gjak
Prej shtâzave të tjera
Fort i përbuzur rrí
Nuk është si nga hera,
Nuk e përfill njerí.
Kafsh e bisha ç'janë
I derdhen me furí.
Me dhëmb' e thonj t'a hanë,
Të çfryjnë ç'do mërí
Kali i fut një shkelmë,
Demi me brir' e rrèh,
Ariu i thotë delmë
Ujku me dhëmb' e zè
Dhe dhelpra e çakalli
Gjith kush me thonj e çjerr
Luanit për së gjalli
I pikon buza vrer!
Afrohet dhe gomari
Dragojt t'i marrë hak,
Një shkelm' i jep i marri,
Luanin e përgjak.

Ahere dhe luani,
Vehten me nj'her' e mbleth,
I derdhet si kapllani,[198]
Gomarin posht' e heth.
E bëri fashë-fashë,
E xhvati e copëtoj
Gomarin kokë-trashë
Që fundin s'e mentoj
Dhe tha: Vdekjen e prisnja
Po jo shkelmë gomari
Prej tjetër kujt të vdisnja
Po jo prej një tru-thari!

[198] Kapllan = tigër

E vehja edhè shërbëtoret

Një grua e vehë kish dy shërbëtore,
Edhè i kish msuar tepër punëtore,
Me punën e tyre plaka gjithë merrej,
Në qetsí s'i linte, me ato ushqehej;
Orë nuku kishte, veç një gjel i xgjonte,
Edhè kur ja thoshte vajzat i tundonte.
Qyqet shërbëtore s'ngjinjeshin me gjumë,
Prejtje s'kishin kurrë se punonin shumë.
Kështu koha shkonte, vajzat po mëziten,
Se mundohen tepër e me punë vriten.
Më në funt mejtohen se kaposhit shkretë
Duhet prerë kryet që të mbeten qetë,
Se ky e ka fajin që i xgjon për natë
Me këngën e tija aqe të bëgatë.
Vajzat që të dyja gjelin e dënojnë
Edhè natën tjetër kryet ja shkurtojnë.
Po e vehja grua, gjeli si s'këndonte
Edhè mbassi s'dinte orën që t'i xgjonte,
Filloj q'atë natë mê shpejt të mëngonjë
Edhè shërbëtoret tepër t'i mundonjë,
Sa të mjerat vajza shumë u penduan,
Që n'atë mënyrë pa mënt vepëruan!
Duam t'a lehtësojmë punën nga ndo nj' herë,
Se ndalim' i vogël n'a duket poterë,
Po prej një së keqes ne tjetra takojmë
Pasimet e keqe as pak s'i mejtojmë.

Gomari dhe të zotrit e tij

Qysh me natë i ngarkuar
Dy kofina zarzavate
Qepë, lakra e domate,
E spinaqe e patate,
Një gomar tyke mallkuar,
Di ç'ka theshte, di ç'ka fliste,
E me fatn' e tij ankohej
E hidhrohej e zembrohej
Edh' as pak nuk ngushëllohej
Thua se di ç'ka i ngjiste

Ishte pron' e një kopshtari,
Që për dita e ngarkonte,
Dhe me të në tregun shkonte,
Her' e rriht' her' e qertonte,
Sa dëshpruar ish gomari,
Dhe ç'të bënte nuku dinte,
Me pazí e me lëmpjeta,
Në për treg' e në marqeta,
Fort i që mërzitur jeta,
Se as natën nuku flinte!

Në mëngjes pa zbardhëllyer,
Gjelat posa që këndonin,
Dhe gomarin shpejt e xgjonin
E kofinat ja ngarkonin,
Dhe i ngrati, zembër-thyer,

I drobitur e pa gjumë,
Kështu ecte i ngarkuar
Tyke shar' e tyke mshuar[199],
Këtë fat të paduruar
Që e lâ të mjerë shumë.

Si ju fal e ju lut Fatit,
Edhè Fati e dëgjovi,
Prej kopshtarit shpetovi,
Dhe tabakut[200] ja ngarkovi,
E shpëtoj prej taksiratit.
Po në vënt që të qetsohet
Dhe i lumur pak të rronjë,
Zuri prapë të rënkonjë,
Edhè fatin t'a mallkonjë,
Që e bëri të pendohet!

Me kopshtarin shkonte mirë,
Hante bar e ç'tjetër deshte,
Gjysmë fjale kush s'i theshte,
As e shante, as e qeshte
Po tani er' e pështirë
Prej lëkurëvet i vinte,
Dhe gomari s'e duronte,
Se psè hûndët ja përsllonte,
Dhe shëndetin ja damtonte,
Edhè qetë nuk e linte.

[199] Mshuar = mallkuar, ankuar.
[200] Tabak = ajy që regj lëkurë, lëkurëregjës."tabakut ja ngarkovi" = ia shiti lëkurëregjësit.

I mejtoheshin kofinat.
Zarzavatet lakr' e gjorë,
Që këputte nga një dorë,
Dhe përtypeshe pa korrë[201],
Po tani me nafthalinat,
Që të dobët mbajnë erë,
Me lëkurat fort të rënda,
T'i ngarkojn' edhè ca lënda,
Që gomarit s'ja ka ënda,
Besa dukej mjaft i mjerë!

Prapë Fatit i ankohet,
Do të ndronjë zot të tretë,
Mundim shumë të mos ketë
Dhe të jetë pak i qetë.
Edhè Fati nuk zembrohet,
Prej gomarit s'hidhërohet,
Këtij qefin nuk ja thevi,
Dhe shërbimin ja çkëmbevi,
Qymyrxhinë i rrëfevi,
Dhe vesh-gjati mjaft gëzohet.

Po si ra në atë dorë
Qymyrxhiu gomar' e ngratë
E ngarkonte dit' e natë,
Ku thëngjill, ku drû të thatë,
Sa nuk flinte as një orë.

[201] Pa korrë = nuk ngopeshe kurrë.

Në për pyjet gjith' e merrte,
Në për kodra, në për male
Në për baltra, nër moçale,
Në për gur e në zdrale,
Nat' e dit plot me derte[202]!
Zû t'ankohet edhè nj'herë
Por se Fati u rëndua,
Edhê mê nuk ju durua,
Shumë ashpër u zembrua,
E e zbrazi tërë vrerë.

I bërtet sa ish e mundur:
Brè gomar, ti u marrove,
A e di se u tërbove
Edhè shum' e teprove?
Këput qafën ti i humbur!
Shumë njerës ka në Botë,
Q'e pësojnë si gomari,
Si i vogli, si i pari,
Se s'i lè cmiri, nakari.
Por ata ankohen kotë,
Se nuk gjendet sot një masë,
Të kënaqur mjaft të jenë,
Dhe ankime të mos kenë,
Dhe me Fatin mos e venë,
Në ç'do pik' e në ç'do rasë!

[202] Dert =brengë, shqetësim, hall, gajle, merak.

Larëska me pêndë palloj

Një pallua pêndët shkundi,
Dhe larëska q'u ndoth pranë,
I përmblodhi dhe sa mundi,
Mveshi me 'to gjithë shtanë,[203]
E u nis e u stolis
U spillos e u ormis,
Dhe lëshohet më një herë,
Në një grigje si pallua
Tundet mjaft e bën poterë,
Edhè thret "a ka si mua?"

Po për dreq dikush e njovi,
E mbassi e kqyri mirë
Shokëvet ja u diktovi,
Dhe të gjithë tyke thirë,
Kush e kap e kush e ngreh,
Kush e plas e kush e rreh
Shpinën fare ja dërmuan,
Dhe si byk, si një tuf' kashtë
Si e rrahn' e copëtuan,
Larëskën e nxuar jashtë!

[203] Shtanë = shtatin.

Në mes t'onë, në ç'do qendër
Ka të tillë mjaft pothuaj,
Që pa turp edhè pa sendër
Mburren me veprën e huaj.
Edhè gjith kush mbeson
Edhè punën ja lëvdon,
Po pastaj kur e gjyrmojnë
E ju nxjerrin në shesh punën,
Oh, sa turp të math pësojnë,
Mos e nga, po…. hidhi gunën!

Dhelpra, majmuni e shtâzat

Ngjau dikur – po s'mbahet ment – ,
Vdiq dragoj[204] që ishte mbret,
Edhè kafshët në kuvent
Mshtillen tok si ju përket,
Do të xgjedhin një mbret tjetër
Qoft'i ri ose i vjetër,
Se pa mbret nuk mund të rrijnë,
Këtë gjê të gjithë e dijnë.
Në shesh qitin një kurorë
E sjellin dorë-më-dorë,
Dhe ç'do shtâzë e shprovon,
Po ajo gjëkunt s'qendron.
Dikush kish të vogël krye,
Dikush kokën kish të ngushtë,
Dikush s'dinte m'e mbërthye
Dikush kish të tjerë kushtë,
Dikush brirë sipër kish
Dikush turi-mprehtë ish,
Dikush veshë kish të gjatë
Dikush ishte krye-patë.
Dhe tijâra[205] rrotull vinte
Po as njerit nuk i nxinte.

[204] Dragoj = luani
[205] Tijâra = diademë, kurorë

Më në funt e merr majmuni,
E vërtit si rath në kokë,
Edhè hip majë një hûni
Edhè gjith' ata malokë
Fiken gazit kur e shohin
Dhe për mbret të gjith' e njohin,
Dhe majmunin tyke parë
Unjen, fallen si të marrë.
Dhelprës shum' i ardhi keq
Sepsè zgjodhë një fatkeq,
Mbretn' e rí nuk e pëlqen
Po gjê s'flet, as që rëfen.
Edhè që t'a turpëronjë,
Dhe nga froni t'a rëzonjë,
I ka lojtur një dredhí,
Q' i kushtoj një mbretërí!
Ngreh një kurth me ca hardhí
E sheshoj me dhè të rí.
Madhëri! Kthehet i thotë
Kemi një thesar të fshehtë,
Edhè ti si fuqiplotë
Ke të drejtë t'a marrç vetë;
Vendin e di mirë unë,
Po të duash urdhro vemi,
Për ty ësht' e madhe punë
Një kësij thesar të kemi.
Madhërij' e tij gënjehet
Edhè shkon t'a gjenjë vetë
Vjen në kurth e rëkëllehet
Ra me krye tatëpjetë.

Dhelpra shtrigë kur e pa,
Thiri, qeshi ha, ha, ha!
Morè mbret, u hoth i tha
Sa më qënke budallâ!
Ti kërkon të hipësh fronë,
Që as vehten nuk drejton,
Ti do të jesh mbreti jonë
Që nuk di si n'a urdhron?
Zotrinj kafshë e shëkoni,
Cilin zgjothtë ju për mbret,
Tani rrijni e gjykoni
Tijâra kujt i përket.
Edhè kafshët si e panë
Muarr vesh q'u bë gabim,
Edhè mbretin më t'a rrahnë,
Për këtë të math kuxim.
Dhe kurorës si ja muar,
U betuan me t'vërtet
Se nuk bën kjo për ç'do duar,
Gjithëkush nuk bëhet mbret!

Ndreu dhe vreshti

Ndreu[206] i ndjekur prej langorve,
Ikën, fshihet në një vreshtë,
Dhe nga duart e gjaksorve
Shpëton mir' e pa të mefshtë.
Po si e kaloj rrezikun,
Edhè sa t'i falet nderit
Vreshtit që s'e la të fikun,
Ky s'ja mbushi synë ndrerit,
Po filloj t'i haj' hardhitë,
Aguridh' e ç'tjetër ishte,
– Një dêm që s'ja bëjn' as dhitë –
S'i la lul' e gjeth e ç'kishte.
Dhe si hëngri dolli jashtë,
Edhè vreshtin s'e kujtovi,
Më ca grûnj u fut të lashtë,
Dhe rrezikun e harrovi.
Po langorët q'ishin pranë
Ndrerin posa e nuhatnë,
Të harbuar fill mbi gjahnë
Sulen edhè e ropatnë.

[206]Ndre = dre, dreri.

Ndreu i mjerë shpresë s'kishte,
E shëkon se do të vdesë,
I pênduar tepër ishte,
Po, mjerisht tani s'ka ndjesë
Edhè shpirtin tyke dhënë
Tha : pësova me të drejtë
Mua mos më qoftë thënë,
Që harrova kaqë shpejt.
Atë vresht që më shpëtovi!
Ah, sa isha kokë-trashë,
Makutërija më verbovi,
Që as flet'as gjeth s'i lashë!
Këjo prall' është pasqyrë
Për atë që nuk' e çmovi,
Si t'a lanjë një detyrë,
Pran' atij që e shpëtovi.

Ljepuri e Thëllëza

Një lepur, një thëllëzë,
Na zunë miqësí,
Jetonin më një rëzë,
Të dy me një qetsí
Si shkoj një koh' e gjattë
Një dit se si takoj,
Një qen tyke nuhatë,
Folenë ju zbuloj;
Dhe lepuri me frikë
Shokun e tij e lè
Ky mori pllajën thikë,
Thëllëza në folê.
Si breth i shkreti shumë
E tepër si u loth,
E pa se ish për lumë
Dhe shukthi[207] u përmbloth;
Po qeni ment tërbohet,
I vete gjithë pas,
S'e lè të qetësohet
Të mjerin as një ças.
Dhe lepuri i mjerë,
Kur ndjen qenin që leh
Ikën e bën poterë
Vjen prapë në folè.

[207] Shuk = i mbledhur, i tulitur, kutullaç, i përmbështjellë në një cep, i strukur.

Mjerisht mbi gjithë hallet
Prej shokut s'ka ngushllim
Thëllëza zè të tallet
Me të që s'ka kuxim.
Shumë n'a jè lëvduar,
O ljepur ti, i tha,
Se jè i shpejt'i xgjuar
Po s'bëke dy parâ!
Atjè ku po e qeshte
Me një paturpësí,
Dhe dokra shum' i theshte
Me cmir e ligësí.
Përjashta vezhgëllovi,
Dhe një langor e pâ,
U hoth e flytyrovi,
Dhe ljepurin e lâ.
Kujtoj më kot e shkreta
Me krahët se shpëton,
Q'i kish aqë të lehta
Dhe trapin e kalon,
Po s'dinte, as mejtonte,
Se shkaba sipër ish,
Dhe gjahun e hetonte,
Në vrî a ku të ish.
Kështu lepur i gjorë
Prej qenit e pësoj,
Thëllëza râ në dorë
Të shkabës q'e coptoj!
Mikun t'a qeshim s'duhet,
Kur vuan e kur heq,
Se s'dijmë ç'fat n'a ruhet
Për nè, për mir' a keq

Luâni në luftë

Luani çpalli luftë një dit,
Masat mori u pregatit,
Kafshët e shtâzat gjith' i lajmoj,
Pllanin e luftës ja u caktoj.
Pas pllanit fili[208] për sipër merr,
Topin të mbanjë, të kllasë tmer,
Dhe të luftonjë me një furrí,
Dhe mos peshonjë as një njerí,
Më tjetrën anë edhè ariu,
I pregatitur ishte vetiu,
Për ç'do msyme, për ç'do *yrysh,*[209]
Terën e lagën[210] t'a ndanjë dysh.
Dhelpra dinake e sy-shkëndí,
Rreshtoj ç'do punë, ç'do orendí,
Grigjës shtâzore që ish në vark,
I vinte rrotull, rreth e përqark,
E frymëzonte qen' e zagar,
Kalë e lopë, mushk' e gomar,
Ju thesh të sillen me trimëri,
Edhe më shumë me dhelpëri.
Kështu, me radhë majmun' i zí,
Kish marrë urdhër për ç'do marrzí,
T'i ngreh' armikut prit' e pusí,

[208] Fil = elefant
[209] Yrysh = Hov, vrull, turr; vrap i shpejtë
[210] Terë = i thatë, lagë = lagështi. Barabar me shprehjen: "me nda shapin nga sheqeri".

Me lodra qeshje, majmunësí
E t'a gënjejë me tinësí,
Të mos e lerë në qetësí.
Dikush luânit u hoth i tha,
Dhe një këshillë të mir' i dha;
Ljepur, gomarë t'i dbonjë krejt,
Mos t'i kushtonin luânit shtrejt,
Se psè në luftë keta të dy,
S'hyn në punë, se s'kanë sy;
Se njëri është fort frikacar,
Tjetri i rëndë që s'ha veç bar,
Mundet i pari me një panik,
T'a hedh' ushtrinë në një rrezik,
I dyt'i plogët po zè e pall,
Gjithë armatën e fut në hall!
Po këto fjalë kur i dëgjoj,
Qeshi sa mundi mbreti, dragoj.
Jo, jo, i thotë, ti mos më mso,
Dhe si të duket mos e beso,
Unë di vetë si t'i përdor,
Se psè armiku pa 'ta na korr.
Gomar' e dua për ushtërí,
Si një trumbetë, si një zântrí
Me një të pallur ajy e ngreh,
Gjithë ushtrinë më këmb e vê;
Ljepurin prapë që shumë rent,
E çonj për lajme e për ç'do sent ;
Kemi nevojë s'bëjmë pa 'të,
Po hesht, rrí urtë e mos bëj zê!
Mbreti i mirë e me urtí
Njeh gjithsecilin e thell' e di
Dhe më ç'do rasje e më ç'do vënt,
Si t'a përdorë punën me mënt.

Mushka dhe prindët e saj

Ish një prift e kish një mushkë,
Pullalleshë e larushkë,
Që lëvdohej dit për dit
Si u lint e si u rrit.
Thosh se kish prindër të mirë
Si fisnikë, si të dlirë,
Dhe mê fort t'ëmën lëvdon,
Pêlën trime që nxiton,
Q' ecte bukur, q' ecte lehtë,
Si kaprolle, si shigjetë,
Që përpinte qjej e rè,
Që nuk shkelte për mbi dhè.
Dikur prapë i kujtohej,
Edhè mburrej e lëvdohej,
Qysh e ëma u stërholl,
E qysh lojti të math roll
Në një çirk me akrobatë,
Bashkë me ca kuaj âtë
Kish këtë e kish atë
E s'kish tjetër mbi këtë;
Ish e hijeshm' e krenare,
Madhështore, lozonjare,
Po mjerisht edhè për fat
Një gabim e një mëkat,
Që s'e shkrovi historija
Pêlën q'ishte mrekullija!

Pas ca vjet kjo mushk' u mplak,
Edhè prifti gjeti shkak
Një mullijsit shkoj ja shiti,
Dhe ky në mulli e shtŷjti
E ngarkonte dit për dit,
Aq sa jeta ju xvetrit,
Dhe ahere mushka plakë,
Tyke ngrënë ca dajakë
Kujtoj babë cilin kish,
Që, gomar, vesh-gjatë ish!

Spiro Bellkamenit

(Elegji)

Pusho bilbil, mos ligjëro,
Hesht o thëllëzë belbërorë,
Edhe ti qyqe mos këndo
Me atë qeshje ëngjëllore.
Qáni Spiro Bellkamenë
Trimn' e rî që dogji dhenë!

Ti petrit që po shkon malit,
Ti larash që heq përpjetë,
Dallëndyshe që rij zallit
Dhe ti shkabë që pî retë
Qáni Spiro Bellkamenë
Trimn' e math që dogji dhenë!

Qani fusha, brigje, male,
Kodra, rripa mos pushoni,
Qani shpella e moçale
Qani me zê e vajtoni.
Qáni Spiro Bellkamenë
Trimin që ra për Atdhenë.

O lumënj që po nxitoni,
O ju lisa që rënkoni,
Pŷje, hone, që ushtoni
E ju valë që valoni
Qáni Spiro Bellkamenë
Trimn q'u vra për Atdhenë.

Qaj Kottor, o pshat[211] i bukur
Negovan krye-përpjetë,
Belkamen[212], krenar, i dukur
Spiron që u la të shkretë!
Qáni Spiro Bellkamenë
Që dëshmor ra për Atdhenë!

Qaj moj Shqipëri e gjorë
Djemt' e tu që t'adhurojnë
Që për ty bijen therorë
Dhe flamûrin t'a nderojnë
Qáni Spiro Bellkamenë
Atë trim që dogji dhenë!

[211] Rreth vitit 1912 kur u shkrua kjo vjershë, përdorej fjala "pshat" dhe jo "fshat".
[212] Bellkameni është një fshat në Follorinë të Greqisë, por të gjithë banorët e tij janë shqiptarë.

Papakristo Negovanit

Të vranë të pabesët, o uratë,
Gjakpirësit e liq,
I varfër mbet pa ty Atdheu i ngratë,
Ah, t'egërit armiq!
Rè si dëshmor për Shqipërin' e gjorë
Djamant që s'kishte çmim,
Ti meriton të artënë kurorë
Q' Atdheu t'a jep shpagim!

Me spata e latoshka[213] ty të ranë
Barbarët e këqinj,
Si Krishtin të munduan e të vranë
Gjaksorët faqezinj!
Po trupi yt sado që u mundua,
Ç'do plagë e duroj
Dhe shpirti yt më fort u shentërua
Në Qjejtë flytyroj.

E shihnje po, të mvarrur për mbi krye
Shpatën e Dhamokleut,
Po zembra s'të lëshoj, as q'u gënjye
T'i bjerë dêm Atdheut
Dhe kur e njeh rrezikun e tmeruar
Dhe vdekjen që po vjen,
Ti, pa u tutur pa u trubulluar,
E pret edh' e pëlqen!

[213] Latoshkë = spatë e vogël që presin drû.

Jè ti prej udhëheqëve të parë
Që s'kè kursyer gjê,
Ti për ideal e gjete varrë,
Dëshmor rè për atê!
Të lumtë ajy zê aq' i begatë
Të lumtë ajy fyt,
Gjuha e mprehtë që priste si shpatë
Dhe predikimi yt!

Të larta ndjenjat t'ënde kurdoherë
Jehojnë edhè sot,
Nderove me ato Atdhen' e mjerë,
Mundimet s'vanë kot,
Lëçitës, i doktrinës së krishterë
I gjuhës shqip besnik,
Për mbi altar' e Kombit t'ënt të ndjerë
U duke mjaft fisnik.

Hiq o dëshmor i math i Shqipërisë
N'atë parajs'atjè,
Ti që i çele rrugën djalërisë
Që llas[214] e shpres'i dhè,
Se pêma që e mbolle u rrënjua
Me gzim e lumërí
Nga predikimet e fjalët e tua
U ngjall kjo Shqipërí!

[214] Llas = Hov; guxim i tepruar.

Gjaku i shêjti yt q'u derth përrua
Ajy që tokën leu
Do të shpaguhet se n' a është hûa,
Shpagimn' e lyp Atdheu!
Hekur e zjarm, o djemt' e Shqipërisë
Armikut më ç'do vënt
Mos ja kurseni, ah, gjakpirësisë,
Latoshkat mbani ment!

Kapitan Kamber Ibrahimit

(Elbasanasit)

Ç'ësht'ajy petrit i malit,
Ky fatos i hippur kalit
Trimi që s'ka shok?
Kush po derdhet si shigjetë
E lufton me gjak të nxhetë
N'atë patalok [215]?

Cili ësht'ajy dragua
Që s'menton fëmij' e grua
Që lufton atjê?
Kush s'e njeh luan-Kamberë,
Trimn' e math me bes'e vlerë,
Që vdes për Atdhê?

Qershori shtatë-mbë-dhjetë,
– Ah, o dit' e zezë' e shkretë –
Kapitani râ,
Ra, oh, ra dëshmor Kamberi,
Që s'e trembi flaga, tmeri,
Për Shqiprin' u vra!

[215] Patalok = fushë, shesh, mejdan.

Oh, sa poshtërsí e dhunë,
Të vritet kështu pa punë,
Nga vëllaj i vet,
Ah, rebelë, ah, të marrë,
Ç'doni pshtyr' e ç'doni vrarë
Që s'dijnit ç'ju ngjet!

Ah, padija ku ju shtyri
Sa të mos ju shohë syri!
Ç'bëtë, o të zinj,
Që përpiqeshit për t'huaj
Tyke vrarë veten t'uaj,
Si ujq, si arinj!

Sa e mirë, sa e artë,
Sa e shêjtë, sa e naltë
Do të ish për nè,
Ky gjak vllaznësh q'u derth lumë
Të mos derdhej kot, pa punë
Veç se për Atdhè!

Ndjesë paçi, o dëshmorë,
Me dafina, me kurorë
Ju përcjellim sot,
Bres pas brezi do kujtohi,
Kurrë, kurrë nuk harrohi,
O s'harrohi dot!

Hakki Glinës

O zogu i verës, o djalosh,
Që ecnje si zarkadhe,
O gojë-ëmbël, o bardhosh,
Me vetullën e madhe,
Bir' i Atdheut që rè për tè
Ku vajti ajy zê?

Ku vajti fjala, ajy kuvënt
E qeshura. gëzimi,
Që i përhapnje më ç'do vënt
Dhe shpresa e kuximi,
Ku shkoj gjith' ajo trimëri
Hakki o djal' i rí?

Nuk pate fatin të mbarosh
Qellimet, ëndrat t'ënde
Atdhen' e lirë t'a gëzosh,
Që për të nuk u rënde
Të vesh dhe jetën në rrezik
Si një djalosh fisnik!

Dora e vllathit t' ënt të vrau
Pa dhëmbje, pa mëshirë,
U thaft' e shkreta që n'a ndau
Një shok kaqe të mirë,
Në vluk[216] të jetës, o Hakki
Në atë lumëri

[216] Vluk-gu = kulm, zenith, grada më e lartër

Të qajnë miq me lot nër sy,
Të qan dhe komb' i gjorë,
Dhe Glina jote qan për ty,
E shkreta mbet pa dorë,
Të qan dhe nëna, të vajton
E zeza nuk pushon!

Atdheu i jonë mbase sheh
Djelm po si ty të tjerë,
Po mëm' e shkretë që e lè
Të varfër e të mjerë,
A munt të ngushëllohet dot
Për plagën që ka sot?

Me lule e dafina plot
Të thurura kurorë,
Dhe syt' e ngrata çurk në lot
Ne dhe jot ëm' e gjorë
Një "udh' e mbarë" me hidhrim
Të çojmë, ty, o trim!

Ceno Sharrës[217]

(Prej Vlore)

Kush do më thesh se dhëndr' i rí
Një jav i martuar.
Gruan e tij si një selví,
T'a lerë pa mejtuar,
Edhe me vrap e me nxitim
Të marrë arm' e hutë
Edhè të sulet pa përtim
Me këngë e me llahutë
Në luftë, në gjaksí?

Kush do më thesh se një bujar,
I pasur i bëgatë
Do të tregohej aq krenar
Në një kësij dërgatë
Sa mos kujtonjë lumërí
E kamje e thesarë
Përveç flamûr e Shqipërí
Edhe si një i marrë
Të derdhë gjakn' e tij?

[217] Hysen Sharra është vrarë nga rebelët e Haxhi Qamilit, por edhe një pinjoll tjetër nga familja Sharra e Vlorës, inxhinieri Abdyl Musa Sharra u pushkatua nga Diktatura më 1946 (H.K.)

Po si një shkabë, si një shpesh
Në Durrës flytyrove,
Gjê s'more sysh, as vure vesh
S'i matte s'i peshove,
Luân i gjallë me rëmbim,
Nga Vlora ike, shkove,
Në sheshm' e nderit po si trim
U hodhe e luftove
O Ceno me kuxim!

Por si një burrë ik' e lè
Gruan jetime, shkretë,
Dhe si dëshmor për kombin rè,
Por si një trim me fletë,
Vlora e gjorë ty të qan
Dhe Labëri' e tërë,
Rè si dragua si luân
Fisnik e zembër gjërë
Shqipëria zî të mban!

Themistokli Gërmenjit

U gdhi! E zbetë dritë
E ditës zezë agoj
Në burgun hyn të rritë[218]
Ku qetë flè dragoj.
E xgjon, çohet me nj' herë
Edhè si ka zakon
Armët si kurdoherë,
Armët e tij kërkon,
Ah, armëtë kreshnike
Breshâne[219], revolver,
Pallaskatë[220] fisnike,
Që janë frik' e tmer.
I lyp po…. Nuku janë
Thonj, dhëmbë s'ka dragoj,
Zhgulur, mjerisht, ja kanë,
Trathtija e dënoj!
Hîdhet, bërtet si burrë,
Thret, shokët djemt' e rí,
Ata që s'tremben kurrë,
Po…. S'e dëgjon njerí! ….

[218] Të rritë = terri, errësira.
[219] Breshâne = Pushkë e gjatë e vjetër.
[220] Pallaska = Qese lëkure për të mbajtur fyshekët në brez, fyshekore.

….Ora tingëlloj fatale
Luâni syt'i çel,
Dera kërcet nga dale
Edhè xhelati del….
Po burri nuku trembet,
Frikë as njeh, as di,
Nuk mshon, as nuk shembet,
Xhelati bën çudí!
Vè gishtin e mendohet,
Të parat i kujtoj
Për Korçën s'ngushëllohet
Për Korçën q'e shpëtoj!
Jeta e tij bujare
Ç'do flí e therorí,
Jeta e tij krenare
Që rodhi për Shqiprí.
Ç'do cep i Toskërisë,
Majë, limèr e kënt,
Veprat e trimërisë,
Herôji sjell ndër mënt!
Fatosit të vërtetë
Për vdekjen s'i vjen keq,
Ky nuk menton për jetë,
S'vuan për të, as heq.
Ëndrën e pa të çfaqur,
Lirinë e gëzoj,
Ndërgjigjen e kënaqur,
Qellimin e mbaroj.

Po, ah, kur i kujtohet
Q'e trathëtuan kot,
Zembra nuk i qetsohet,
Nga syt'i shkojnë lot!
Të vdesë, po, si burrë
Për Komp e për Atdhè,
Të mos kursehet kurrë
Për Shqiprin' e rè,
Po jo edhè të vdesë
Për ca të huaj kot
Për t'huajn interesë
Të falë jetën sot!
Po burri nuku tutet,
Mendjen me nj'her' e mbleth,
Zembra e qet' i zbutet,
Xhelatit syt'i heth:
Vemi, i tha, jam yti,
Nga vdekja frikë s'kam,
I pari, as i dyti
T'a dish se nuku jam!
Njiheni sot Shqiptarin,
Vdekjen s'e bën për gjê,
As pushkën as litarin
Nuk i përfill, s'bën zê!
Këto tha edhe s'priti,
Xhelatit i ra pas
Në *Golfgodhánë*[221] zbriti
Vdekjen atjè e has!

[221] Golgota = kodër jashtë mureve të Jerusalemit, ku u kryqëzua Jezu Krishti.

. . . . . .
. . . . . .

Një batarè mizore
Erën e tunt, shungllon,
Prej dorës trathëtore
Themistokliu mbaron!
Shpirti i shkon përpjetë
Më një[222] m'atë gjëmim,
Bashkohet tok me retë
E gjen një ngushëllim.
Edhè me retë bashkë
Në qiejtë flytyron,
Thua se kanë Pashkë
Se Shqipërija rron!

[222] Më një = menjëherë

Meleq Frashërit[223]

Gryka, kodra po rënkojnë
Ngushëllim nuk gjejnë dot,
Meleq Frashërin kërkojnë
Mbajnë zî e derdhin lot,
Qajnë fusha, qajnë male,
Qajnë pyje e përrenj,
Qajnë brigje, qajnë zalle,
E këneta e lumenj,

O Meleq, o Meleq,
Për ty qajnë djem e pleq,
O Meleq, o Meleq,
Për ty kujt s'i ardhi keq?

Ti me besën e Shqipëtarit
Për Atdhenë re theror
Të vrau pushka e trathtarit,
Vdiqe, shkove si dëshmor,
Po në zemrat tona kurrë
Nuk ke vdekur po je gjall,
Se për ty si trim e burrë
Ndjejmë adhurim e mall[224].

[223] Toger Meleq Frashëri, patriot shqiptar, ka qenë anëtar i gjykatës ushtarake të kryesuer nga gjenerali hollandes De Weer, më 1914 që gjykoi komplotin e majorit turk Beqir Grebenea, krahut të armatosur të Ismail Qemalit, ku Kristo Floqi ishte gjykatësi hetues dhe Meleq Frashëri krahu i djathtë i tij.

O Meleq, o Meleq, etj.

Ishe shëmblla e ushtrisë,
Gjithë kush të kish zilí,
Ishe shënja e trimrisë,
Ç'do ushtar të kish lakmí.
Në ç'do luft ti përpara,
Gjithëmonë prinje ti,
Dhe me plagë e me varra,
Gjithënjë ishe gati.

O Meleq, o Meleq, etj.

I armiqve ishe tmeri
Dhe për miqtë një ngushllim,
Mbi 'ta turrshe si skyfteri,
Këta prisnje me gëzim,
Për trathtorët ishe kmesa[225]
Ty të kishin fort marras,
Për ushtrinë ishe shpresa,
Një kurajo e një llas.

O Meleq, o Meleq etj.

[224] Kjo strofë e kësaj poezije është shtuar nga Kristo Floqi në botimin që ka bërë tek "VALËT E VJOSËS" të librit me këngë kombëtare nga Nazif O. Mamaqi më 1923

[225] Kmesë = spat e vogël, latoshkë, nagaçe.

Qysh në *Lofçen në Vraninë*[226],
E në *Krâj' e Tarabosh*
E në *Vlor'* e në *Kaninë*
Në *Mirditë*, në *Orosh*,
Zëri yt si vrëngëllimi
Gjithëkunt buçet gjëmon,
An' e kant jehon tingllimi,
Por si brima depërton.

O Meleq, o Meleq etj.

Luftëtar, o burr' i rrallë,
Flytyrove lart në qiell
Plumbi të qëlloj në ballë,
Si ty tjetër Atdheu s'pjell!
Sot na ike n'a lè vetë,
N' a varfrove, o Meleq
Ah, u thaftë dor' e shkretë,
Që n' a la të mjer' e keq!

O Meleq, o Meleq etj.

Qaj o *FRASHËR*, i bekuar,
Qaj me vaj e qaj me lot,
Se *Meleqin* e dëgjuar,
Nuk e sheh as e gjen dot!
Dhe ju zoq që flytyroni
Mbani zî Meleqn' e rí,
Mos ligjroni, po vajtoni,
Qaj dhe ti moj Shqipëri!

O Meleq, o Meleq etj.

[226] Vranina = ishull në Mal të Zi (në liqenin e Shkodrës).

Mustafa Qullit[227]

Rënkon moti e mban zî,
Mban zî Mustafan' e gjorë,
Që e vravi Mal' i zî
Se e shtynë ca trathtorë!
N'atë fushë, n'atë vrî
T'asaj Shtojës historike
Mustafaj tradhsisht u grî
Mbaroj jet'e tij fisnike!
Se psè burra po si ky,
Djem si zána, si vllastari[228],
I kish alê mu në sŷ
Shqau i egri e barbari!
Qysh, se shkeli në Shqiprí
Thundr' e tij e trash' e ndyrë,
Patriotët me dhelprí
Vret e mbyt me ç'do mënyrë,
S'pat mëshir' e njerëzí
Që një grua la të mjerë

[227] Në AQSH F.429-3-259 gjejmë këtë shënim të Kristo Floqit: "E shoq' e Muç Qullit, vajzë pa mbushë edhè të 17 vjet, 1 mot para vrasjes ish martuar dhe me të shkretin Muço. Kur e zuri Mali i Zi Muçon, e shoq' e tij posa kish 3 ditt që kish lèe një vajzë. Mustafa Qulli ishte kaqe liberal sa edhe gruas s' tij ja kishte ngjitë emrin Teftë"

[228] Vllastar = Lastar, filiz, pinjoll.

Me një foshnjë miturí
Tri ditsh vajzë posa lerë!
"Drit' e Popullit"[229] mbet fyll,
Mbet pa krye, ah e mjera,
Që shkëlqente si një hŷll
Ndër disa shoqe të tjera!
Pênd' e tij lëshonte gjak
Gjuh' e tij si shpat' e mprehtë,
Në mendimet si një plak
Atdhetar i rall' i nxehtë.
Shkodra plakë ku i kè,
Burrat trima të dëgjuar,
Që Muç Qullin n' a e le,
T'a vrasë dor' e mallkuar[230]?
Qaj i shkreti Leskoviq[231],
Melesin' o mal i thatë,
Që ca horra, ca të liq
Ju vranë Muçon e ngratë!
Ra Muç Qulli në komplot,
I detyrës ra shkrimtari,
Ra si burrë patriot
Gazetari, atdhetari!

[229] Mustafa Qulli ishte gazetar e pronar i gazetës "Populli" në Vlorë më 1914, por kur hynë në Vlorë rebelët e Haxhi Qamilit, mbasi kishte kritikuar në gazetën e tij Ismail Kemal beun, u detyrua të shkojë në Shkodër ku themeloi gazetën me vlera patriotike "Drita e Popullit".

[230] Këto katër vargjet e fundit Kristo Floqi i ka shtuar më pas në botimin e kësaj poezije tek "VALËT E VJOSËS" me botues Nazif O. Mamaqi.

[231] Mustafa Qulli ishte Leskoviqar.

Çerçis Topullit

(Valle Labërije)

Det, o lumë mbyt dynjanë
Vranë Çeço-kapetanë,
Çerçis Topullin me nam,
Mal i Zi të qoftë *harram!*
Çerçis Topull kapitani,
Q'ishte trim po si luâni,
Me Muç-Qullin bashk' u vra,
Për Atdhenë dëshmor ra!
Ra theror po si një burrë,
Trimi që nuk u tremp kurrë,
Ra me Mustafanë tok,
Flamurtari që s'kish shok.
N'atë fush' atjè të Shtojës
Shqau i kish urdhruar rojës,
Dhe ajo dragojt i râ
Pabesisht Çeçua u vra!
Ah, e griu, e griu laduti,
E griu shop' i trash' hajduti,
Pa një gjyq, pa një xhurnall[232],
Si një ujk, si një çakall.

[232] Xhurnall = gazetë.

Ah, o *Topull,* o *Labovë*,
Gjinokastër, Libohovë,
Lekël, Lunxhëri, Sopot,
Qajeni Çeçon me lott!
Qajeni pllaja e kodra,
Se Çerçizi mbet te Shkodra,
Trobojinë[233] lanèt qofsh,
Cernagor[234]' e shkret' u shofsh!

[233] Traboin = është vendbanim në komunën e Tuzit në Mal të Zi
[234] Cernagor = Mali i Zi

Bab-Dudë Karbunarës[235]

N'atë kohën e Robnisë
Të pês-shekujve të rëndë
Q'ajo xgjedh' e Tyranisë
Nuk përshkruheshe me pëndë,
Babë-Dudë-Karbunara
Me disa shokë të tjerë
Bën' ato hapat e para
Për shpëtim t'atdheut të mjerë.

Babë-Duda, Tahsin Çami,
Konstantin Kristoforidhi
Ishin të trè një programi,
Fati që të trè i lidhi.
Si me pênde, si me fjalë,
Me kuxim edhè pa drojë
Shqipërisë dal nga dalë
I përmbushnë ç'do nevojë.
Ish trilidhja e Shqiprisë,
Që themel të fort'i vunë,
Me fuqin' e diturisë
Bënë vepra, bënë punë;

[235] Në AQSH F.429-3-263 ndodhet dorshkrimi i vjershës Bab-Dud Karbunarës ku gjejmë shënimin e Kristo Floqit, sipas të cilit Bab-Dud Karbunara vdiq në Berat më 18-12-1919

Njëri me vokabullarin,
Tjetri me kuxim e vepra,
Dhe Bab-Duda m'Abetarin,
Dobí prunë e jo gjepra.
Fshehtazi djelmnin' e msonin,
Gjuhën t'ëmbël e amtarë,
Dhe as një rrezik s'peshonin,
As q'u trembej syri fare.

Ish një kohë e rrezikshme
– Fat i keq i Shqipërisë –
Koh' e mnershme e e frikshme
Kû të bijt' e Arbërisë
Vriteshin me shoqi-shoqnë
Pa një shkak edhe pa punë
Shqipërin' e ropnë e poqnë,
Rebelët dh'ata q' i vunë[236]!

Gjê s'lëviste, kush s'kuxonte
Kundra bishave të marra,
Gjith kush rrezikn' e dronte
Dhe veç Dudë-Karbunara
Me kurajon që të rallë
E fëlliq Musa Qazimin[237]
Si një trim e burr' i gjallë
(Aq të math e kish kuximin).

[236] Rebelët ishin njerëzit e Haxhi Qamilit, kurse ata që i vunë ishin pashallarët, bejlerët shqiptarë, të ndihmuar nga ushtarë turq.
[237] Një prej kryetarëve rebelë (Shënim i Kristo Floqit)

Syri prej burgut s'i tutej,
As prej mizorive tjera[238]
– Që gjithkush s'kish kû të futej
Se e hant' e zeza mnera –
Dudë plaku Karbunara,
Mjekër-bardhi, trim i gjallë,
E shpëlavi me të shara,
Eli-kjamin[239] pshtyu në ballë!

O Nestor[240] i Shqipërisë,
Plak i mentshëm, mendje-gjërë,
Ti, o pish' e diturisë
Që të njeh Atdheu i tërë,
Vdiqe, ike, u largove
Fort i lodhur, i drobitur,
Por se veprat që punove
Kombin sot e kanë ndritur!
Prej të motshmëvet ti vetë
Kishe mbetur si antikë,
Mjerisht ike n'a le shkretë,
Veteran, që s'pate frikë!

[238] Duke lexuar gazetat e vitit 1914 rezulton se njerzit e Haxhi Qamilit (rebelët) e kapën Bab Dud Karbunarën dhe e nxorrën rrugëve të Beratit duke u tallur me të, duke e fyer, si nënshkruesin e Aktit të Pavarsisë megjithse ishte i shtyrë në moshë.
[239] Me këtë titull i njihte rebelat shumica e popullit (Shënim i Kristo Floqit)
[240] Nestori ishte ajy më plaku e m'i mençmi ndër prijësit e luftës trojane (Shënim i Kristo Floqit)

Djemt' e vajzat të përcjellin
Mathusallë[241], me kurorë,
Edhè lule mjaft të sjellin
Mbi të ftohtit t'ënt krahrorë,
Çpag' e vogël po me vlerë,
Për kujtimet që ke lënë
Edhè shëmbëll për të tjerë,
Këmbën t'ënde për të zënë.

Udh' e mbar' o Babë Duda,
Hiq n'uratën e Përndisë,
Po të pret *Bogdani, Buda*,
Vasso-Pasha i Gegnisë,
Veqil-Harxhi, Kunturijoti,
Mitkua, Vretua e Naimi,
Ât-Xanoni e Tahsini,
Po të pret dhe *Konstantini,*
Elbasanasi i vyer
Edhè *Dino-Abidini,*
Dhe *De-Rada* i çkëlqyer,
Po të pret *Kamardë*-plaku:
Me mjaft italo-shqiptarë,
Që të gjithë prej një gjaku,
Të shkëlqyerit shkrimtarë,
Jy flytruat e n'a latë,
Gjyrmët t'uaj të vazhdojmë,
Po dhe nè me duar thatë,
Mos kujtoni se do rrojmë!

[241] Mathusalla = Matusalemi, sipas Biblës njeriu me jetgjatësinë më të madhe në historinë e njerzimit.

`Kollonelit Hollandas Tomson[242]

Si rrufê, si një plump, një shigjetë
Lajm' i hidhur n'a therri, n'a çpoj,
Kombit t'onë të ngratë, të shkretë,
Fuqí, gjunj e kërsinj i shkurtoj!

Ah, te Urr[243]' e mallkuar gjaksore
Trim' i math i Hollandës n'a râ,
Prej një dore të ndyr' e mizore,
Kolloneli mjerisht n'a u vra!

Dit' e zez e zisë tmeruar
Shkrepi sot për të mjerën Shqiprí,
Shqipëtarët të pa ngushëlluar
Po vajtojnë luânin e rí!

Po vajtojnë Tomsonin e vyer
Që për Mbret e Shqiprí ra theror,
Po vajtojnë njerin' e shkëlqyer
Kollonelin krenar, madhështor!

242 Koloneli Thompson ka qenë një nga organizatorët kryesor të xhandarmërisë shqiptare. Ai arrestoi Beqir Grebenenë dhe ishte nënkryetar i gjykatës ushtarake ndërkombëtare që dënoi pjesmarrësit e komplotit të Turqisë në fundin e vitit 1913 kundra ardhjes së princ Wiedit si mbret i shqiptarëve. Koloneli Thompson, si shqiptarofil, ishte personazhi kryesor, bashkë me përfaqësuesit e Kontrollit Ndërkombëtar (të gjithë juristë), që rrëzuan qeverinë e Ismail Kemal beut dhe e dënuan atë me largim nga detyra për përkrahjen morale e materjale që i bëri komplotit kundra Wiedit. Koloneli Thompson ka qenë mik i ngushtë me Kristo Floqin.

[243] Ura e Dajlanit në Durrës.

Ishte burrë, vërtet, i pa tundur,
Në trimni s'kishte tjetër një shok,
Kuximtar e ushtar i pa mundur,
Zembër-mirë, i qetë si zok.

Ah, te *Urra* e shkretë mizore,
U krûs mali, u shemp e u ça,
Ra Tomsoni prej dorës tradhtore,
Ra vërtet por se nderin s'e dha!

Zê vajtimi e vaji ushtojnë
Për dëshmorin e math që n'a shkoj,
Edhè kodra e zalle jehojnë,
Se Tomson' i pashoqtë mbaroj!

Kollonel! Shqiptarët s'harrojnë
Therorit' edhè veprat që lè,
Me ty shekuj me rradhë do rrojnë,
Një kujtim të pashojtur n'a lè.

Në radhorin e burrave t'onë,
Që dëshmuan për Komp e Atdhê,
Do rreshtohesh dhe ti për gjithmonë,
Se m'i madhi dëshmor jè për nè!

Dhe sa lëmshi i dheut do vërtitet,
Sa të rronjë ky shtet për mbi dhè,
Embri yt, kollonel, do përsritet,
Do çuditet me ty mas'e rè.

Do të jesh nj'adhurim fort i ëmbël,
Ti që rè i detyrës besnik,
Do të jesh për të rinjtë një shëmbëll,
Që dhè jetën për nè si fisnik!

O! do vinjë ajo dit' e shënuar,
Që në Durrës do ndrit si âr,
Përmendorja krenar' e bekuar,
Që t'a shohë ç'do burrë Shqiptar!

I dergjuni

(Millevoye "La chute des feuilles[244]*)*

Ranë fletët e shelgjeve ranë,
Plepa, lisa u shkuntnë një e një,
Zoqtë flytyruan, shkunë e vanë,
Qyq' e bilbila nuk dëgjohen më!
Të verdha shtrihen gjethet e zbeta,
An' e kant me 'to u mblua dheu,
Fishken, shduken, mbaroj për 'to jeta,
Kaloj vera, ndryshoj, moti ktheu!

Një djal' i rí, i sëmur' i mjerë,
Bir i vetëm i s'ëmës q'e kish,
Ecte nga dale për të fundit herë,
Përmes një pŷlli q'i shkretë ish!
I pafuqishëm, i zbet'i krusur,
Pa shpres'i ngrati, pa ngushëllim,
Njëzet pranvera èdhe pa mbushur,
Pŷllit i thotë me një mallnjim:

O pŷll i dashur, ah, lamtumirë!
Ty që të shetisnja gjithë gas,
Më nuk do t't'a shoh, ah, atë hirë,
Bukurit' e tua më s'i has!

[244] *La chute des feuilles* = Rënia e gjetheve është poezia më e çquar e Charles-Hubert Millevoye. U muzikua nga George Bizet.

Fletët që po shkunden e po shkojnë,
Më kujtojnë fundin që afron,
Më kujtojnë ditët që kalojnë,
Më kujtojnë jetën që mbaron!

Edhè në ç'do fletë që rëzohet
Shoh nga një mandatë, lajm të zí,
Vdekjen njoh dhe shpirti më tmerohet,
Ah, e shoh, e shoh sa jam fatzí!
Po dergjem, po venitem, po bije,
Fatin t'im m'a thanë, ah e di,
Nuku gjenj një prejtje, as një hije,
Veç hijen e një qiparisit t'zi!

Edhè m'i zbetë unë se vjeshta,
Nga dal-nga dale po hynj në varr,
Nuk shoh mê lisa, bunge e kreshta[245],
Luadh' e bukur shtruar me bar!
Edhè pa ardhur pranver' e bukur,
Edhè pa çelur gjethi i rí,
Jeta e shkretë do jetë shdukur,
Do të jem future në varr' e zí!

Po vdes i mjerë fort, i dëshpëruar,
Në një mosh' i shkreti kaq të rè,
Si hije jeta ime tyke shkuar,
Trupin t'em pa shpirt të ftoht' e lè.
Po tretem, po shuhem si qiriri,
Po si kandili kur nuk ka vaj,
Ah, mëm' e varfër m'humbet prej gjiri,
Ah, nuk do mê shohë paskëtaj!

[245] Kresht = Pishë e zezë.

Bini, o fletë, një nga një bini,
Gjer të shkretohet i mjeri pŷll,
Dhe ju të fundit sigur t'a dini,
Perndon me jyve dhe i imi hŷll
Mfshihni vendin ku nesër do jem,
Nga syt e mëmës të pangushlluar
Fatin e zí që nesër do kem!

Dhe në arthtë e vluara ime,
Të derdhë lotte mbi varrin t'im,
Zgjoni pak, ju lutem hijen t'ime,
Që prej sajë të gjenjë ngushëllim!
Thotë' e thotë edhè po largohet,
Edhè mê nuk kthehet …. iku, shkoj,
Me të mbramen fletë që rëzohet,
Edhè djal' i mjerë ra! …. Mbaroj!!

Afër një lisi në varr' e ftohtë
E kallnë djalin, djalin fat-zí,
Por se e vlûmja gjê s'vjen t'i thotë,
As lotte s'derdhi, as mbajti zí!….
……Pushim i thellë në pyll e qetë,
Mbretron gjithmonë, s'dëgjohet zê,
Mbet i përzishëm pylli i shkretë,
Qyqet e zoqtë s'këndojnë mê!

Veç një përrua që po shkon pranë
E rjeth nga dale më një fishllim,
Shtërpar' i qetë që fryn xhuranë,
Berrat e buta me blegërim,
Plepat e lisat që po rënkojnë,
Dhe kron' i vogël që po pikon,
Djalit të mjerë po ja tundojnë
Hijen e varfër që po pushon!

Përpara

(Marsh)

Përpara, përpara
Flamurit, o burra,
Me armët e lara
Vraponi te Urra,
Me gjakun e nxehtë
Me shpatën e mprehtë
Armikut i bini me zjarm e rrufè.

Vraponi, vraponi,
Si shkaba, si trima,
O djema luftoni
Po si vetëtima
Me flag' e dëshirë
Pa patur mëshirë
Armikut i bini, mos vini gjê rè.

Ashtu si qëmoti
Luftonte Shqyptari,
Për luftë i zoti,
Gjithmonë i pari,
Luftoni o çuna
Ashtu si lyp puna
Armikun e futni të gjallë në dhê.

Dëgjoni, dëgjoni
Një zê që së thelli
Një shpatë shëkoni
Që ndrit por si Dielli,
Dëgjoni se ç'thotë,
I ashpër, i fortë
Më shpatën në dorë një hije ç'po flet:

O djelma ku jini,
O trima të rallë,
O çuna mos flini,
Po bëhi të gjallë
Armiku i ndyrë
Në tok' u ka hyrë,
Oh, shtypni armikun, Atdheu po ju thret.

Këto kryetari
Me zê madhështuar,
Bërtet që nga varri
I pangushëlluar,
Edhe ju Skënderbenë
Flamûrin, Atdhenë,
Nderoni, o burra, si kur ju përket.

Te Urra, te Urra,
Atjè ku flamûri
O djelma, o burra
Vërsuli e turri,
Luftoni si Zâna,
Fatosa, luâna,
Për nder e flamurit, që ju po ju pret.

E bukura Pranverë

Na ardhi prapë Prilli,
I çelur si nga mot,
Mëllinjat e bilbili,
Ligjrojnë bukur fort.

Shih lulet e burbuqet
Sa kanë ëmbëlsí
Shih bimët lulukuqet
Me vesë e me shî.

E vogla faqe-kuqja
S'po lodhet, belbëron,
Atjê përtej dhe qyqja
E fshehur po këndon.

E lehta dallëndyshe
Fjalë po thotë plot,
Verdhashi[246] këndon ndryshe
Thëllëza s'pushon dot

Shtërgu e gjet folenë
Me shokn' e tij besnik
Guguçet[247] radhë s'lenë,
S'mejtojn' as një rrëzik.

[246] Verdhash = kanarin.
[247] Guguçe = Kumri.

Fusha, bregor' e male
Veshur me aq' stolí,
Lumënj, liqena, zalle,
Po ndritin si florí.

Rëketë ven' e vinë
Si vija, si gjarpinj,
Dhe derdhen, sokëllinë
Ndër rripa, ndër shkëmbinj.

Larashi[248] si shigjetë,
Lartsohet për mbi Qjeje,
Dhe shkaba që pi retë,
Sillet andej, këtej.

Pemët e drurët gjithë,
Po endin shpejt e shpejt,
Dhe arat plot me drithë
Përhapen por si det.

Zëmbaku trendafili,
Gazija jasemi
Viollca, karafili,
Kan' hapur për zili.

Ajazma[249], bosilogu,
Po kundrëmojnë fort
Dhe trajçja, selinogu[250],
Lëshuan fletë plot.

[248] Larash = fajkua, skyfter.
[249] Ajazma = mendër, mente, nenexhik.
[250] Selinok = një farë zarzavati.

Miza, flytyra, mbleta
Shëndijnë[251] pa pushim,
Në kopshta, në këneta
Kullosin me nxitim.

Dhe shtâzat e përdheshme
Nga vrimat me gëzim,
Dalin si të pa ngeshme,
Lëvrijnë pa përtim.

Bretkosi futur n'ujë
Kuak, kuak këndon,
Noton e bën rëmujë
Pa masë bisedon.

Bërtasin dhî e shqerra,
Nër brigje në përrënj,
E kec' e qengj' e berra,
Nër rripa, në shkëmbënj.

Të mugëtit kur bije
Një tjetër shpesh këndon,
Gjoni me aqe shije
Të vjen si kur vajton.

Vjen nata, nat' e terrët,
Sheh tjetër një çudi,
Sheh gjith' ata mysterët,
Sheh gjith' atë magjí.

[251] Shëndijnë = janë me shend, janë të gëzuara.

Shëndritin fort shkënditë
Si hyje me mizrí,
Lëshojnë tjetër dritë,
Një tjetër bukurí.

I natës lakuriqi,
Posa që ngryset del,
I aravet irriqi,
Rëmon dhe rrugën çel.

Dëgjohet kukumjaçka
Me zê që po vajton,
Nxjer zoqt' e saj kuaçka[252],
I kndjell edhè i çon.

Rreth e përqark natyra
E qeshur lulëzon,
Me mijra ngjyra e ngjyra
Si nuse nusëron.

Oh, sa ka ënd' e shije,
Sa bukur çel e ndrit,
Pranvera sa ka hije,
N'a ngjall, n'a përsërit.

N'a e çel e n'a jep shpresën,
N'a sjell të mira plot,
Dhe n'a përmënt krijesën
Q'e kreu i madhi Zot!

[252] Kuaçka = pula kllukë.

Ujku dhe Gomari

Tek kulloste një gomar
Tek po hante bim' e bar,
Sheh një ujk që i afrohet
Edhè s'di se ngaj të mprohet,
Sepsè ujku i hutuar,
E arrin i zgurdulluar,
E kish zënë fort urija,
Syt'i kish si dy shkëndija!

Fort u tremp gomar' i mjerë
Se ndër thonjt' e tij do bjerë
Ku të vejë, ngaj të shkonjë,
Nuku di si të shpëtonjë,
I mbet zembra, i ngriu gjaku,
Mbet; po vdiste nga meraku!

Po nevoja, ç'nuk n'a mson
Kur e keqja n'a takon?
Dhe gomari veten mbleth,
E përjashta pak e heth,
Bëhet si kur ësht' i çalë
E po ecën me nga dalë,
Njërën këmb' e ngreh përpjetë,
Tri të tjerat tatëpjetë.

Ujku befas i vjen pranë
Dhe me nj'her' e përfshinë gjahnë,
Do t'a çqyej, do t'a xhvatë,
M' ato dhëmbë po si shatë[253],
Po gomari ju lut pak,
Tyke dredhur, pa pik' gjak,
E i thotë mor vëlla,
Më dëgjo pastaj më ha.

Sot pa gdhirë, që menatë
Shkela një gozhdë të gjatë
Shëkomë këmbën e mprapë,
Nxirma të lutem me vrapë,
Nxire, pak ashtu më rruash,
Pastaj bëmë si të duash,
Se më dhëmp e s'duronj dot,
Se më vjen që qanj me lot!

U gënjye ujk-budalli,
Edhè kryet unj me nj'herë,
Ja merr këmbën ktij topalli
E kërkon gozhdën t'i nxjerë
Dhe gomari mê s'vonoj,
Shkelmën ujkut ja lëshoj,
Ja lëshoj me gjith' fuqinë,
Sa ja theu dhëmbët, turrinë.

[253] Shat = vegël hekuri për të thyer, ose për të thërmuar tokën.

Ujku shtrik u plas për dhè,
Dhe gomari shkon e lè,
Brodhi shpejt, palli sa mundi,
Prej gëzimit botën tundi!
Ujku plak kur arth ndër mënt,
S'bëri fjalë, as kuvënt.
Tyke qënë ujk, luân,
Ç'desh të bëheshe nallban?

Babaj me djemtë

Ishte një baba një herë,
Edhè djemt' e tij q'i kish
Ziheshin, bënin poterë,
Plaku i pa qetë ish.
Dit për dit i këshillonte,
Po ata nuk vinin mënt,
As njeri nuk e dëgjonte,
Sa i shkreti plak u rënt.
Një dit kur këta po zihen,
Plaku vjen e i ndalon
Edhè nuk i lè të rrihen,
Urt' e but'i këshillon.
Në një tufë kishte lidhur
Babaj plak disa shkopinj,
Dhe i vrazhët e i hidhur
Djemve q'ishin të këqinj,
Tufën ja u jep me sërë
Që t'a thyej cili munt,
Dhe i kndjell ata të tërë
Po shkopinj' as një s'i tunt!
Edhè plaku me gjak ftohtë,
S'i qërton, as që i shan,
Merrni, djem, nga një u thotë
Dhe shkopinjt ju shpërndan.

Djemtë shpejt t'i thyejn zunë,
Një nga një me lehtësí,
Panë q'ish e vogël punë,
S'hoqn' as një vështirësí.
Plaku ju kthehet at-herë
Dhe ju flet me një ngashrim,
Bijt' e mij jini të mjerë
Po nuk muart nga kjo msim!
Ju në qofshi të bashkuar
Dëm s'ju bije as njerí,
Do të rroni të nderuar
Do të rroni në lumní.
Po në qofshi të përçarë
E n'u zënçi si gjer sot
Jini gjithë për të qarë
Puna juaj ju shkon kot!

Mos i rrihni kafshët

Kurrë mos i rrihni kafshët e mjera,
Kalin, mushkën, gomarin me drû,
Kanë[254], lopën, bagëtit' e tjera,
Kan' edh' ato shpirt e kanë trû.

Kali n'a shërben si shok i vyer,
N'a çon ku të duam, më ç'do vent,
Kohën me atë tyke kursyer
Punën e mbarojmë dhe ç'do sent.

Mushka n'a shetitën në për male,
Me një lehtsí e me kujdes,
Thundrat e asaj shkelin nga dale,
Po shkelin sigur e pa përtès.

Dhe gomari është i duruar,
Sa do t'a ngarkojmë vesh më vesh,
Shkon i ngrati ku t'a kesh urdhruar,
Si kur edhè vetëm po t'a lesh.

Kan' e përdorojmë në për ara,
Bujku e ka shok e ka vëlla,
Puna me atë i shkon përpara,
Me atë lëvron, fiton e ha.

[254] Kanë = kaun

Lopa q'ësht' e but' e e bekuar,
Qumështin n'a jep me begatí,
Edhè me bulmetin e uruar
N'a ushqen e mjera bagëtí.

Bualli heq qerren e ngarkuar,
Xgjedhën me durim të math e mban,
Qëni, shërbëtori m'i besuar,
N'a ruan shtëpi e vath' e stan.

Pra duhet të kemi mjaft mëshirë
Për kafshët e mjera gjithënjê
Duhet t'ju tregohemi të mirë
Mbassi n' a shërbejnë për ç'do gjê.

Dhe të mos i rrahim, t'i mundojmë,
Po t'i duam fort si miqt' e vet,
Se me ato punët i mbarojmë,
Me ato jetojmë dit' e nett.

Është faj i rënd' e i pa ndjerë,
Është turp i math edhè mëkat,
Kafshët edhè bagëtin' e mjerë,
T'i përdorim liksht e me inat!

Do që të të duan?

Ji i dashur e i urtë,
Ji i qetë e i butë.
Ji i bindur e i sjellë,
Dhe kur flet, mendohu thellë.
Ji i drejtë e i matur,
Dhe nakar[255] tyke mos patur.
Mos përbuz njërin e tjetrin,
As të rinë, as të vjetrin,.
Mos tregohu i mërzitur,
As në pleq, as në të mitur.
Mos gënjeh kurrë në jetën,
Folë vetëm të vërtetën.
Kur e jepni mbani fjalën,
Mos drethoni as për âlën[256].
Mos qërtoni kot pa punë,
Mos shkaktoni kob' e dhunë.
Të mbëdhenjtë t'i nderoni,
Mikun, shokun fort t'a doni.
Po t'a doni dhe armikun,
Dhe t'i prîni në rrezikun.
Mos kërkoni t'ju lëvdojnë,
Gëzohi t'ju kritikojnë.

[255] Nakar = zilí
[256] âla = halë pishe. Në këtë rast "aspak"

Kur t'ju besohet një fjalë,
Nga goja të mos ju dalë.
Kur një ndodhet në të keqe,
Ti në muntsh të keqen ndreqe.
Mos u tall me fukarânë,
U ruaj ng' ata që kanë.
Kur të ndihmosh dorë-hollë,
Bëj të mirën e mos folë.
Mos u mburr për prind e âtë[257],
Mos u mburr as për paratë.
Mos zembrohu kur të shajnë,
As kur ty mëri të mbajnë.
Po trego fisnikërinë,
Shpirtn' e lartër e burrninë.
Mos kërko të shkosh përpjetë,
Puno, vendi të gjen vetë.
Po të jesh i merituar,
Të gjen vendi dhe pa ftuar
Ji i ndershëm të të çmojnë,
Pastaj sheh si të lëvdojnë.
Në kërkon që të të duan,
Kthehe kurdoherë huan.
Rron me njerës e me shokë,
Mbaji ment këto në kokë[258].

FUNT I LIBRIT "SHKËNDIJA"

[257] âta = babâ

[258] Në këtë poezi shihet se Kristo Floqi, për të shkruar këto këshilla, është inspiruar nga vlerat morale nxjerrë nga Bibla dhe konkretisht në 10 Urdhërimet e Zotit, në 7 veset e 7 virtutet e njeriut.

Dr. KRISTO FLOQI

TINGËLLIMET E ZEMBRËS

Kèngë dashurije e satira

ÇPALLJE E DYTË

e ndrequr e e plotësuar

SHTYPSHKRONJA "LUARASI"
TIRANË 1940

KËNDONJËSVE

Kaluan tetë-mbëdhjetë vjet që kur botova për të parën herë librin: "Tingëllimet e Zembrës", një anthollogjí këngësh dashurije, të cilat u bënë popullore e këndohen an' e kand të Shqipërisë. Sa do që u botuan 5.000 e ca kopje, këto u shitën brënda një kohe pêsëvjeçare që të gjitha, kështu që prej 18 vjetsh e këtej nuk mbet asnjë kopje, përveç asaj që unë e ruanja në bibliotekën t'ime për koleksjon të veprave të mija të çpallura gjer më sot.

Ky libërth, mjaft i nevojshëm, psè përmbante mê tepër se 60 këngë që këndohen edhè sot, ishte një mungesë e madhe për amatorët, si dhe për ata që ja kishin ngjeruar shijen dhe gjatë këtyre vjeteve shumë Shqiptarë e të huaj m'a kërkuan e më shtynë t'a ribotonj. Këtë dëshirë, duke dashur t'u a përmbush këtyre miqve, edhè psè mbassi sot për sot n'asnjë librarí, ose bibliothekë Shqiptare nuk gjendet asnjë copë, vrapova t'a rishtyp të ndrequr nga gabimet që kishte kur u çpall për të parën herë, dhe të plotësuar me shumë këngë të tjera dashurije, blegtorale, bakhike[259] *e satirike që për të parën herë po shofin sot dritën.*

Kujtonj se me këto këngë, përveç që forcojmë lyrën Shqipëtare, po plotësojmë edhè një mungesë e i bëjmë një shërbim popullit.

Tiranë, 28 Tetorit 1940-XVIII.

---

[259] bakhike = nga Perëndia Bacco e latinëve (Grekët e quanin Dionis) është Perëndia e verës dhe e mistereve.

Shënim nga Henrik Kaçulini: Shpjegimet në thembrën e faqeve (footnotes) i kam konsultuar që të gjitha në fjalorin shqip-shqip të Kristo Floqit dhe fjalorin e K.Kristoforidhit.

KËNGË DASHURIJE

Flutura Korçare

Maggior dolore ricordarsi
della felicitá nella miseria[260]
DANTE

Tani që gjithë flenë
Veç unë po vegonj[261]
Pushimi mbuloj dhenë,
Po un' i ziu vajtonj,

Ah, ankthin t'em kujt t'ja rëfenj
Që qetësí s'kam kurrë,
Një ngushëllim ku do të gjenj
Që m'u bë zemra urrë,

Ah, më harrove fare
Moj flutura korçare

Veç ti bilbil i mjerë
Për mua jè një shok,
Ah, thuaja një herë,
More i shkreti zok!

[260] Këtë thënie të D.Alighierit Kristo Floqi e ka vënë në botimin e vitit 1922 të vëllimit "Tingëllimet e zembrës" por e ka hequr ai vetë në ribotimin e vitit 1940

[261] vegonj = vezhgëllonj, shoh, kqyr, gjuanj, përgjuanj (përgjoj), profetizonj

Deh! krahërorin kush m'a ngroh,
Q'e kam po si mermeri,
Një pikë shprese nuku shoh,
Më pikëllovi vreri,

Ti më harrove fare,
Moj flutura korçare!

Një virgjireshe

Rrufet' e vetëtimat nuk janë aq' të flakta,
As llamburitin aqë sa ndrit e shkëlqen ti,
As drit'as fuqi kanë, sa sŷt' e tu të zjarta,
Sa afsha e pashojtur, që vet' e ndjen, e di.
M'a thotë zembra ime, m'a ndjen edhe krahrori,
Që, si shigjetat t'ënde, nuk gjenden as gjëkunt,
Prandaj, prej asaj flage dua t'a djek, i gjori,
Shpirtin e përvëluar dhe jetës t'i jap funt!

Prej teje i ngjeronj

Ti flet se jam vjershtor, moj sŷ-larushkë[262],
Këngët që bënj, që zembra m'i dikton,
Sa bukur i këndon, si engjellushkë,
Sa mirë q'i dëfton!

Dhe shoqeve sa ëmbël q'u a thua,
Sa bukur zëri yt i ligjëron,
Sa më lëvdon, e sa mburresh për mua,
Sa gjëra q'ëndëron!

E di, këngët e mija të pëlqejnë,
Kënaqesh gjith' sa herë i kujton,
Buzët e syt' e t'ua m'a rëfejnë
Që ti më dashuron!

[262] sy-larush = . Ajy që i ka sytë me shumë ngjyra

Zëmbaku, trëndafili dhe ti

Zëmbaku, trëndafili po haheshin një dit,
Kush është më i bukur dhe kush do quhet mbret,
Kush ka më tepër hije, kush shpirtin t'a përsrit[263],
Kurora kujt i bije dhe cilit i përket.
Po kur e vogla ime u del, u hyn më mes,
Pushojnë me një herë e nuk pëzajnë më,
Të dy i ulin kryet dhe më nuk nxjerrin zë,
Dhe shkrihen edhè zhduken, si hyjet në mëngjes!

[263] përsrit = rifillonj, bënj një të ri, ringjall

Asaj

Në syrin t'ënt që sheh me aqë hîrë,
Që ngjet por si një det plot me magjí,
Që fundin s'ja sheh dot, se s'duket mirë,
Që shpirtin ma gadhnon[264] brenda në gjî,
Dallonj një gjë të ndritshme si pasqyrë,
Që më tërheq me vrap si një magnit,
Dhe në atë të kandëshmen fytyrë,
Një panoramë çquanj e stërdit[265]!

Si një burbuqe Prilli, goja jote,
Si gonxhe, që s'ka çelur, po më flet,
Me jetën t'ime, ah, po lot zotrote,
Ti nuk e di, e gjorë, sa më vret!
Faqet e buta po si një kadife,
Hûnda e derdhur por si një qiri,
Buzët e kuqe por si xinxife[266],
A munden të mos dehin ç'do njeri?

[264] gadhnon = pushton
[265] stërdit = has, takonj, gjenj përpara
[266] xinxife = një farë peme e vogël e e ëmbël, hide

Lundra na pret

Pa shih sa ndrit mbi det hyll' i mëngjezit,
Po sbardhëllehet, sa vjen po gdhihet,
Eja të ikim tani sa s'njihet,
Pluhurën hapur lundra n'a pret.

Shëko si deti flè, si një pasqyrë,
Vettijnë hyjet mbi qjell' e ndritur,
Sa bota flenë, sa s'janë ngritur,
Eja të shkojmë, se koha s'pret.

Fullimi përgëdhel zallin e bukur,
Zefir[267]' i qetë ndehet e tundet,
Lundra e vogël shih si lëkundet,
E paduruar nè po n'a pret.

Lark edhe tok të dy e të pandarë
Jetë të lumur plot ëmbëlsirë
Do shkojm' o Lule, po shpejt pa gdhirë,
Nxitò të ikim se koha s'pret.

N'atë nisin'[268] atjè, të gjelbëruar,
Ku lulet endin e lulëzojnë,
Qyqe, bilbila ëmbël këndojnë
Eja t'arrijmë, lundra po pret.

[267] zefir = Erë e lehtë dhe e freskët, që fryn nga perëndimi
[268] nisi = ishull, ujdhesë.

Mendimet i largo, leri më nj'anë,
Oh, lere botën, lere, harroje
Priru këtejzaj, këmbën drejtoje
Këtu, ku lundra me gas të pret.

Deti zu e po lot, valët po ngrihen
Po shkumbëzojnë të bardha dborë,
Lundra çan ujët m'ato krahrorë,
Turret mbi valët, ikën e s'pret.

Vrapo, moj lundrë ti, lundro, rëkllehu,
Hapu, o velë, mbushu plot erë,
Të dy bashkuar atjè n'a shpjerë
Ku jet' e lumur nè po n'a pret.

Ngrehu nga gjumi

O, mjaft fjete, ngrehu nga gjumi,
Ngrehu dëgjo rënkimn' e thellë,
Që ushton me zë si lumi
Edhè prejtjè më s'gjen dot,

Ngrehu e ngushlloje pakë
Shpirtin t'im të përvëluar,
Ngreu e shuaj këtë flakë,
Që më djek krahrorin sot.

Ngreu të ikim sa më parë
Në mërgim në shkretëtirë,
Të dy bashk' e të pandarë
Atjè ku njeri s'n'a lot!

Thuaj asaj

O fullim, ti që fryn aq' i lehtë
Dhe prej detit nga dale po vjen,
Zembrën t'ime të varfër, të shkretë
Ngushëlloje, se prehje më s'gjen.

Shko i thuaj asaj, që e qetë
S'do të nqaset, as nuku më do,
Binde ti, o fullim, ca më shpejtë,
Zbutja zembrën mizore, nxito.

Ah, në muntsh, më ja thuaj dy fjalë
Po, u ruaj mos ndjenjë njeri,
Zembra ime për të palë-palë
Rreh për hera, se ndjen dashuri.

Thuaj engjellit t'im sa të thashë,
Thuaj, thuaj,që unë po pres,
Lè t'a dijë se, po nuk e pashë,
Do të dergjem pa shpresë, do vdes.

Ti s'ke mëshirë!

(Muzika Thoma Nassi)

Të dua fort sa s't'a tregonj
Me dhemburí, me shpresë,
Edhè për ty vuanj rënkonj,
Për ty, o e pa-besë!
S'dua thesar' e begatí,
Dhurata e fitime
Përveç se syrin t'ënt të zí
Q'e dogji zembrën t'ime!

Sikur të vdes nuk më vjen keq,
Jeta m'u rënt s'e dua,
Me sa po vuanj e po heq
Për nj'ato syt e tua!
O, moj sy-zezë hith një sy
Shëkomë, kij mëshirë,
Ah, do të vdes i ziu për ty,
Në këmbët të jam shtrirë!

Të lutem fort, të përgjëronj
Folmë të mjerit mua,
Ah, kur e di se pa ty s'rronj
Një fjalë pse s'm'a thua?
Sa më sheh gjallë mos vono,
Zgjat dorën përdëllomë,
Oh, hidhi syt' e më shëko,
Shpëtomë, ngushëllomë!

Pse kaqë ftohtësi?

Kur të shoh drejt pse s'më shëkon
Pse rri po si e mpijtë
Unë të flas e ti s'fjalon,
Kaq jè e ftoht'e ngrijtë?
Shumë më loth e më mundon
Ç'të bëra, zotris s'ate,
Psè s'më vè rè, as më mendon,
Fajtor jam, a po ç'pate?

Sa shpejt harrove sa më thè,
Harrove benë t'ënde,
Harrove besën që më dhè,
E shoh se fort u rënde!
Ti nuk e di se sa bën faj,
S'e shkon ngaj mëndja fare,
Se më shkurton shpres'e uzdaj[269],
Ty nuk të bëjnë pare!

Të thash' edhè t'a përsërit
Edhè mendohu mirë,
Tjetër njeri, ah, ti mos prit
T'ushqenjë kaq dëshirë!

[269] uzdaj = shpresë

Ndofta do shkosh me pasurí
Fisnike e bujare,
Po të këtillë dashuri
Nuk do t'a shohësh fare!

Do kesh dhe sherbëtorë plot
Dhe ç'farë do të duash,
Po mua do më qash me lot
Do më kujtosh, do vuash.
Kamj' e thesar i gjen kudo
Kjo bukurija jote,
Po zembrërn t'ime mos kujto
Se s'do t'a qash me lote!

Kurrë s'të harronj

Tash që po largohem e që ndahem teje
Mos pandeh se s'piqemi të dy si ishim tok,
E dashura Lirí,

Male dhe në shkofsha, pyje e përronj
Kurrë nuk të ndahem, kurrë nuk t'harronj!
Do t'të kem në zembër, s'më del mëntsh asnj'herë
Do mos të të ndanj nga shpirti im ku do që t'jem,
E dashura Lirí,

Det në kapërxefsha, fusha e lumenj
Prehje pa ty kurrë, besa nuk do gjenj!
Atjè ku do vete dije fare mirë
Me ty nat' e ditë do jetonj si gjithnjë,
E dashura Lirí,

Gjithë ty në gojë dhe ndër mënt do kem,
I pa ngushëlluar veç për ty do jem!
Kij kujtim të ëmbël benë q' u betova,
Se besnik për jetë do të t' jem gjer sa të rronj,
E dashura Lirí,

Ah, duro dhe pakë, mos u dëshpëroh,
Se do kthehem prapë e do të të shoh.
Lamtumir' e dashur edhè falju Zotit
Që të vinjë mê shpejt se s'duronj dot, ah, në mërgim,
E dashura Liri,

Qjelli me uratë, ti me dashurí,
Do më bijni prapë, do më kesh në gjí.

Virgjireshës krenare

Ah, syt' e tua kur më shëkojnë,
Më dehin mëndjen, shpirtin ma thekin,
Si dy shkëndija zjare lëshojnë,
Më ngjethin mishrat, zembrën ma prekin!

Buzët e tua, si gjak të kuqe,
Kur zen' e flasin shërbet lëshojnë,
Si lulukuqe, si dy burbuqe,
Nektar e mjaltë po të kullojnë!

Ah, sy-larushe, baluke-prera,
O mez-unazë, selví plot hije,
Jè si një engjëll, vetë Pranvera,
Me ato gjinjë si moll' Ohrije!

Gërshetat thurur mezin t' harrijnë,
M' ato qerpiqe më përvëlove,
Balli dhe gusha si âr të ndrijnë,
Me ecjen tënde, ah, më marrove!

Shëkomë nj' herë, kij pak mëshirë,
Lëshohu pakëz në kto krahrorë,
Në këmbët tënde shih si jam shtrirë,
Ngrohma pak zembrën të ftohtë dborë!

Ti me një pamje e ngjall njerinë,
Me një bisht syri i fal një jetë,
Me frymën tënde eshtrat i shkrinë,
Një fjala jote e çon përpjetë!

Mallkim

Sa herë që me lot ndër sy
T'u luta pa një shpresë
Edhe sa herë q'unë ty
Të njoha të pabesë,
Kaq plagë ti në trup të kesh
Sa prehje kurrë të mos gjesh
Kurrë mos qofsh e qetë!

Sa net' e dit që po rënkonj
Që më ha vreri, cmiri,
Edhe sa herë që kullonj
E tretem si qiriri,
Aq lote t'hidhura të derthç
Dhe aqe vrerë ti të preç
Sa gjallë rron në jetë!

Hir' e fundit

Para se shpirti im në qjell të fluturonj' i qetë,
Para se trupi im në dhè të hynj' i ftoht' i zbetë,
Hirën e fundit po të lyp, afrohu pranë meje,
Të të shtrëngoj në krahëror, tani që ndahem teje!

Ah, si të vdes, të përbetonj, të vish mbi varr' e shkretë
Lule të njohma të më sjellsh, burbuqe edhe fletë,
Të derdhësh lote sa të muntsh dhe varrin t'a vaditësh
Koskat e gjora t'i ngushllosh, t'i zbutsh, t'i halladitësh[270]!

Në shkretëtirë kudo jem, i ndarë e i lënë,
Ku m'ato sy nuk do më shohsh, as më dëgjon dot zënë,
Të vish për dit' e t'a vajtosh atë që të desha aqe,
Dhe e mallëngjyer të kujtosh atë që flè në paqe!

[270] T'i halladitësh = t'i freskosh, t'i qetësosh, t'i ngushëllosh.

Oh sa bukur këndon

Kur perndon djell' i flaktë si zjari
Edhe nata e qetë afrohet,
Kur del hëna e zbetë si ari
Dhe natyra nënqesh e gëzohet,
Ti, si engjell po del,
Zërin t'ëmbël e çel,
Oh, sa bukur, sa mirë këndon!

Në mëngjes posa zè agon dita,
Sa pa dalë mbi qjell edhè Djelli,
Kur zbardhllèn edhè shkon Afërdita
E shkëlqen fort i kalltërtë Qjelli,
Këngën prapë e zè
M'atë zè qe t'i kè
Sa dhe qyqj' e bilbili pushon!

Buzë-qeshur kur rij afër zallit
Dhe nga dale fullimi i lehtë
Tok me hënën e sërmët[271] prej mallit
Përgëdhelin ato dy gërshetë,
Mua zembra s'më lè,
Syri im ty të sheh,
Pranë teje të jet' i pëlqen!

[271] serm = argjend

Kur në kopshtin shetit aq' e lehta
E këput trëndafilet me vesë,
E kur sytë m'i heth si shigjeta,
E më jep një fuqi e një shpresë,
Shpirti im s'pushon dot,
Ah, për ty qan me lot,
Këtë rasje të bukur s'e gjen!

Ku do shkel këmba jote e artë
Manushaqe të bukura mbijnë
Ku do heth syt' e tu flak të zjartë
Qesh natyra dhe zoqtë lëvrijnë,
Edhè unë kujtonj
Se në qjell fluturonj
Nuk e di sa të math që ndjenj mall!

Lermë, lermë të rrí pranë teje,
Të harronj jetën t'ime, mjerimet,
Zembra jote ç'të ndjen, ah, rëfeje
Më çliro nga të shkretat mejtimet,
Se pa ty nuk duronj,
As një çast s'munt të rronj,
Lermë, lermë të vinj sa jam gjall!

Anës zallit

Anës zallit lundra po shkon,
Shpërndan ujët me një hirë,
Edhe ti sa bukur këndon,
Me sa ëndë, sa dëshirë!

Er' e malit lehtas po fryn
Edhe lundra dyke bredhur,
Shih sa bukur valët i shtyn,
Dyke hikur, dyke hedhur.

Shih si ngryset hëna po del,
Edhe mjergulla e lehtë
Nuk dëgjohet as zok, as gjel,
Shih sa deti flè i qetë.

Mos më tutje ikë, pushoh,
Ndali rëmat e qetsohu,
Rudhe velën, posht' e lëshoh
Edhè pranë mej' afrohu.

Në të ka ënda gjith të lundrosh
Këtë fjalë psè s'ma thua?
Ah, mos lodhu, ashtu më rrofsh
Këto rëmbat lermi mua.

Daç e ngasim lundrën të dy
Si të dehur, si të marrë,
Shihmë dendur edh' un ty
Si kur kurrë s'jemi parë!

Ti s'jè për mua!

Thua më do, po s'të besonj
Se më rrejte shumë herë;
Për se të vuanj të lotonj
E të jem për dit i mjerë?
Ti s'më do, sa do që thua
S'jè për mua!

Thua se ti për mua vdes,
Dhe pa mua s'bën as thrime,
Ah, po prej teje ç'munt të pres
Veç dëshprim e hidhërime?
Ti s'më do, sa do që thua
Qesh me mua!

Thua se qan për dit me lot,
Kè dëshirë, kè mall shumë,
Po un e shoh që më rren kot
Gjer sa të më vesh në gjumë;
Ti s'më do, sa do që thua
Qesh me mua!

Thua për mua nuk duron,
E se nukdo ndahesh kurrë,
Edhè pa mua qinse s'rron
Edhè vuan, je sëmurë,
Po sa do që kështu thua
S'më do mua!

Thua se tjetër nuku do
Dhe betohesh nat' e ditë,
Ah, po të di të shoh, të njoh,
Se t'i msova dhelpëritë,
Po sa do që flet e thua
S'më do mua!

Thua se bën theror e flî
Jetën tënde kurdo herë,
Për Zotin fort të kam zilí
Që gënjen kështu pa prerë,
Sa do rren e flèt e thua
S'jè për mua!

Syt' e tu të kaltërt

N'ata të thella dete, të kalltr'tat syt' e t'ua,
Sa lundra vallë mbyte, moj vajzë, sy-shkëndí,
Sa djelm më qafë more, bashkë me 'ta dhe mua,
E di, apo s'e di?

Na rrejti pamja jote, buz-qeshja dhelparake,
Qerpiku, vett'lla jote dhe shtati si selví,
Shigjetat që n'a hodhe, të tundurat dredhake.
Dhe syri i maví!

I shkreti ç'u gënjeva, kërkova, ah, lumrinë,
Kuxova t'u afrova, të gjenja një limer,[272]
Po, po! i mjeri unë, ç'më ngrite, ah, qetsinë,
Më mbushe helm e vrer!

Të dorëzova zembrën, dhe shpirtin pênk t'a dhashë,
S'peshova jetën t'ime, të jem bashkë me ty,
U treta si qiriri, ndër këmbët ty të rashë,
Po ti s'më pè me sy!

Ti tallesh, moj e bardhë, ti lot, moj lozonjare,
Të duken gjithë lodra, me nè të varfrit qesh,
Ah, Zoti t'a shpërbleftë dy-fijsh, moj grabitçare,
Dikur do t'a març vesh!

[272] limer = vend i fshehtë në mal ose pyll

Thëllëzës mitare[273]

Thëllëza im' e bukura
Ndaj meje u afro,
E lehtë, por si flutura,
Në zembër më qendro,
Të shohsh se sa të hidhura
Këto buzët q'i kam,
Eja thëllëz' e mitura,
Pa ty i mjerë jam!

Afrohu, krahëshkruara,
Afrohu të më ngrosh,
Buzët e dëshëruara
Eja të m'i shërosh.
Shih, shih sa të venitura
Kaq kohë ti i lè,
Për eshtrat e drobitura
Meshirë nuku kè?

Mjaft më mundove fshehtazi,
Me lojna, me dredhí,
Eja si flutur lehtazi,
S'duronj këtë mërzí,
Ti do jesh m'e lumtura
Nga shoqet, që po kè,
Për nj'a dy trí të puthura
Lotët i derth rëkè!

[273] Thëllëza mitare = thëllëza që me belbërimin e saj tërheq mashku-llin për vehte.

Pyet në të dua?

Më pyet në t'harrova? Përse më hidhërohesh?
Ah, pyet dallëndyshen, n'harroj pranverën' Prillin,
Pyet edhe thëllëzën e qyqen e bilbiln,
Pastaj rri e zembruar, pastaj të dëshpërohesh!

Në munt t'harronjë plaku të ritë, djalërinë,
Në qoftë q'i sëmuri nuk dëshëron shëndetin,
Skllavi nuk do lirinë edhe detari detin,
Ahere munt t'ankohesh dhe ti për dashurinë.

Ashtu si kur i verbri dritën kërkon të shohë,
Edhe shtektari etjen mundohet që t'a shuaj,
Ashtu dhe un' i mjeri për ty çdo dit po vuaj,
Pres shpirtin tënt t'afrohet dhe zembrën të m'a ngrohë!

Nastija

Ish një mëngjes i bukur fort, pranvera në fillim,
Maji kish veshur plot me hîr gjithë stolit' e tija
Dhe lulet endnin an' e kant, natyra në blerim
Kur më pëlqeu Nastija!

Kur ardhi vera pak mê von me duart e saj plot
Dhe ujrat derdheshin rëkè, shkëlqente bukurija,
Kur një bajame po stërdit dhe me atë kur lot,
Më dashuroj Nastija!

Po mbrîni vjeshta mê pastaj dhe er' e ftohtë fryu,
Filluan shirat, breshër râ, u shkundnë drût, ardhija,
Moti ndryshoj, u mbush me rè dhe dheu i shkretë ngriu,
Ah, m'u sëmur Nastija!

Në funt vjen dimbri me cingrim, me dbor' e me tufân,
Thëllim i math shkrepi me hov, u thanë suka, vrija[274],
Malet rënkojnë, dheu mban zî, akull kudo, murlân,
Ahere vdiq Nastija!

[274] Vri = kullotë dimbri. Pyll i dendur e i mprojtur prej malesh me ku-llotë brenda.

Jeta mê e lumur

(OMER KAJAM)

Si kur se vesa lulet i mbulon,
I krus, përûlen dhe rënkojnë,
Dhe zembra ime nat për nat' ngufon,
E vrasin dertet[275], e dërmojnë.

Po kur shkrep Djelli, rezet i lëshon,
Lulet ringjallen, kundrëmojnë,
Dhe zemra ime hallet i harron,
Kur syt' e tua më shëkojnë.

Nga dijetarët mos prit gjë të msosh,
Lumrin' e qielltë s'ta tregojnë,
Shëkomë thellë edhè do m'i njohsh
Shpirt e zembër si t'adhurojnë.

Oh! Ç'është vdekja? Veç se një ngushllim,
Mjafton t'jap shpirtin pranë teje,
Midis Parajsës kam një përdëllim
Kur ti avitesh afër meje!

O sy-larushe, duket se s'e di
Q'ësht' e caktuar jeta, moti.
Ushqim i krimbit jemi un' e ti,
Në mos e dijmë, e di Zoti!

[275] dert (arkaike) = dhimbje, merak, mjerim.

Po .... bukuroshe, eja, mos përto,
N'hijen e dendur të hurmâsë,
Veç dashurisë tjetër mos kujto,
Kjo botë s'paska pêsh e masë!

Eja me mua, buzët m'i afro,
Bashkë këtʼ jetë tʼa rëkllejmë,
Të flemë qetas, gjë mos ëndëro,
Mjafton të lumur të dëfrejmë!

Të parat

E para dallëndyshe ësht' e bukur,
Si edhè lul' e parë, posa skuqur,
Dbora sa ka lezèt të parën herë
Si dhe bilbili kur këndon në verë,
I pari shî në vjeshtë kur zè bije,
Sa bukurí që ka edhè sa hije,
Si edhè fleta e parë e një pême
Kur er' e dimbrit e rëzon të zbême,
Nj'ashtu ka shije dashuri e parë
Kur del prej zembrës e prej shpirtit t'larë.

Pleqërija

Mos kij frikë, sa rron as një herë,
Mos u tremp, mos u tut, u frigoh,
As nga Zoti mos trembu e mjerë,
Veç nga moti që shkon u tmeroh!
Ah, gëzohu, dëfrehu sa mbahesh,
Fol' e qesh sa jè gjall' e jeton,
Se vjen dimbri pa fishkesh e thahesh,
Arrin vdekja, të merr edhè shkon!

Dridhu, dridhu se do vinjë dita,
Fill të bardhë në flokët të shohsh,
Sytë s'shohën, shkurtohet, ah, drita,
Si dhurata të motit t'i njohsh!
Ah, gëzohu, e gjorë, sa mbahesh,
Qesh, oh qesh, sa jè gjall' e jeton,
Se vjen dimbri e tretesh e thahesh,
Edhe vdekja të merr edhè shkon!

Do të mplakesh, do thinjesh si dele,
Do shurdhohesh, do krusesh një dit,
S'ka mê lodra, as ka përgëdhele,
As pekule, as lajka mos prit!
Ah, gëzohu, defreu sa mbahesh,
Fol e qesh sa jè gjallë e sa rron,
Se arrin dimbr' i shkretë pa thahesh
Edhè vdekja të merr edhe shkon.

Do kujtosh ndo një ditë çupërinë,
Kohën t'ëmbël do lypësh më kot,
Që të gjitha kalojn' e mê s'vinë,
Do t'a qash këtë kohë me lot.
Po, gëzohu sa rron e sa mbahesh,
Ah, dëfrè edhè qesh' e këndo,
Se të ritë do shkonj' e do thahesh,
Sot zbavitu e gjë mos kujto!

Mos e beso!

(La donna è mobile)

Si penda n'erë
Tundet, vërtitet,
Fembra nga herë,
S'qendron e s'ngjitet,
Të rren me fjalë kot,
Të thotë s'ndahet,
Gënjen e tallet
Mos e mbeso!

Me lajka shumë
Të lan të lyen,
Të vë në gjumë,
Të vret, të thyen,
T'ep fjalën që të do
Të bint me nj'herë
Gjer të të lerë
Të mjerë fort

Po jè i pasur
Vjen e të futet
Dhe sa pa hasur
Të rrjep e s'kuqet,
Të xhvesh e thump të vè
Të çpon si grerë
Dhe zè të tjerë
Ikën të lè!

Mos zerë besë
Në sa të thotë,
Fjalët si vesë
Kthehet si rrotë,
S'qendron në fjalë dot,
Dhe s'të do kurrë,
Po mbahu burrë
E mos u ep!

Levarashja[276]

(Trovatore)

Sa që kam parë
Në botën tërë
Si ty të bukur
Nuk gjeta dot,
Këto tiparë
E ato llërë
Ku ishin futur
Fshehur gjer sot?
Ball' e florinjtë,
Hund' e qirinjtë
Vetulla jote
Si kordha[277] pret,

Afrohu pakë,
Mos kaq e madhe,
Se s'të ka hije,
Besa s'të ka,
Do bëhesh plakë,
O moj zarkadhe,
Të shkon ç'do hije,
Mos bëj shaka!
Qepall' e shkretë
Si shpat' e mprehtë
Nga të dy anët
Shkurton e pret.

[276]levarash = dredharak,i paqëndruarshëm,ajy që sillet posht e lart; ajy që nuk zè vent. Ergjelè, rrugaç, vagabond.
[277] kordha = palla, shpata, jatagani.

Kush të pa tynë
E s'u hutua
Dhe gjakn' e tija
S'derdhi rëkè,
Kush të pa synë
E s'u marrua,
S'i ra zalija,
S'u fut në dhè?
Ti me qerpikun
E therr ashikun
Ah, me një pamje
Tjetrin e vret.

O, moj dredhake
Ndalu, mos ikë
Për kokën t' ënde
Ndalu, qëndro,
Ah, moj zëmbake
Më lè një pikë
Që s'më përmende
E që s'më do!
Ah, buz' e kuqe
Po si burbuqe
Mua të mjerin
Në varr më kllet!

Ah, fjalët s't'i harronj

Kur jam i vetëm shpirti im
Të dëshiron pa masë,
Zembra lufton e s'ka durim
Si kur do të pëlcasë
Psè nuku vjen me mua
Që kaqe fort të dua
Eshtrat më dridhen kur kujtonj,
Ah, fjalët s't'i harronj!

Që kur të pashë s'di ku jam,
S'di psè të dua kaqe,
As ha, as pi, as gjumë kam,
As qetësi, as paqe,
Psè nuk kthen kryet nj'herë,
Psè më bën kaq të mjerë,
S'të zbutin këngët që këndonj?
Ah, fjalët s't'i harronj!

Për mua jè nji jetë ti,
Jè nji thesar i tërë,
Të adhuronj sa nuk e di,
Them Qjelli të ka bërë,
Po ti s'e prish qetsinë,
As më përfill të zinë,
Pa ty as qesh, as ligjëronj,
Ah, fjalët s't'i harronj!

Sa her' u mata me guxim
T'avitem afër teje,
E të të thesha me mallngjim
Që pa ty nuk gjenj prehje,
Po trembem e kam frikë,
Se mos më thuash "ikë"
Buza më dridhet e s'guzonj,
Ah, fjalët s't'i harronj!

Për se natyra të krijoj
Të bukur por si Hënë,
Pse è m'ato sy ty të pajoj,
Psè Qjelli t'i ka dhënë?
Psè s'të tregoj një herë,
Mos lesh njeri të mjerë,
Se m'a lè plagë sa të rronj,
Ah, fjalët s't'i harronj!

Llahuta ime dhe ti

Po si bilbili kur ligjëron
Dhe s'lodhet nat' e ditë
Llahuta ime të tingëllon,
Ah, çohu, Afërditë,
Po vjen agimi
Po fryn fullimi
Ah, këjo zembër ty të kërkon!

Oh, lere shtratin, nuk po dëgjon?
Të thres, o hŷll, o dritë,
Llahuta ime nuk të lëndon?
Dëgjoje, Afërditë,
Eja të shkojmë
Bashkë të rrojmë,
Atjè ku shpirti n'a dëshiron.

Të dhashë zembrën e t'adhuronj,
Të dua po si sytë,
Haj, Afërditë se pa ty s'rronj,
Të shkojmë tash me hyjtë,
Në çerdhen t'onë
Për gjithë monë
Qjelli për jetë nè n'a bekon!

Hijes s'asaj

Selvi e lartër ti
Që hijen po të shoh,
Të lutem u kujto
T'i thuash me nga dalë
Prej mejet dy-tri fjalë
Asaj që po mbanj zí;
Sa do e ftohtë jè,
I thuaj s'e harronj,
Edhè për të vajtonj,
E se kjo zemra ime
Nuk gjen dot ngushëllime
Për të dhe sot po rreh!

Më tradhëtoj, e di,
Këtë mëkat ja fal
Sikur se t'ishte gjall,
Dhe sot që s'rron në jetë
Ç'më ndjen kjo zembër e shkretë,
Kallzo-ja gjithë ti,
Sado që jam në vaj
Ajo nuk më shëkon,
Vajtimin s'm'a dëgjon,
Dhe lottët çurk si lumi
S'e zgjojnë dot prej gjumi
A ndjen që bëri faj?

Kujtim i vogjëlisë

(Heine)

Mban mënt kohën e parë,
Kur ishim të parritur,
Kur losnim të pandarë,
Të vegjël e të mitur,
Kur fshiheshim e futeshim
Atjè n'ata kotecë,
Kur nguteshim e hidheshim
Të dy si karkalecë?

Bërtisnim si dy gjela,
Si pula me kaposhin,
Dhe gjëmbat si tryela,
N'a çponin nënë koshin,
Në koshin, ku mbuloheshim,
Ku mbronim trupat t'ona,
Në koshin që po çpoheshim
Me thuprat si perona?

Kur rroknim shoqi-shoqin,
Kur ziheshim për qafe,
Kur shtypnim kollomboqin
E s'ngopeshim me llafe,
Kur rentnim e kur shtyheshim,
Kur hynim në koshère,

Në shtregull[278] kur lëkundeshim,
Kur futshim nënë qère?
Në prehrin e dëllinjës,
Kur vinte n'a afrohej,
E buta mac' e fqinjës
Edhe pas nesh lëmohej?
A e mban mënt kur pyetshim
Qysh u gdhí plak' e gjorë,
Sa qeshnim e sa shkuleshim
Me macen dorë-më-dorë?

Kur macën ti e shtrinje
Dhe un' e gudulisnja,
Kur bishtin ti ja zinje
Dhe veshët un' ja hiqja?
E shkreta sa mundoheshe
Prej nevej të shpëtonte,
Sa herë n'a zembroheshe,
Na çirrte, n'a kafshonte?

Kur vijnim në plevicë[279],
Kur hyjnim në kashtore,
Kur shempnim ç'do kapicë,
Mullare e grazhdore,
Mbi kashtin kur po hidheshim,
T'harbuar e të marrë,
Në kopshtin kur vërsuleshim
E s'lijnim gjë pa ngarë?

[278] shtregull = lodër fëmijësh, lisharës, shilarës, kolovajzë.
[279] plevicë = kashtore, grazhdore,kolibe

Sa bukurí që kishte
Kur nqaseshe Pranvera,
Nër pyje, nër ahishte
Kur delnim tok nga hera,
Kur në trifilin shtriheshim,
Të dy e pa përtesë,
Edhè mbi bar kur zhgryheshim
E lageshim me vesë?

Por, ah, sot jemi ndarë,
Nuk shihemi as nj'herë,
Par' asaj kohës s'parë,
Kjo duket një Sketerë,
Të dy po cigarisemi[280],
Nër *halle*, në *merake*,
Po mplakemi, po fishkemi,
Ah, jetë rrenacake!

[280] cigaris = pjek në tigan me gjalp ose vaj, tiganis.

Del pakë në dritare

Nga gjumi ngreu në të vjen keq,
Del pakëz në dritare,
Për një të varfër që po heq
Mëshirë nuk kè fare?

Në mos kè zèmbër, në jè gur,
Në mos ndjen gjë për mua,
Për se m'a bëre shpirtin zhur,
Dy fjalë psè s'më thua?

Nat' edhè ditë të këndonj,
Tufani s'më tremp kurrë,
As dbor' as akulla s'kujtonj,
As vdekje e qivurë!

Në më dëgjofsh që nuk jam gjall,
Ti mos e prish qetsinë,
Po, si më parë prap' u tall,
Me mua ah, të zinë!

Një hije t'errët po të shohsh
Prej varrit që të dalë
Jam unë prapë mos harrosh,
Ty nuk të ndahem halë!

Haj këtu me mua

(Muzikë Thoma Nassi)

Prapë ardhi vera,
O thëllëz' e malit,
Eja, si nga hera
Të t'heth vithe kalit,
Haj këtu me mua,
Drejt t'ja mbajmë penë[281],
Në fshat t'im të vemi,
Të ngrehim folenë
Të dy tok të jemi,
Tjetër gjë nuk dua!

O moj nus'e pyllit,
O moj Leonorë,
Er' e ves'e Prillit
Që s'të vë në dorë.
Jè si një pallua,
Mos për kokën t'ënde
Mos u lëkund aqe
Norë, mos u çmënde
Që s'më përfill kaqe?
Tallesh, a po ç'thua?

[281] pe – peri = fill, filli i jetës

Në mos ndjen dëshirë,
Në jè e penduar,
Thuaje më mirë,
Mos rrij e zembruar
Çpalle, si një grua,
Në mos besa-besën,
Për të fundit herë
Prema fare shpresën,
Lè të vdes i mjerë
Kur ti s'jè për mua!

Nuk je ti?

Gjono, të thonë, të njoh që voglije,
O sy-larushe, mes-hollë e selví,
S'të kam harruar po ti sytë s'm' i shtije
Psè s'm'a shpjegon t'a di,
Nuk jè ti?

Ah, Gjono,psè mohove dashurinë,
Ti mbaj ment si kemi shkuar në vogjlí,
Si kemi lojtur bashkë në lëndinë
Kur ishim miturí,
Nuk jè ti?

Tani q'u rrite, nuk di pse ndryshove,
Dukesh si tjetër, habitem, bënj çudi,
Ku vanë fjalët, beja q'u betove,
E madhja dashurí,
Nuk jè ti?

Mos, moj dredhake, janë gjithë hua
Ahti[282] jem do të të ndjek si stihí,
Ah, lozonjare, që më rrejte mua
Do vuash për Pèrndi,
Dije ti!

[282] aht = (tr.) vreri i zembrës, zjarri i zembrës,ankthi i shpirtit, flaga e dashurisë.

A e mban mënt?

A e mban mënt kur ishim tok,
Kur losnim të gëzuar,
Edhè dëfrenim shok me shok
N'atë luadh' e shtruar?
Të dy mbi lulet gjithë gas
Rëkllehesim e qeshnim,
As un' as ti nuk rijshim pas,
A e mban mënt se ç'theshnim?

Her' herë unë me gëzim
Në lodër të gërgisnja,
Edhè me shpres'e me guxim
Diçka në vesh të flisnja,
Sa do që skuqesh atë ças
E dridhesh e tundohesh,
Ti, gjithënjë buzën gas
E kishe, s'hidhërohesh.

Harrove shpejt dëfrimn' e math
Lulet e trëndafilet,
Harrove krejt atë luath,
Lëndinën e trifilet,
Harrove qeshjet për njëmënt
E lodrat e fjalimet,
E ç'tjetër thamë n'atë vënt ....
Të puthurat, premtimet?

Po mos u mburr, se vjen një dit,
Të gjitha do shpërblehen,
Dhe një pas një këto i prit
Se hua do t'të kthehen.
Kjo pabesí që më tregon
Dikur do t'të mundonjë,
Zoti vonon po nuk harron,
Dhe ty do t'të dënonjë!

Dremit o engjëll

Dremit, o engjëll, flij, pusho,
Pusho e lum' e qetë,
Edhè gjësendi mos kujto,
Po flij me të vërtetë,

Mos u trazo për as njeri,
Mos u tundo për mua,
Mos prish qetsinë, po rrí, fli,
S'më do, po un të dua!

Dremit se hylli tash po del
Dhe dita po afrohet
Edhe agimi përgëdhel
Gjumin t'ënt që po shtohet.

Ti nuk po ndjen aspak hidhnim,
Mermer jè, s'kè mëshirë,
Sa do që vuan shpirti im,
Ti flí mir' e më mirë!

Ah, flij, se pranë teje jam,
S'të ndahem as një herë,
Një zjar në gji, një flagë kam,
E shoh se jam i mjerë,

Se të kam dashur sa s'e di
Nuk munt të gjendet masë,
Po prapë gjumin mos prish ti,
Ky hall mos të të vrasë!

Dëshpërimi

Gjëmo, o val' e detit,
Buçit e shkumbëzo,
Si krisma e tërmetit
Kërcit e shkatëro,
Ashtu si zembra ime
Krahrorin m'a lufton,
Ashtu si me trokllime,
Më djek, e më copton!

Si shkëmbin që tallazi
E rreh e depërton,
Dhe trupin t'em marazi
M'a tret e ma dërmon!
I shkretë pa një shpresë,
I vetëm pa njeri,
Si lule që s'ka vesë,
Jeta m'u shojt, m'u nxi!

I ndarë e i mjerë,
Pa ngushëllim po rronj,
Me val' e poterë
Nuk di si po duronj,
M'u fik e shkreta jetë
Do vdes me do-mos-do,
Se mbeta krejt i shkretë,
Ajo, mjerisht, ç'më do!

Duro moj zembër tmerin,
Tjetër mënyrë s'ka
Gëlltite helmin, vrerin
Që po të breh, të ha!
Si prisnje nj'herë gazin
E lumur me galldim[283],
Duro dhe sot tallazin,
Çdo vrer e çdo pikllim!

[283] galdim = Gëzim i madh; ngazëllim

Mos harrò

Me lule plot varrin m'a shtrò
Të bukra si jè vetë
Dhe dit për dit haj i mbulò
Me lote e me fletë
Dhe një nga një numurò
Të puthurat, dëfrimet
Dhe mua pak më ngushëllò
Me t'ëmblat, ah kujtimet!

Era e lulevet më xgjon
Dëshirën që kam tretur
Eshtrat ajo m'i ballsamon
Sa do pa shpirt kam mbetur,
Edhe sa do që nuku ndjenj
E jam mermer, i ftohtë,
Gëzimin, ah, n'ato e gjenj
Ato më mbajnë ngrohtë!

Ah, mos harrò fjalën që dhè
Ah, mos harrò premtimet,
Ah, mos harrò se sa më thè
Ah, mos harrò betimet,
Si mua kurrë tjetër shok
S'do gjesh në këtë jetë,
Mbaj mënt se kush për ty u doq,
Si shoku i vërtetë!

Ngushëllimi

Del prej malit e bukura hënë,
Çele dritën e plottë që kè,
Tash që bota në gjumë ka rënë,
Ndrit mbi detin e qetë që flè.
Në mjerimin që kam q'e di vetë
Ngushëllim, përdëllim më vërshò,
Kësaj zembre që dridhet si fletë
Pak gëzim q'atjè lart i lëshò.

Gjithë flenë, e qet' ësht' nata,
S'tundet fletë, as halë, as gjeth,
Veç se ankthi i zembrës, lëngata
Qetësin' e tundon rreth e rreth.
Barr' e rëndë për mua jetesa,
Këjo jet' e mërzitur që rronj,
Shpresa ime u zhduk por si vesa,
Dëshpërime e ankthe duronj!

Ah, o hënë, e bukura hënë,
Ngushëllim sot për mua ti jè,
Për të mjerët ballsam ti kè qënë,
Në dëshprim ata kurrë s'i lè!
O, e bukur e Qjellit krijesë,
Kur del malit dhe qetas zè breth,
Ç'do hidhrim ti e kthen në një shpresë
Buzëqeshjen pa masë e derth.

Në të kandëshmen t'ënde fytyrë
Një nënqeshje të ëmbël po shoh,
Me ty ndrit an' e kand kjo natyrë
Çdo njeri e lëmon e e ngroh,
Hën' o hënë, e bukura hënë,
Plagët t'ime tani s'i mentonj,
Psherëtimet tani i kam lënë,
As atë që s'më do s'e kujtonj!

Hylli dhe ti

Po kqyrnja lart, një hyll në qjell
Që s'loste, as që tundej,
Po befas zu lëkundej
Dhe u këput e ra,
Ah, thashë, ku do vejë,
Rrezik të math do gjejë
Prej shokëve q'u nda!

Po kur me nj'herë po shëkonj
Se hylli paska rënë
Dhe vënt mbi dhè ka zënë
Sa kaqe vinj nder ment
E hŷllin kur e pashë
Të njoha ty, o vashë,
Se ishe ti njëment!

Pse po qan?

Ç'kè moj Kate, që po qan,
Psè ankon,
Psè rënkon?

Kush të flet, mërí të mban,
Psè s'kallzon
Psè s'tregon?

– Ah, morè bujar, të lutem,
S't'a them dot, jam vajzë e tutem[284]!

Ç'kè, moj Kate, që pshertin,
Me hidhnim,
Me pikllim?

Mos të foli njeri gjë,
E për të
Nuk bën zë?

– Jo, morè, bujar, të lutem
Mos më nga, jam vajz' e tutem!

Psè, moj Kate, nuku flet,
Kush të nget
Kush të thret?

[284] tutem = kam frikë, trëmbem.

Mos jot' ëmë ty të shau,
Mos të rrahu
Mos të vrau?

– Jo, morè, bujar, të lutem
S't'a them dot, kam frikë, tutem.

Fol' o Kate, folë ç'ke,
Njeri s'sheh,
Kush s'n'a njeh
Mos kè dashur? Edhè sot
S'e flet dot?
Psè derth lot?

– Po, bujar, po, hesht të lutem,
Se jam goc' e s'bën të ngutem

Ah, moj Kate, tash marr vesh
Psè po qesh,
Do rëfesh?
Mos më do e nuk' e di?
Jam gati,
Folë ti

– Ah, të dua s'ta merr mëndja
Eja mermë se jam t'ëndja!

Shkumbinit

O, Shkumbin, Shkumbin me valë,
Ç'kè more, që shkon nga dalë,
Psè po ecën i mentuar,
Psè jè tepër turbulluar?

– Ah, more çun, morè djalë
Mos më pyet, s'nxjer dot fjalë,
Ç'më ka zembra s't'a kallzonj
Frikë kam se të helmonj!

O Shkumbin që shkon si ati[285],
Mos kalove nj'atij fshati,
Ku e kam thëllënzën t'ime,
Që e pres plot me gëzime?

– Ah, mos prit i gjori djalë,
Po më len të shkonj nga dalë,
Të më lesh të qanj me lot
Se ngushllim nuk gjendet dot!

Mos ajo të ka kallzue
Disa fjalë ty per mue,
E ti trembesh të m'i thuash?
Folm' aman, ashtu më rruash!

[285] Âtë, i = kalë i vargër (i patredhur), që përdoret për ndërzim, kalë i shpejtë.

– Ah, mor djalë, psè më pyet,
S'di ku jam e ku kam kryet,
Plagën, ah, mos e gërga,
Se shërim kjo nuku ka!

O Shkumbin, Shkumbin i lehtë,
Psè unj kryet e shkon qetë?
Ndale, rrugën, kam dy fjalë,
Do t't'i thom, s'të ndahem halë,

– S'kè psè pyet, mor' i marrë
Për një plagë, për një varrë,
Sy-larushja të harroj,
Tjetër desh... e mori, shkoj!

Gjer sa të vdes

Tatëpjetë bregut zbrisnje,
Moj mëshqerë, sy-shkëndi,
Gjithë qeshnj' e gjithë flisnje
Lodra, qesëndi,

Po si kaproll' e malit,
Losnje, brithnje pa përtim
Si princes'e bij e kralit,
Flutur në fluturim.

Isha mituri si tynë
Dhe të kqyrnja me çudi
Ball' e vetull, hûnd e synë
Dhe se ç'tjetër s'di.

Si magnit, si elektrikë,
Syt' e mij s't'u shqitshin dot
Dhe një drithme e një frikë
Më lëvrijnin kot.

Oh, si rentnje e si brithnje,
Moj sy-blertë mituri,
Belth e shtat si i përdrithnje
Oh, sa bukuri!

Dallëndyshja lozonare
Kish zilí, të vinte pas,
Shqer' e butë e manare[286]
Të ndiqte me gas.

[286] manare = qengj i vogël që rritet në shtëpi e të ndjek pas ku shkon.

Atë çast s'dinja ku isha,
A në qjell, a po në dhè,
Mënt e goj' e fjalë s'kisha,
S'di se qysh m'u pè,

A të fola ndo një fjalë
A t'a ndala çapin t'ënt?
S'di – se isha tepër djalë
Besa s'e mbaj mënt!

Vjete mjaft kanë kaluar,
Ti u rrit' e para s'jè,
Jè martuar, zbukuruar,
E fëmijë kè.

Po sa do që jè martuar,
Unë s'mund të të harronj,
Gjithënjë të kam kujtuar,
Fort të dëshironj.

Po si *Wèrtheri Karlotën*[287],
Bardhë, ty në shpirt të kam
Gjer të vdes e t'a lè botën,
Pranë teje jam;

Bënj mëkat se psè të dua?
Folë, folë, mos e mbaj,
Ah, ti s'di sa vlen për mua,
Qaj, moj zembër qaj!

[287] Në AQSH F.429-3-258 ndodhet origjinali me shkrim dore i vjer-shës "Gjer sa të vdes". Aty Kristo Floqi shkruan: "Vjershëtori Gjer-man Goethe,në roman' e tij "Werther", kallzon se ky Werther e desh Karlottën, po me një dashuri pa dredhi, e me gjithë shpirt, sa që të mos i prish lumniën të shoqit të saj Albertit,mikut t'vet, vrau vedin".

Ah, kijmë pak ndër mënt!

(Serenata Shubert)

Në mest të natës, të qetësisë
Njatë po të shkonj,
Edhe me këngën e dashurisë
Gjumin t'a tundonj,
Ah, e çil atë dritare,
Të të shoh syrin t'ënt,
Edhè mos kij frikë fare,
Ah, kijmë pak ndër mënt!
Bilbili vetë që po ja thotë
E po ligjëron,
Sa do ka zëthin t'ëmbël të plotë
Pak më ngushëllon,
Nxire kryet pak në dritë
Fytyrën të t'a shoh,
E shëkomë syt e rrijtë[288]
Edhè në daç mbeso.
Jam i venitur, jam i drobitur,
S'gjenj një përdëllim,
Jam i brengosur, jam i mërzitur,
Vrer e hidhrim,
Shpëtimtari jè ti vetë,
Ti në daç më shpëton,
Ti më ngjall, më mban në jetë,
Veç ti më qetëson!

[288] syt e rrijtë = sytë e përlotur.

Eja, eja!

Sa e bukur këjo natë,
Hëna plot posa ka dalë,
Deti flè i gjer' i gjatë
Edhè flladi fryn nga dalë.
Eja, eja të vrapojmë,
Lundr' e vogël po n'a pret
Eja bashkë të lundrojmë
Në këtë të bukur det.
Eja eja, Eja eja!

Gjithë flenë këtë orë,
Zë gjëkundi nuk dëgjohet,
Eja shpejt në kto krahrore
Zemr' e varfër të më ngrohet,
Eja, eja të vrapojmë,
Lundra jonë po n'a pret,
Eja bashkë të lundrojmë
Mbi këtë të bukur det.
Eja, eja!

Shëko qjellin ç'farë ngjyrë,
Sa i kthellët, sa i qetë
Sa e ëmbël kjo natyrë,
As gjeth tundet, as një fletë,
Eja shpejt të flutyrojmë.
Det'i kaltert po n'a pret,
Eja bashkë të lundrojmë,
Lundr' e vogël po n'a thret.
Eja, eja!

Fryn veriu me ëmbëlsirë,
Fllad' i bukur, erë mali,
Oh, sa ënd' edhè sa hîrë,
Oh, sa shije ka ky zalli!
Eja, eja të nxitojmë,
Eja t'ikim sa më shpejt
Zgjidhe lundrën të lundrojmë
Mbi këtë të bukur det.
Eja, eja!

Qjelli mbushur plot me hŷje
Po shndrit i bukur shumë
Rreth e rrotull kodra, pyje
Edhe njerëzit në gjumë,
Eja t'ikim e të shkojmë
Se nuk gjenden kësíj nett,
Eja vajzë, të lundrojmë
Mbi këtë të bukur det!
Eja, eja!

Pa shih uji sa fosforë
Ka për brënda si mizrija,
Shih dhe lundrës krahërorë
Q'i përhap po si shkëndija
Eja, eja të lundrojmë
Të dy bashkë për mbi det,
Ngutu, ngutu që të shkojmë
Lundr' e vogël po na pret.
Eja, eja!

Flenë gjithë! Gjum' i gjatë
E i thellë i ka zënë,
Shih, oh, shih ç'e bukur natë
Shëko qjell, e shëko hënë!
Eja, eja të vrapojmë
Mbi këtë të bukur det,
Të bashkuar të lundrojmë
Eja lundra po n'a pret.
Eja, eja!

S'ndahem teje!

Ti që flytyrove qjellit
Pa mentuar kê lè prapa
Dale prit, mos hiq[289] me hapa
Shpirti im èdhe të do,
Prit, ah prit, mos hiq kaq shpejtë
Prit dëgjo këto dy fjalë
Që prej zembre kanë dalë
Preje rrugën, ah, qendrò!
Dhe në qoftë se kjo botë
N'a piklloj, n'a la të mjerë,
Dashurija do n' a bjerë
Atjè sipër një lumrí,
Ah, mos ikë, mos largohu,
Ku po shkon më merr dhe mua,
Të kam dashur dhe të dua
Vinj atjè me ty të rrí!

[289] Hiq = ik

Pse të njoha?

Psè u ndodhe ti për mua,
Psè më ndeze këtë flakë,
Dhe tani s'qendron as pakë,
Po shkon, ikën e më lè?
Ah, psè zembra t'u ndryshua,
Edhè s'kè as pak mëshirë,
Ikën, shkon në hapësirë,
Edhè prapa nuku sheh?
S'e besonja nga ty kurrë
Të qendronje kaq në besë
Po sot shkon, më pret çdo shpresë
Sa do që pa ty nuk rronj.
Shpirti im zhur, po si urrë[290],
Nuk të ndahet asnjë herë,
Në Parajs'a në Sketerë
Me ty dua të qendronj!

[290] urë = drû i djegur me zjarr akoma.

Dashuri e Atdhè

Dit' e luftës po shkrep e tmeruar,
Hyjet fshihen, sa vjen zbardhëllehet,
Luftëtari po ndizet e nxehet
Dhe me vrap për në luftë po shkon;

Po e dashur' e tij që ka frikë,
As një çast nuk e lè, e ndalon,
Është natë, i thotë, mos ikë,
Po ajy do të shkonjë, s'qendron.

Lermë, lermë, i thotë,se gdhihet,
Afron dita dhe duhet të shkojmë,
Tok me shokët atjè të luftojmë,
Lermë, lermë, detyra më thret!

Po ajo ca më tepër i lutet,
Me fuqí në krahror e shtërngon,
Fjalë t'ëmbla i flet që të zbutet,
Lotet lumë i derth e s'pushon.

Po shoh hyjet e dashura ime,
Zunë tremben, nga dale po fshihen,
Vjen mëngjezi dhe hŷjet më s'shihen
Dua t'ikënj, më tepër s'qendronj

Po ajo prej atij nuku ndahet,
S'e lëshon, po më shumë e shtërngon,
Rij dhe pakëz, i thotë, i qahet,
Rij, mos ikë, ka kohë, s'agon.

S'po dëgjon vrengëllimin e shpatës,
Zën' e topit, ushtimin e hutës[291]
Zërin t'ashpër e t'egër të luftës,
S'i dëgjon, nuk i ndjen, s'i menton?

Po ajo dyke qarë nga herë,
Syt' e zeza kulluar në lott,
Ah, i thotë, pa ty jam e mjerë,
O, mos ikë se s'ndahemi dot!

Ah, lëshomë, e dashura ime,
Duhet t'ikinj me vrap, se më presin,
Ushtërija, zantrija[292] më thresin,
Zër' i kombit në zembër më çpon,

Duhet shpejt nga rreziku Atdhenë
T'a shpëtonj prej armiqve të vet,
Për me mujtë[293] a me dekë dhashë benë,
Lutju Zotit të kthehem më shpejt!

[291] hutë = Lloj pushke e vjetër.
[292] zantrija = tromba, trombetë, briri (corno) që lëshojnë zë fortë.
[293] me mujtë = me fitue luftën, me ia arritë qëllimit.

Si ty tjetër s'ka

(Serenada Faust)

Ti që flè e rrí e qetë
Pa del të të shoh,
Të të them, ah, zembr' e shkretë
Ty sa fort të do.
Jarâni[294] kështu të thotë
Të këndon me gojën plotë
Si ty tjetër s'ka,
Ha, ha, ha!

Çile derën, mos më lerë,
Se s'duronj pa ty,
Mos më vraj, më bëj të mjerë,
Shihmë pak në sy
Ha, ha, ha!

Katerinë sa të dua
Ti pse më mohon,
Psè dy fjalë nuk më thua
Për se më copton?

Jarâni kështu të thotë
Të këndon me gojën plotë
Si ty tjetër s'ka,
Ha, ha, ha!

[294] jarân = Dashnor, dashuronjës, i dashur.

Del të lutem në dritarë
Pa durim të pres,
Të të shoh, o moj mittare,
Pastaj lè të vdes,
Ha, ha, ha!

Po të thres, moj gjeraqinë
Mos bëj sikur fle,
Ti s'e çmon, ah, dashurinë,
Aspak nuk m'a njeh!
Jarâni kështu të thotë
Të këndon me gojën plotë
Si ty tjetër s'ka,
Ha, ha, ha!

Jè e fortë si graniti,
Shpirt e zembër s'kè,
Shtati yt, ah, më mahniti,
Mermèr' jè a ç'jè?
Ha, ha, ha!

Lè të vdes, pra krejt i mjerë
Pa ty s'rrohet dot,
Më mbulò, në dhè më shtjerë
Dhe mos derth as lot,
Jarâni kështu të thotë
Të këndon me gojën plotë
Si ty tjetër s'ka,
Ha, ha, ha!

Lamtumirë Katerinë,
Gjumin, ah, mos e prish,
Kur të zgjohesh, ah, të zinë,
Do mos më gjesh, t'a dish!
Ha, ha, ha, Ha, ha, ha!

Bilbili dhe ti

N'atë kopsht me lul' e trëndafij,
Me bar të njohmë, jargavan, trifil,
Këndon bilbili, po këndon dhe ti
Sa edh' ajy nemitet, për çudi!
Ajo fytyrë
Me atë ngjyrë
Njerin' e robëton
Zëri tingllyer
Fort i mallnjyer
Zembrën ma depërton.
Të shoh për dit kur lulet i vadit,
E kur këndon, ti jetën m'a përtrit,
Po edhe lulet endin me gëzim,
Dyke dëgjuar këngët me galldim.
Ky qjell' i naltë
Fytyrën t'artë
Sa bukur t'a pajoj,
Dhe syt' e tua,
Shpata për mua,
Natura t'i dhuroj!
Vadit, vadit dhe këngën e vazhdo,
Zëthin e qjelltë nxire, mos e mblo,
Mendjen m'a tret ti m'atë ligjërim,
O, engjell i perndijtë, kerubin [295]!

[295] kerubin = ëngjëll i pranishëm para lavdisë së Zotit.

Ah, sa kè hirë
E ëmbëlsirë,
Ky zë vallë nga del,
Që prân[296] bilbili,
Hap trëndafili,
E vjollca për ty çel!
Këndo, këndo, se ti njerin' e ngjall,
Shpirtin ja zbut'i shton dëshir' e mall,
Moti kalon, po njeriu s'e menton
Se plaket, vdes, ah, kurrë s'e kujton!
Si kur se zënë
Kij moj kadënë[297]
Dhe fjalën një shërim,
Që të shëronje
Të ngushëllonje
Të mjerin shpirtin t'im!

[296] prân = pushon, nuk nxjerr zë, hesht.
[297]kadënë = grua, zonjë fisnike, bujare.

Desha të di

Desha të di psè mot për mot
Po ngjallesh e po rritesh,
Desha të di psè qesh e lot,
Psè nisesh e stolisesh?

Desha të di psè po nxiton
Psè kaqe tepër tundesh,
Psè as me sy nuk n' a shëkon
Psè aqe fort lëkundesh?

Desha një herë të të shoh,
Ku sillesh e vërtitesh,
Desha në syrin t'ënt të njoh
Vallë për cilin vritesh?

Desha të di psè gjithë gas
Ecën e gjithë ngutesh.
Desha të nisem të vinj pas,
Të shoh ku shkon, ku futesh!

Desha të di, desha të di
Psè gjithë më largohesh,
Desha të msonj psè kaqe ti
Ndaj meje nuk afrohesh?

Desha në vesh diç' të të them,
Po ti do më zembrohesh,
Desha me ty bashkë të jem,
Po ti do dëshpërohesh.

Desha një fjalë që më thè
Ty të t'a përsëritnja,
Desha, ah, besën që më dhè
Prej shpirtit t'im t'a shqitnja!

Desha kur, plakë ti të jesh
E fishkur e e thinjur,
Fajin e math thellët'a ndjesh,
Ti, që nuk kè të ngjinjur!

Beqari

(Muzikë Thoma Nassi)

I shkreti beqar, i shkreti,
Ah, ç'e keqe që të gjeti,
Që s'do të martohesh,
Që s'do të gëzohesh,
Ku di ti ç'është *xheneti*,
I shkreti beqar ç'të gjeti!

Jeta vetëm nuku shkohet,
Dhe beqari do martohet,
Se me të vërtetë
Merr vesh ç'është jetë,
Ah, nuk di ç'është *xheneti*,
I shkreti beqar ç'të gjeti!

Mos beqar u mendô kaqe,
Se t'u fishknë ato faqe,
Mos rij i helmuar,
Që s jè i martuar,
Merre vesh ç'është *xheneti*,
I shkreti beqar ç'të gjeti!

Prej thëllëzash faqe kuqe
Zgjith e merre një burbuqe,
S'rrijet kështu vetë,
Si qyqar i shkretë,
Se laraskë pa bisht s'mbeti
Ah, orè beqar, ç'të gjeti!

Edhè të dua!

Sa do vjètët e lumur kaluan,
Sa do krejt u harruam të dy,
Atë jetë të ëmbël që shkuam,
S'e harronj, se të desha fort ty!

Ti u rrite e tash nuk kujtohesh
Cilin shok ti kè pasur e rè,
Rron e lumtur e nuku mentohesh
Për atë që të varfër e lè!

Të kam dashur me gjithë fuqinë,
Jetën flí e kam bërë gjithmon,
Po mjerisht un' e humba lumrinë,
E pa-besë më dolle më von!

Në tallazin e jetës i mbetur
Pa një shok, pa mëshir' e ngushllim,
Edhè sot qetsí nuk kam gjetur,
Jam i shkretë pa një përdëllim!

Ti, o Hënë e artë, e zbetë,
Që në qjell me nga dalë lëvron
Kësaj zembrës së varfës, së shkretë
Bëju shok, që të thrret, të kërkon!

Jè e vetëm dhe ti, po si mua
N'hapsirën e gjatë që shkon,
Lotet t'ime q'i derth si një krua,
Vetëm ti nat' për nat'i shëkon.

Do t'i jem një besnik i vërtetë,
Edhè fjalën q'i dhashë e mbanj,
Do të mbetem i mjerë për jetë,
Po prej shpirtit atë nuk e ndanj!

Ngjalle shpirtin tim!

(Bella figlia dell' amore)

Vajz' e bukur engjellore
Skllavi yt të jam për jetë
Ah, ngreh kryet pak përpjetë
Kij mëshirë e përdëllim.
Eja nqasu, moj hyllore
E më fal një ngushëllim!

Syt' e tua si shigjeta
Kur m'i shtije më përvlojnë
Edhe plagën m'a lëndojnë
Q'ësht' e hapur e s'u mbyll,
Janë shpata fort të mprehta
Që farojnë dhe një pyll!

Eja shpejt e pa vonesë,
Plagën t'ime ti shëroma,
M'ato buzë aq të njohma
Derthmi zembrës një gëzim,
Ngushëllomë, o prinçesë
Ngjalle, ngjalle shpirtin t'im.

Ankthi

Rënkon i mjeri det,
Buçet e shkumbëzon,
Dhe vala po kërcet
Dhe shkëmbin e dërmon.
Tangë[298] të madhe duket
I shkreti det që ka
Shih vala si shkëputet
Dhe zallet si i ha!
Kështu si ty, o det
Dhe shpirti im rënkon
Si vala që buçet
Ashtu dhe ky ngufon
Edhe, si shkëmpn' e gjorë
Kjo val' e shkatëron,
Dhe ankthi im krahrorë
E rreh, e depërton!
Ti det dikur pushon
Edhe tallaze s'ngreh
Stuhija jote shkon
Edhe qetsohesh, flè,
Po unë s'kam si prehem,
Qetsí nuk munt të gjenj,
Edhe më kot gënjehem,
Jetën t'a rëkëllenj!

[298] tangë = dert, siklet, aht, dhëmbje

Qoftë mermèr, a gur,
A hekur, ose trunç[299],
Qoftë granit, a mur,
Ose çelik, a brunç,[300]
Prej zjarit munt të tretet,
I gjendet një derman,
Po zembr' e saj nuk epet.
Të vdes, të tret, të than!
Qënka e ftoht'ajo,
Që ankthi s'e tundon,
E kuptonj, e shoh,
Sa mizorí tregon!
Ah, sa i rrejtun isha
Kur bes'i zur' asaj,
Kur fare mir' e dijsha
Që s'kisha një uzdaj!

[299] trunç = tunxh, lidhja e bakrit me zinkun,brunxhi,bakri, rema
[300] brunç = një farë metali i verdhë e i fortë, bronz.

Largimi

Kur të thashë se do shkonj
Ti u zbejt' e derdhe lott
Atë çast kur e mendonj
Ah, më mbushet zembra plot,
Ika i piklluar
Fort i përvëluar,
M'u droth shtati s'e harronj,
Ah gjer sa të rronj!

Kur të pashë drejt në sy
Ndjeva një të math trishtim,
Dhe sa isha tok me ty
Kisha tepër turbullim,
Ika e të lashë
Edhè më s'të pashë,
Po sa do që lark të kam
Prapë me ty jam!

Sa do det i math n'a ndan,
Fort e gjata largësí,
Mendjen, oh, asgjë s'm'a mban,
Vjèn ne ty e gjen qetsí.
Prit se nuk vonohem,
Shpejt do të t'afrohem,
Se pa ty e di që s'rronj,
Veç se do duronj ....

Më dolle e pa besë

Ç'u bëre? po të pres,
Ike më lè e s'dukesh,
Edhe sa do të thres,
Ti as që lot, as ngutesh,
Psè më mundon,
Psè më dërmon,
Jè hekur e nuk zbutesh?
Ku jè nuk m' i dëgjon
Ankimet e rënkimet?
As kthehesh, as shëkon
Si lottet, si pikllimet?
Nuk do të vish,
As do t'ja dish?
Të zënçin, ah, mallkimet!
E mora vesh, s'ka gjë,
U rrejta kot me shpresë,
E shoh se nuk bën zë
Më dolle e pa-besë,
Unë do heq
Po mos kij keq
Se do të marr shpagesë!
Ah, m' a punove ti
Më ndeze si një furrë,
Edhè po bënj çudí,
Psè nuk qendrove burrë!
Ah, ç'zembër kè
Bishë, a ç'jè
Që nuku ngjinjesh kurrë?

Dashuri e pare

Hyjet zhdukshin dal nga dal,
Dhe qjelli zu zbardhllonte,
Qeshte ç'do fushë, kodër, mal,
Natyra gjelbëronte,
Shpeshët të gjithë drû më drû
Me ëmbëlsi këndonin
Bilbilat herët ishin çû
Dhe pyjet po jehonin.

Duket se dita kish' një ndrim
Prej ditëve të tjera,
Një kundrëmim e një blerim
Kish pas'ardhë pranvera.
Bima, trifili mbushur plot
Me një të lehtë vesë
Dhe shpirti im s'gjinjeshe dot,
Ndjenja një gas, një shpresë!

E par' e Majit ish' at' dit
E kthellët, e shkëlqyer,
Kur kishe dalë me shetit
E kandëshm' e pëlqyer,
Veshur ndër lule funt e krejt,
Pranverën po stërditnje,
Dhe si thëlleza ecnje drejt
Sa bukur qe shetitnje!

Ah, atë dit sa lumërí
Ka ndyer zembra ime
Dhe me sa droj' e dhemburí
Ty më s'të ndahej grime[301]!
S'kishte m'e madhe dashurí
M'e ëmbël, m'e mallngjyer,
Oh, kishe tjetër bukurí,
Që nuk ka të rëfyer!

Ndjeva shigjetën që më çpoj,
Shigjetën dashurore,
Që zembrën tepër m'a tundoj
Një drithmë depërtore,
E qysh ahere jam shitû[302]
Shërim s'kam për të gjetur,
Dashtnin e parë tue kujtû,
Ah, sot beqar kam mbetur!

301 grime = aspak, fare.
302 shitû = plagosur.

Si kur të deshe!

Si kur të deshte zembra jote
Të marrë vesh këtë dashurí,
Do t'ja dëshmonin këto lotte
Që derdhen sysh me dhemburí!

Në e kè zembrën aq të ftohtë,
Sa s'ndjen dëshir' a përdëllim,
Ah, shpirti yt mos e premtoftë
Të dergjet kot ky trupi im!

Oh, atë çast kur të kam parë,
Kur u stërditmë sy-për-sy,
Ndjeva një plagë e një varrë
Dhe s'ëndëronj përveç se ty!

Po ti, si duket, s'ndjen dëshirë,
Nuk ndjen për mua dashurí
Se do të kishe pak mëshirë,
E nuk do mbanje kaq mërí!

Në mos u pjekshim lamtumirë,
Mos më harrò, më kij ndër mënt,
Në mos më daç, oh, jè e lirë
Të bësh ç'të t'thotë shpirti t'ënt.

Lè të lotojnë syt e mija,
Po si rëkè e si përronj,
E lè të bëhen kronj' e vija
Se gjer të vdes nuk të harronj!

Plagën m'a lëndon

(Muzika Thoma Nassi)

Dy fjalë t'ëmbla dua të të them,
Ah, qasu pranë edhe dorën nem,
Të dua fort sa s't'a tregonj
Zembra për ty gjithnjë lufton,

Lermë të të afrohem,
Me ty të përgëzohem,
Me ato sy kur më shëkon,
Ah, plagën m'a lëndon!

Eja, afrohu edhe mos u kuq,
Dhe kaq' e egër vajzë, mos u duk,
O moj zarkadhe, që, kur shkon,
Mua më vret, më përvëlon

Mos ji kaq' e pa-shkuar,
Si shpeshi i harbuar,
Eja bardhoshe m'u afro,
Ah, plagën m'a shëro!

O virgjineshë që ndrit po si âr,
Këtë maras që kam e këtë zjar,
Ti me një qeshje m'a pushon,
Fletët e zembrës m'i qetson,

Shuaje këtë flagë,
Ah, mbyllma këtë plagë,
Tjetër të lutur nuku kam,
Në këmbët t'ënde jam!

Të lè shëndenë!

(Paloma)

Të lè shëndenë se ikinj lark e shkonj,
Ah, lumtumirë e dashur se nuk t'harronj,
Prej teje s'ndahem kurrë po kij durim,
Dhe dashurinë t'ime kij për kujtim,
Ah, mos u dëshpëro,
Besnike më qendro,
Se do kthehem prapë, nuku duronj,
Ah, kurrë nuk t'harronj!

Lundra e hapi velën, u nis, po shkon,
Detin e kaltërt shih si e çan, nxiton,
Po si një flutur ecën e lark më çon,
Edhè tallas e valë po i kapton,
Ah, besën do t't'a mbanj,
Nat' edhè ditt do qanj,
E do mos gjenj as prehje, as qetësi,
Lark teje jam fatzi!

Të lutem për mua mos u dëshpërò
Dhe n'u vonofsha pakëz mos m'u tmerò
Kur të vinj pranë teje do t'i harrosh
Trishtimet e mërzitë s'do t'i kujtosh.
Ah, lamtumirë shkonj,
Po ikinj, po kalonj
Zoti të past' e dashur tynë kujdes,
S't' harroj gjer sa të vdes!

Atë natë s'e harronj

(Barcarollë[303])

Ndritte hëna një natë mbi liqen,
Ndritnin dhe hyjet dhe shkëlqenin,
Po syri im fort më të bukur gjen
Ty që lundronje mbi liqenin.

Ishte pranverë, natë mrekullí,
Edhe shkëndijat xhixhillonin,
Po syt e mija, tepër me habí
Veç bukurít e t'u shëkonin.

Oh, për njëmënt ishte vërtet çudí,
Lundrimi mbi liqen' e qetë,
Po sa do q'ishte kjo një mrekullí,
Ti jishe mrekullija vetë!

Sa desh' ahere të të vinja pas
Lundër me lundër të lundronim,
Të mos peshonim valë e tallas,
Harrinte[304] tok të dy të shkonim.

Po ti nuk deshe shok as një njerí,
Këtë e pash' e kupëtova,
Edhè sa do që ndjenja dashurí
Të të afrohem nuk guxova!

[303] Barcarollë = këngë që këndohet sidomos natën, në lundrim me barkë.
[304] Harrinte = do të mjaftonte.

Ah, atë natë kurrë s'e harronj
E vetmja natë q'ëndrova,
Sa të jem gjallë, ah, do t'a kujtonj,
Atë gëzim që s'e ngjerova!

Pse m'u zembrove?

M'u zembrove? Për se, nuk më thua?
Se psè fola me pezm' e rëmbim?
Un' e di se kam bërë gabim,
Po, kujton se s'të dua?

Ah, moj zonjë e mirë, shtëpresë[305]
Përgjëratë[306] e zembrës s'di ti
Që un' jam kurdoherë gati
Të kërkonj ngaj ty ndjesë!

Në zembrim e sipër i ngrati,
S'di si fola dhe gjuha ç'gaboj,
Edhè ty kaqe fort t' hidhëroj,
Që t'u droth aqe shtati!

Po a mundesh mëkat ti t'a quash
E të mbash kaqe shumë mërí
Sa të sillesh me aq ashpërí
E kështu mos më duash?

Deti është i butë, i qetë,
Po përnjerjesh ngrah val' e tallas,
Që anijet i mbyt, i përplas
Kundra shkëmbit të mprehtë.

[305] shtëpresë = nikoqire, zonjë shtëpije, punëtore, anvisë, (Kristoforidhi)
[306] Përgjëratë, a = i vyer, i dashur.

Po kush thotë se valët me shkumbra
Nuku unjen, nuk bëhen si vaj
Sa kërnjallin[307] e math fort kollaj
E kalojnë dhe lundra?

I Afrikës luan' i rëpirë[308]
Kur ka etje të çqyen, të çan,
Po kur ulet as pak nuk e ndan
Prej një qëngji të pirë.

Kush kujtonte se shkerba[309] gjaksore
M' atë hovin e rreptë që kish,
Që përfshinte kal' buall e ç'ish,
S'bëhej berrë-milore[310]?

Dhe stuhija kur fryn si e marrë
E rrëzon lisa, plepa mbi dhè,
Shungullon, çkatërron e gjë s'lè,
I këput, i merr xvarrë.

Thua ti se tufan' i vështirë
Nuk përposhtet e s'del një fullim
Që vallzon me një andj' e dëfrim,
I ngadalshëm, i dlirë?

Gjith'ashtu, ah, dhe unë i gjori
Qesh' i urtë, i butë njëmënt,
Po nuk di si kështu për fat t'ënt,
Cili mëndjen m'a mori!

[307] kërnall = oqean.
[308] Rrëpirë = i vrullshëm
[309] Shqerbe = shtazë e egër, bisha.
[310] berrë-milor = shqerrë dyvjetshare.

Jo, për Zotin, ti mos ashpërohu,
S'të ka hije, as pak s'të përket,
S'meriton kjo për ty, *s'ka lezet*,
Mos u ftoh, mos dëshprohu!

Unë sot, nesër ti, njerës jemi,
S'ka njeri në këtë botë pa faj,
As kurr-kush s'e njeh veten kollaj,
Duhet çiltas t'a themi.

Është e ditur e nuku do fjalë
Se butsija pa një turbullim
Nuk bën pare e nuk ka një çmim,
Si bunaca[311] pa valë!

Edhe nè ashtu duhet të rrojmë,
Herë t'urtë e t'egër dikur,
Jemi njerës me gjak e jo gur
Ashtu duhet të shkojmë.

Pa pësuar turbllim këjo jetë
Nuk kthellohet, nuk dliret, s'kullon,
Ashtu koha m'e bukur kalon,
E kupton dhe ti vetë!

[311] Bunaca = qetsi deti apo liqeni

KËNGË BLEGTORE

Vajza e bariut

Mos e patë, o druvarë, vajzën e bariut,
Kapërollen, e sy-zezën? Thoni-më të ziut!
Një mes-hollë, një biskonjë[312], llërë farfurí,
Kujt prej jush ja zuri syri, mos e pa njerí?
Manushaqen, trentelinin a e njihni jy,
Qafë-bardhën, gush-dborën kush e pa me sy?

Jam i lodhur, i kapitur s'mundem t'a rëfenj
Qetësinë krejt e humba, s'di ku do t'a gjenj!
Më ka djegur kaqe kohë syr' i saj i zí,
E kërkonj po si i marrë, ku t'a gjenj s'e dí,
Ku të jetë flytyrakja folmë, o stopan[313],
Dhënjtë shkovi të kullosë, a mërí më mbàn?

Strunga, vatha gjith' i pashë, stane e kopè,
Po mes-hollën, lodër-madhen syri nuk m'a zè!
O dhenarë, o shtërparë, s'patë në kaloj
Një thëllëze faqe-kuqe tej atij përroj?
– Tash i qiti bagëtinë, atjè tej po pret,
Majë shkëmbit ka qëndruar, s'e dëgjon që thrret?

[312] biskonjë = grua e holl' e gjatë.
[313] stopan = bariu që tunt qumështin e bën gjalpën, djathën, gjizën, e që u jep të hanë barinjvet, baxhua, çakmashi, kryebariu.

O hyllesh' o moj verore, pritmë se po vinj,
Mos u ngut, o moj bareshë, se po të harrinj,
Jam i lumtur e fat-bardhë kur me ty fjalonj,
Pranë teje të këqijat gjithë i harronj.
Nuk tregohet kjo dëshirë, që shpirtin m'a tret,
Syri yt si teh' i shpatës, për Perndí më vret!

Falma pak, ah, atë prehër, dua të çdëfrenj,
Të pshtet kryet e të çlodhem, një qetsi të gjenj,
Të harronj çdo helm e brengë, të pushonj, të flè,
Se Parajsa e vërtetë ti për mua jè.
Oh, më trete, më kullove, o moj sy-shkëndí,
Balt' e dhè bariu t' u bëftë o moj shtat-selví!

Baresha e mitur

Moj bareshë,
Moj hylleshë,
Moj sy-kalltërt, sy-mëshqerë,
Nuk më thua,
Ç'kè me mua,
Që s'kthen kokën asnjë herë?

Po si mbletë
Shkon përpjetë,
Po sí flytura në erë,
Syt' e tua,
O fajkua,
Janë sy, a po nishterë[314]?

Vajz' e mitur,
E pa rritur,
Që mban erë trantafilli,
Faqe-kuqe,
Si burbuqe,
Jè ti Maji, a jè Prilli?

[314] nishter = një farë instrumenti çponjës medikal.

Turpin hidhe,
Gojën zgjidhe
Edhè folmë, mjaft pushove,
Do hidhrohesh,
Do pendohesh,
Po s'më fole, më marrove!

Shkon si valë
E s'pret fjalë
As prej meje, o bareshë,
Si më tundesh,
Si më shkundesh,
Si me qenë baroneshë!

Mos kè punë
Edhè unë
Qetë kurr nuk të lashë?
Ah, qertomë,
Ah, mallkomë,
Veç një sy më fal, moj vashë!

Si zok mali,
Bijë krali,
Oh, sa bukur e sa lehtë,
Me shilegun,
M' a ngjit bregun,
Shkon përpjet' e tatëpjetë.

O, moj Zanë,
Nqasmu pranë
Të m'a njohësh dashurinë,
S'ndjen gjë fare,
Moj mitare
S'm'a përfill ti miqësinë?

Mos akrohu[315],
Mos zembrohu,
Ç'të ka zembra thuajm' mua
Për se ruhesh,
Prej kujt druhesh,
Kur më do e kur të dua?

Leri berrat,
Leri shqerat,
Eja bashkë të dëfrejmë,
O, mos ikë,
Mos kij frikë
Këtë kohë nuk e gjejmë!

Po si vesë,
S'ka qendresë,
Flyturon, ah, djalërija
Vjetët shkojnë,
Shpejt kalojnë,
Vjen e shkreta pleqërija!

[315] mos akrohu = mos u kanos, mos provoko.

Ah, afrohu,
Ah, bashkohu,
Dua tok të dy të rrojmë,
Moj bareshë,
Perëndeshë,
Nuk do jetën t'a ngjerojmë?

E bukura e fshatit

Posht'atjè n'atë skundill[316]
Po shoh një barí
Me një tuffë dhí,
Bleron bari e trifili
Këndon qyqja e bilbili,
Dhe më tej buçet xhuraja[317]
E gjëmojnë kodra, maja,
Sa i bukur jè o, Prill,
Kush s'gëzohet sot,
Kështu arthç për mot!

Pranë strungës një livath,
Tjetër bukuri
Një bareshë rri,
Ësht' e kuqe bukuroshe,
E lezetshme e bardhoshe,
Dhe i ndritin faq' e dorë,
Llër' e gushë po si dborë,
Lot me lulet e këndon,
Nga del ajy zë,
Ajo s'menton gjë?

[316] skundill = cep toke
[317] xhurâ = fyell i bariut, duduku

Është vajzë turfandâ[318],
Lumthi kush e pa,
Më të bukur s'ka,
Dhe në fshat shëmbëll e kanë,
Bukuri' e saj s'ka anë,
I ndrit shtati, i ndrit balli,
Sa e sheh të shtohet malli,
Ecën lehtë për zili,
Ah, kur zè shetit
Botën e mahnit!

Të ka shtatin qiparis,
Pamj' e saj të vret,
Syr' i saj të tret,
Atjè pran' atij skundillit
Që sheh bukurin' e Prillit,
Shkon e bukura e fshatit,
Si një engjëll, hipur âtit,
Si vijollca kundrëmon
Tepër po shkëlqen,
Më të bukur s'gjen!

Kur në rrugë e stërdit,
Syt e saj s'i ngreh,
As që të vè rè!
Di të mbahet, ësht' e rëndë,
Ka një tjetër shij' e ëndë,
S'e do djalin e qytetit,
As atë të bir' e mbretit,

[318] Turfandâ = gjë e re, e bukur, freskët, taze.

Ajo ka një dashuri,
Me një çun bari,
Që kullot cà dhí!

Aj, moj vajzë, moj dudí,
Sa e egër jè
Sa njeri s'të zè!
O moj gocë fshatarake,
Moj bareshë, moj zëmbake,
Zembra jote ka të drejtë
Që e do barín' e qetë,
Flas të drejtën e bëj bè
Që vetëm ajy
Është shok për ty!

Pse moj malësore?

(Muzikë Thoma Nassi)

Majë bregut po qëndron,
Edhè nè s'n'a numuron,
Vallë ç'ka mentohesh,
Psè si kur harrohesh,
Psè, moj malësore,
Mendjen ti m'a more?

E kur ikën e nxiton,
Psè s'n'a sheh, as n'a kujton,
Psè s'kthen kryet fare,
O moj trathëtare,
Psè, moj malësore,
Mendjen ti m'a more?

Zembra ime të kërkon,
Nat' e dit për ty rënkon,
Falma ngushëllimin,
Hiqma krejt pikllimin,
Psè, moj malësore,
Mendjen ti m'a more?

Shih sa dashuri të kam
Që nuk di ku rri, ku jam,
Vjollcë, manushaqe,
Psè të dua kaqe,
Ah, o malësore,
Ti mendjen m'a more!

Ti dëshirën po m'a shton
Dit për dit po më shiton[319],
Plaga s'më shërohet,
Pa ty nuk jetohet,
Ah, o malësore,
Ti mendjen m' a more!

Do venitem paskëtaj,
Si kandili kur s'ka vaj,
Do derth lottë krua
Po s'të mora grua,
Ah, o malësore
Mendjen krejt m'a more!

[319] Po më shiton = po më plagos, po më jep shuplaka.

Haj me mua, se të dua

Malësor' e malit,
Që hyp bukur kalit,
Dhe shkëlqen si një pallua
Nuk më thua
Psè të dua?

Malësor' e malit
Që shkon njatë zallit,
Jo si vajzë, po si grua,
Nuk më thua
Psè të dua?

Malësor' e malit,
Lule e Cukalit[320],
Që mban erë po si ftua,
Nuk më thua
Psè të dua?

Malësor' e malit
Er' e portokallit
Që po shkon n'atë përrua
Nuk më thua
Psè të dua?

[320] Cukal = Bllok malor në skajin më jugor të Alpeve Shqiptare.

Malësor' e malit,
Shtjeri sytë djalit,
Që derth lottet po si krua,
Shihmë mua,
Se të dua!

Malësor' e malit
Që i shkon tërmalit[321],
Më shëko me syt' e t'ua
Mëndja mua
M'u turbllua!

Malësor' e malit,
Ah, për syt' e ballit,
Gjeraqin, o fajkua,
Vjen me mua,
A po ç'thua?

Ah, thëllëz' e malit,
Moj e bij' e kralit
Ti s'më do sa un' të dua,
Ç'më bën mua
E gjeç hua!

[321] Tërmal ose tërmall = anë mali.

Eja bareshë

Po gjëmon bije shi, o bareshë,
Retë shterë po mvaren mbi ty,
Mblidhi shpejt bagëtin' e i ndry,
O e bukur shtëpresë!
Nuk i dëgjon bumbullimat vikasin,
Vettëtimat, rrufetë s'i sheh
Dhe rrezikun e math nuk e njeh,
Kur dhe berrat bërtasin?

Ngutu, ngutu, do lagesh, do ftohesh,
Futi shqerrat në vathë mê shpejt,
Retë derdhen e koha nuk pret,
Mos u sill, do pendohesh!
Që në daç, o bareshë e lehtë,
Haj me mua e çlodhu, u preh,
Atjè tej në kasollen që sheh,
Kemi zjar, është nxehtë.

Atjè baba e nëna n'a thresin,
Atjè kam gjithë njerzit e mij,
Atjè çlodhu e ha e dhe píj,
Atjè lodra n'a presin.
Te e mbramja, në daç, o bareshë,
Jetën tënde me mua t'a shkosh,
Haj, si zonjë të jesh, të jetosh,
Të të kem mbretëreshë.

Mê të mirë nuk gjen mos mundohu,
Jam si ty, djal' i ëmbël i rí,
Jam i urtë e i butë barí,
Qasu, pra, mos largohu.
Do t'të kem një thesar të vërtetë,
Dashurinë e ruanj për ty,
Do t'të shoh nat' e ditë në sy,
Do t'të dua për jetë!

Tanga[322] e shtërparit

Bjerë, more fyell bjerë,
Krrejma zembrës ti një herë,
Këtë vrer, këtë poterë
Qaj edhè vajto,

Ah, s'e di sa jam i mjerë,
Shok si veten s'kam të tjerë,
Shkulma tangën, ankthin, tmerë,
Thuaja, këndo!

Bjerë, morè fyell, bjerë,
Ngushëllo shtërpar' e mjerë,
Të përzishmë mos e lerë,
Eja, ligjëro.

Çele zëthin t'ënt të gjerë,
E i sërëndit pa prerë
Një e ler' e një e zerë,
Hallet m' i numro!

Bjerë, morè fyell, bjerë,
Se mëkati s'ka të ndjerë,
Sa shigjeta e nishterë
Po më çpojnë sot,

Ah, ajo baresh' e ndjerë
Më varroj, më la të mjerë
Bjerë, morè fyell, bjerë,
Ah, më qaj me lot!

[322] tangë = dert, siklet, aht, dhëmbje.

DY DËSHIRA

Një natë në Venetik

Ah, s'e harronj at' natë, të ëmbël e të qetë,
Që në kanal e shkuam të dy në Venetik,
Ku hyjet shndritnin tepër, dhe Hëna nëpër retë
Aq' bukur pasqyroheshin mbi detin magjestik!
A e mban mënt, kur bashkë, me gòndollën nga dalë,
Lundronim të kënaqur, këndonim me gëzim,
Dhe zhurmin e dëgjonim, që bënin ato valë,
Që gòndolla i çante, kur ecte me nxitim?
Si laheshe qyteti me gjith' ato pallate,
I zhytur brenda n'ujë, që ndritte por si âr,
Dhe gòndolla e bardhë, si silluetë[323] pate,
Shpërndante me krahrorët fosfor, margaritâr?

U dukte për së largut i *Dogëve* pallati,
Dhe kathedral' i famshëm, *Shën-Marku* madhështor,
Piaceta, monumentat, që Republika pati,
Qytet' i Venetikut, limâni shekullor!
Ç'të theshnin ata hyje, ç'të theshte ajo Hënë,
Që s'ngjinjeshim së pari, si un' ashtu dhe ti,
Mendonim Venetikun si ish e si ka qënë
T'Adriatikut nusen, me aqë madheshtí!
Dëgjoheshe qithara e një gondolijèri,
Që dhemburit' e zembrës këndonte me mallngjim,
Në mes t'atij kanalli, kush di se ç'thosh i mjeri,
Për sè vallë vajtonte me aqë ngashërim?

[323] siluetë = hija e një sendi.

Më ngjan si në për ëndër' ajy shkëlqim që pamë,
Nga *Ura e Pshertimit*[324] kur shkonim nën' atë,
Në detin e lumrisë të thell' atje ku ramë,
Ku veç jehim' i këngës s'dëgjohej tjetër zë!
Sa shpejt kalovi nata, s'kuptova kur zbardhllevi,
Kur dolli Afërdita e zjartë, si florí,
Në jetën t'ime kurrë as gjë s'më mallëngjevi,
Sa më mallngjeu kjo natë me aqë bukurí!
Si filma sinemâje, si ëndra po kalonin,
Madhrija Venecjane ç'do fam' e pasurí,
Dhe me pallatet bashkë përpara rrutullonin,
Gadhnim e zylm[325] e famë, e shkenx e mizorí!
Ah, s'ka si Venetiku në Botën an' e mb' anë,
Netët e tij kënaqin të rinj, po edhe pleq,
Aty muajt e mjaltës kalojn' ata që kanë,
Qytet i ëndëruar, që si magnit tërheq!

[324] Ponte dei Sospiri (Shënim i Kristo Floqit)
[325] zylmë = famë, lavdi.

Një natë mysterioze

O moj nat' e kandshme, o moj nat' e qetë,
Natë mysterjoze, natë mrekullí,
Me Qjellin plot hyje, me Hënën e zbetë,
Sa të kam në zembër, sa të kam zilí!
Këtu gjë s'dëgjohet, veç fullim' i lehtë,
Vala e ngadalshme që zallet lëmon,
Që me rërën luan posht' edhè përpjetë,
Që belbron[326] aq bukur, si kur çeç kërkon.

O moj Zân' e Natës, eja shoqëromë,
Zbrit nga maj e malit, eja më ndihmò,
Flyturò, hyjneshë, zëthin t'im forcomë,
Harpën nem në dorë dhe ti rri, dëgjò!
Merr krahët e erës, krahët e rrufesë,
Fuqin' e shigjetës, e abrit me një vrul,
Ti, që flet me ëngjejt, që na mbush me shpresë,
O moj Zân' hynore, këtu pak u ûl.

Ç'të këndonj mê parë mbi Qjellin e bukur,
Hyllin e Luânit, nj'atë *Orijôn*[327] ,
A Kashten-e-Kumtrit, Plejâdën[328] e dukur,
Marsin a *Merkurin,* ç'lëvrin n' Orizôn?

[326] që belbron = që cicëron, që i merret goja, belbacuk.
[327] orijôn = kostelacioni Orion.
[328] Plejâda = kostelacioni i Luanit.

Shpirtin t'im shkëputma, bëje er'e flagë,
Ndaje nga ky trupi, me vehte ma merr,
Ndryshe, o moj Zânë, më shterroj çdo vlagë,
Do dergjem i mjeri, do më lesh në vrer!

T'ikij Dheu prej meje, të jem në Hapsirë
Ku aj Qjell' i kalltërt brend' asaj noton,
Të shkonj Oqeânët me ândj' e dëshirë,
Të shoh ku mbarojnë, fundi ku qendron!
Natë kaq' e ëmbël, me napat e zeza,
Zgjatu sa të mundesh, kurrë mos u gdhî,
Oh, sa më pëlqejnë këto bukureza[329],
Ato xhixhillonja, gjith' ato shkëndí!

Mos u gdhîj, moj natë, lermë të dëfrehem
Në thellsirën t' ënde të të shoqëronj
Me magjit' e tua lermë të gënjehem,
Dua jetën t'ime sonte t'a ngjeronj!
Sonte, këtë natë dua të harrohem,
Të lëvrinj me hyjtë, me syrin t'i ndjek,
Nga mërzit' e ditës, nga Dheu të largohem,
Dritën e vërtetë t'a stërdit, t'a pjek! ....

O, Hapsir' e madhe, Qjêj, që s'kini anë,
Hyj e Djêj, mysterë, që me mënt s'ju zè,
Botë e panjohtur, e ju Oqeânë,
Ç't' ju radhit mê parë, ç't' ju kujtonj, ç't' ju lè?
Bashkë me ju mëndja dëshiron të jetë,
Në qarkun e ndritshëm, ku lumrí mbretron,
Ku agon pa prerë një jetë e vërtetë,
Ku shpirti i lirë e kupton se rron!

[329] bukureza = shkëndija e natës, xhixhja, xhixhillonja.

SATIRIKE

Vallja e fundit

Flokët e zeza m'u bënë dborë,
Më troket derën nga dal' pleqrija,
Dhe sot s'më bëjnë as këmb' as dorë,
Sa shpejt kalovi, ah djalërija!
Djalrí, të keqen, ç'pate që shkove?
Mos nuk të desha? Nuk t'adhuronja?
A nuk të dhashë ç'do që kërkove,
Ku do më hiqnje nuk të dëgjova?
Nuk kisha dashur plot me duzina,
Vajza të njohma, goca të reja,
Selví të holla, si gjeraqina,
Grâ të martume dhe grâ të vehja?

Nuk e kam pirë të shkretën verë,
Me plloshka, shishe e kanatë,
A po rakinë që s'lash as nj'herë,
Në kaq' ahengje nat' e për natë?
Nuk lojta valle, këngë s'këndova
Me bagllamâra[330] e me bozuqe[331],
Edhè dollinë sa her' e çova,
Dyke çkulluar verën e kuqe?

[330] Bagllamâ = buzuku, tamburaja, një farë mandolle.
2 buzuk = Vegël muzikore. Mandoll; me 12 tela.
3 çkulluar = rrëkëlluar, pij me fund gotën e verës.

S'ngrihnja qetsinë nga do kalonja,
Natën e Zotit s'e bënja ditë,
Sa herë lagjet i trumbullonja,
Dyke kënduar, dyke bërtitë?

Jo! S'më trëmp kurrë pleqrija mua,
As nyjt' e këmbëve, shpîna, kërsitë,
Dhe të pendohem kurrë nuk dua,
Keq më vjen, vetëm që shkoj të ritë!
S'kam lën' ahengje, qejfe pa bërë,
S'lashë dëshirë pa plotësuar,
Nuk lashë rastë, nuk lashë sërë,
Pa përfituar, pa i shijuar!
Vërtet i lojta të gjitha vallet,
Por se, një valle s'e lojta mirë,
Se e pësova, më ranë hallet,
Vall' e martesës, ah, më ka shkrirë.

Merrushja

E përkëdhelura Merrushe,
E bukura e sŷlarushe,
Që po shkreptin si ndo një hŷll,
Djaloshit t'rí sŷrin ja mbyll,
Po dhe me plakun kurris-dalë,
Sa her' e gjen shkëmben ca fjalë,
Plaku e sheh q'është shtrigân,
Por e heq vehten si vigân!

Merrush' e vogël e harbuar,
Dhe plakn' e shkret' e ka tërbuar,
Djalin e do, e dashuron,
Po edhè plakun s'e harron,
Djali rininë i tregonte,
Dhe i betohej se e donte,
Ky i premtonte lumërí,
Po edhe plaku âr, flori!

Edhè Merrushja, si e marrë,
Burra të dy kërkon t'i marrë,
Ja njërin, ja se tjetrin gjen,
Puthjet e saj nuk i kursen.
Plakun martohet piksëpari,
Q'e trashëgoj e i mbet âri,
Pastaj rëmbeu djalin e rí
Jetën e shkoj në lumërí!

Nxënëses bukuroshe

Mos këndo shumë se do sëmuresh,
Djetare me dipllomë s'të dua,
Mjafton të dish të çmosh e të mburresh
Që më do fort e pa dredhí mua

Të mësonje gramatikën un' a kam fitim?
Të bëhesh skollastike[332], ç'do kuptonja?
Verbin "të dua" po t'a dinje pa gabim,
Ahere po, do kisha ç'dëshëronja!

Do ishim që të dy një trup i tërë,
Të dy do t'ishim fjala "dashuri"
Si kur do n' a kish prerë një gërshërë,
Asaj i thonë "jet' e lumtërí"!

[332] skolastika = njeri që e ka mëndjen vetëm tek shkolla.

Dita e parë e Prillit

Një dimbër të tërë më mbajte me fjalë,
Fjalë plot gënjeshtra, kohën tyk' e shtŷ,
Më dhè kaq' premtime "dimri sa të dalë",
Do vije me mua, do rronim të dy!
Por sot që gënjehen, sot që gjith' u rrejtën,
Shkurt më thè "s'të dua" dhe mëndjen t'a mbleth,
Ty të lumtë goja, se më thè të drejtën,
Mëndjen sot e mblodha, një tjetër do zgjeth!

Të Penguarit

Një çupë katundi, që bashk' ishim rritur,
Ish e bardh' e kuqe, fort më ishte ngjitur,
Dit' për dita shkonim rrugën e qytetit,
Herë rëzë malit, herë buzë detit,
Flisnim edhe qeshnim, qeshnim edhe flisnim,
Njerí nuk trazonim, as njerí nuk ngisnim,
Por se një dit Maji, një mëngjes pranvere,
Tok sikundër ecnim çupa u pengua,
Flokët ju ngatruan rrotullë një ferre,
Dhe si lulukuqe u skuq, u turprua!
U unja me nj'herë, nga ferrat e çqita,
Por ca fije flokësh pas meje u thurrë,
Desha të çlirohem, por u kacambita[333],
Atë që pësova nuk do t'a them kurrë!
Buzët na u puqnë, kot, pa hîrin t'onë,
Fort u turbulluam, mbetmë si të ngrirë,
Por e kupëtova, e mora vesh vonë,
Ajo s'desh t'i hiqte, se i vinte mirë!
M'andej tue kalue një tërmal të shkretë,
Prapë shkau e gjora, tue u rukullisur,
E prita në krahët – duket e desh vetë –,
Dhe prapë më puthi, pa u sëkëlldisur!
Tani jemi msuar, msimn' e dijmë mirë,
Dhe nga shoqi-shoqin droje nuku kemi,
Her' ajo më turret, më puth me pahîrë,
Her' i turrem unë, s'ka sa mirë vemi!

[333] U kacambita = u ngatërrova

Jo, jo, jo!

Një dit' e pyes zembrën: asaj mos i artht keq,
Që ika, q'u largova, s'i thashë "lamtumirë",
Edhè tani mos vuan, mos qahet, a mos heq?
E m'u përgjeq se "jo"!

Dhe prap' e pyes zëmbrën, n'e di q'e adhuronj,
Që plaga, që më çeli, më ka shkretuar, nxirë,
E se pa'të i gjallë nuk mundem dot të rronj?
E m'u përgjeq, "jo, jo"!

Të mbramen her' e pyjes: kur qetë do të jem,
Kur do të jem i lumur, në gjî kur do t'a kêm,
T'a harronj brengën mizore, q'u zgjat, u bë litar,
Edhè më tha, "në varr"!

Asaj që gjithë qeshte

Qeshte gjithënjë pa mas', çkulej gazit,
Dorën kush ja kërkoj, njeriut s'ja dha,
Kush e di sa u dëshpruan prej marazit,
Dhe sa të tjer' i përvëloj, i lâ!
Por një dit pâ dy zhubra majë ballit,
Dy rrudha pâ në xverk e qau me lott,
Vajtoj, vajtoj, se râ në pikë t'hallit,
Edhè akoma qan, s'ngushllohet dot!

E puthura e fundit

Desha t'a puth, po m'a dha gjegjen me një herë,
Edhè më tha: Për ty kam vdekur, mor i mjerë!

"Kè vdekur, them? Ahere pritmë pak, e gjorë,
Se po të puth herën e fundit dor'-për-dorë!

Thesari – thengjill

Në ëndër të kam parë,
Si kur të kisha marrë
Në gjît' e të shtërngonja,
Po ti fort m'u zembrove,
Shum' ashpër më qortove,
Por unë të duronja!

Më trete, më plagose,
Më vrave e më sose
Me nazet që ti kishe,
U unja, gjynjëzova,
Me shpirt të përgjërova,
E imja desha t'ishe.

Lutja ime të mundi,
Të binda më sëfundi,
Edhè m'u dhè e tëra,
Të putha me dëshirë,
Me shumë ëmbëlsirë,
Sŷ, faqe, gush' e llëra!

Më dehnë sŷt' e tua,
Jot' ëmë m'u afrua,
Më qojti bir e dhëndër,
Por atë ças u zgjova,
Dhe kur sŷt' i fërkova,
E pashë q'isha.... n'ëndër!

Më kryqëzove si Krishtin!

Si Jezu-Krishtin më kryqëzove,
Paret m'i more, ike s'më pè,
Kurorë gjëmbash mua më vure,
Dhe buzë varrit ah, ti më lè!
Për mua ishe *Anna, Pillati*,
M'i zhgule pêndët si t'isha zok,
Drejt *Gollgothasë* po shkonj i ngrati,
Po lè lëkurën me shpirtin tok!
Shkoj ëndra ime, flutroj gëzimi,
Jam në mëshirën e t'Madhit Zot,
Shih ku më pruri, ah, ky dëshprimi
Të qënke *Juda-Iskarijot*!

Asaj që ka gjakun e ftohtë

Jepi, pemëshitës, ca qepë asaj dose,
Qepë të djegin shumë, sa lotët mos t'i mbajë,
Dhe në mos qau për mua, me qepët ti dëngose,
Të qajë sa të nginjet dhe gjithënjë të qajë!

Dëgjo se ç'flasin bota!

Zoti t'i sheh gabimet, po gjë s'flet,
Po fqinja që nuk sheh, zjen e s'pëlcet!
Zoti ty të shëkon ç'do të palarë,
Po fqinja? Mbushi botën gjë pa parë!

Dëgjo vetëm dy fjalë

Dëgjo dy fjalë të të them, të matura me mënt,
Në daç që të të duan fort,mos dashurò njeri,
Premtimet që të japin, t'a dish nuk kanë vënt,
Do të të rrejnë, fukarâ, se ti jè mituri

Me mjete adhurimi

Në kishë, kur të shoh, e vogla ime,
Në adhurime,
Kur puth konismat[334] një nga një, t'a dish ç'mendonj,
Më vjen at' ças një shenjt të jem dhe unë,
Dhe me përdhûnë,
Të puthurat e t'ua t'i grabit, t'i shijonj!

Këtë dëshirë, ah, si kur t'a dinje
Sa shpesh do vinje,
Dhe, qinse, shenjtit do t'i faleshe me mënt,
Konismën do t'm'a puthnje fort, pa korrë,
O, moj e gjorë,
Do nxirnje mallin, që ushqen në shpirtin t'ënt!

[334] konisma = ikonë

Prapa grillavet

Cepin e dhromit[335] t'ënt posa kalonj,
Dritoren, ti e çel e rri më mbyll[336],
Dhe kur të shoh mêmir' e të dallonj,
Penxhêrên me një herë ti m'a mbyll!

Duket se je zëmbruar për njemënt,
Dhe nuk pret as fjalë, as kuvënt,
Por, tuke vezhgëlluar, heth një sŷ,
Dhe prapa grillave nuk shoh, veç ty,

Prandaj, sa do të druesh, kot e kè,
Se ti vetëmme mua rron e jè,
S'ka gjë se mbyll dritoret me kërcllim,
Prapë ti imja jè, nuk kam dyshim!

[335] dhrom = rrugë.
[336] rri më mbyll = rri e mbyllur në dhomë

Goca e mitur

Thuaj, moj goc' e bukur, përsè kè kaq dhurata,
Me sè tê rriti nënja, me sè të ushqen âta?
T'ushqyen me llokume, me bakllavâ, me mjaltë,
Prandaj jè kaq' e ëmbël, që Zoti më të faltë?
Mos të vaditnë prindët me ujë trëndafili,
Që kundërmon kaq mirë, sa prishet mëntsh secili?
Mos flè në të mëndafshta, pra, dukesh kaq e butë,
Porsi një lesh i rrudë, por si pambuk i lmutë?

Nënja s'më rriti me sheqer, s'm'ushqeu me ëmbëlsira,
Veç se me lajka e dashurí dhe me një mij' të mira,
Nuk më vaditnë me kurrgjë babaj dhe nënja ime,
Po me pekûl' e argëtí e me përkëdhelime.
Në të mëndafshta nuku flè, prindët në mes më mbajnë,
Sepse më duan fort e fort, nga gjîri nuk më ndajnë,
Dhe ëmbëlsirën që po kam ata të dy m'a dhanë,
Se bij' e vetëm jam për 'ta, vetëm ata më kanë!

Ah, moj zëmbake, mos gënjeh e mos u tall me fjalë,
Qinse prej gjîjsh të prindërve nuk kè kurrë me dalë,
Se nuk do mplakesh tok me 'ta, s'do mbetesh prapa derës,
Po eja tash, sa është shpejt, në moshën e Prenverës,
Se, në daç kështu të rrish me mua pa martuar,
Do vinjë dita që të shohsh sa shumë jè gabuar!
Me pleq ti jetën nuk e shkon, nevojë kè për mua,
O bukuroshe, eja shpejt, nuk sheh se sa të dua?

Ajo që gjithë puth!

Sa herë i kam shkrojtur, sa herë e porosita,
Që puthjet t'i kursejë, mos puthë ç'do njerí,
Ajo nuk hoqi dorë, sado që ja përsrita,
Fort ma ka ftohur zembrën, se është miturí!
Dhe tash po më përgjigjet çapkënka e urgjisur
Q'e mori letrën t'ime, q'e puthi më ç'do vênt,
Po edhe letërprursin, pa turp, pà u sëndisur[337],,
"E putha dy tri herë," "më thotë," në vënt t'ënt!

Së voglës

Shëkomë me sŷ mirë të të fotografis,
Që brenda sŷve t' mija të mbetesh e përshkruar,
Qendro, në beben t'ime ty të të zografis[338],
Nj' ashtu si të kam dashur e të kam adhuruar!

Së miturës

I thom së miturës t'a puth, e ëma nuk e lè,
Dhe prap' i lutem e i them, për sè s'të lè, për sè?
Ajo e turpshme, kokën ûl, më faqkat hall të kuqe,
"Mos", thotë, "djalë, mos më trazo,
jam gonxhe", jam burbuqe!"

[337] pa u sëndisur = pa u trazuar.
[338] zografis = pikturoj

Midis dy dashurive

Para se të nisem të shkonj në kurbet,
Dashurova tepër një flokë-gështenjë,
Ish si trëndafili, kishte mjaft lezet,
Një lule të 'tillë shpirti im s'do gjenjë!

Por këtu ku ndodhem një tjetër më dolli,
Q'i ka si dy shpata, vetullat e saj,
As unë s'e desha, por fati ma solli,
Qysh do vejë filli s'dihet paskëtaj!

Njëra prej atyre ndrit por si florí,
I ngjet shumë Hŷllit, që del nga mëngjezi,
Tjetra është ëngjëll, gushë-farfurí,
Nuk i shahet hûnda, syri, goja, mezi!

Të dy dashuritë tepër më mundojnë,
S'di se si të sillem, perin nga t'ja mbanj,
Në zemër më vrasin, shpirtin ma lëndojnë,
As atë s'heth poshtë, as këtë s'e ndanj!

Njëra-tjetrën s'dijnë, se cila më do,
Gjithcila mundohet të më gllabërojë.
E para më shkruan, "eja më marto",
E dyta s'më ndahet, s'do të më lëshojë!

Si do vejë halli? Ju lutem mos qeshni,
Hŷlli nuku duhet? Engjelli ka faj?
Në vënt t'em urdhroni, rrobën t'ime mveshni,
Dhe pastaj gjykoni.... Haj, i mjeri, haj!

Hyjet dhe sytë

Mos i dëgjo bardhoshe, vjershtorët që të thonë,
Se "syt e hyjet ngjasin në drit' e bukuri"
Pse hyjet nuk gënjejnë, shkëlqejnë për gjithmonë,
Por, sŷt e tu mashtrojnë e rrejnë ç'do njeri!

Gabova!

Kur të kam parë djè në Sinemâ
Më terrët, thashë: si ty tjetër s'ka!
Me nj'herë t'u afrova, t'ardha pranë,
Edhe nga goja jargët çurk më ranë!
Kujtova se po jam në paradhis,
Dhe s'dinja nga t'ja mbanj e nga t'ja nis!
Po kur u çelë dritat me një herë,
Po, po! ... Më kalle bretkun[339] edhe tmerrë!
Si sholl opinge ish surati yt,
Sa m'u zû fjala e më mbet në fyt,
Dhe u betova .... mê në Sinemâ
Mos bënj, një tjetër gafë, një shakâ!

[339] Bretku, ose brotk = flamë, murtajë,katarrojë, shastis.

Një kamarjere

Ç'do dit e fshîn kuzinën, e bën dritë,
Edhè pjastrelet i shkëlqen si një kristall,
I lumtur do të isha Margaritë,
Tok me ty të punonja si .... hamall!

Kontrollimi i gruas

Ah, ç'desha t'isha i pamartuar,
Letra ty të të shkruanja për dit,
Po si t'ja bënj, ah, moj e uruar,
Që kontrolli i gruas më trondit?

Perënditë flenë

Brenda në ret' e zeza janë mbshtjellë
Dhe të tulitur flenë Perënditë,
Gorrêni[340] po gremis avllí e kshtjellë,
Por se ata ëndrojnë lumtëritë!
Këtu rrufè, si bomba po pëlcasin,
Bota përmbyset krejt e po shkatrohet,
Por ata flenë ngroht' e gërgërasin[341],
As një prej vendit s'tundet, as që çohet!
Mos jam i marrë që t'a lith tufanin,
A të ndalonj të mos shbërthejnë retë?
Mê mirë le të mbshtillem me jorganin,
Të flè si 'ta, pa gûr mbi gûr mos mettë!

[340]Gorren : murlân,tufan.
[2] gërgërasin = gërhasin.

Maji

Mir' s'erdhe, orè Maj, plot bukurí,
Që ngjall me nj'herë shtâza e njeri
O mbret i muajve, me lule plot,
Që për mbi 'to ç'do flutur rri kullot,
Kur vinje tjetër herë si të prisnim,
Me sa e sa kurorë të stolisnim!
Po, fukarâ, të shkoj dhe ty mazíja[342],
Se sot n' a vdiq më këmbë krizi, zîja!
Sa këngë që dëgjonje tjetër herë,
Kur vinje e gjëmonje me poterë,
Por sot, më pyeç ti për këngëtarë,
Të thom, se nuk të mbetnë veç .... gomarë!

[342] mazí = një fare kokre liri, ose valanidhi që zjehet e lëshon një lëng të zi për lyerje flokësh.

Një kopraci (neqezi)

Për paret ti, mor derëzí, SHYLOKUN[343] e kè shkuar,
Njeri koprac kështu si ty as pash' as kam dëgjuar,
Ti dhe në ëndër gjithënjë nuk sheh për veç kusarë,
Që po të vjedhin sërm' e âr dhe zgjohesh si i marrë,

Edhè të hollat i numron, mos ikn' a muar dhenë,
Mëndjen në kasë gjith e kè, ose në çëkmexhenë[344]!
Ti nuk kè fè, as miqësí, shet nënën dhe babanë,
Edhè lëkuren s'e beson, shet gruan për paranë!

[343] Shylock = është një fajdexhi hebre venecian, personazh i veprës së W. Shakespeare "Tregtari i Venedikut", i çquar për mizoritë dhe kopracllëkun e tij.
[344] çekmexhe = kas' e vogël paresh. Kas' e vogël e një tryeze ose dollapi.

Një rrenacaku

Rrenat t'u bënë një zakon, morè t'u mbylltë dera,
Se ti nuk rren si ç'do njeri, po rren për dit, nga hera!
Ti nuk gënjen me hollësi, me një lezèt, me masë,
Po rren rëndom, paturpësisht, me torba e me thasë!
Ruaju mirë se një dit ti do të gjesh belanë,
Me këto rrenat që na shet, që an' e funt nuk kanë
Dhe të vërtetën në na thënç,
Njeri nuk të zè besë,
Embri që jè "një rrenacak"
Për jetë do t'të mbesë!

Çilësitë e së vehsë

E vehja ka dy çilësí,
Kur ësht' e rè e mbahet,
Zjar edhè flag' ushqen në gjî,
Sa ësht' e njohm' e hahet,
Shijen e virgjineshës ka,
Gojën plot ëmbëlsirë,
Po në vazhdoft' e vè, ca vjet,
Ahere .... lamtumirë!

Një vjehre kandidate

Për mua koha po kalon,
M'u thinjnë flokt' e ngratë,
Kur se për ty moti qendron,
Flokët i nxin për natë,
Edhè si përsëritesh ti,
Si rron, moj jetë-gjatë,
Gjer sa të bëhem dhëndri yt,
T'a dish do jem yt'atë!

Atij, që s'e paguan dhëmbtarin

Fajin s'e kè vetë, po e ka dhëmbtari,
Që nofullat t'ënde t'i forcoj me dhëmbë,
Që peshîn[345] s't'i mori të hollat i marri,
Po, kur s'pati kokë, lè të ketë këmbë!

Ty nuk të mjaftovi topi që i hodhe,
Poe shan me fjalë, fjalë të këqijâ,
S'arrin q'e grabite, s'arrin që e mvodhe,
Po e tremp, akoma me dhëmbët e tija!

[345] peshin = pagesë me para në dorë.

Çupa plakë

E bën njëzet vjetsh kur e sheh të nisur,
Por i jèp dyzet, kur s'ësht' e stolisur,
Kur lyen suratin bëhet çup' e rè,
Po, kùr nuku lyet, frikë prej saj kè!

Katër-pesë zhubra mbi ballin i shihen,
Dhe kockat e thata një nga një i njihen,
Do t'i fshehë vjetet, por lodhet më kot.
Nat' e dit' e gjora po i qan me lot!

Topi i qiraxhiut

Një top dëgjova krisi dhe u zgjova,
Mos është luftë, thash' a mos gabova?
Po si fërkova sýt e kupëtova,
Shkoj qiraxhiu, s'ma dhâ qiran' e psova!

Të dy zalitë[346]

Burrit i kërkon kapellë,
Dhe fustane me dantellë,
Dhe çorape e skarpina[347],
Që të jenë extra, fina.
Po, kur burri nuk ja jep,
Zonja bije në gazep,
Hyn një grindje, hyn një zihje,
Gruas një zalí i bije!

Burr' i shkretë mallëngjehet,
Por se shumë shpejt gënjehet,
Gruan ngreh e e ngushllon,
Dhe të gjitha ja premton,
Po kur ardhi llogarija,
Burrit i râ vilanija!
Ish fuskosur[348] shum' hesapi
Ra si sqapi ne kasapi,
Fund' i fundit i pagoj,
Edhè vehten e mallkoj!

[346] zali = të fikët, alivan, të hollët.
[347] skarpina = këpucë grash elegante.
[348] Fuskosur = fryrë, zmadhuar.

Në daç qëndro!

Duar dhè këmbë të fali Zoti,
Puno e rendë me zjar' e zellit,
Të râ më qafë fati, a moti?
Daç qëndro burrë, daç prapa Djellit!

Të gjitha të kota!

Mos dashuron? Mos tregëton? Mos shkruan? Jè djetar?
Mos jè i pasur? Jè i math? Mos jè një luftëtar?
Në dalç faqebardhê sigurisht do mbètesh i pavdekur,
Ndryshe, ti vdiqe, derëzi, gjesendi s'të ka mbetur!

Martesa e pleqvet

Kur vè kurorë plaku, ose plaka,
Q'u shkoj lezeti e q'u shua flaka
S'u kam zili, as që më zè nakari,
Martes'e tyre mban pak erë varri!

Një gruaje llafazane

(Epigramë[349])

Gjuh' e saj, si një sovajkë[350],
S'la njeri pa gjellavitur[351],
Çponte thellë, si një shajkë[352],
Gjer sa heshti e nemitur[353]!

Një mjeku ushtarak

S'kè nevojë të mbash shpatë,
Ti fort bukur e di vetë,
Se, si mjek, morè i ngratë,
Mjaft përcolle n'atë jetë!

[349] epigramë = mbishkrim. Shkrim i kepur (i skalisur mbi rrasat e varreve në prozë ose në vjershë si shenjë kujtimi)
[350] sovajkë = një farë vegle prej druri në formë hunde të vogël që shërben për të thurur në vegël. Meqik i tezgjahut.
[351] gjellavitur = flas keq për një njeri, e mbaj nëpër gojë, ngatëronj.
[352] shajkë = gozhdë e vogël, thumb.
[353] e nemitur = e habitur, e hutuar, e tapitur, gojë-mbyllur.

Adhamit

Nuk të kam zilí pse linde në parajsë, aq i ndjerë,
Dhe nga sa të mira pate, për as gjë s'të kam lakmí,
Veç se rrojte mjaft fatbardhë, si njeri që s'pate vjehrë,
Burr' i par' i kësaj bote që s'pè zhurm' as pè zjarmí!

Një muzikanti të ri

Vjolija jote, kur zè i bije,
Ja përngjet maces, kur mjaullin,
Të gërvisht zorrët,ethet t'i shtije,
Si zë çakalli kur zè ulrin!

BAKHIKE [354]

[354] Bacchus = perëndi e besimit roman, që korespondon me Dionisin e besimit grek. Perëndi e verës dhe e të vjelave të rrushit, si dhe e kënaqësive dhe dëfrimeve. Kulti i tij quhet **baccanale.**

Nuk dehem mê

Or hapni sŷtë mirë,
Se mos në varr më hidhni,
Se ndonse jam i pirë,
S'kam vdekur, gjallë jam,
S'prish gjë se jam i shtrirë,
Më merrni mê përmblithni,
Me hîr e me pahirë,
Se mëndjen prap' e kam!

Nuk do të pijem kurrë,
Në gojë s'vè mê verë,
Fjalën e mbaj si burrë,
Nuk pî mê paskëtaj,
Sa do që djek si furrë,
Nuk dehem dhe një herë,
Më zijni, daç me gurë,
N' e bëfsha këtë faj!

Deti – verë

Të ishe verë ti, o det,
Ah, ç'do t'ja shtronja dit' e nett,
Pran' teje të dëfrenja,
Të losnja 'të kërcenja,
Aty do ngrihnja një shtëpí,
Të rrí, të flè, të ha, të pî,
Të pinja pa një masë,
Ta bënja kokën drasë!
Të ishe verë ti, o det,
Aty do rinja ditt e nett,
Ta shihnja verën trumbë,
Si valë plot mè shkumbë,
Të kundrëmonte er' e saj,
Mbi bregje, zalle e ç'do skaj,
Me nj' herë të më dehte,
Mos t'ish' aspak ndër vehte!
Të ishe verë, ti, o det,
Un' do t'harronja ç'do siklet,
Do pinja dit' e natë,
Ah, verën e begatë,
Do ta thëthinja fort e fort,
Se, kush e pi s'ka asnjë mort,
O verë mbretereshë,
Prinçesë, baroneshë!

Të ishe verë, ti o det,
Do të lundronja dit' e nett,
Mbi verën e kulluar
I pir' i zgurdulluar,
E do të binja gjithë not,
Ta mbushnja barkun plot e plot,
Ja të të pî, të çahem
Ja pijmë, se s'të ndahem!

Sarahoshi

Hapi[355], se më zuri vera,
Hapi, të më fryjë era,
Nuk më trempas djall, as hije,
Mbamëni vetëm mos bije!

Si më duket këjo botë,
Që vërtitet por si rrotë,
Herë çohet lart përpjetë
Herë unjet tatëpjetë!

Sŷt' e mija shohin vengër,
Herë shqarthi[356], herë shtrëmbër,
Herë malin e shoh truall,
Herë mizën e shoh buall!

Ndali pak, kështu ku vini?
Shkoni drejt, a gabim kini?
Haj, haj, haj, nga po më çojnë,
Këto këmbë që s'qëndrojnë!

Këto rrugë gjithë ecin,
Herë rendin herë ngecin,
Herë venë, herë vinë,
Do t'a gjejmë dot shtëpinë?

[355] hapi = hapuni.
[356] shkarthi = pjerrtas, tërthoras, për së kithi, shkarazi

Shkon patrulla duke sharë,
Ku po shkon, morè i marrë?
Psè po sillesh në për rrugë,
Si një tartareckë[357] fugë?

– Mos u ngut, i thom prit pakë,
Se kam zjar edhe kam flâkë,
Se po pres të shoh shtëpinë,
Nga këto që ven' e vinë.

Shih si sillen gjith' vërdallë,
Mos kujton se jam budallë?
Tani del shtëpija ime,
E hynj brendapër një grime.

Me vjen të bërtas, të çirem,
E të thres gjer sa të ngjirem,
Tavernâr, gostitna verë,
Mbushi gotat, shtjerë, shtjerë!
O moj ver' e ëmbël mjaltë,

Perëndija më të faltë,
Më vjen se nuk ka si mua,
Kush s'pí verën nuk e dua!
Hapi shpejt, se .... pasha Zonë,
Ah! .... pardon .... zonja kollonë!

Ti m' a fal se nuk të pashë,
Haj medet! .... S'ka gjë se rashë!!

[357] tartarèc fugë = Ajy që sillet andej këndej, ajy që s'zè vent gjëkundi duke u sjellur rrotull e rrotull.

Mos rij hesëll

Kush rri esëll s'ësht burrë,
Vleftën verës s'ja di kurrë,
Ajy s'di psè rron,

Kush s'e pî verën me plloskë[358],
Gegë qoftë, ose Toskë,
Jetën s'e ngjeron!

Rroftë plloska e uruar,
Që kalon duar më duar,
Me verën si lot,

Embr' i saj mos u harroftë,
Kjo ç'do punë n'a mbaroftë,
Qoftë gjithë plot!

[358] plloskë = Enë druri e rrumbullakët për të mbajtur ujë, verë, raki.

I dehuri filosof

Thonë se vera njeriut të ngratë,
I fal një jetë tepër të gjatë,
Kush di t'a pijë verën, rakinë,
Me sŷ do shohë dhe Perëndinë!

Thonë se plagët i shëron vera,
Kush pijet dendur edhè nga hera,
Vetëm ahere di si të flasë,
Di si të presë, disi të masë!

Dhe filosofët vleftën ja dijnin,
Prandaj të gjithë verën e pijnin,
Dhe oratorët nuk nxirnin fjalë,
Po të mos laknin fytin nga dalë!

As vjershëtorët e gjithë botës,
Nuku i shmangen as nj' herë gotës,
I math, i vogël, të gjithë pinë,
Edhè pa dehur kurrë nuk rrijnë!

Pinte Pindhari, pinte Eshyli,
Pinte Orati, pinte Virgili,
Aristoteli edhè Platoni,
Edhè Seneka e Ciceroni

Pinte dhe Leka, dhe Pirrua pinte,
Po dhe Filipi esull nuk rrinte,
Pijnin jo vetëm kur do luftonin,
Po dhe në gjumë verë kërkonin!

Dhe Perënditë kur s'pijnin verë,
Nuk bënin zhurmë, s'bënin poterë,
Pa lagur fytin kurrë s'gjëmonin
Rrufè të zjarta kurrë s'lëshonin

Nuk ka si vera, s'ka si rakija,
Këto i fali vetë Perëndija,
Ajy që çpiku verën, rakinë,
I fali botës jetën, lumërinë!

Dëshira e të pirit

Kur pî verën e rakinë,
Mëntë në kokë më vinë,
O rakí, sa fort të dua,
Po dhe verës s'kè ç'i thua;
Njëra të forcon pa masë,
Tjetra t'a bën kokën drasë!

Kur pî verën e rakinë,
Sa të madh' e ndjenj fuqinë,
O rakí dhe ti o verë,
Ju paça në bark për herë,
Ç'do të keqe m'a largofshi,
Majë Qiellit ju më çofshi!

Kur pî verën e rakinë,
Ahere shoh Perëndinë,
Oh, rakija e kulluar,
Dhe ti vera e bekuar,
Ju që kurrë nuk m'u ndatë,
Mbifshi dhe mbi gur' e thatë!

Kur pî verën e rakinë,
Botën e shoh shesh lëndinë,
Kush e piu e s'u gëzua,
E s'e ndjeu vehten dragua?
Do të rrosh një jet' të gjatë,
Rakí, verë pî për natë!

Endra e pianikut

Desha të isha voze e gjerë,
Desha të isha but[359],
Barkun t'a kisha mbushur me verë,
Si sprîhë[360], si makut[361]!

Desha mbi vozën hipur të isha,
I dehur, sarahôsh,
Verën e saja në bark t'a kisha,
Mos vinte pikë bosh!

Desha të losnja, me zë të thrisnja,
Me vozën të dy tok,
Verën t' ja pinja sa të pëlcisnja,
T'a ndjenja vehten zok!

Dhe nga ndo nj' herë i lodhur shumë,
Me gojën nënë sop[362],
Verën t' ja linja të derdhej lumë,
Mos bënja kurrë stop!

[359] but = Vozë e madhe, varele e madhe që nxè 100 okë e përpjetë verë, uthull ose raki.
[360] sprijë = përbindësh i pangopur, kulçedër, lubi.
[361] makut = hamës i lakmuar. Llufaç, harbut.
[362] sop = kanule.(e vozës,vareles,butit, etj.)

Desha të shkonte vera si prrua,
Të mos shteronj' aspak,
Desha të rithte si çesm' e krua,
Fytin ç'do çast t'a lak!

Desha çatitë t'ishin plot verë,
Të derdheshin pik-pik,
Dhe nënë strehët etjen pa prerë,
T'a shuanja vrik-vrik!

Desha të kisha, – nuk di as unë –,
Tirrën[363] me verë plot,
T'i futsha brenda dhe me përdhunë,
T'a pinja si një lot!

Dhe kur të vdisnja në varrin mb' anë,
Tirrën t'a kisha shok,
Sa her' t'u çojsha, t'i vinja pranë,
Sopin e saj t'ja rrok!

[363] Tirë = Kade e madhe druri, për të mbajtur verë.

Pijaneci

O, moj verë e uruar,
Ver' e ëmbël e bekuar,
Por si loti i kulluar,
Sa të dua ty,

Jè e shishme, jè e mirë,
Jè llagare[364] jè e dlirë,
Si nektar jè për të pirë,
Për këta dy sŷ!

Ah, kënaqe zembren t'ime,
Nxirmë ahte e hidhrime,
Të këqija e mjerime,
Rrith e mos shterò,

Ngrohmë shpejt këto krahrorë,
Q' i kam akull, q' i kam dborë,
Ngrohmë bark, e ngrohmë zorë,
Plagët m' i shëro!

[364] Llagar, i = i qartë, i pastër, i kulluar, i dlirtë, i paqmë, i filtruar, i panjollë.

Kur të pî ndjenj vehten flutur,
Jam ifort' e i patutur,
Jam i prejtur[365] e i zbutur,
Bëhem djal' i rí,

Jam i pasur, i begatë,
Jam fat-bardh'e jetë-gjatë,
Jam i lumtur dit' e natë,
Nuk më tremp njeri!

Ah, moj vera bukuroshe,
Kuqalashe e bardhoshe,
Her' e athtë e her' majoshe,
Melhem jè, a ç'jè,

S'kè të blerë, jè e rallë,
Me ty e ndjenj vehten gjallë,
Kush s'të piu, qenka budallë,
Besa shoqe s'kè

Do të pij, sa të tërbohem,
Do të dehem të harrohem,
Të shoh ëndra, të mos zgjohem,
Gjer sa të pëlcas,

Derdhu, derdhu, nuk do ndahem,
Dehmë gjer sa mos të mbahem,
Të të pî, palè të çahem,
Lè të vdes q'at' ças!!

[365] prejem = qetsohem,shtrihem, rri rehat, bënj qejf, zbavitem, dëfrehem,çlodhem.

Varele[366] bukuroshe

Më thonë disa shokë për sè s'i ndahem kurrë,
Vareles plot me vere q'e kam të vetmin shok,
Për sè në këtë shkallë vet-veten e kam prurë,
Për sè rí gjithnjë i dehur e bënjsi çamarrok?

Më thon' e më qortojnë psè pijem dit' e natë,
Dhe gjithë qeshin, tallen me mua që s'di ç'flas,
Për sè nër pijetoret më kot harxhonj paratë,
Dhe pí e pí e s'ngopem, sa dehem e pëlcas?

Po un' o moj e dashur, varelja bukuroshe,
Që të kam nën' e babë dhe grua e ç'fardo,
Sado që ti më shpije në cepa e në qoshe,
Unë për ty lè kokën, të dua, se më do!

Për ty shita shtëpinë e mbeta ryp daulle,
Shtëpija s'më bën pare, sa pare më bën ti,
Për ty në penk kam lënë sënduqe e baulle,
S'më djers as pak ky veshi pse rronj si nj' ashkëti[367]

Dhe koh' e vdekjes akoma kur të vijë,
Qivûr o moj varele, të bëhesh ti,
Trupi në ty të futet, verën t'a pijë,
Bashkë me ty të çlodhet në rehatí!

[366] varelë = vozë, bucelë, kade
[367] Ashket, iu = eremit, kallogjer

Plloska rrumbullake

Atë plloskën pa ma bini,
Shtini verë brenda, shtini
Pa ma mbushni plot,
Dhe ju shokë hani pini,
Dehi sot, esëll mos rrini,
Mos silli më kot.

Ç'e do kamjen, ç'e dogjënë?
Kur kè verë për të qënë,
Jè një pasanik,
Vera është mbreti vetë,
Të fal jetën e vërtetë,
S'të gjen një rrezik.

Pllosk' e bukur rrumbullake,
Faqe kuqe topolake,
Tjatër shije ka,
Kllû-kllû-kllû e saj e rallë,
Gurgullon si një gjinkallë,
Nuk është shakâ!

Zër' i plloskës, fishkëllimi,
Këng' e saj e ligjërimi,
Verâ kur lëshon,
Armoni' ësht' e vërtetë,
Me fis-fisn' e saj të lehtë,
Kur zè belbëron.

Plaçin armonit' e tjera,
Kur s'ja thotë plloska, vera,
Pika që s'u râ,
Instrumentat s'bëjnë pare,
Para plloskës lozonjare
Që deh burra, grâ!

FUND I LIBRIT "TINGËLLIMET E ZEMBRËS"

PJESA E TRETË

Poezi origjinale të Kristo Floqit dhe poezi të përkthyera prej tij të mbledhura andej e këtej

nga Henrik Kaçulini

Tiranë më 11-VII-1942-XX.

DËSHIR' E VËRTETË

e

SHQIPËTARËVET

PREJ

NAIM BE FRASHËRIT

Shqipëruar në vjershë nga Greqishtja

prej

Kr. Floqit

ÇPALLJ' E 2-të
E shtuar, e qëruar e e zbukuruar

Mburo pik-së-pari Kombin e Atdhenë
Pastaj mëm' e atë, Besën ose Fenë

S O F J E
Shtypur ndë Shtypshkronjët shqipe "Mbrothësija"
Kristo Luarasi, Ulitsa Tsar Simeon 60
1912

Shqipëtarëve të vërtetë për shënjë atdhesije
ua çon

Përkthenjësi

Kr. Floqi

Dëshir' e vërtetë e Shqipëtarëvet[368]

O djemt' Mëmëmdheut, o trima Atdhetarë!
Të ditur, të dëgjuar, e burra luftëtarë,
Sikundrë të bashkuar, që ndodheshim të tërë,
Të besësë për kombin, e miq për jetë bërë;
Lipset dhe sot të jemi, si jishimë një herë
Të lidhur, të bashkuar, vëllezër kurdoherë;
Për punën e Perëndijtë, për Lirinë t'ënë,

Kur sot Tyrani humbi, e s'është si ka qënë!

O Far' e Trimërisë, Fëmij' e Aleksandrit[369],
E burrit Shqipërisë, e Pirros, të parit,
Dhe djemt' e Skënder-Begut, e trimit të dëgjuar,
Që trimërit' e tija as një s'i ka haruar,
Kini pandem[370], e shpresë, o burra, sa na jipet,
Të gjithë më një mëndje, të bëjm' atë që lipset.

Pellazgë jemi lindur, nga Hëna më përpara,
Ahere kur Adamit as s'po i dukej fara!
Jo vetëm të llauzit[371] të ndritçmit burrat t'ënë,
Pô dhe të Perëndive, prindër kanë qënë!
Gjuh' e pa-vdekur jona, e qruara[372] e lara,

[368] Ky është përkthimi i dytë që Kr. Floqi i ka bërë kësaj vjershe. më 1912. Përkthimi i parë është bërë më 1899, botuar më 1904.
[369] Fëmij' e Aleksandrit = familje e Aleksandrit të Madh
[370] pandem = pandehmë, shpresë, pritje.
[371] llauz – njerëzi, grumbull njerzish
[372] Qruara = e pastër, e dlirë.

Perëndi miq po krevi, në kohëra ta para!
Njeri s'mohon dot kurrë famën e prindve vyer
Se istoria gjithë plottsisht i ka rëfyer.

Por si shkabonjat n'erë, n'Asinë flytyruan,
Lëftuanë Darinë[373] e fronë ja rëzuan,
I çkyen tërë Persët, i shuan, i dërmuan,
Qytetarin' e vlerë nga tmeri e shpëtuan!
Prapë po si luanë u derdhë që të tërë,
Dhe Romën e tmeruar e bënë hi e rërë!
Ç'ish vall' ky i huaj, ky burrë Maqedhoni,
Që Grekëtë i muntte, i mposhte pas zakoni?
Ç'ish ky i madhi burrë, që Grekët më s'mënuan[374],
Grek t'a emrojnë pa arsim, po kottë u munduan?
Po kur u ther' armiqtë prej t'huajt luftëtarit,
Cilët e doqnë Thivën[375], e vetëm të Pindharit?
Shtëpin' e prëjtjen lanë[376], s'e prishnë, s'e trazuan,
Se respektuan Zanat, s'e doqnë, s'e cënuan?
Ata nuk jishin Grekër as Shqenj, si ca që thonë,
Po ishin prindrit t'anë, të huajt Maqedhonë,
Plutarhu, Dhimosteni, të vjetrit me Strabonë,
Dhe njerzit e ditur të gjithë po dëshmojnë,
Që kombi ynë jishte qëmoti i çkëlqyer,
Fisnik e trim e madhështor, i fortë e i vyer!
Ata ishin si nevej të fjeshtë Shqipëtarë,
Të Besës edhe trima, e burra luftëtarë;

E mori ketè embër qëmoti Shqipëtari,
Nga "Shkaba", q'ish i fortë në luftratë m'i pari.

[373] Dario I i Persisë (522-486 para Krishtit)
[374] Mënoj = vonoj
[375] Thiva = Thebes, qytet në Greqinë Qëndrore.
[376] shtëpin' e prëjtjen lanë = vetëm shtëpija e Pindharit nuk ra prè e dhunës.

E nga që mbante shënjë në flamur kur-do-herë
Shqiponjënë, shënjë të trimëris' së vlerë.
Në Shqipëri qëndronte, Perëndi i të Qëmotit[377]
Në majën e Tomorit shkëndijte Kish' e Zotit!
Të parët për të lutur shëtijnin m'atë Kishë,
Pra adhuronin me kaqë nder, Perëndin' e Shqipërisë!

Edhe në dashçi ç'do njeri, të drejtën të gjykoni,
E të kërkoni me qëllim, të shihni të këndoni,
Aristotel e Ptolemenj, dhe sa të ditur dini,
Do msoni q'është Shqipëtar dh'i madhi Kostandini,
Që ish Dardan nga fis i ti, filiz' i Shqipërisë,
I ditur, burrë luftëtar e shenj' e Trimërisë!

Mbretresh' e grave gjer më sot, e zonj' e Diturisë
Nuk është Dora d'Istria, e bij' e Shqipërisë?
E cila kurrë nuk harron Atdhenë e uruar,
E kur-do-her' e lëvduron, e ngreh të adhuruar?
E me dëshir' e dashuri, për kombin ka punuar
Me nder të math, me shpresë plott, ka folur pa pushuar.

Sa kombe vallë humpnë sot, pe Botësë të tërë,
Dhe sa të tjer' u ngjallë pas, vallë sa janë bërë,
Po Shqipëtari kurrë, s'ndroj as kombin, as zakonë,
Gjuha e gjaku jan' ato, q'i pati gjithë monë.
Thesprotinj e Mollosinj, Ilirinj, Maqedhonë,
Shqipëtarë jishin gjithënjë, si edhe sot na thonë,
As një i huaj s'mundi dot të mposhtë Shqipërinë,
Të shuhanj gjuhë, a zakon, të prishë kombësinë.
Vetij' e gjuh' e kombësi, të pritur, të përcjellë,
Shqiptari kurrë nuk i ndroj që ditën q'është pjellë.
Të hekurtë, të nxehtë fort, me shpatën myllit nxjerë,

[377] Perëndi e Qëmotit = Zeusi Pellasgjik.

Binin a vdisnin burrërisht për Shqipërin' e mjerë,
Grekë a Sllavë, ose Shqenj, Qeltë, Roman, Bulgarë,
Qenë të huaj para nesh, se s'ishin Shqipëtarë.

Të gjithë kombet një e një, sa ishin an' e mb'anë,
Ranë me vrap në robëri, të frikshmëve Romanë,
Po Shqiptarët, trima fort me shpres' e me forcatë,
Lëftuan gjithë burrërisht Romanët' e pëgatë[378].
Sa luftra të përgjakura të mjerët Shqipëtarë,
Bënë ahere me ata të ndezurit barbarë!
Ranë të gjithë trimatë si burratë me besë,
U vranë dëshmimtarët[379] për nder' e Mëmëdhesë!
U xhvat, u mbyt në gjakëra atdheu i Burrërisë,
Dhe u shkretua funt e krej ky vent' i Trimërisë.
Po Shqipërija gjithënjë me kryetë përpjetë,
E dlirë qe, s'hoq robëri, e ndriturë për jetë!
Njeri po s'mundi kurrë dot të mposhte Shqipëtarë,
Të hedhë nënë robëri të Botës luftëtarë!
Është si dele në paqësi, i butë Shqipëtari,
Po kur zë luftë quhetë "dragoj a gjakatari".

Kur zun' e dilnin bishatë kopé ng'Asija,
Duke shkretuar Botënë, si sora, si mizrija,
As Shtet, as komp s'lanë në vent të gjitha i rëzuan,
I xhvatn' i çkyen më gjithsej[380], i vranë e i shuan!
Dhe Bizantinjtë ca më fort me besën e me fenë,
Njerës të frikshim e pa shpirt, pa trimëri, pa ndjenjë,
S'qëndruan fare, s'mbajtin dot krahrorë mizërisë,
Po ranë gjith robërisht në xgjedhën e Turqisë!,

[378] pëgatë = begatë
[379] Dëshmimtar = dëshmor
[380] më gjithësej = të gjithë

Shkaku u bënë gjith ata që suall robërinë,
Se s'kapnin hutën me kuxim, po prisnin më Perëndinë.
Turqit e egër e barbarë, Tartarë të mërzitur,
Prishës, gjakpirës, po si ujq, Tyranë të mahnitur,
Eshtra nuk lanë pe njeriu pa çvatur e pa grirë,
Gjakun e derdhë si rrëke, s'e lanë pa thëthirë!
Perndimi ish në tmerr, në zi, nga bishatë barbare,
Po dhe Ariu[381] ra, u tukeq[382], më s'pipërinte fare!
Edhe s'kuxonte as njeri t'u mbante krahërorë,
Kudo pushim, kudo një tmerr, s'tundej as këmb' as dorë!
Si ranë gjithë robërisht në xgjedhën e tmeruar,
Një komp i fortë midis tà u mbajt i krahëruar,
Si qëndroj ballë trimërisht barbarëve tërbuar,
Shpëtoj sa kaq nga një rrezik të math e të vështirë,
Perndimin që s'ja pat për hir, Evropën e pështirë!

Kush ishte vall' ajy petrit, i kombit kryetari,
Kjo shkab' e fortë, ky hero, ky burrë kordhëtari?
Mos ishte Marsi[383]? Athina[384]? A po ky Zoti[385] vetë?
A mase s'ish njeri po shenjt, që nuk la gjë të metë?
O Zanë, gojë artë ti, që di të drejtën tërë,
Thuaj, trego embrin e shenjt, rëfehi gjatt' e gjërë!
Ligjirona trimrit' e Tij, Fisnike Perëndeshë,
Lerë Omer, Virgjil, Anian e prallat o ligjreshë?-
Trimn' e vërtet' e di kushdo, të gjithë e rëfejnë,
Kryetar' e Shqiptarëvet të madhë **Skënder-bejnë**!

---

[381] Ariu (ή **Ἄρκτος τοϋ Βορρά**). Shënim i K. Floqi
[382] u tukeq = ra në ditë të hallit, në pocaqi.
[383] **Ἄρης**. = Marsi (Perëndi e luftës që kishin të vjetërit). Shënim i K. Floqit
[384] Athina (Perëndi e diturisë,siç i thonin Grekët **Ἀθάνα,Παλλάς, Ἀθήνη**) Shënim i K. Floqit
[385] Zoti (Greqisht **Ζεύς, Διός, Ζηνό, Ζήνα, Δωριως** Zana shqip Zone). Shënim i K. Floqi

O! i pa-vdekur! Prehu sot, ô shpirt i Shenjtëruar,
O embr' i dashur kaqë fort, i ëmbël, i bekuar,
O vleft' e famës, o kujtim i math i trimërisë
Shënj' e Atdheut e kombësis'e rënj' e dashurisë!
O! bir i dashur e fisnik i Mëmëdhesë gjorë,
E cila që kur vdiqe ti ka mbetur pa dorë!
Të gjithë Shqiptarëtë të lusim, t'adhurojmë,
Me lott në sy, me dashuri, embrin tënt kujtojmë
Se dimë ç'ke punuarë, të gjitha sa ke bërë,
Gjëra të lartra, gjithë çmim për Shqipërinë tërë!
Kur do vinjë ajo dit' e bardhë e uruar
Të ngrihetë shtatua jott'e e lart', e adhuruar!
Të bijen gjithë me respekt nër këmbëtë të t'ua,
E të të falen ty, o shenjt, o Engjëll, o pallua!
Veprimet t'ënde kryetar, trimrinë fuqizojnë,
Entusiasin gjithë ne, na çelin e na xgjojnë!
Vdiqe! Të dlirë[386] ti na le, të gjorën Mëmëdhenë,
Po shpresë ki, o kryetar, për Qell' e për Dhenë,
Se prap Atdheu, ky vendi yt, Shqipëriza jott' e lirë
Do të çlirohetë një dit me hir, me të pa-hirë,
Dhe ajy varri që të mba në heshtje të qetsuar
Do të nderohet ca më fort, do jet' i shenjtëruar.
Kujtimi i pa-vdekurë për jetë ty të qoftë
Veprat e tua e çdo gjë për jetë t'u kujtoftë!

Vraponi, burra, sot e sot, o miq mëmëdhetarë
Për Shqipërinë gjithë tok, o trima Shqipëtarë,
O ju, vëllezrërit e mij, o djemt' e Shqipërisë
Jemi të gjithë një e një të bijtë të Lirisë,
Një gjindje gjithë e një komp, një mënt një vetëdijë

[386] dlirë = të papushtuar nga armiqt, të spastruar nga armiqt

Kemi një gjak, zembër e shpirt, këtë gjithkush tà dijë,
Kemi një gjuhë, një zakon q'i patmë gjithëmonë,
Jemi Shqiptarë si një, një, si-do që të na thonë.
Turqër po s'jemi, Shqenj, a Sllev, as Grekë nuku jemi
Përveç Shqipëtar fjesht e krej, këtë embër gjithë kemi.
Ky ësht' i shenjttë e ka duk, fam' edhe nder e hijë,
Me këtë rrojmë edhe sot, se ky ka vleft' e shijë.
Ësht' i pa-turpshëm e i lik, i poshtër, i pështirë
Ësht' i dobët gënjeshtar, i unjur, i vështirë,
Cili s'nderon kombin e tij, cili mohon Atdhenë
O! ësht' i ndyrë, tradhëtor, një rëndësi për Dhenë!
Si mjerë, mjer' ajy njeri që tradhëton vëllanë,
Kombin e tij, Atdhen' e vet, e t'ëmën e t'anë!

Gjer kur këta të huajt o miqt' e mij të vyer
Me vishkn e Qirqit[387] gjithënjë, magji duke rëfyer,
Do na verbojnë më çdo gjë, si kafshë si të marrë
Do na pengojnë nat' e dit, që as djalli s'e ka parë!
Gjer kur për t'huajt gjithënj do lodhemi të tërë
Këjo trimëri edhe ky mënt për t'huajt qënkan bërë?
Gjer kur therorë ne për tà do bëhemi? Si mjerë!
Pse për të huajt gjithë këto? Nga se këjo poterë?!
Sa punra, punra të mbëdha, sa gjëra për të tjerët
Punuan Shqipëtarët, të ndriturit, të ndjerët!
Turkut i ndihmë kaqe fort, Halldupit të mërzitur,
Që na varroj, na çkatëroj, na doq, na ka zhuritur!
Kafshë të egra gjithënjë, Mongolë të mahnitur,
Vrasës, dëmprurës, faqezes, gjakpirës të fëlliqur!
Për të shpëtuar Turqit sot, u vramë kaqë shumë,
Gjaku i Shqiptarit!! u derth e u-bë lumë!

[387] vishkn' e Qirqit = vishkulla (thupra) e magjistares Circe që, sipas mitologjisë greke, kishte kthyer shokët e Uliksit në derra.

Popo sa turp, e sa mëkatë t'i ndihimë armikut
Që na ka sjell' Atdhenë sot, në buzë të rrezikut!
Sa burra vallë gjith' ashtu pe djemt' e Shqipërisë,
Therorë ranë pa kursim për jetën e Turqisë!
Ç'ishin ata q'e ngjallë shpejt, Turqinë që po vdiste?
Oh! Qypërlinjtë[388] ata dragonj, që kordha aq u priste!

O moj e dashura Shqipëri, o Mëmëdheza jime,
Të paske kaqë burra ti, pra sot të jesh jetime!
Të kishe një Mehmet Ali dhe Ibrahimnë[389] vetë,
Misiri[390] të çlirohetë, dhe ti kopil'[391] e qetë!
O fat i lik! o gjëm e madhe! ah! ku na kini sjellë,
Të kishe Marko-Boçarin, Mjaul e një Xhavellë,
Të kishe Bubulinënë dhe trima kaq të tjerë,
Për Grekët të përpiqenë dhe ti të jesh e mjerë!!
O! burra që s'haroji dot! më kot qëllimi juaj,
Shpëtoj Greqija e rron sot me gjakn' e shenjtë tuaj!
Me armët e perëndijta ju, me gjuhën e uruar
Lëftuat bukur e me zel, me shpresën e bekuar,
Po t'huajt panë hirë jush, për fatnë ton' e mjerë,
Dhe shpresa juaj e perndijt' u shua me një herë
Atje ku ratë si dëshmor' e dhatë jetën tuaj
Në atë dhé që e liroj e ngjalli dora juaj!

[388] Për familjen "Qyprillinjtë" Kristo Floqi ka shkruar një dramë me të njëjtin titull, e cila ka humbur, por historinë e kësaj familjeje ai e ka shkruar në prozë me shkrim dore që gjëndet në AQSH.

[389] Mehmet-Ali Pasha (1769-1849) me origjinë nga Korça, sundimtar i Egjyptit, quhet themelues i Egjiptit modern. Dinastia e krijuar prej tij sundoi Egyptin deri më 1952. I biri i tij, e pasardhësi i tij si sundues i Egjyptit, Ibrahimi, me ushtritë e tija theu disa herë ushtritë ottomane. Arriti deri në dyert e Stambollit.

[390] Misiri = Egjypti

[391] Kopil = Shërbyes për punë të rënda të shtëpisë në familjet e të pasurve, shërbëtor

Ardhë Turq-gënjeshtarëtë, Romanët, Bizandinjtë,
Kallamaranj' e Fanariot' e tërë çorbaxhinjtë,
Komb' i liruar, fjala vjen, Elinët, miqt' e parë,
"Të huaj" ju qojtinë dhe "Palioshqipëtarë"!
Popo! rëmuan varretë, të çndershmit të mallkuar
Dhe hodhë rrugave ato eshtrat e shenjtëruar.
Po prap' të drejtënë pa dashur vet' e thanë,
Që: "Këta të huaj vërtet, po Shqiptarë janë".

Ushqeh e mba gjarprin e lik në gji e në pëllëmbë,
Të të helmonjë gjithënjë eshtrë e trup e rëmbë!
Ç'kërkoni ju o Grekë sot nga Shqipërija vallë,
Doni të vrisni me djallzi djemt' e Piros të rallë?
Jo, jo se s'bëhet ajo gjë, që kurrë s'ka të ngjarë
Gënjeshtra duket faqeza, dhelpëria s'zë dot farë!
Bullgarë sa u bënë sot, si Grekë të pa-ndarë,
Po kush mohon kombin e vet, o është për të vrarë,
Edhe Atdhen' e gjuhënë q'u rit me to më parë,
Qysh? e shëkoni mirë ju, t' Sokratit djemt' e mbarë.
Po është e mundur kurrë sot një komp t' humbas' i tërë,
T' haronjë gjuh' e ç'farëdo? jo! këjo s'ka të bërë!
Gaboni shumë asi soj me fjalëtë pa kripë,
Poshtë gënjeshtra se u duk që s'pask' as nder as cipë!
Themistoklin' e Qimonë këta kini të parë
Miltiadh' Epaminondënë, të ndritur atdhëtarë;
Mos kini Efialtinë, tradhëtorë Pafsaninë?
Dhe nën' akoma e përçmon djalin e saj fatzinë,
Që për fitim, për interes, për rrogë, për ca pare,
Tradhëton Atdhè e kombësi, pa nder, pa skuqur fare,
Nga çdo e mirë e çdo gjë, fëmije, mëm' e atë,
A ka m'i mirë se Atdheu, m'i fisçim, m'i begatë?
Ka më të bukur Bota sot se ndjenjën e Lirisë

E më fisnike nga çdo gjë se çështj' e kombësisë?
Thoni mos jemi Grekë ne? Jo, ashtu pashim Zonë,
Për veç se Shqiptar' o miq, siç ishim gjithë monë!
Është mëkat, çnderim i math, e turp i pa-treguar,
Emrinë t'onë kombiar t'a ndrojm' o të mallkuar!
Si ësht' i vyerë për ju fjala "Ellin", e ndjerë,
Ashtu dhe emri "Shqiptar" është për ne m'i vlerë.
Në thoni q'jini edhe ju Pellasgë mor të mjerë,
Mase, po janë shumë sot kombe Pellasg të tjerë:
Frëngjër, Spanjoll e Italian e kush e di sa janë
Juve a jini Itallonj? Frëngjër no njer'[392] u thanë?

T'Adhamit e të Evësë jemi vërtet fëmijë,
Po çdo njeri ka kompn' e vet' e gjuh' e vetëdijë,
Pra vetëm, vetëm për një gjë njeriu duhet të vdesë
Se ësht' e shenjt' e i perndijt mbures'[393] e Mëmëdhesë!
A! Jini të krishterë ju! Fort mirë po na thoni
Prandaj gjith të krishterëtë Ellin' i emëroni?
Aher' Evropi si për se me qenë të krishterë
S'quhen Ellin' as emrin "Grek" s'e qasin në derë?
Nuk ishte Grek, jo, Zoti Krisht, as Apostojt' e dukur,
Komp' i Isujt dihet sot, e njeh gjith kush fort bukur.
O! qënki Orthodhoksë ju! .... Po Russëtë aherë
Pse nuk quhen Grekërë, dhe Sllavët e të tjerë?
Që janë mase më besnik se ju t'Orthodhoksisë,
Pse ju nuk quhi Sllavë sot kur paski dhe një kishë?
E mir' e hir' e Slavëve dhe armët e tyre
Fitim u prun' Ellinve me ç'farë-do mënyre,
Dhe më së fundi prap' ata e shtuanë Greqinë,
Duke u dhënë juve sot dhuratë Thesalinë.

[392] No njer' = ndonjë herë
[393] Mburesë = mbrojtje

Po ju në vënt t'i doni sot Sllavunët Shpëtimtarë,
Armiq i quani kudo, s'u lini gjë pa sharë,
Sepse tmerohi gjithënjë e kini frikë shumë
Mos bëhi Sllavë, dhe pastaj jini për det për lumë.

Ahere, të Krishterët t'im, të dashur miq Ellinë,
Harroni duket shumë shpejt të Krishtit Porosinë
"Kurrë një tjatri mos i bëj atë që mërzit vetë"
Ashtu urdhëron Krishtrimi sot dhe Zoti i vërtetë!
Atë që dridhi juve sot nga Slavët mos pësoni,
Shqiptarëve me dhelpëri t'uà bëni po kërkoni?
"Duaj si veten t'afermin" po thotë Bes'[394] e mirë,
E ju ndiqni çdo njeri me hir me të pahirë.
Ju kaqë Grekë gjer më sot në Robëri po kini
Dhe po kërkoni dhe çdo komp në robëri t'a vini?
Cilë? Shqipëtarë? Këtë trim të Botës të rallë,
Këtë luan, këtë petrit q'u theu dhëmp e dhëmpallë?
Në këtë kohë q'jini sot, në shekullin që rrojmë,
Doni të kemi miqësi, me dashuri të shkojmë!
Lini më nj'anë thash' e them, gënjeshtrat, arratinë,
Lini idhetë të mbëdha dhe prallat që na nginjnë.
Ne jemi Shqiptarë sot, dhe ju Ellinë jini,
Shqipërinë ne, Elladhën ju, t'a kemi e tà kini
Gjuhënë t'uaj kini ju, dhe nevej t'onën kemi,
Ashtu kuptohemi gjith-kush edhe vëllezër jemi.
Duam me fqinjët gjithënjë të rrojmë të jetojmë,
Me Sllavë, Grekë e këdo, me dashuri të shkojmë,
Po me një "fjalë" një "vështrim" thellisht të kupëtohet
Q'e drejt' e tjetrit gjithënjë lipset të respektohet".
Tyrann' i lik nuk ka shpëtim, vdekjen po pret i gjori,

[394] Besë = fè

Andaj pushoni, është mjaft, se djalli po na mori.
Harrijnë kaqe mjerësi kaq brenga e potera
Koh' e dëfrimit është sot "Liri" e jo "Skëtera".
Duhet të jemi gjithë miq me mëndje e vettija,
Poshtë çdo buj' e trumbullim, Rroftë Vëllazërija.
Në janë pakë Grekë sot në mes të Shqipërisë,
Se mos të pakë ka prej nesh Shqipëtarë të Greqisë?
Prapë në ndodhen dhe ca Sllev, që rrojnë në Dhè t'onë,
Janë dhe mjaft Shqiptarë sot me Sllavët gjithë monë.
Posht'ato duar ju, o Shqenj! mërgohi Shqipërisë,
S'ju sosin dheratë pa funt të gjëra të Shqerisë?
Jemi të zotrit ne këtu të mbajmë Shqipërinë,
Pràpsi pe nesh, çpori q'andej, në doni miqësinë.
Në doni ju një dashuri të kemi e të rrojmë,
Si fqinjë q'jemi gjithënjë në paqësi të shkojmë,
Kjo mëndje tepër nâ pëlqen e shum' e dëshërojmë,
Si miq të dashur gjithëkush njër' jatrin të nderojmë.
Ndryshe në qoftë, zotërinj se shkelni vëndin t'onë,
Më tej se vdekjen a ka më? S'është ky fundi i jonë?
Zjarri ahere rëntë shpejt! u djektë an' e mb'anë
Qiell edhe Dhè u bëftë hi, pluhur e gjithë ç'janë!
S'u rukulliskërkan me to dhe Perënditë vetë
Kur të humbasim nevej sot Atdhenë të vërtetë?
Doni të kapni, o të zinj, dhen' e Gjigandet rallë,
Cilët rëzuan Perëndi e duall tej në ballë!
O! ju që jini rotull nesh, Diplomati thinjake[395]
Dijeni fell' e pa dyshim, o bushtër, o dinake[396],
Sa rron Shqipëtar' i gjallë sot s'jà çkulni Shqipërinë
Më mirë vdekjen dëshëron, po kurrë robërinë,

[395] Thinake (e thinjur, e mplakur). Shënim i K. Floqit
[396] Dinake (thingjill' i mbuluar). Greqisht: **πονηρά**. Shënim i K. Floqit

Juve ja njohtë mirë fort atdhetarin' e gjërë
E ja provuat thellësisht, dëshirënë të tërë.
Atë nuk' e mposhtnë gjer tani, nuk' i qëndruan mb'anë
Roman' e Bizantinj e Turq të fortë Venecjanë,
E po përpiqi juve sot në robëri t'a shtini?
Poshtë, mërgohi, hiqi lark, këtë mejtim e lini!
O! o! qëndroni se më vjen që shëmbëllenj një hije!
Del me vërtik me shkumbëzim, sytë këtej po i shtije!
Shihni, pa shihni atje tej majën e malit të lartë,
O! qënka vetë **Skënder-beu** me shpatënë të zjartë!

Pushoni pak se po dëgjonj një zë si një tromarë[397]
Një ah! të math, një psherëtim, një bujë një llahtarë!
"Ku jeni burrat e Shqipnis, flini o djelm o çuna
Ku je trimni e naltë ti q'ke bamun kaqë puna!
Djelm q'i pat dhanun nder Shqypnis ma shifni dot varrë
Tà shkel me kam i huej sot, e mbani dot ktë barrë?
O! Turp i math! O turp për ju të vuenj Mamdheja,
Tuj shku anmiku nën shpat ket gja më s'e pandeja"!

Hija po duketë kudo dhe malet sokëllijnë,
Gumxhitin pyje e përrënj dhe Qejtë vetëtijnë,
Gjëmon Hapsira me kërcëllim dhe një rrufe nga retë
Këputet prej Tomorit shpejt e heth ky Zoti vetë,
Për të trohosur[398] më gjithsej të liq e të pështirë
Zjar e rufe dërgon mi Dhè Skëter e Shkretëtirë[399].
Mërzjen Gjithësia pa pushim, vollkanët nxjerin valë
Nata tmerohet në pushim, dita s'kuxon të dalë!
Përhapet Hija e perëndon, humbet sa kaqë herë,

[397] si një tromarë = që të tremb, të tromaks
[398] trohos = trohas, bëj thrime-thrime, thërmoj
[399] *shtojmë ca ligjërime, duke u hequr nga fantasia*. (Shënim i K. Floqit)

Dhe një pushim, një qetësi po mbretëron në erë.
Ëndër po shoh i madhi Zot, a jam në të vërtetë?
O hije dale, qëndro pak, mos ikë me të shpejtë.
Mëndje harrije dot në munç, pas gjyrmëve saj nisu
Mblidhe forcatënë që ke, fuqin' e shpirtit ngjishu.
Falm' edhe ti o Perëndi, në zëmbërë fuqinë,
Bashkomë shpejt, të lutem fort, t'i shoh një herë synë.
Afromë Leshit[400], ti o Zot, të përgjëroj i gjori,
Tregomë këtë hirë sot të lutem, prej Tomori!
Më rrofsh, t'jam falë e përmbys të lavduronj taninë
Lëshom' e lemë vetëmë të qanj pakë trimërinë!
O! qënkam pranë varreve të ndriturë të parët
Qënkam vërtet në Leshn' e math t'atyre Shqiptarët!
Mëndje, përse lëkundesh kaq? mbahu e mos tronditu,
O! mos u tremp, mos u tmero, mos dridhu, mos drobitu
Pusho moj zembër e mos qaj, e mos vajto pa prerë,
Mba vet-hen pak e mos rënko, mos u këput e mjerë!
Vdiqe, u thave, t'u përzhit thelp' i dëshirës s'ate
Vajte, u trete, t'u zvetrit[401] jeta me breng që patte!
E ftoht' e natës nuk të le, gjaksija, a thëllimi,
A mos u dobëtove kaq nga hij' e ati Trimi!
Shije[402] pa shije ja ku zbret, vëndin e saj të gjenjë,
Hy me ngadal në varr të zi të prëhet të dëfrenjë.
O! s'mu mbajtkan lottët sysh të shoh një trim një burrë
Që tundi botën fund e krej tà mshtjell një tok me gurrë!
O hije, hije e perëndijt, o Skënder-be i gjallë,
Ty që s'të mposhti dot njeri, të mposhti vdekja vallë?
O kordhëtar' i Shqypnis, o burrë, o i mburrur,

[400] Leshi = qyteti i Lezhës sot
[401] zvetrit = zbeh
[402] shije = shihe

Dil pak prej varrit të të shoh, kuror-arti thurur!
Jam Shqiptar dhe nipi yt, po s'kam guxim i gjori
Të dal përpara shtatit tënt, që Zot'i math më nxori!
Ja tek të shoh dhe të përndanj me shpatën kurdoherë
Ja tek të njoh në vrëngëllim që po krastit plot krerë!
Folna një her' ashtu na qafsh, tregona dashurinë,
Ar a ç'të kan' ata dy sy që retë mënt përpinë.
Dërguar jam tek Ty, o Mbret, prej Mëmëdhesë gjorë
Të sjell të larta adhuri edhe kanisk kurorë....
Më vjen se flet... ja po pushonj... Gjerë dëgjonj e gjatë
A!... më s'duruakam dot zëthin tënt të begatë!
"Ç'më qënke lodhun vllathi im? Ç'më ke pas arth kti veni?
"Ç'më pate marr rugën e gjat? Ç'dojni këtu të gjeni?
"Na që ky Dhê na mba, na që të dekun jena,
"Ç'munt me ju bamun ju o miq? Lena paç Zot lena!
"Në jeni t'gjall e me shpirt kapni pushk' e martinë,
"Por n'jeni dekun por si Na, mir kini robninë!
"Ja xgjohi shpejt me çel "Liri" me rrojtun të lirumë
"Ja se po disni gjith me nder, e jo kshu me dhunë".
Mbaron së foli dhe me vrap sheh qark si vetëtime,
Tretet në tym dhe shpat' e Tij i bije duarsh thrime!
Rënkojnë eshtrat pa pushim, oshtijnë si shigjetta
Kërrusen varret në rëndim, mbetet e shkretë jetta[403].
T'u mirë mbeç o moj Liri, t'u mirë mbeç at-herë,
Po hapni syt' o miqt' e mij, mos hedhim poshtë nderë.
Ndritna o Zot, o Perëndi, lëshona paqësinë

[403] *Këtu kthehemi prapë ne e brëndshimja* (shënim i K. Floqit). Duket nga stili i vjershimit si dhe dialekti geg që K. Floqi ven në gojën e Skënderbeut, se 54 vargjet nga shënimi nr.3 i f. 325 e deri këtu janë vargje origjinale të Kristo Floqit. Por, kushdo qoftë shkruesi i këtyre 54 vargjeve, N. Frashëri, apo K. Floqi, që të dy mbajnë mbi kryet e tyre kurorën me dafina të "Poetit Kombëtar Shqiptar" (H.Kaçulini).

Ndihna dhe ne të lutemi, të shohim pak lirinë.
Mos Sollomon[404], mos shpejtoh, të preç t'im bir të mitur
Lere të lutem ty, o Zot, të tërë, pa cënitur!
E ju Perëndi të Paqësis që majë Qiellit rrini,
Epni të zotit që e ka, Mollën e Grindjes[405] lini!
O ju, vëllezërit e mij, o trima Shqipëtarë,
Shihni ç'do bëjmë paskëtaj, mja mbetmë të përçarë!
Duhet përpjekje e shpejtsi për gjuh' e përparimnë
Për famënë të kombitë, për rrojtjen, për shpëtimnë,
Se shekulli[406] që jemi sot është për dritë bërë,
Pa msim e pa-qytetëri janë të kota tërë.
Përpara ejani o ju, vëllezrit t'im të dashur,
Shpëtimi ynë po na pret, ja tek na është qasur.
Kemi një komp të zgjuar fort e mjaft të përparuar,
Dhe gjuhë që munt tà punosh me kë të duash pluar[407].
Pra që të jemi si çdo komp është një gjë e lehtë;
Ahere ç'lipset? Një bashkim, një dashuri e nxehtë,
Atdhetari e kombësi, e drejta, urtësija,
Një mëndësi, një miqësi, veprim, vëllazërija.
Çdo pun' e mirë me pëlqim, çdo punë e uruar,
Për Shqipëtar' e Shqipëri të bëhet pa përtuar.
Tërë një gjindje e një komp e prej një mëme jemi,
Një trup, një shpirt, një far' e fis, një Mëmëdhe po kemi,
Kemi të gjithë një mendim, dhe zembër e zakonë,

[404] Sipas Biblës Mbreti Solomon njihej për drejtësinë e tij. Një ditë i paraqiten dy gra që pretendonin secila se ishte nëna e një fëmije. Solomoni do vendoste se kujt i përkiste fëmija. Ai i tha grave: "Unë me këtë shpatë po e ndaj fëmijën më dysh, gjysmën ta marrë njëra e gjysmën tjetra". Nëna e rreme pranoi, kurse e vërteta kundërshtoi. Ahere Solomoni kuptoi se cila ishte nëna e vërtetë dhe ia dha fëmijën asaj që refuzoi vrasjen e fëmijës

[405] Greqisht: **Τό μήλον τής ἐριδος** (Shënim i K. Floqit)

[406] shekulli = jeta reale, njerzia mbarë.

[407] pluar = pa pengesa

Gjuhë edhe ndjenjë tërë një, siç ishim gjithë monë.
Na lith të gjithëve një gjak një eshtër jo e mefshtë,
Dhe më në funt një kupëtim për vepërim të fjeshtë.
Kemi dhe gjithë një Perëndi, një besë, nj' adhurojë,
Pa le të lusë gjithë-kush Perndinë si të dojë.
Rrënja e Besës është një, e fet' e gjithë ç'janë,
Dhe rrënja e Rrënjës ësht' ajo që **Njerëzì** i thanë.
Mos epni kurrë rëndësi në fjalët e armikut
Q'u kllasin "fenë" gjithënjë, si vegëln' e rrezikut.
Duan të na përçajnë sot për një qëllim që kanë,
Po kombësija duhetë t'i muntnjë t'i përndanjë.
Kur mbretëronte midis ne, Pa-dija, Erësira,
Edhe fedakët[408] fanatik, e Kishësë Fuqija,
Ahere ne lëftuamë pa mënt e si të marrë,
Për t'huajt' e armiqt e vet ramë, mjerisht të vrarë!
Po sot po lodhenë më kot për Shqiptar' e gjorë
Cili s'gënjehet kurrë më, as q'u zë bes' a dorë!
As që ka kohë më për tà, të lodhet, të përpiqet,
U ngop, u nginj edhe sa vjen po ftohet e po hiqet.
Pra edhe Besa është sot në Shpirt e në vullnesë,
Për kohën ku jetojmë ne Njerëzija është besë.
Kish' e vërtet' e Zotit Math, është Hapsir' e p'anë,
E shënjtëruar libr' e Tij, Gjithsi' e tërë ç'janë,
Shkronjat e ti të bukura lëmshet e Qiellit lartë,
Çdo na sheh syri që lëvrin, çdo yll që ndrin i zjartë.
Lëçit's i kishës që meshon ësht' Dituria vetë,
Q'afron njerinë e e sjell te Zoti i vërtetë.
Zoti i Jetës e i Math është Gjithësija tërë,
Drita që shohim nevej sot Fytyr' e Tij e gjërë!
Po mi kto njeriu më fort ka një me Të pikturë[409],

[408] Fedak = njeri i dhënë pas fesë, manjak feje, religjioz.

Fron ësht' i Zotit zembr' e tij, e larë si pasqyrë.
Gjykonjës ka si cili-dò Vetdijën që së qeti
E hirësin kur mir bën, e hidhëron po fjejti.
Detyrë kemi cili-do në Botën që jemi pjellë
Besën' e tij si-cili-do t'a lusë, nder t'i sjellë,
Po edhe fen' e tjetërit t'a donjë t'adhuronjë,
Mos jetë kurrë fanatik, të shohë, të gjykonjë.
Ka çmim të math edhe respekt dogm' e vëllathit t'uaj,
Me cilin ke një gjak një shpirt, një gjuhë e s'je i huaj.
Çdo që të lusë vllathi yt t'a kesh të shenjtëruar,
Kini një mëmë që të dy të dashur të uruar.
Njerì, a popull, a kush-do që rron me dashurinë
Që ësht' i urtë e duron e rron me njerëzinë,
I sjellë është te kush do, i mirë, mëndje-dlirë,
E jo i marrë, fanatik, i dëmshim, i rëpirë.
Besën e Shqiptarëve e dëshmon një Bot' e tërë,
Të shkuarin në dashuri, në miqësi, në sërë,
Vëllazërinë, që s'ka shok, fjalën e Bes-pranimnë,
Dëshirën për të mësuar, lirinë e kuximnë,
Çdo mirësi, çdo urtësi, të rallën kombësinë,
Edhe mendimin që ushqen për mëmën Shqipërinë.
Ahere çdo mëmëdhetar lipset të ketë shpresë
Se Perëndija gjithënjë na do, na ka në pjesë.
Shkronjat e gjuhës edh' ajo e Diturisë drita,
Do ndritin kombin me çkëlqim të çelë po si dita,
Do sjellin një vëllazëri, të gjitha mirësitë,
Një shekull t'artë, një liri e tërë lumtëritë.
Dhe më së fundi prap' ato do sjellinë ngjallimnë,
Rrojtjen e kombit e t'atdheut, e tërë lulëzimnë.
Ato do të përndajnë shpejt armiqtë e Tyrannë

[409] Sipas Biblës njeriu është krijuar një me fytyrën e Zotit.

E do na ngrehin për mi tà, si burra, si luanë!!
Ahere rroftë gjuha jon' e Shqipëriz' e ndjerë!
Rrofsh kombi ynë Shqipëtar! Vëllazëri e vlerë!
Poshtë tradhtor, Armik, Tyran, përhapu errësirë!
Rrofsh, o moj Bes'e dashur ti! Rrofsh, o Liri plot hirë!!!

Mbi ardhjen e eshtrave të NAIM FRASHËRIT

prej
KRISTO FLOQIT

(Vjershë e botuar në gazetën "Drita",
6 qershor 1937, faqe 3)

Naim, mir' se n'ardhe n'Atdhé, q'e dëshrove,
Në tokën e shenjtë, te mëma Shqiprí,
Ku vjete ëndronje të shohsh një lirí,
Që gjall s'e shijove!

Bilbil i Pranverës me zëthin e naltë,
Që kaqe këndove pa çlodhj' e pushim
Burrninë Shqiptare, vllazri e bashkim
Sot çlodhu, goj-artë!

N'atë arqivolin, të vogël, të çmuar
Përmblidhen, ah, eshtrat e shkreta që lé,
Gjith' ëndrat q'ushqeve për Komp e Atdhé
Oh! I pate përshkruar!

Poét krye-naltë, profet, që s'harrohesh
Me mendjen e thellë të gjithve na thé
Se toka Arbrore, i shenjti Atdhé
Një dit do lirohesh!

Qé, shkrepi dhe dita, fatbardh' e bekuar,
Ku flamur' i shenjtë u ngrit valoj,
Q'u tret por si vesa, u zhduk e kaloj
Robrí' e mallkuar!

Ah, fjalët e urta, të buta fisnike,
Të ëmbla, të kjarta, plot frym' e fuqí,
Tingllojnë akoma në zembër, në gji,
Si shëmblla jetike.

Si një manushaqe Shqiprin' e përshkrove,
Të zhytur në shpendra[410], në hithra, në vaj,
Po prap' i dhé shpresë, shpëtimin e saj,
Ja pé, ja diktove!

Robrin si dimbër të math e lëçitte,
Po brenda dëshprimit një dritë e pé,
Që shpirt'i Shqiptarit një dit' për Atdhé
Me zhurm' do buçitte!

Tani, Naim, zgjohu të shosh se ç'ka ngjarë,
Lirin' e dëshruar q'e prisnje me mall,
Të shohsh Skënderbenë si befas u ngjall!
Në ZOGUN e parë!

AJY nuk t'harrovi, s'i dolle mentsh kurrë,
N'atë Merdivên-qoj[411] s'të la që të flesh,
Se vendin e çlodhjes këtu do t'a kesh,
Prandaj të ka prurë.

[410]shpendër = një fare bimë e egër, hither, hithkë.
[411] Merdivên-qoj = emri i varrezave të Stambollit, ku u varros Naim Frashëri më 1900

E di se s'të mbanin as gjemba, as fletë,
At' frymën e naltë ndaj neve t'a falsh,
Si ëngjëll prej Qielli lirinë t'a ngjallsh,
Lirin' e vërtetë!

"Atdhé" fjal' e fundit, "Atdhé" fjala jote,
Në orën e vdekjes "Atdhé" tjetër s'thé,
Me 'te e dhé shpirtin, që vetë s'e pé,
Q'e qave me lotë!

Tani hij' e shenjtë n'Atdhé le të prehet,
Se malli, dëshirat të shkuan në vend,
Për ty u mallëngjye ç'do cep e ç'do kend
Sa s'munt të rëfehet!

Kujtimi të qoftë, Naim, i pavdekur,
Ç'do zembër Shqiptari për ty sot loton,
Dhe veprat e gjalla gjithmon' i kujton,
Ah! .... sa jé përpjekur!

KUSHTIM

mikut të dashtun e vjershtorit komtar
në zâ, Atë Gjergj Fishtës

(Botuar në revistën "Zani i Shna Ndout"
viti 1919, Nr. 2, f. 36-39, si dhe në librin e botuar nga
Êtnit françeskan më 1941, kushtuar Ât Gjergj Fishtës në
përvjetorin e parë të vdekjes së tij)

Quod si me Lyricis vatibus inseres
Sublimi feriam sidera vertice.[412]
Horatius – Ode I.

Kthillet Qiella e me harmën vrulûe[413] Appoloni[414]
Vrik pershkon t'agimit mjergullin e lehtë,
Dielli shkelzen me rezat të flakta, jetike
E që, po lên e kândshme nji ditë Prilli.
Midis qetsies, që shekuj tash mbretnote
Të jetës s'mnershme, të gjumit t'randë të dekës,
Nji zâ i kthellët sa edh' i kjartë pritëj
Se do shungllote, pushimin m'e tundûe.
Kâ shkrefë nj'atëhere nji rez' e po si sgjettë[415]
Vrap nget këndej kah megjet[416] arbënore,

[412] Po të numurohesha unë si poet Lirik do të ndjehesha sikur kam prekur qiellin me dorë (përkthyer në shqip nga Prof. Filip Fishta e Prof. Henrik Lacaj në fjalorin Latinisht-Shqip hartuar prej tyre bashkarisht)
[413] harma vruluese = arma sulmuese
[414] Apolloni = Perëndia e bukurisë,e poesisë e të arteve të bukura
[415] sgjettë = shigjetë
[416] megje = kufij

E si krongjillat[417], aklli i Pranverës shduket
Tui lâ mbi qiell e kaltërt të Shqypnis s'ngratë,
Me shndritë nji hyll i zjartë qi vettote.
Befas nji shpirt t' rii, nji frym' merr remeti[418]
Q' i ngathët në plogsi ish i denûe
E pîjtas shmangun pranë nji cepit rrijte[419]
Prej kush din ç'farë mekatesh katragjyshe.
Fishkllèn nër rrembat nji gjak i nxehtë,
Vlon nji gjallnì me nji her' e përftyrohet,
I âmbli flad vallzon me nji gëzim e hîrë
E çel gjithkah nji tjetër jetë, nji naturë.
Orfeu[420] kur kishte hupë të bukrën Euridihe[421]
E po e lypte nat' e ditt në Ferr pa shpnesë
Me lyren e tij të andshme, harmonike
Qeverin sbuti. Dante, të dashtnën Beatriçe
Pa prajë[422] e kerkon e mbas aqe potera
Kâ mujtë te e mramja m'e gjetë e m'u gzue.
Në zâ e bûjë ka kenë Mitelena
Sa do qi njifej prej Elinve barbarë,
Se pati fat me nxjerë aqe vjershtorë,
Sa edhè sot, kujtoj, i ndihet zani
Lyrës, barbare, Barbetos Lesbiane.
Thonë se Arioni, aj Lesbjân i vjetër
Dikuër prej Perandorit, avânit[423] të Korinthës

[417] krongjill = Hell akulli.
[418] rrëmet = turmë njerzish, gjindje
[419] Ât Gjergj Fishta ishte fizikisht i bëshëm (i shëndoshë)
[420] Orfeu është një muzikant legjendar, poet e profet në fenë dhe mitet e lashta greke. Luante me veglën muzikore lyrën.
[421] Euridika = grua e re që Orfeu e dashuronte.
[422] Prajë = praj, pa pushim.
[423] avân = despot, tyran

Në Siqelî qe çue me një çmim muziket,
E se, t'anijes detarët e lakmushëm
Qi dojshin vleftet m'zhdeshë kangtarin
Në det t'a qesin nji-ment u mundûne;
Të ndiimen bolbën me zâ qiellore
Hutoj dhe peshkët, sa me vrap ja mrrini
E e shelbeu nji alamet – delfini,
Që t'gjall' e nxjer mbi skâjë t'Tenarit!
Kshtû statû' e bardhë prej mermerit
Shkëlzote m'Arionin, hippun mbi delfinin
Pêr mbi Tenâr e mal' e Helikonit.
Terpandri[424], gjith' ashtu Lesbjan prej fisit
Lâ nji kujtim të math e t'amshuem
Se ish i zoti me kendû me ândje
Kangët e veta e vjershat e Homerit,
Sa dhe të Spartës t'egrit luftëtarë
Nji adhurim për tê të gjith' e ndjejshin.
Kush ka harûe jon'[425] e tingëllimit
Të Aeneadës aq të kandëshm të Virgilit
Të odeve shlleuore[426] të Horatit,
Laurën e përmallshëm të Petrarchit
E të Torquattos[427] Jerusalemin?
Mburret sot plaknesha Albiona,
Për Byron e Milton e Shakespearin
Mburren Teutonët për nji Goet' e Schiller
Edhe Gallatët për Corneille e Racinin,
Për nji Cervantes Spanja Ibirike

[424] **Τέρπανδρος** = Ishte baba i muzikës Greke dhe nëpërmjet saj i poezisë lirike
[425] jon = shkurtim poetik i fjalës "jehonë"
[426] shllim = ide, përfytyrim
[427] Torquatto Tasso = poet, shkrimtar, filozof italian. Vepra e tij më e rëndësishme është "Jeruzalemi i liruar"

E Portogali me Camoëns për Lusiadat,
Por se kujtonj nj'ashtû dhe Arbënia
Ka psè të mburret me ty, o At-Fishtë,
Qi me Lahutën e Malciis e aq të tjera
Vjersha lyrike e gjith farë zânit,
Atdheut nji shpirt të rii i fal' e dritë.
Me lyrën e Xanonit e harpën e Naimit
Me të Kamardës luttën e lahutën t'ande
Kumoj dhe nj'hera Zana Arbnore.
– Qi sllig' e namun vllaget[428] ja kish shterrë –
E deri lamsh' i Dheut t'kthehet rrotull boshtit,
E të vettojnë hŷllet nen të Qiellës kûbë
Ka me gumxhitë e kjartë, madhshtore,
Mest shekujve, saa dit' e Ruzullimit.
A thue kishte m'u gjetë nji Maecenë[429],
Ose një tjetër Periklès, si i Greqisë,
A nji Louis i Francës i dhet-e katërt[430]
Qi veprës shejtë frymore e jetike
Zot me i dalë e m'e perkrahë si duhet?
Hè! po shpresoj dhe mbaj uzdajë Zotit
Se kâ me shkrepë dikur e bardha ditë
Kû luftëtarët e lodhët të Kastriotit
Prehje do të gjejin nën çinar' e dijës;
Ahere oh, ahere, âsht e dijtun
Se kena m'ja mrrijtë së bukres Babylonë
E fâri i dijës gjithkahë do shndritë

[428] vlag = njomësi, lagështirë, lagësirë.
[429] Gaio Clinio Mecenate = ishte një mbrojtës i rëndësishëm i një gjenerate të re poetësh madhorë midis të cilëve Orazio, Vario Rufo e Virgili sepse ishte këshilltar me influencë dhe aleat i Imperatorit August. Po këtë rol protektor ka luajtur Perikliu i Greqisë e Luigji XIV i Francës.
[430] Luigji i 14-të

Mbi lulëzim të blert e veshillûer.
Por si Horati kur percjell Virgilin,
Nj'atehera kur ajy u nis me shkûe
Për në qytet të famshëm të Palladës
M'e plottsû nj'atê q'i kish mungûe
E me tiktim të zembrës e me frikë
Hŷjit i falet Perndive save
Shndosh t'a çotte lundra përtej bregut
E prap shndosh n'atê Romë t'ja kthette,
Nj'ashtû dhe vet' i lutem Perendisë
Në të vështirën lundrën e vjershimit
N'anijen prirse të fantasiis hyjnore
Durrim të math, fuqî e një dëshirë
E gjith ç'ka të lypet ty t'i faltë!
Ti mos u loth, mos u mërzit, hej burrë
Mos pshaj[431] psè s'çmohet pun' e rândë,
Se kâ m'i ardhë gjith se cillës dita
E gjithsecilla çmimin kâ m'e gjetë,
Mundohet bredhsi qi nget n'pik të vrapit,
Prej Marathonës rrugën tui fillûe
E per me ardhë n'Stadium t'Athinës
E din sa fort' e fshtir' â rrug' e gjattë,
Por se, tui derdhë djersët rkâe, lumë,
Nji gzim të madh në zemêr ndijn i ngrati,
Trupin nji ethe ja përshkon si têja
Deri t'fitojë kunorën Olymbike.
Nji kshtû dhe nè për fije do t'i vemë
Veprat dijetare, vjershën, ose prozën
Qetas fillojmë lettrsiën t'onë
Fort tui durûe, por tui shkûe përpara.

[431] pshaj = fshaj, ofshaj.

Që, për kujtim të vlefshëm, t'ditës argtore
Të meshtarîs t'ande nji–zet e pêse vjetshe
T'a kushtoj këtë vjershë.
Deh, sa dishirojsha
Qi n'at vallen t'uej, t'andëshm' e lyrike
T'mujsha m'u afritë, vallen me këcye,
Fyll nji gêm ullinit kish me më vleftë aqe
Sa gjith pasuniët, gjithë farë dhuratet.

Shënim i redaksisë së revistës "Zani i Shna Ndout": Si mundet me u pá prej diftojsit, per kto pêsë fletët e mrame na patem gatue landë tjera per të perkohshmen t'onë, por me gzim të madh t'onin para se kto fletë të hijshin në makinë, u duk në drejtim t'onë i vlerti e i permenduni dijetar Dr. Kristo Floqi, i cilli, shty prej bindjet ndaj vjershtarit t'onë A. Gjergj Fishten, tuej pasë marrë vesht se ky do të kremtote me 25 Fruer të njizet e pestën vjetë të meshtaris, kishte pasë gatue nji vjerrshë e na lutej me i bâ vend në të perkohshmen t'onë. Të kënaqun kah zêmra, na ket vend ja lshueme ktij shkrimtari ta palodhshëm, tuej lânë landët e tjera per nji tjeter numer e ket pûnë e bâme së parit per nderim e çmim me të cillin na i percjellim veprimin e Dr. Kristo Floqit e së dytit, pse të përkohshmes s'onë ishte tuej i ra rasa, per mâ të parën herë, me hijeshue fletët e veta me shkrime të nji pinjuellit të ndritshëm të Toskënisë, tuej u bashkue kshtû dy degët e mdhá të nji lisit të vetëm të Shqypnis, per me madhnue veprimin e njati qi nder shkrime të veta, si edhe në zêmer t'vet nuk diejt me njoftë kurrnji ndryshim ndërmjet të Toskvet e të Gegvet, por i desht vllaznisht, si Shqyptarë.

MIKUT TË VLERTË D. NDRÉ MJEDES MBI SHTATËDHETË VJETSHORIN E TIJ

(Poezi e Kristo Floqit kushtuar Dom Ndré Mjedës, botuar në revistën "LEKA" Nr.12,viti 1936 faqe, 532)

Pegasit krenuer, si Belerefondi[432],
I hypun përsipri, kalorës kreshnik,
Himêrën[433] e shkele, të mnershmin anmik,
Që mbytte Shqipninë;

Fryu era e lehtë, u çel horizondi,
Atdheu mori frymë, filloj jet' e ré,
Shkreptiu Djell' i flaktë, shpërndau mjergull, ré,
E ngjalle Djelmninë!

Prej thundrash t'Pegasit dy ambuj[434] mburruen
Mbi trûllin e shêjtë, mbi mal' Elikôn[435],
I Zânave tingulli hynuer kumbon,
Kur ti ju avrite,

[432] Bellerofonte ishte një hero i mitologjisë Greke, që vrau kimerën. Esiodi dhe autorë të tjerë tragjikë e përfytyrojnë atë sikur të ishte i ulur mbi kalin Pegasos (kalin me fletë).
[433] chimera = monstër legjendare sipas mitologjisë greke, romane e etruske me kokën e një luani, kurse pjesët e tjera të trupit janë të kafshëve të ndryshme. Është e kjartë se K.Floqi me "Himera" quan Turqinë
[434] ambull = pus, pellg uji
[435] mali Elikon ndodhet në Greqi

Rreth tejet u mblodhën, me gzim të shtërnguen,
Dhe ti ju dhé dorën, ju bane një shok,
Prej sijsh nuk u shmange, gjithmon' ishit tok,
M'ato bash' u rrite.

Me hapa vigani Atdheut i shërbeve,
Talenti jot ndezi të flakten kumì[436],
Punove, vrapove me afsh' e zjarmì
Në lâmën vjerrshtare;

Pjoner i palodhun kurrgjâ nuk kurseve,
Djelmnìs i tregove detyrën e saj,
Ashtu, pra, perpjetë flamûrin e mbaj
Në fushën letrare!

S'ka gjâ se po plakesh, se vjetat randojnë
Mbi shpînën djaloshe, qi moti orvat,
Ti ecën si flutur, cok si nji kal' ât
Qi shkel curra[437] e gurë,

Prandaj një mirnjoftje të thellë të çojnë,
Djelmnija e gjallë, gjith ky brez' i rì,
Të kqyrin si shëmbull për Nanën Shqiprì,
NDRÉ MJEDA s'vdes kurrë!

KRISTO FLOQI

[436] kumì = furrë për të pjekur tulla ose tjegulla.
[437] curr = shkëmb i lartë me anë të thepisura

DY LOTTË MBI VARRIN E KOSTANTIN KRISTOFORIDHIT

(Kjo poezi e Kristo Floqit është botuar në vitin 1923, tek "VALËT E VJOSËS" me botues Nazif O.Mamaqi)

Në një kohë të vështirë,
Nënë xgjedhën tyranike,
Kur Atdheu tepër i mpirë,
Ish në breng' e në rrezike.

Shkrepi befas e shëndriti,
Hyll' i dritës i agimit,
Dhe Atdheut të mjer' i zbriti
Dritën e qytetërimit.

Ç'ish ajy luân luâni,
Që u derth prej Elbasani,
Që aq fort i jehoj zâni,
E s'ju unj as një tirani.

Ç'ish ajy i rrallë burrë
Që rrezikut s'ju shmang kurrë,
Që për kombin u bë urë,
Me shërbimet q'i pat prurë?

Elbasanas ty të lumtë,
Se punove gjithë jetën
Nami kurrë mos të humptë,
Nxore në shesh të vërtetën,

Me atë vokabullarin,
Themelove gjuhën t'onë,
Ti e ndrite Shqipëtarin,
Mos t'harrofshin për gjithmonë.

Vepra jote nuk harrohet,
Ndrit për hera si shkëndija,
Bres pas brezi do kujtohet,
Në parajsën e vërtetë,
Me dëshmorët atdhetarë
Zot' i math ju prijtë vetë,
Ju, o burra Shqipëtarë

Kristo Floqi

AQIF PASHË ELBASANIT[438]

Prej oxhakve të Shqypnisë
Ti n'a dolle patriot,
Ndritte për mes Bujarisë
Dhe Shqypnis' i ardhe zot.
Sa do që jishe i rrethuar,
Me të huaj e anmiq,
Ç'do intrig' e kè larguar
Pa peshû' as një rrezik!

Si Ministr' i Mbretit t'onë
U përpoqe për Atdhè,
Shqipëtarët gjith' e thonë,
Se veç ti Ministër që!
Që Ministër i vërtetë,
Që punonje me gjith zel,
Me një shpirt e gjak të nxehtë
Për nj' idèe e një themel.

Propaganda nuk dëgjove,
As që deshe m'u përzìi,
Vërtet' hoqe, ike, shkove
Po nuk dolle faqe-zìi!
Dhe sa do q'Eli-kiami
Ty të doq, të përvëloj
Po shyhreti yt e nami
Përmes flagëve shpëtoj!

[438] Dorëshkrim që ndodhet në A.Q.SH. F.429-3-322.1 e vijues.

Ti e njohe bukur mirë
Që Shqypnia s'â çifliq,
Për të ngrën' e për të pirë
Arrankatë e anmiq,
E Dhespotë e Tyranë
Që n'a mbajtnë në Robnìe
Duhet t'iqen krejt mê nj' anë
Qoft se duan një Shqipnìe!

Mbi këtë princip të bukur
E të drejt' e kombëtar,
Aqif Pashë, ti jè dukur
Mâ i madhi atdhetar.
Si një hyll në mes të Qjellit
N' errësirë një shkëndì
Por si rez' e kjart' e Djellit
Jè një shëmbëll për Shqypni.

Ah, duro o plak i rallë
Por si mali – plak Tomor,
Mbahu trim e burr' i gjallë,
Kije shpresën në krahnor,
Se kjo barrë do kalonjë,
Hylli nuku perëndoj,
Shqipëria do të rronjë
Zoti vet' e tha, urdhroj!

Do të vinjë nj' ajo ditë
Që Ministër prap do jesh
Edhè emni yt do të ndritë
Dhe nderimet do t'i gjesh.
Përsëritu pra dhe nj' herë
Sa do plak i motshëm jè
Aqif Pash' o burr' i ndjerë
Djelmt' e Kombit pas i kè!

Z-ës MARGË POZIO[439]

(Mbaj flamurin përpjetë)
(fortuna adjuvat audaces)

Si thëllëza kur del duke qeshur,
E me gas për mëngjes belbëron
Si bilbili kur zê ligjëron
E nuk prànë dit' e natë,
Më ke dalë me llërë përveshur,
E me shpres' e guxim po vrapon,
E pa-lodhur lëçit predikon
M'atë zê por si shpatë!

Si një mburrim që mburron kurdoherë
Si një ambull që kurrë nuk pran,
Ndjenjat t'ënde të nalta përndan
E nuk shmangesh kurrë.
Si një lule që çel dimbër-verë,
Po përhap kombësin' më ç'do vent
Është zjarm' është flak ç'do kuvent
Që e flet por si burrë!

[439] Poezi me shkrim dore nga Kristo Floqi. Ndodhet në AQSH., F.429-3-224

Shqiptarë ka mjaft Shqipërija,
Që t'i mbajnë kudo krahënor,
E t'a mprojnë me gjak e theror,
Sa të jenë gjallë.
Po kujtonj se dhe ty Perëndija
Të krijoj si një shpres' e kuxim,
Si një vegël të fortë për xgjim
T'i dalç veprës në ballë.

Mbaje flamurin e shejtë përpjetë,
Mos pushoh kudo je e qëndron,
Se kjo vepër ty mjaft të nderon,
Në ç'do shpirt e ç'do zemër,
Mos u loth po vrapo me të shpejtë,
Mos u hiq prej të naltit qëllim,
Shqiptarkat i xgjoh dhe fitim
Për ty mjaft â një embër.

Dora d'Istria ish Shqipëtare
Që shëndrit si një hyll n'historì,
Kam uzdajë praa kshtu edhe ti
Do shkëlqesh no një ditë.
Mos u drasht po qëndro kordhëtare,
Xgjohi shoqet me fjalë, me msim,
Që t'i bijen Atdheut përparim
Lulëzim, mirësitë.

SALIH NIVICËS[440]

(Satyrë)[441]

N'atë Shkodër, at qytèt,
Ç'n'a ka ndodhun, ç'n'a ka gjèt
N'a pat ardhun nji dajì[442]
Një esmèr, mustaqe-zii
Q'e ka kryet si baxhi[443]
Sy e hûndë çinezi[444]
Trup të derdhun okllagì
Ecën si kapodajì
E e quajnë Salih.
Âsht i dijshëm e i matun,
Mendje-hollë, i begatun,
E n'a arth si inspektor
Mjaft i rand' e madhështor,
Arësimin me ç'do mjeti

[440] Salih Nivica dhe Kristo Floqi kanë patur miqsi e cila lindi në Shkodër ku shkuan që të dy nga Vlora, më 1914. S.Nivica ishte gazetar atdhetar që ka shkruar shumë artikuj me pseudonimin **Godo Duda**. Në ceremoninë mortore të Salih Nivicës, në emër të Shoqërisë Vllaznija, Dr. Kristo Floqi i uroi me pak fjalë, paq' e qetsi në jetë të âmshueme (Shih revistën "Agimi", viti 1920, Fruer Nr. 10).

[441] Dorëshkrimi ndodhet në AQSH F.429-3-345.1

[442] daì = burrë trim e bujar

[443] baxhi = Përdorej për të thirrur me nderim një grua të moshuar

[444] çinezi = si kinez

E kërkovi, po e gjeti,
Gurr'e dhè e baltë tundi
Sa e prûni më së fundi,
E vjen n' Shkodër Salih-âj
Gjithë shpresë e uzdaj
E shetit rruga e truall
E heq vedin por si buall,
Ndonse ashtë një bretkoc
Mendje-vocër, torroloc[445].
Por s'e njeh kërkush Salinë,
S'i sheh mendjen por japinë[446],
E kuximi po i shtohet,
Dita-ditën po smadhohet,
Din e hiqet si stoik
Fjal' e tij sa një shinik,
Flet nga pak' e nuku ngutet,
Jo prej dijes, po prej tutet[447],
Se ka frikë mos gabojë,
E i del e shkreta bojë;
Asht i msuar fort erifi[448],
Kush e mburri, veç se çpifi,
Por se hallku e nderon,
Edhe aj s'di psè e dron,
Nuk se trembet, a gjâ tjetër,
Por se s'pa sijsh no i vepër.
Po Salikua mendje-gjati,
Popullin me kut e mati,

[445] torro, ua = i çmëndur, i marrë
[446] japi = Trupi i njeriut, shtati
[447] prej tutet = prej frikës
[448] erifi = (turqisht) studjues?

Edhè tash don m'u kallzûe,
Gjan' e gjatë m'u tregûe,
Që t'a shohin djelm' e burra
Sa parà i ban lëkura
E t'a dijn' i vogël' i math
Se dhe pleshtin ky e mbath.

II.

Deh, moj Zanë, pa n'a thûe
Ç'ka Saliu q'â trubullûe
E shetit posht' e përpjetë
Edhè duket i pa-qetë?
Mos dikush n'a e zhigati[449]
E ju prish të ziut rehati,
A mos keq i eci fati
Ose dishkâ tjetër pati?
Ç'ka i shkreti professor
Edhè sillet kshtû terthôr?
Ahì, aj, Sali-agaj
Duket se nuk râ më skaj,
Se këtij ju vû për barrë
Për m'e bamun sa mâ parë,
Një gazettë popullore
E të gjall' e tingëllore;
Këtë Saliu kërkon t'a nxjerrë,
Me kalû shokët e tjerë,
Nep e merr edhè premtohet,
E maraz' i tij po shtohet,
Sot me nesër hê të dalë,

[449] zhigat = tundoj

Zembr' e tij tallâs e valë,
Edhè mbarset mal' i zii;
Bûj' e madhe! Ç'leu? .... Një mii!
Po Saliu nuku hutohet,
Psè e shajnë nuk zembrohet,
Mjeshtërinë gazettare
Ky e kâ të ndryshme fare,
Se me shkrûe bejta e pralla
E me prèe bishta, kopalla
Kjo â një mënyr' e rèe,
E jo thash' e them e thè!
"Populli"[450] di ç'ka një vlerë
Sa shkruajn në 'te të tjerë,
Pa kur mbetet mbi Salinë,
Qâje Hanko Met-Alinë,
Thua se kè Halimanë
A këndon Dervish-aganë.
Po, Saliu si burrë trim,
S'ndjen as hîr as përdëllim,
Po vazhdon thell' e më thellë,
Tui u tall' e tui u sjellë,
Fut turinë më ç'do gjellë,
Pralla, dokra duke pjellë,
Sa dhemb barku, ka të mshtjellë
Edhè zgrofi zë të vjellë!
Po Saliu nuk i merr vesh,
I duket se hâ përshesh.

[450] Gazeta "Populli" ka qenë botuar në Vlorë nga gazetari Mustafa Qulli, por pas rebelimit të vitit 1914, ai e transferoi këtë gazetë në Shkodër ku ishte bashkëpunëtor edhe Sali Nivica.

Hè! Po si i bahet halli
A mos â fletë bakalli?
I çuditshmi ka guxim
Don Qichoti' ndaj ish trim!
Robert School[451]-i psè e pati
Professor (se i ndiu fati).
Mos kujton se ky i ngrati
Dinte ç'ka âshtë zanati?
Ashtë cok si një Kines,
Që shet lule për mëngjèes
E psè din këndim e shkrim
E merr Shkolla për këtë msim,
Kshtû dhe Salua shkoj si msûes,
Jo se ishte meritûes.
La-Fontaine-i aq' i ndjerë
Kallzon se bretkosi nj'herë
Doli ûjit, pa një buall
Që po shtrihej për mbi truall,
E i pat lakmi japinë.
Tui e pamun në lëndinë,
E e kapi një dëshirë,
E filloj me të pa-hirë
Por si bualli të bahej
Edhè fryhej edhè âhej[452],
E s'e len as pak marasi
Deri sa u shkrii e ...plasi!
Pra merr shëmbëll, o Salì,
Se dijen s'e kèe mjeshtrì,

[451] Robert college = shkollë amerikane në Stamboll që frekuentohej nga shumë studenta shqiptarë.
[452] âhej = ënjtej

Mos të t'gjejë e bretkosit.
Masandej i fryn dhe kosit.

III.

Po të thras dhe nj'her' o Zanë
Kaliopi[453], qasmu pranë
Në Parnâs a n'Elikôn[454]
Ku do jè e n'a digjon,
Eja shpejt e dridhe vallen,
Se me ty zun' e po tallen,
Shife professor Salinë,
Se u kap me poezinë,
E do fenë me t'a lujtë
Po veç Zoti ty të rujtë;
Hè! moj Zan' a kèe mërzì
Se po flas për poezì?
A din ti kush â poêt,
A po kott bërtet e thret?
Msoje praa dhe dije mirë
Vjersha â një sent e fshtirë
Se vjershtori do të ketë
Një moral me vjershën vetë!
Edhè po nuk âsht' i zoti
Të të ndezin si baroti,
Ose lehtas edhè butë
Edhè âmbl' e pa u ngutë
Të t'shetit' e të të shkojë

[453]Kaliopi = sipas mitologjisë greke Kaliopi ishte gruaja e Apollonit dhe nëna e Orfeut, këngëtar i famshëm i Greqisë së lashtë.
[454] Parnâs e Elikôn = dy male në Greqi ku, sipas mitologjisë Greke qëndronin muzat (Zanat)

Kû atij qefi t'i dojë
Në për kopshtet ândërore
Me do lule mësimore,
Ajy s'quhet vjershëtor,
Me përdhûnë s'hâ laknor!
E kështu, ju raftë pika
Kush të bajin satyrika,
Kush të merret me elegjì[455],
Ose me nekrologji,
Kush ban hymne edhè drama
Ose luan m'epigrama,
Ase thur një komedì
Dithyramb'[456] e tragedì!
Kshtû të kritikon Saliu,
Se e tha dhe Firdefsiu,[457]
E përmendi Nizamiu
E ka shkrûe dhe Sadiu
E kush din se sa vjershtorë
Të Persisë këngëtorë,
Që Saliu veç i nuhati,
Se fitim tjetër nuk pati;
E Homeri – aj i ngati –
E Virgjili e Horati
Tassua[458], Dante Aligjeri,
E Racina[459] e Volteri
Për professor Saliânë

[455] Këngët elegjake ishin këngë melankolike, këngë vajtimi
[456] Dhithyramb = (**Διθίραμβοι**), këngë për nder të perëndisë së verës *Dionisit,* ose *Bakhusit*,
[457] Firdefsiu = Homeri i Persianëve,
[458] Torquato Tasso = poet, shkrimtar, dramaturg italian i shek.XVI
[459] Jean-Baptiste Racine - dramaturg francez i shek.XVII

Terra incognita janë.
Libra t'hueja Saliu
Ka, po s'i këndon i ziu,
Por i mban për bukurì,
Mbasi t'i këndojë s'di.
Hè, morè, Sali Nivica,
Mos kujton se janë gorica
Vjershat e shkreta, q'u ngute
Me mënyrë aq' harbute
T'i gjykosh si t'a preu gllava[460]
A po thè se hâ bakllava,
Muhalebì, hallv' Stambolli
A po mendja kshtû t'a polli,
A të shtyri cmira, nakari
A të hodhë trû gomari?
Hiqu, morè Salo, hiqu,
Kû s'kè punë mos përpiqu,
Mos u ngatërro o i mjerë
Gozhdë kâmbës mos i verë.
Një këshillë t'ap më së fundi
Shko u bëj msuës gjëkundi
Se ti s'jè për kësij punë
Këtë shkurt po t'a them unë.

[460] gllava = koka

PONTA DEL GADA[461]

(Azores-Portugal)

Tri ditt e tri nett lundronj mbi Oqeân,
Desh Zoti sôt në tokë shkela,
M'u duk një jet' e tërë, një zamân[462]
Kjo koh', e thashë se po, ngela!

Azores! o oâz në këtë shkretie
PONTA DELGADA, SAN MIGUELLO[463]
Nisì[464] të bukra e shtegje për shtektie
Që me tallas bëni duello.

Ju shof e marr prej jush një ngushëllim,
Një shpresë, si Kollomb' i mjerë
Që mbas kaq det' e valë e thëllim,
Dikur do të shofim dhen' e gjerë.

Kollomb' i gjorë ishte një fatzi,
Nër ato lundra q'i çoj fati,
Se udhëtoj me muaj dhe mezì,
Mbrini në Amerik' i ngrati!

[461] Poezi me shkrim dore nga Kristo Floqi. Ndodhet në AQSH F.429-3-249.1
[462] zamân = epokë, kohë e kaluar
[463] Ponte Delgada = qytet Portugez, kryeqyteti i ishullit San Miguel në Arqipelagun e Azores
[464] nisi = ishull, ujdhesë

Të isha si Kollombi kisha dek
Andaj s'them gjë e ngushëllohem,
Sod me vapor, kabina e dyshek
Nuk është turp të qanj e të ankohem?

Po, prap mejtonj se kam dhe pêsë ditt,
Der sa t'harrinj atjè kû dûa,
Kjo më tmeron, më vret e më topit,
Edhe më ngjethet mish e thûa.

Ah, o e shkreta Amerikë ti,
Sa lark që qënke s'të mejtonja,
Tash po të shof, e kupëtonj, e di
Ty as n'ëndër s'të ëndërova.

I shkret', i ndarë, vetëm, pâ njeri,
Këtë të gjattë rrugë mora,
Ç'kishte me bâa njeriu i shkretë,
Shpresa më mban dhe mû, e jam gatì
T'heq ç'do rrezik në këtë jetë.

Për ty, o Shqypnie mërgohem sôt,
Për ty po shkoj tallaze-mal,
Kush din se si e bën embër ajy Zot
E kthehem prapë dal-nga-dal.

HYMN' I ZOTIT[465]



O Zot' i math i jetës,
Shpëton' Atdhenë t'on,
O drit' e së vërtetës
Mburona nè gjithmon.

Prej tejet Shqypënia
Pret drit' e lulëzim
Prej tejet vjen lumnija
Ti jè për nè gëzim.

Flamurin ti bekona
Të shêjtin arbënor
Fatbardhësin' urona
Ngroh zemrën në krahnor.

Një shpirt të rii Shqypnisë
O Perëndi i fal,
Prej gjumit të robnisë
E ço në jet' e ngjall.

[465] Ndodhet në AQSH F.429-3-350

Ti jè e Kombit shpresa
Shqyptari me ty rron,
E fisit t' tija jè "besa"
Me ty gjith kush e dron

O Zot, të qofshim falë,
Ti doret mos n' a lshô
Për ty s'mjaftojnë fjalë
N'a shih e n'a peshô

Ne ty kemi uzdajë
Të rrojmë në këtë dhè
Dhe dorën ti pa-prajë
O Zot e ngjit mbi nè

NË MEST T'OQEANIT[466] [467]

Fryn e gjëmon me brîtmë ky tufani,
Valët ngrihen si male, si stihi[468],
Buçet më t'katër anët Oqeani,
Tallaz i math, poterë e stuhi.

Qjell nuk shëkon se e përfshijnë retë,
Mjergull kudo e dendur rreth e qark,
Ec tuj lëkundun ky vapor i shkretë,
Lufton me valët me krahnor, me bark.

Tjetër s'dëgjon përveç tallaz' e marrë,
Që ç'do që gjen e fshin e çkatëron,
Kujton gjithkush se kâ përpara varrë,
Kjo frikë kap gjith-kënt e e tmeron

O sa mjerim i math i pa-treguar,
Zembra e shkretë friget, të lëshon,
Lodrë nuk ësht' Oqeani i tërbuar
Që po buçet i egër e s'pushon!

[466] Këtë vjershë e bëra mbasi lâmë "Azores". Tallaz i math, valët ngrihen por si male, vapori kërcet si kur do çahet, një drithmë e tmerr na ka kapë të gjith passaxherve (Shënim i Kristo Floqit).
[467] Ndodhet në AQSH F.429-3-249.1.
[468] Stihi = hije, llamje, kulçedër.

Tufan i rrebt, çpërthyes e çkatrûes
Rëmben ç'të gjejë, e përplas, e flak,
Lundër e ç't'jetë gjithënjë gadhnues,
Fuqin' e madhe s'e ndalon as pak.

Shtektarët e vaporit buzë-plasur,
Aviten shoq me shoq me një dëshprim,
Në thelp të shpirtit tmerin duke pasur,
Shtërngojnë njëri-tjetrin me përdllim.

Ah, jam dhe unë një prej shtekëtarve
Që fati më largoj prej Atdheut t'im,
Që jena kruspull ktu si sogj't e t'marrve
E n'a rref zembra me të math tiktim[469].

Kû di shtëpia jeme ç'po heq unë,
Të dashurit e mij s'i kam, s'i shoh,
Ah, ky tallaz nuk ësht' e vogël pûnë,
Sa vjen rreziku shtohet, po e njoh.

Ah, kur do dukesh o tok' e urûar,
Le të të shoh dhe nj'herë pa të vdes,
Le të shpëtonj prej valëve t'harbuar,
Pra tjetër pasuni' as dua, as pres.

O, o! po tundet ky vapor i shkretë,
Çohet e ûlet s'di deri kû,
Truall i tij përpjet e tatëpjetë
Po ikën prej këmve mija... u bû bû!...

[469] tiktim = n'a bën tik-tik

S'na është mjaft tallazi e potera,
Po që, dhe kapitani po bërtet,
Me zë të ashpër që të çpon si grera,
Alarmë, Alarmë popullit i thret.

Fishllen duduku[470] i vaporit t'ngratë,
Dhe sokëllin tallas e er' e rêe,
Dhe një tjetër vapor i gjerr' i gjatë
Tfaqet mest mjergullit po si rrufe!

S'po shofin njani-tjetrin nga t'ja mbanjë,
Lundrimin seicili e ndalon,
Prorin e njani-tjetrin s'munt t'ja ndanjë
Se mjergulli nuk hiqet, as kalon.

Trishtim i math n'a kap i pa-rëfyer,
Një drithmë funt e krejt n'a depërton,
Të gjithë syt'atjè i kemi kthyer,
Edhè një djers'e ftohtë n'a kullon.

Desh Zoti dhe mbas pakë ne shpëtuam,
Vapori mori ûdhë edhe shkoj,
Vërtet rezikn' e math ne e kaluam.
Por atë çasht të mnershëm s'e harroj[471].

[470] duduk = Pipëz a zamare e bërë me lëvore shelgu (këtu "sirena")
[471] Kjo ish e para herë që e shkoja Oqeanin për me shkûe n'Amerikë, pse mbas ksaj heret edhe 3 herë të tjera e kapërxeva Oqeanin Atllantik (K. Floqi)

MBI KËSHTJELLËN ROZAFAT[472]

Shndrit ti, o hyll' i bukur i Lirisë
O Diell' i flaktë rezet i lsho
Per mbi kështjellat mbarë të Shqypnisë
An' e kant ndritso

Edhe ti Flamur i shêjt' i Arbnisë
Mal' e fushë e ç'do pullas mbulo
Ngjalli, o ngjalli shpnesat e djelmnisë
Kuq' e zi valo!

Asht Bajram i math, a Pashk' e Zotit
Dita e lume, qi n'a shkrepi sot,
Kû të bijt' e Lekës[473], Burrit[474] e Kastriotit
Rkajë derdhin lott?

Jo, s'â Bajram, as Pashk' as Panaire,
Kjo ditë fatbardhë qi leu në Shqypni
Q'u kputne hekra, hallka[475] e sinxhire
Q'u shtyp nji robni!

[472] Kjo poezi e Kristo Floqit është botuar në të përmuajshmen "AGIMI" Nr. 8 Dhetuer 1919
[473] Leka = Aleksandri i Madh
[474] Burri = Pirro i Epirit
[475] Hallka = pranga.

Zêmr' e Shqyptarit sot â tui flakrue
Nji zjarm në gjì po ndijn e nji gazmend
E mizorit' e mdhâ qi kà durue
Tash i sjell nder mend.

Zoqt' e mjerë të Shkabës arbnore
T'arratisun kah Dielli lén e prendon,
Çerdhen e gjejnë të shembun, mizore
Dhe Shkaba i mblon

O Rozafat, kështjell i Shkodrës plakë
Qi i pa-tutun si gjigant qindron,
Kape të lutem ket flamur si flakë,
Kombi t'a dhuron,

Edhe n'a prîj në rrugen e lumnisë
N'a ço prej gjumit t' rând e n'a ngushllo,
Detyren n'a trego të Shqyptarnisë
N'a mso, na kshillo.

Prâjni muzika, kângë e lahuta
Prâjni britme, klithm' e brohorì
Ulni poshtë arm' e pushka e huta
Shtîja[476] e zantrî[477].

Oh, prej kah vjen ky zâ, kjo gjâm e mnershme
Nji kjo stuhî e rrebët si rëmor
Qi po më bjen ner mend kohët e hershme
Në shpirt, në krahnor?

[476] Shtija = shtiza
[477] Zantri = lloj arme

Mos â tallas, apo shperthŷne rêtë
A Qielli mos u çil e bumullon
Dhe si shgjeta kndej lëshon rëfetë
Dhen' e shungullon?

Oh! Zânë ti, goj' artë e qiellore
Zân' e Shqypnisë, qi të ka ardh keq
Ligjrona trimin m' atë zâ madhshtore
Shqypënija heq!

O! qenka vetë Skanderbeu i gjallë
Ky qi buçet kështû e po ligjron,
Edhe sa do që s'ka as shpat' as pallë
Zân' i tij tmeron.

Prejtje nuk ka në vorr as ka pushue
Eshtnat e vorfna edhe s'janë shkrî
Deri sa kjo tokë të jetë librue
Qetë nuk po rî.

Çoji shternipat të Gençit, t'Agronit
Të Teutës, të Bardhylit, burrit të dheut
E djelmt' e Ballçejt t'gjith mbas zakonit
Bijt' e Skanderbeut,

E lidhni gjithë besën e Shqyptarit
Por si vllazen qi jeni shok-me shok
Ket dhé të trashigueme prej së parit
T'a gëzoni tok.

Â marre për burrnî q'u fali Zoti
Të ngelni si të dekun në plogsi
Ju, q'u ka njoftë Shekulli e Moti
Fusha e Malsi,

Sot qi per popujt ka ague dita
E lyp gjith cili njatë shtegn' e vet
Çilni sytë, avrituni kah drita
Koha nuk u pret.

Pshtym' e flak, mjergull, tym e shkndija
Tomori prej Tosknije po flakron
Dhe zân' e tij e çon tu Perendija
Mshirën i kërkon.

"Shkodra Shqyptare ky qytet i vjetër
"Kerthiz' e Kombit që s'u çduk kaq vjet
"Kjo seli' e bukur qi s'ka shoq tjeter
"Shqypes i perket!

"Burra Shkodranë, Shkodrën mos e lini"
Thret, sa shungllon Liqè e Tarabosh
E ndijn dhe Kiri, Bûna e Drini
Burrë, plak, djalosh!

Përpara, burra, bekim paçi Zotin
Dorën njani tjetrit jepni me të shpejt
Rueji mos çnderoni Topejt[478], Kastriotin
Shkodra prej jush pret!

[478] Topejt = familja e Topiajve.

Le t'i nderojmë atà prindët t'onë
Qi nji ket vend n'a lanë si trashgim
Qi me burrni e nder kan rà gjithmonë,
Per nder e shelbim.

Atà me shpata edhe na me penda
Atdhenë t'a pështojmë si përket
Të gjith na Shqyptarët jasht' e mbrenda
Ket, Atdheu po pret!

KONT UGOLINI [479]

D. ALIGHIERI[480]

Kokën[481] lëshoj dhëmbësh, si e breu, e xhvati,
Buzët e përgjakta pas flokëvet fshiu,
Sŷt' i zgurdullovi, por si sŷ lugati,
Tepër ashpër foli mëkatar-fatziu:

"Ç'kam me këtë kokë, që s'po ngjinjem kurrë,
Doni që ta msoni, çashtjen t'ju tregonj?
He, dëgjoni mirë, kjo ku më ka prurë,
Të keqen e madhe që sot ju zbulonj!
Vjete tash e ruanj brenda zembrës s'ime
Plagën e majisur, kobin që më gjet,
Që më coptoj eshtrat me aqe pikllime,
Bolbën e poterën që shpirtin ma vret!
Ç'më punoj i poshtri s'kanë të rëfyer,
Më mundoj, më treti, më dogji, më shoj,
Kjo s'ka ngjarë kurrë, tepër më ka thyer
Ky qên, ky gjakpirës që më përvëloj!
S'pati frigë Zoti, s'pat as një mëshirë,
Shpirtin ky ma fiku, krejt ma shkatëroj,

[479] Botuar në revistën "LEKA" Nr. 4, prill 1937 faqe 162
[480] SHËNIM NGA HENRIK KAÇULINI: Nuk e di nëse këtë poezi K.Floqi e përktheu nga origjinali, apo është një krijim i tij bazuar te "Divina commedia" e Dante Alighierit. ("Ferri", Canto XXXIII), siç bën jo rrallë herë.
[481] Sipas wikipedais, koka është e arqipeshkvit Ruggieri degli Ubaldini, i cili e gënjeu dhe e futi Kontin Ugolino në një kurth për ta arrestuar

Lotët që kam derdhur n'atë burg[482] të pështirë
Kjo bish' e mallkuar, kjo mi shkakëtoj!
Mizoritë q' hoqmë Zoti ja shpërbleftë,
Se s'mjaftojnë mshimet për këtë xhelat,
Ah, vujtjet e mija Zoti trish ja ktheftë,
Si na ka munduar voftë[483] ky lugat"!
"Cilli jé zotrote[484] s'dua ta msonj kurrë,
Si e qysh u ndodhe brenda në këtë Ferr,
Veç dëgjo dhe mbahu, mbahu në jé burrë,
Edhe n'e paç zëmbrën gur, ose mermer!
Fjalët që dëgjova, fjalë Fjorentini
Më duket se janë, s'kam as një dyshim,
Mso, pra, kush jam un.... KONTE UGOLINI,
Qytetar' i mjerë, që vdiq në dëshprim!
Koka që po shifni, q'e brenj i tërbuar
Është koka vetë e njeriut të keq,
E atij RUGJERIT, ipeshkvit mallkuar,
Që prej sijsh nuk ndahem, as dorë nuk heq!
I besova shpirtin këtij arrakati,
Këtij klyshit t'Ferrit, nieriut rrencak,
Gjer sa e psova dhe flî rash' i ngrati,
Në një llom të thellë, në muzg' e batak!
Psè kërkon t'hap gojën, psè më lëndon plagën,
Plagën e tulitur për se ma skëlfit[485],
Që më shtyp krahnorët e që kërkon shpagën,
Pse s'më lé ta shqyhenj, kokën ta zgërmit?

[482] Sipas wikipedias bëhet fjalë për burgun La torre dei Gualandi (Torre della Muda) në Pisa, që më vonë u quajt Torre della Fame (kulla e urisë).
[483] voftë = le të vuaj
[484] sipas wikipedisë është vetë Dante Alighieri
[485] skërfit = gërvisht, lëndoj, gërgas një plagë.

Më gënjeu të mjerin ras'[486] e tij priftnore,
Ras'e tij shêjtë ajo më mashtroj,
Dhe më vrau me vdekjen, vdekjen, më mizore,
Ah, rasën e shkretë kurrë s'e harronj!

Nalt n'atë kështjellë t'errët ç'kam pësuar,
Askush s'e kuptovi, mbet si një problem
Por se ju tanithi kini për ta mësuar,
Atë që më gjeti sot do t'ju a them.
Tani do dëgjoni si ky na ka vrarë,
Si na shoj urijet, gjall' si na mbuloj,
Djemt e mij dhe unë si e gjetmë varrë,
Më dëgjoni pakë se ç'do t'ju zbuloj.

Në atë kështjellë, – që "*kështjell' urije*"
U qojt qysh ahere – ky na pati ndrŷ,
Ku, nga vrim' e vogël një reze shkëndije
Dikur hynte brenda, na binte ndër sŷ.
Prej asaj birruce shumë herë pashë
Hënëzën e zbetë mbushur plot me ré
Dhe kur më zû gjumi dhe në ëndër rashë
Një tmerr më topiti, më ra një rrufé!
Një brengë të keqe shpirti m'ëndëriti,
Dhe më çfaqi fatin, atë fat të zì,
Që ky i mallkuar né na pregatiti
Pa pikë mëshire, pa një dhemshurì!

Pashë nj'ulk që ikte me klyshat e trembur[487],
Që ky tradhtor ndiqte me një shpejtësì,
Dhe mundohej tepër si një bish' e çmendur
Ti shtinte të gjith brenda në pusì;
Me qenj e langorë shumë të drobitur

[486] rasë = Rroba e zezë e gjatë e me mëngë të gjera e të gjata që vesh prifti
[487] Sipas wikipedias, ujqërit ndodheshin në malin San Giuliano.

Brithte! Pas i vijnin do shoq të këqinj,
GUALAND, LANFRANGË, SISMUND[488] të mërzitur,
Gjakpirës të gjithë pleq edhe të rinj.
Ujqtë mjaft u trembën dhe qent' e dopsuar
Mbi 'ta si të marrë turren me furrì,
Copë cop' i bënë ujqit e friksuar
Që s'kishin si mbrohen brenda n'atë vrî[489]!

U zgjuash me nj'herë, – ishte me të gdhirë
Djelmt' e mij të ngratët që i kisha shoq,
Bukë më kërkonin, qanin ishin shtrirë,
Mu fik shpirt e zembër, mu zhurrit, mu doq!
Do të jesh prej guri, granit' a mermeri[490],
Në mos derthsh çurk lotte, në mos qafsh tanì,
Në s'të gufon vaji, brima edhe tmeri
Ah, mendoje mirë ketë tiranì!

Kish kaluar ora, që – si kur se qenvet –
Bukën na e hodhë me të keq qëllim
Dhe një sŷ ngashrimi u drejtova djemvet
Që më kqyrnin gjithë me lott' e pikllim!
Oh, ç'të shoh përpara! .... Ah qyqari unë,
Një krizm' u degjua dhe dera u mbyll,
U mbyll të mos hapej, në nji varr na vunë,

Mbetmë të piskllуar[491], si thika në myll[492]!

---

488 Sipas wikipedias ishin tre familje ghibelline. Ghibellinët ishin mbështetësit e familjes fisnike gjermane Hohenstaufen, që ishin në luftë për pushtet me Guelfët pas vdekjes së perandorit Henrik V më 1125, që mbështesnin bavarezët e saksonët.

489 vrì = bjeshkë, vent malsor i veshun me shelgjë, plok

490 Sipas wikipedias, Konti Ugolini akuzon Danten që është shumë mizor që nuk qan nga ky tregim

491 piskllуar = në gjëndje të vështirë e pa rrugdalje, të zënë pisk.

492 myll = kapëza e thikës, hanxharit, por edhe kllëfi i thikës.

Çelsat e kështjellës përtej i flakruan,
Tej, në lumin ARNO për më sigurì,
Dhe kështu, si minjtë, gjalltas na varruan,
Na u pré çdo shpresë, gjaku na pat ngrî!
Në fyt më ngel fjala, lotët mu shteruan,
Asht[493]' e mish mu ngjethnë, s'dinja nga t'ja mbanj
Djelmt' e mij të ngratët gjith' u dëshpëruan,
Dhe vet' u ngurosa, s'mundja as të qanj!
Javo[494] ANSELMINI hap gojën e thotë:
"Babë, pse mendohesh? Thueja ç'na gjet?"
Por, mjerisht, përgjigjen e priste të kottë,
Mu klyç goja, heshta, gjë për nè nuk mbet!
E gjith' ajo natë shkoj me psherëtime,
Gjer sa zbardhi Qielli, gjer sa dita agoj,
Dhe kur Dielli shkrepi, gjëma, ulërimi
Burgun e tronditnë, vaj i math gjëmoj!
Vezhgëllonj të katër djelmt' e mij të dashur
Edhe një shigjetë zembrën ma përshkoj,
Djersët më mbuluan dhe me shpirtin plasur
Duart po kafshonja, pika më pikoj!
Djelmt' e mij aherë: "Thona, babë, thona,"
Më bërtisnin gjithë "babë, mos pshertì,
Ç'pret? Therna të gjithë, haj nga trupat tona,
Jetën që na fale merre prapë ti!
Jemi mê të lumtur, kur ti të jesh mirë,
Jeta nuk na duhet, s'na dhimbet as pak,
Dëshrojmë vdekjen sa të t'shofim shtrirë,
Të zbet' e të ftohtë, pa një pikë gjak!"
Vehten e përmbajta mos t'i dëshpëronja,

[493] asht = kockë, eshtra, rrashti, kokadha, rrokulla.
[494] Javo = Që, ja ku, në atë kohë, ahere, befas, pa pritur.

Gojën e klyçita, nuku fola gjë,
Ç'do hidhrim gëlltita, ç'do ankth e duronja,
Heshta, u nemita, nuku nxora zë!
Po ditën e katërt?... Zot ç'panë sŷtë!....
Në gjunjët e mija mu shtrî djal i rì,
Djal' i vyer, GADDUA, djali jem i dytë,
Rëzohet i vdekur, u tret si qirì!
Dhe ditët e tjera gjith ata që mbetnë
Një pas tjetrit ranë, ah, më shkuan kot
Vdekjen aq' mizore prej këtij e gjetnë,
Ngela un' i shkreti në vaj e në lot!
Mbet i shurdhë burgu!... Djelmt' e mij kërkonja
Zëth' i ëmbl' i tyne për mua pushoj,
Qanja e s'pushonja, kufomat lëmonja,
Ç'e deshnja më jetën kur shpresa perëndoj?....

....Mbaroj mëkatari dhe i zgurdulluar
Kokën rëmben prapë, me tërbim e xhvat,
Dhëmbët ja ngul thellë si qên i tërbuar
Dhe s'nginjet së ngrëni, ha si një lugat!

NË TË NGRYSURIT E JETËS[495]

Ikim dal – dal nga dale, po e ngrysim jetën,
Ah, si shkojnë vjetet, moti si kaloj,
Tani sŷt' e mija shohin të vërtetën,
Ëndrat që u zhduknë, fundin që afroj!

Vërtet kalon moti, apo né vrapojmë?
Si rrodhi kjo jetë e s'kuptuam psé?
Lindmë që të vdesim e me kaq mbarojmë,
Nesër të mos jemi, veç pluhûr e dhé?

Oh, sa të gabuar qënkemi të mjerët,
Shtymë dita-ditën, kohën që na lé,
Mbshtillet lëmsh' i shkretë, mbetemi më terrët,
Na korr kos' e vdekjes, ah, të ngratët né!

Në vlugun e moshës qeshnim e dëfrenim,
Koha ishte mjaltë, jeta një blerim,
Gjë s'mendonim mbrapa, vehten e gënjenim,
Pleqëri s'kujtonim, vujtje, a mjerim!

Shkuan këng' e valle, lodra dashurije,
Gjith' ato dëfrime, ato bukurí,
Lule, trëndafile, ëndra djalërije,
Shkuan e mê s'vinë, shkoj ajo lumrí!

[495] Poezi e Kristo Floqit botuar në gazetën "Drita", 1937, Nr. 52, 31 janar faqe 4.

Flytyruan, iknë, që të gjitha vanë,
Né n'a lanë prapa, nuk i shohim mê,
U tretnë si vesa, si lulet u thanë,
U ngrys, arriu nata, jeta s'qënka gjê!

Oh, për sê të ndodhen netë plot mystere,
Nettë magjistare, mbushur me lumrí,
Vajza bukuroshe, burbuqe Pranvere,
Që të dehnin shpirtin, kur jé djal i ri?

Jemi plënk i tepërt, jemi rëndësirë,
N'a u mërzit jêta, rrojtja s'na pëlqen,
Po dhe që të vdesim, prapë s'na vjen mirë,
As në torbë s'hyjmë, as në thes s'n'a gjen!

Në dëshprim e sipër vdekjen e kujtojmë,
Si kur do na çlothte nga ky kob' i zî,
Por se prapë mëndje qint për qint ndryshojmë,
Sa dhe né s'e dijmë, s'kemi terezí!

Psé na tmeron vdekja? Psé kemi dyshime?
Psé njeriu t'i trembet? Plaku psé e dron?
Nuk ka jetë tjetër, të tjera gëzime?
Kjo ish rrojtja jonë? Gjer këtu mbaron?

Sikur të fillonim të rronim dhe nj'herë,
Do t'ja dijim vleftën asaj jetës s'ré?
E themi, po prapë do t'ishim të mjerë,
Jeta s'ka të ngjinjur, prapë né se né!

Kështu qënka jeta, s'paska funt e krye,
Një mashtrim, një rrenë, gjithë sa kaloj,
Dhe kush mbet kënaqur, e kush u dëfrye
S'ka se psé të mburret, se as gjë s'fitoj!

Kot rrî e mendohem, nuk e gjenj dot kurrë,
Për sé, vall' u lindmë? A ka një qellim?
Rritesh, bëhesh djalë edhé pastaj burrë
Edhe në funt mplakesh e vdes me pikllim?

Psé të rrosh me shpresë mos nesër mê mirë,
Ditë mê të lume do shkrepin për ty,
Dhe në shtrat të vdekjes, ku ndodhesh i shtrirë,
Edh' atjé ké shpresë, gjer të mbyllësh sŷ?

Ç'ësht' edhé ky moti që ngryset e gdhihet,
Vera plot me lule, dimri dbor' e shî! ....
Që kur ka filluar? Fundi a i dihet?
Ku ishim? Ku jemi? Ku shkojmë tashi?

Jo, jo! Moti s'ndahet, gjithë kështu ka qënë,
Né e kemi ndarë në stina, në dit,
Ajy me né tallet, né s'ja ndjejmë zënë
Lodrën s'e kuptojmë, që na lot për vit!

Né i shkojmë sipër motit kurdoherë,
Uj' i tij i valë, trupin na përvlon,
Rrudhesh, tretesh, thahesh edhé vdes i mjerë,
Dhe një dit' harrohesh, balta të mbulon!

Kush vdiq e u kthye që të na shpjegonte
Në ka jetë tjetër, Parais' a Ferr,
Ku kullosin shpirtrat të na siguronte,
Të paktën t'a dijnim, mos rrijnim në terr?

Jeta qënka nj'ëndër, gjer sa njeriu zgjohet,
Dhe kur vdes ahere e merr vesht që rron,
Po dhe në mos qëntë duhet të pranohet,
Ndryshe kjo problemë s'ka se qysh mbaron!

ANKIM I QIPARIZIT [496]

Te Buda i math u qah një dit krenari qiparisi,
Për se s'ka fatin edhe ky, sikur se pati lisi,
Pse e dënoj që shoqëri të vdekurve t'u jetë,
Pse lisn' e mbolli për mbi mal, këtë e la të qetë?
Lisit për se i dha liri dhe erë kaq të mirë
Dhe qiparisin e dënoj të rrojë në shkrettirë?
Ajy të ndjejë nat' e ditë bilbila e ligjrime,
Ky të dëgjojë gjithënjë vaj, lotte e pikllime?
Dhe Buda qeshi e i tha: S'më thua i begatë,
Kush do t'u mbajë hijeshim të vdekurve të ngratë?
Gjethet e lisit nuk i sheh si fishken e rëzohen,
E flett e tu gjelbrojnë krejt gjithnjë çelin, krekohen?
Lisin shigjetat e rrufês' e djegin e dërmojnë,
Por ty s'të nget as er' as gjë, qetsinë s'ta trazojnë!
Lisit të mjerë një tufan ja shtron për dhè ç'do fletë,
E ty s'të tremp as një stuhì, kryet e kè përpjetë!
Qahesh për lisin, që e sheh sè po qëndron i dlirë,
Dhe nuk mejton se fati yt është prej tij mê i mirë?
Apo nuk sheh me ç'bukurì ty shtatin ta stolisa?
Të kesh pak turp kur flet ashtu, kur lisin s'e pajisa!
Kështu tha Buda dhe një sy i hodhi qiparisit,
Dhe ky u tremp, kryet e ul, u mek përpara prîjsit!
Heshti, pushoj, mbet për gjithnjë i varreve rojtari,
Dhe qysh ahere, kur sheh lis e vret cmiri, nakari!

[496] Kjo është poezia e fundit që kam gjetur të botuar nga Kristo Floqi, botuar në revistën "Njeriu" Nr. 11 viti 1943, f.6. (H.K)

DY SHPIRTRA ZIHEN[497]

Të zhytura mu në skëterë
Dy shpirtra ziheshin një ditë,
Shamatë bënin e poterë
Puna u zgjat, u kacambit!

Njëri nga shpirtrat ish i pasur
Tjetri i varfër, një harbut[498],
Që rinte pîjtas, buzë-plasur,
Kur se i pari qe nj'hajdut!
Harbuti i shkretë ish i urtë,
Kusari fort harbutn' e nget,
Pse ish i ashpërt, zemër-gurtë,
Harbutit shumë rënd' i flet:

Ti s'je si mua, s'munt të mburresh,
Unë kam qënë pasanik,
Ti s'kishe as një morr të kruhesh,
Në xhep s'të gjen as metalik!
Kur vdiqa unë më mbuluan
Me një shkëlqim, salltanet
Po ty pa hoxhë të varruan,
Si një evgjit, si një lanet!

[497] Poezi nga Kristo Floqi botuar në gazetën "Njeriu" 1943, Nr.9, faqe 5
[498] harbut = njeri i pagdhendur (njëri nga kuptimet e kësaj fjale)

Kujton se do vesh në parajsë,
Kështu me raqe si zhelan,
Ti, që nga paret ishe drasë,
Hiqu të mbytesh, mor hajvan.

Po dhe harbuti nuk ja mbajti,
Kusarit t'qelbur ju vërtit,
I foli djathtas e së majti
Hajdutit që po llomotit:

"Ti syt' e Zotit s'i sheh kurrë,
Ditë të bardha s'do ngjerosh,
Këtu kusar, shpirt-zi e urrë,
Do dergjesh brenda sa të rrosh!
Të rrofshin paret që fitove,
Duke i vjedhur si kusar,
More gjë pas? A i gëzove?
S'të kam zili, s'të kam nakar!
Unë vërtet jam i vobektë,
Por jam i ndershm' jo faqe-zi
Mëkati ty gjithmonë të ndjektë,
S'le gjë pa bër' faqe-zi!
Këtu ku jemi s'ke ç'të thuash,
Nxir sa të muntsh gëlbaza, vrer,
Ato që bëre do t'i vuash,
Se ty as djalli nuk të merr!"

ËSHTË I PAVDEKUR SHPIRTI?[499]

Platôn, thua të drejtën, kur bën për shpirtin fjalë,
Se Perëndija vetë, me shpirtin t'onë flet,
Se shpirti kur nesh ndahet, nga trupi kur të dalë,
Prap' i pavdekur mbetet? Kështu është vërtet?
Filozofija jote, e nalt' e pasuruar
Rreth shekujve t'pafundtë si një magnit me heq
Dhe fantazinë t'ime, që ësht' e paduruar,
Në Qiejtë nalt përpjetë ma çon e ma tërheq!
Vargonjtë që më lidhin në jetën e përkohshme
Dua t'i thyenj gjithë, ç'do sent që më vjegon,
Dhe pranë Perëndisë me krahë të palodhshme
Dua të shkonj t'afrohem, zembra fort ma dishron!
Në jetën e pasosur, që s'ka as funt as krye,
Aty dua të gjendem, të çlodhem, të dëfrenj,
Të shoh madhnit' e Zotit krijesat që ka krye
Një jetë krejt të ndryshme brenda n'ato të gjenj!
O Dritë, o Djell' i zjartë, o Qiej, o Hapsirë,
O Naltësi pa anë, që syri im s't'harrin,
O Natë, o Hën' e zbetë, o Hyj, o Erësirë,
Që kur vall' u krijuat? Kush ju përmban, ju prîn?
Po ç'them? Për se habitem, ku jam e ku kam qënë,
Ku shkonj, ç'rrugë kam marrë, ku jam tani, ku rrî,
Ku vete, nga kam ardhun, këtu kush më ka lënë,
Ku nesër do të gjendem a ma tregon njeri?

[499] Poezi e Kristo Floqit botuar në revistën "Njeriu", 1943, Nr. 10, f. 4.

Që nga jam i tërhequr? Në Botën si u gjinda?
Ku do më çojë vdekja, në ç'gjî po më lëshon?
Për ç'qëllim u krijova e për ç'qëllim u linda,
Kjo diturî, kjo mëndje më tutje a vazhdon?
Ç'më pregatitet nesër dua ta di dhe vetë,
Ta flê, të paktën, mëndjen, dyshimin ta largonj,
Mos rronj gjithnjë në frikë, i trembur, i paqettë,
Të drejtën vlla është për se të mos e msonj?
Platôn! Në jè i bindur se shpirti rron për jetë,
N'e kè kuptuar hollë se ka një Perëndî,
Një jetë t'amshuar si posht' edhe përpjetë,
Pse s'e shpjegove mirë me shëmblla që t'a di?
Në ka, pas mëndjes s'ate, një Zot në Botën mbarë,
Krijuës e sunduës dhe prijës, kujdestar,
Ky Zot duhet të jetë i urt' e jo i marrë,
I drejtë e i dhemshur dhe për ç'do mëkatar!
Në qoftë se e Zotit e vogël një krijesë,
Platôn, jam edhe unë, për se më lè të heq,
Të dergjem e të vuanj, i mjerë e pa shpresë,
Të duket kjo e drejtë? Vërejtjen s'ta tërheq?
Njëri të hajë mirë dhe në mëndafsh të flerë,
Të rrojë fort i lumtur me kamj' e pasuri,
Dhe tjetri një kafshatë në gojë të mos shtjerë,
Të vdesë prej urije, pa strehë, pa njerì?
Platôn, a jè i drejtë? E kè gjykuar mirë
Ky Zoti të këqinjtë për se nuk i dënon?
Të drejtët e të mirët psè s'gjejnë' as një mëshirë?
Këto në cilën Bot' Perëndija i gjykon?

O e vërtetë q'humbe, që s'kè shpresë shpëtimi,
Dritën t'a zu gënjeshtra, ti s'kè një vleftë sot,
Se vleftën e ka rrena, e keqja e mashtrimi,
Ku jè o moj e ngratë, që nuk po të gjenj dot?
Mê mirë lè të dalim nga kjo qelì e shkretë,
Prej ktij burgu të ngushtë, ku shpirti po rënkon,
Të flutrojmë lirë e të shetisim lehtë,
Në jetën e pasosur, ku gjë nuk na mungon,
Atjè ku s'ka vent cmiri, ahmarrja e e keqja,
Ku mbretëron e drejta, ku nuk dëgjon ankim,
Ku nuk ka duk lakmija, ku nuk të tremp as vdekja
Atjè flutrò e ikë dhe ti, o shpirti im[500]!

[500] Kjo është poezia e parafundit që unë kam gjetur të botuar nga Kristo Floqi. Kjo poezi është botuar kur autori i saj ishte në moshën 71 vjeçare. Ai ndjen se po i afrohej vdekja dhe shpreh dëshirën dhe lumturinë që shpirti i tij do shkojë në Mbretërinë e të Barabartëve dhe të të drejtëve (8 vargjet e fundit), por është shumë i dëshpëruar për Shqipërinë, që ai e donte aq shumë, e cila kishte marrë rrugën e së keqes. Ashtu si Krishti Biblik, edhe Kristo Floqi në këtë vjershë ia dorëzon shpirtin e tij Perëndisë.

POETI DYKE VDEKUR [501]

CHARLES MILLEVOE

Përpara një kandili poeti po vajtonte
Jetën e tij mizore me një të vajshëm zë,
Kandili po klejitte, iskrat[502] e tij lëshonte,
Drita nga dal po shuhej, se vaj nuk kishte më!...

"Lulet, ah, mu venitnë, mu fishknë e m'u thanë,
Njëra pas tjetrës bijen, fletë as një nuk mbet,
Të ritë t'em, kjo jetë u zhduknë edhé vanë,
Ah, si e ngrysa kohën, të mjerin se ç'më gjet!
Arrivi nat' e shkretë dhe gjumi më afrohet,
Gjumi i rënd' i vdekjes në portë më trokllet,
Të vojturat mbarojnë, ky shpirt do të qetsohet,
Kush e di se ku do gdhihem dhe nesër kush më pret!
Thyju ti, o moj lyrë, lyra ime zanore,
Që kaqe të kam dashur e nuk të ndanja dot,
Se zëthin tënt të ëmbël, o lyra tingëllore
Nuk e dëgjonj më kurrë, ah do ta qanj me lot!
Në varrin t'em të ftohtë të gjitha do mbulohen,
Me mua do të vdesë dhe shpirti poetik.

[501] Botuar në revistën e përmuajshme shpirtnore kulturore "NJERIU" Nr. 2, Gusht 1943, f. 10.
[502] iskra = shkëndija

Të gjitha do humbasin, të gjitha do harrohen,
E shkreta jetë ikën me vrap e me vërtik!
Vraponi ju, o shokë, t'ju shoh edhé një herë,
Brenda në kto krahrorë dhe nj'herë t'ju shtërngonj,
Dhe mëmën e përzishme, që po e lé të mjerë,
Ta ngushëlloni, shokë ju lutem, ju përgjronj!"

.... Kështu foli vjershtori, pushoj mê s'u dëgjua,
U shtri mbi shtratn' e vdekjes, ju prè fuqi e zê,
Kandili me një herë u fik, drita ju shua,
Dhe lyr' e tij fatkeqe u thye, cop' u bë!...

VALA DHE HIJA [503]

Sipas VIKTOR HYGO, "LES MISERABLES"

Një njeri shkau, râ në det,
Por anija ecën, s'ndalet,
Lundron, ikën, ngutet, s'pret
I çan valët vark si malet;
Se psè râ njeriu në det
Do të ndaleshe anija?
Ajo mban rrugën e vet,
S'i prish punë, nuk râ zija!

Breth anija, po udhton,
Ikën shduket dal-nga dalë,
Dhe i mbyturi lufton,
Me tallaze e me valë!
Thret, bërtet po kush dëgjon?
Kërkon ndihmë, ah i ngrati,
Zembr' e tij vuan, rënkon,
Oh, i mjeri se ç'fat pati!

Herë zhytet, herë del
Mbi tallazin e harbuar,
Herë vala e përkdhel,
Her' e kryth të deshpëruar!

[503] Poezi nga Kristo Floqi botuar në revistën "Njeriu" viti 1943 nr. 8, f. 6.

Duart lart në Qjell i ngreh,
Po mjerisht kush ja vè veshin,
Shoqt' e shohin, ky i sheh,
Po për të njeri s'jep peshin[504]

Mjerë, mjer' i ziu njeri,
Kryet mezi q'i dallohet,
S'ka fuqi, as ka trimri,
Kot përpiqet, kot mundohet!
Tash anija s'duket mê,
As katart[505], as vel' i shihet,
Nata vjen, s'dëgjohet zè,
Veç se val' e egër ndihet!

* * *

Si një fandazmë shduket anija,
Gjithë largohet, vijën s'e ndron,
Dhe kapitani, tajfa[506], njerzija,
S'e çajnë kryet psè njeriu shkon!
Mos nuku ishte dhe ky i gjori
Me ata bashkë, të gjithë tok,
Psè tani fati ndër këmb' e mori,
Psè e ndau syresh, nuk ishte shok?

Pakëz mê parë dhe ky fjalonte,
M'ata ish bashkë për mbi aní
M'ata shetitte, lirí ngjeronte,
Po ah, të shkretin ç'e gjet tanì!

[504] s'jep peshin = nuk paguan, nuk i jep rëndësi,nuk çan kokën.
[505] Katart = albero, dru i gjatë e i drejtë që vendoset në anije për të mbajtur velat.
[506] tajfa = ekuipazhi

Tani me valët lufton i mjeri,
Ju prenë krahët, ç'do shpres' e lâ,
E kapi frika, e zuri tmerri,
Për gjithëmonë shokësh u ndâ!

Humbi i gjori, humbi ç'do shpresë,
S'ka ku të mbshtetet, deti s'ka funt,
U loth e s'mbahet, s'munt as të thresë,
Perndoj gjith shpresa, s'e sheh gjëkunt!
Këmbët e tija mbshtetje nuk gjejnë,
Noton, po valët s'i lenë shtek,
Njëra pas tjetrës e rëkëllejnë,
Nuk sheh më tokë, as zall, as brek!

Poshtë po shtrihet një natë sterrë,
Një napë e zezë, një errësí,
Ku të qëndrojë? Ç'drasë të zerë,
Që e përfshiu vala dhe deti i zí?
Kërkon të mbrohet, por s'ka ku mbahet,
Ju prè fuqija, mê s'qëndron dot,
I ngrivi gjaku, goja i thahet,
Duart s'i bëjnë, këmbët s'i lot!

Orën e fundit i ziu bërtiti,
Shpirtin t'a japë është gatì,
Valës, hapêsirës ju lut e thiri,
Zoti ku është? A ka Perndì?
E lshon zembra, vdekja ja mbrini,
Zhytet, fundoset, thellë po shkon,
Varr' i tij deti, Qjelli qefini,
Jeta mizore kështu mbaron!

O ti, që quhesh SHOQRI NJERZORE,
Ti s'kè mëshirë për një që heq,
E lè të mjerë, e lè të gjorë,
E ndan prej gjirit, qysh s'të vjen keq?
Sa njerës vallë prej teje presin,
Por ti u shmangesh, nuk i vè rè,
I lè të shuhen, i lè të vdesin,
Shtrigë, kulçedër, llamje[507] jè?

[507] llamje = bish e egër, kuçedër

DRINIT TË ZI [508]

Për librezën e të I-it Kuvent Kombëtar Kullturor

A ka vënt më të bukur e t'hijshëm,
Se nj'aj vënt ku ti del e mburron,
A ka kënt më të ëndshëm e të hijshëm
Se nj'aj kënt që të mbron?

N'atë prehrin e bregut plot hije,
Q'e rrethojnë shelgjishta për qark,
Ku mezi rezet Djelli i shtije,
Ti na çfaq cok një park!

Uji jyt, aq' i ftoht' i kulluar,
Shkon me vrul, si një trim kordhëtar,
Ngjyrë-blertë, llagar, i praruar,
Si kristall, qehlibar,

Ku përfundi leshteriket[509] dallohen,
Që lëvizin me një bukuri,
Si qilima që ndehen e shtrohen
Plot me art e mjeshtri.

[508] Marrë nga AQSH., Fondi 429-7-001, material i daktilografuar.
[509] leshterikë quhen ato bimët që mbijnë në fund të liqenit.

Dhe formon dy të vegjël liqenë
Që të k'ënda t'i kqyrsh e t'i shohsh,
Si dy sterna[510], të thellë legenë
Që me lundra ti shkosh.

Kull' e nalt' e atij Shënt-Naumi,
Dit' e natë të sheh, të përgjon,
Kur ti shtrin rrotull tij vala-lumi,
Që prej gjirit lëshon.

N'ato sheshe të këndshme, magjike,
Do të shtrihem, do rri, do qendronj,
N'atë heshtje prallor' e mystike
Do të thres, do këndonj.

Do këndonj bukuritë hyjnore,
Do ligjronj panoramën që kè,
Vrit' e hijet e kodrat gjelbrrore
Që mbi 'to tjetër s'vè!

Rrugën t'ënde të gjatë pa marrë,
Ti përbën afër teje një vrell,
Po ç'farë vrelli, që kurrë s'kam parë,
Që shkreptin e të kndjell

Kur sheh lekat për fundi që shndritin
Që shtektarët të falin, o Drîn,
Si brillande shkëndija të qitin,
Kjo më ngjall, më përtrin.

[510] sternë = Depo e gërmuar në tokë për të mbledhur dhe ruajtur ujin e shiut

Pranë teje i gjat' e i gjerë
Shtrihet qetas liqen' i Ohrìs,
Q'i sheh fundin të thell' e plot rërë
Ktij liqenit Shqipris!

Vetëm ti ja trazon, po, qetsinë
M'atë hov që mbi të e lëshon,
Q'e përçan si tufân, shakullinë,
Kur shbërthen e gjëmon!

E kalon me rëmbim nj'atë rrugë,
Pa u ndalur, pa bër' as një bryll,
Gjer sa prek nj'atë të bukurën Strugë
Si një nuse, një hyll!

O Perëndeshë, o Muza goj-artë,
Që po ndehesh si flutur kur shkon,
Më ligjro m'atë zërin e zjartë
Këtë Drîn q'e shëkon,

Nënë Hënën e plott' e të zbetë,
Në kanalin ku breth e kalon,
Që Parajsë përbën të vërtetë
Kur belbron e valon!

Në pushimin e natës të thellë,
Ah, ç'dëfrim e zbavitje që ndjenj,
Të shetit, të shoh Hyjet e Qjellë
Që në jetë s'i gjenj!

Ç'do të thot' ajo ecje nga dalë,
Pështpëritjet që rrjedhja tregon,
Që s'përshkruhet me pên' as fjalë
Ky myster që vazhdon?

Edhè ecën në shtratin e bukur,
Dyke lagur Veleshin Shqiptar,
Vala jote, kaskadet e dukur
Shkumbëzojnë si ar!

Shko e piqu me Dibrën luâne
O symbol i vërtet'i Arbris,
Që bashkon këta vende vigâne
Të Toskris e Gegris,

Dhe me Drinin e bardhë takuar,
Derdhi tutje ku Buna valon,
Tok me 'të si dy shoq të vllazruar
Det' i kalltërt ju fton.

Drin, o Drin, ti o lumi i rallë,
Sa kujtime të ëmbla na jep,
Se fatosin e math e të gjallë
Ti e pè kur s'u ep.

Kur luftonte me trimat Shqyptarë
Bishat t'egra, Çagatët[511] armiq,
Kur krastitte nj'ata pashallarë
Ata turqit e liq!

[511] Çagat - ushtar i Perandorisë Osmane (gjuha çagate është paraardhëse e gjuhës turke të sotme)

Sa betêja që pa kjo luginë
Që u lye me gjakun armik
Që shpëtoj an' e kant Shqipërinë,
Q'i largoj ç'do rrezik!

Ty, stërgjyshët e t'onët të parë
T'adhuruan me droj' e me nder
Gjithë Lekët[512] e burrat Shqiptarë
Q'ishin flagë e tmerr.

Po të falem, O Drîn i bekuar,
Shpres'e Kombit, e gjithë Atdheut,
Qofsh për jetë symbol i shêjtruar,
I atij Skënderbeut!

[512] Lekët = malësorë sidomos të Shqipërisë së Veriut

PËRMBAJTJA

Në vend të hyrjes 3
S'ime bije, Teftës 5
S'ime bije, Shpresës 8
Shpirtit s'im' mëje 10
PJESA E PARË - SHKËNDIJA 13
Flamûri jonë 19
Indipendenca jonë 21
Ushtari i rì 23
Pranvera 26
Liqeni i Ohrisë 29
Xgjohu djalë 31
I verbri 33
Ndero prindët 36
Duaj Atdhenë 37
Lavdi e Zotit 38
Marsh triomfan 39
Dallëndyshja 41
Natë e qetë 43
Tomori 45
Pŷlli i gjelbëruar 50
Qelì e varfër 52
Teqêja 53
Lark nga i keqi 55

Nekrologji 57
Vëllazëria 61
Lindja e Diellit 62
Luleshitseja 64
Stinët e Motit 65
Hymnë Kombëtar 71
Kënga e Ushtarit 74
Bretkosi e Kau 76
Njeriu i gënjyer 78
Plepi e Kallmi 80
Shpresa e detarit 82
Një mëngjes Pranvere 83
Maji 85
Gjahu 86
I marri e i piri 88
Shkaba dhe korbi 90
Dija e padija 92
Për mbi detin e qetë 96
Mburimi i Çardhakut 98
Aht-Marrja 102
Sami bé Frashërit 103
Tallazi e Detari 105
Dervishi 106
Oshenari 110
Ora 117
Zëri i Atdheut 119

Qyqeja....121
Gjahtorët....124
Arth Pranvera....129
I dënuari....130
Valo Flamûr!....134
Hymni i Djelmnis....136
Dielli perëndoj....138
Kënga e Ushtarit....140
Mëshira e Zotit....142
Kaposhi dhe Brillandi....165
Ujku dhe lejleku....167
I pandehuri shent....169
Gjahtori dhe Dragoj....171
Gomari dhe Kali....173
Bonjaku....175
Dhelpra dhe Shtërgu....177
Rrëkêja dhe Lumi....179
Të dy miqtë dhe ariu....181
I marri e i urti....184
Këshilla për djelmët....186
I bukuri Maj....189
Furtuna....190
Palloj e bilbili....193
28 Nëntor 1912....197
Djali dhe Zogu....201
Kënga e bonjakëve....209

Pullumbi e Thneglla 211
Dhelpra e Sqapi.....217
Dragoj i plakur 220
E vehja edhè shërbëtoret.....222
Gomari dhe të zotrit e tij.....223
Larëska me pêndë palloj 227
Dhelpra, majmuni e shtâzat 229
Ndreu dhe vreshti.....232
Ljepuri e Thëllëza 234
Luâni në luftë 236
Mushka dhe prindët e saj 238
Spiro Bellkamenit.....240
Papakristo Negovanit 242
Kapitan Kamber Ibrahimit 245
Hakki Glinës.....247
Ceno Sharrës.....249
Themistokli Gërmenjit 251
Meleq Frashërit 255
Mustafa Qullit 258
Çerçis Topullit.....260
Bab-Dudë Karbunarës.....262
`Kollonelit Hollandas Tomson.....266
I dergjuni.....269
Përpara 272
E bukura Pranverë.....274
Ujku dhe Gomari 278

Babaj me djemtë 281
Mos i rrihni kafshët 283
Do që të të duan? 285
PJESA E DYTË - TINGËLLIMET E ZEMBRËS..... 287
KËNGË DASHURIJE 291
Flutura Korçare 293
Një virgjireshe 295
Prej teje i ngjeronj 296
Zëmbaku, trëndafili dhe ti 297
Asaj 298
Lundra na pret 299
Ngrehu nga gjumi 301
Thuaj asaj 302
Ti s'ke mëshirë! 303
Pse kaqë ftohtësi? 304
Kurrë s'të harronj 306
Virgjireshës krenare 307
Mallkim 308
Hir' e fundit 309
Oh sa bukur këndon 310
Anës zallit 312
Ti s'jè për mua! 313
Syt' e tu të kaltërt 315
Thëllëzës mitare 316
Pyet në të dua? 317
Nastija 318

Jeta mê e lumur 319
Të parat 321
Pleqërija 322
Mos e beso! 324
Levarashja 326
Ah, fjalët s'ť'i harronj 328
Llahuta ime dhe ti 330
Hijes s'asaj 331
Kujtim i vogjëlisë 332
Del pakë në dritare 335
Haj këtu me mua 336
Nuk je ti? 338
A e mban mënt? 339
Dremit o engjëll 341
Dëshpërimi 342
Mos harrò 344
Ngushëllimi 345
Hylli dhe ti 347
Pse po qan? 348
Shkumbinit 350
Gjer sa të vdes 352
Ah, kijmë pak ndër mënt! 354
Eja, eja! 355
S'ndahem teje! 358
Pse të njoha? 359
Dashuri e Atdhè 360

Si ty tjetër s'ka 362
Bilbili dhe ti 364
Desha të di 366
Beqari....368
Edhè të dua!....369
Ngjalle shpirtin tim! 371
Ankthi....372
Largimi....374
Më dolle e pa besë 375
Dashuri e parë....376
Si kur të deshe! 378
Plagën m'a lëndon 379
Të lè shëndenë!....380
Atë natë s'e harronj....381
Pse m'u zembrove?....383
KËNGË BLEGTORE....387
Vajza e bariut....389
Baresha e mitur 391
E bukura e fshatit....395
Pse moj malësore?....398
Haj me mua, se të dua....400
Eja bareshë....402
Tanga e shtërparit....404
DY DËSHIRA 405
Një natë në Venetik 407
Një natë mysterioze....409

SATIRIKE....411
Vallja e fundit....413
Merrushja....415
Nxënëses bukuroshe....416
Dita e parë e Prillit....417
Të Penguarit....418
Jo, jo, jo!....419
Asaj që gjithë qeshte....420
E puthura e fundit....421
Thesari – thengjill....422
Më kryqëzove si Krishtin!....423
Asaj që ka gjakun e ftohtë....424
Dëgjo se ç'flasin bota!....424
Dëgjo vetëm dy fjalë....424
Me mjete adhurimi....425
Prapa grillavet....426
Goca e mitur....427
Ajo që gjithë puth!....428
Së voglës....428
Së miturës....428
Midis dy dashurive....429
Hyjet dhe sytë....430
Gabova!....430
Një kamarjere....431
Kontrollimi i gruas....431
Perënditë flenë....432

Maji 433
Një kopraci 434
Një rrenacaku 435
Çilësitë e së vehsë 435
Një vjehre kandidate 436
Atij, që s'e paguan dhëmbtarin 436
Çupa plakë 437
Topi i qiraxhiut 437
Të dy zalitë 438
Në daç qëndro! 439
Të gjitha të kota! 439
Martesa e pleqvet 439
Një gruaje llafazane 440
Një mjeku ushtarak 440
Adhamit 441
Një muzikanti të ri 441
BAKHIKE 443
Nuk dehem mê 445
Deti – verë 446
Sarahoshi 448
Mos rij hesëll 450
I dehuri filosof 451
Dëshira e të pirit 453
Endra e pianikut 454
Pijaneci 456
Varele bukurosh 458

Plloska rrumbullake 459

PJESA E TRETË - Poezi origjinale të Kristo Floqit dhe poezi të përkthyera prej tij, të mbledhura andej e këtej nga Henrik Kaçulini 461

DËSHIR' E VËRTETË E SHQIPËTARËVET - prej Naim Be Frashërit 463

Mbi ardhjen e eshtrave të Naim Frashërit.....486

Kushtim – Dedikuar At' Gjergj Fishtës.....489

Mikut të vlertë dom Ndré Mjedës mbi shtatëdhetë vjetshorin e tij.....495

Dy lottë mbi varrin e Kostantin Kristoforidhit.....497

Aqif Pashë Elbasanit.....499

Z-ës Margë Pozio 501

Salih Nivicës 503

Ponta del Gada.....511

Hymn' i Zotit.....513

Mbi kështjellën Rozafat.....518

Kont Ugolini 523

Në të ngrysurit e jetës 529

Ankim i qiparizit.....532

Dy shpirtra zihen 533

Është i pavdekur shpirti?.....535

Poeti dyke vdekur 538

Vala dhe hija 540

Drinit të Zi 544

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Floqi, Kristo
"Shkëndija": (antologji shkollore); "Tingëllimet e zembrës": poezi të Kristo Floqit të mbledhura andej-këndej: album me poezi / Kristo Floqi; mbl. e përgat. për bot. Henrik Kaçulini.
– Durrës : Jozef, 2026
558 f. ; 14,5 x 20,5 cm.
ISBN 9789928942173
I. Kaçulini, Henrik (përgatitës, mbledhës)

1.Letërsia shqipe 2.Poezia
3.Përmbledhje (antologji)

821.18 -1 -82